

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave të edukimit

Viti LXXI (71)

2021

Shkodër, 2021

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Gëzim DIBRA
Sekretar shkencor - Prof. dr. Fatmir VADOHEJ
Anëtarë –Prof. dr. Mimoza PRIKU, prof. as. dr. Fatbardha Osmanaga,
prof.as.dr. Arjana Striniqi, prof. as.dr. Dhurata Hoxha, dr. Eranda
HALLUNI, dr. Visar DIZDARI, dr. Besara KADIU

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave të Edukimit
Tel/fax: 0035522243747

PASQYRA E LËNDËS

Eranda HALLUNI, Fatmir VADOHEJ

Rrjetet profesionale në funksion të zhvillimit profesional të mësuesve në arsimin parashkollor

Professional networks in function of professional development of pre-school teachers.....5

Brilanda LUMANAJ

Prindërimi pozitiv dhe aspekte praktike të zbatimit të tij

Positive parenting and practical aspects of its implementation.....19

Erika BEJKO, Rudina RAMA

Varfëria urbane dhe përjashtimi social

Urban poverty and Social Exclusion.....31

Ambera DUKA, Shqipe HAXHIHYSENI

Teknologjia digjitale në ndihmë të përshtatjes së mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse

Digital technology assisting teaching adaptation to inclusive education.....45

Lediana XHAKOLLARI, Adelina KAKIJA, Entela Xhakollari

Balanca emocionale për një shëndet të mirë

Emotional balance for good health61

Elona HASMUJAJ

Prevalenca e varësisë nga interneti në periudhën e pandemisë Covid -19 te studentët e universiteteve shqiptare

Prevalence of internet addiction during COVID-19 pandemic among students of Albania's universities.....71

Migena HAXHI

Të drejtat e personave me probleme të shëndetit mendor brenda sistemit Penitenciar

The rights of people with mental health problems within penitentiary system ...83

Bujanë TOPALLI, Stelina SHABI, Shërbimet sociale në qendrat ditore <i>Pak</i> Rasti: Banda Muzikore “ <i>The Door-Albania</i> ” <i>Day care social services for people with disability</i> (<i>Case of musical band “The door – Albania”</i>).....	97
Suela KUSI DRITA, Zyhrada KONGOLI Ndërmarrjet sociale:si një mekanizëm aktiv i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Shqipëri <i>Social enterprises: an active mechanism to ensure the social protection and social</i> <i>inclusion in Albania.</i>	107
Shkëlqim XEKA, Arjana MUÇAJ Bashkimi Evropian dhe e drejta për një jetë familjare në ditët e sotme <i>The European Union and the right to a family life nowadays.....</i>	123
Silvana LULASHI Puna sociale në shkolla. Roli i punonjësit social në shkolla dhe perceptimet rreth këtij roli <i>The role of the social worker in schools and perceptions about</i> <i>this role. (Case of Shkodra).....</i>	145
Agron TELI, Aida GEGA Përmirësimi i metodologjisë në mësimdhënie për nivele të ndryshme në klasa kolektive. (Rasti i shkollës Baks-Rrjoll-Drap Lezhë) <i>Improving teaching methodology for different levels in collective classrooms. (The</i> <i>case of the school Baks-Rrjoll-Drap Lezha).....</i>	155
I. Botime <i>Publishing.....</i>	173

RRJETET PROFESIONALE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Eranda Halluni (Bilali), Fatmir Vadohej

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Mësuesisë"

ABSTRAKT

Rrjetet profesionale janë një nga format më efektive të zhvillimit profesional në nivelin lokal. Mësuesit, pjesë e rrjetit, kanë përfitime në drejtim të rritjes dhe zhvillimit profesional. Në pesë vitet e fundit, Shqipëria ka krijuar struktura për të mbështetur këtë lloj rrjeti profesional. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë rolin e rrjeteve profesionale në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit parashkollor. Dizajni i kërkimit cilësor u përpoq të identifikonte perceptimet e 4 drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin parashkollor. Të dhënat u mblodhën me anë të vlerësimit të raporteve, intervistave gjysmë të strukturuar dhe një fokus grupi. Rezultatet treguan se ekziston një perceptim i përgjithshëm pozitiv midis të gjithë drejtuesve që rrjeti profesional është një strategji e mirë për të lehtësuar të mësuarit bashkëpunues midis mësuesve dhe për të ndihmuar ato në zbatimin e praktikave inovative të të nxënit. Sipas tyre, burimet e trajnimeve duhet të azhornohen në mënyrë që të sigurojnë një sasi trajnimesh të përshtashme dhe cilësore për mësueset e edukimit parashkollor bazuar në përparësitë e zhvillimit profesional të tyre.

Fjalë kyçe: rrjete profesionale, zhvillim profesional, përfitime, vështirësi.

Professional networks in function of professional development of pre-school teachers

ABSTRACT

Professional learning networks are one of the most effective forms of professional development in local level. Teachers, as part of a network,

have benefits in terms of growth and professional development. In the last five years, Albania has established structures to support this type of professional network. The purpose of this study is to evaluate the role of professional learning networks related to the professional development of pre-school teachers. The qualitative research design attempted to identify the perceptions of 4 network learning leaders in pre-school teachers. Data were collected by means of reports assessment, semi-structured interviews and a focus group. The results showed that there is a positive general perception among the all network learning leaders that Professional Learning Network is a good strategy to facilitate collaborative learning among teachers and help to implement learning innovations practices in the classrooms. According to them Professional Learning Network training resources should be updated in order to provide an adequate qualitative amount of trainings to pre-school teachers based on their professional development priorities.

Key words: Professional learning networks, professional development, benefits, challenges.

Hyrje

Në arsimin parauniversitar po zbatohet kurrikula e re mësimore bazuar në kompetenca. Kjo kërkon ndryshimin e rolit të mësuesit dhe të shkollës si dhe pritshmëritë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca kërkon mësues cilësorë dhe të aftë për të lehtësuar të nxënit e nxënësve të tyre, të përkushtuar ndaj tyre dhe nevojave të tyre, si dhe t'iu sigurojë atyre strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënit më efektiv. Rritja e cilësisë së mësimdhënësve është një faktor kyç në atë që e bën shkollën të suksesshme dhe është rruga më e rëndësishme për të përmirësuar rezultatet e nxënësve (OECD 2009).

Në këtë kontekst me rëndësi është zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësueseve të arsimit parashkollor dhe drejtueseve për të pasur një arsim cilësor dhe një mësimdhënie efikase. Ai përfshin një seri veprimtarish dhe procedurash që përcaktojnë shkallën e zgjidhjes së problemeve profesionale me kompetencën e duhur dhe sidomos aftësitë e tyre mësimdhënëse. Sipas Kremer (1988), qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit profesional të mësuesve është që të mbrohet dhe të përmirësohet cilësia e mësimdhënies, me synimin që mësuesit të bashkëpunojnë për të përmirësuar praktikat mësimore në klasë.

Një nga format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë sipas udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017. “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” janë rrjetet profesionale.

Metodologjia e studimit

Qëllimi i studimit është të vlerësojë rolin e rrjeteve profesionale në zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit parashkollor. Pyetjet kërkimore të parashtruara për studim përfshijnë:

- a) Si realizohet dhe perceptohet funksionimi i rrjeteve profesionale në arsimin parashkollor?
- b) Cilat janë benefitet e rrjeteve profesionale në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit parashkollor?
- c) Cilat janë vëshirësitë që drejtueset e rrjeteve përballen në organizimin e takimeve?

Qasja hulumtuese e përzgjedhur për t’u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit është ajo cilësore. Në këtë studim u përfshinë 4 drejtuese të rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si pjesë e ZA-së Shkodër.

Fazat e studimit.

Fazat nëpër të cilat është hartuar, zhvilluar dhe konkluduar ky studim janë të paraqitura si më poshtë:

Faza e parë: Njohja e situatës.

Faza e parë e studimit ka pasur në fokus të saj hulumtimin me kuadrin teorik që ekzistonte në lidhje me formimin e rrjeteve profesionale në arsimin parauniversitar (specifikisht arsimin parashkollor) në Shqipëri. Gjatë kësaj faze u shqyrtuan dhe u analizuan paralelisht udhëzimet e MASR-së; akte ligjore dhe nënligjore të politikës arsimore dhe raportet. Kjo fazë siguroi një bazë të rëndësishme për pjesën e hartimit të dizajnit të kërkimit.

Faza e dytë: Hartimi i projektit të kërkimit.

Kjo fazë e dytë e studimit u orientua drejt hartimit të dizajnit të kërkimit, qëllimit, objektivave, pyetjeve kërkimore, përcaktimin e kampionit, kohëzgjatja e studimit, përcaktimin e teknikave të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Qasja hulumtuese e përzgjedhur për t’i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit është ajo cilësore. Sipas Willig. C. (2013) kërkimi cilësor lidhet me mënyrën se si njerëzit i japin kuptim botës si dhe përvojave të tyre në jetë dhe kjo është shumë e rëndësishme për t’u referuar edhe në këtë studim, pasi teorizimi i subjekteve do të realizohet brenda kontekstit ku ato ndërveprojnë.

Faza e tretë: Përzgjedhja e kampionit.

Gjatë fazës së tretë të studimit, kampioni është përzgjedhur duke përdorur strategjinë e kampionimit jo me probabilitet, kampioni i qëllimshëm (mbi bazën e gjykimit). Në këtë studim u përfshinë 4 drejtuese të rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si pjesë e ZA-së Shkodër. Arsyeja e përzgjedhjes së drejtuesve të rrjeteve profesionale u bazua si një përpjekje e vetëdijshme nga ana e studiuseve për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit. Rikujtojmë që roli i drejtuesve ka disa funksione sipas Udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017, të MASR, *“Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”* të cilat janë si më poshtë:

Drejtuesi i rrjetit: a) harton në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të rrjetit planin vjetor të veprimtarisë së rrjetit; b) ka përgjegjësi për zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit, nëpërmjet organizimit e përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit; c) organizon dhe drejton takimet e rrjetit me një tematikë të caktuar; d) realizon takime të rrjetit dhe përcjell informacionet që merr nga institucione të tjera si DAR/ ZA-te, IZHA, ISHA, AKP-ja etj.; e) plotëson listën e pjesëmarrësve me nënshkrimin e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i DAR/ ZA-së; f) përgatit raport të shkurtër për çdo takim të rrjetit, si dhe raport vjetor për veprimtarinë e rrjetit përkatës. Drejtuesi i rrjetit luan edhe rolin e trajnerit për tematika të ndryshme në rrjetin që ai drejton.

Kampionimi i qëllimshëm është një prej llojeve të kampionimit pa probabilitet i cili bëhet në momentin kur vendimi për përfshirjen e pjesëmarrësve merret nga kërkuesi, bazuar në një ose disa karakteristika të caktuara të tilla, si: njohuria e specializuar për çështjen e marrë në studim ose kapaciteti e gatishmëria për të marrë pjesë në studim (Jupp,2006). Pjesëmarrësit përzgjidhen mbi bazën e karakteristikave apo përvojave që lidhen drejtpërdrejt me fushën e interesit dhe pyetjet e studimit, të cilat i lejojnë studiuesit ta studiojë temën në thellësi. Rastet e zgjedhura janë ato që mund të zbulojnë dhe të hedhin sa më shumë dritë mbi fushën e studimit (Matthews & Ross, 2010). Duke analizuar udhëzimin përkatës, drejtuesit e rrjeteve kanë peshën më të madhe dhe kryesore të përgjegjësive të realizimit të takimeve në rrjet, por edhe të raportimit të tyre si një zë përfaqësues i nevojave të mësuesve për zhvillimin e tyre profesional.

Faza e katërt: Mbledhja e të dhënave

Faza e katërt ishte faza aplikative e studimit. Ky studim u realizua përgjatë vitit shkollor 2020-2021. Në fillim të vitit shkollor me lejen e ZVA Shkodër u mundësua kontakti me drejtueset e rrjeteve profesionale të arsimit parashkollor. Drejtuesve iu shpjegua qëllimi i studimit, dizajni i kërkimit, mënyra se si do mblidheshin të dhënat, çështjet etike gjatë

studimit dhe se si do të përdoren të dhënat gjatë përfundimit të studimit. Kjo fazë pati disa etapa.

Etapa I: Intervista gjysmë e strukturuar.

Në këtë etapë u realizuan intervista gjysmë të strukturuar me secilën drejtuese të rrjetit. Bazë për strukturimin e pyetjeve të intervistës ishte analiza e udhëzimeve të MASR-së; akte ligjore dhe nënligjore të politikës arsimore dhe raportet. Kjo lloj interviste mundëson fleksibilitet dhe lirshmëri në mbledhjen e të dhënave në kontekstin dhe realitetin që ndërveprojnë pjesëmarrësit. Pikërisht për këtë arsye u përzgjedh ky instrument në mënyrë që t'u lejojë pjesëmarrësve t'u përgjigjen pyetjeve dhe të diskutojnë për çështjet në mënyrën se si ata dinë të shprehen, të lejojë studiuesin që të eksplorojë çështjet me pjesëmarrësit, të nxisë pjesëmarrësit të shprehin opinionet dhe ndjenjat e tyre, të jetë fleksibël dhe e përshtatshme për pjesëmarrës të ndryshëm, të garantojë që me secilin pjesëmarrës të diskutohen të njëjtat aspekte të temës së hulumtimit (Matthews & Ross, 2010).

Intervista gjysmë e strukturuar përmbush qëllimin e kërkimit, pasi nxit dhe inkurajon pjesëmarrësin të flasë në thellësi për përvojat dhe opinionet e tij, si dhe eksploron arsyet e sjelljeve apo qëndrimeve të tyre ndaj çështjeve të caktuara. Struktura e intervistës përfshinte pyetje për të dhënat demografike, pyetje rreth njohurive që ka respondentit për temën që po hulumtohet, pyetje nga eksperiencia, pyetje për opinionet që ka respondentit rreth çështjes, pyetje se si ai ndjehet ndaj çështjes, pyetje për ndjesinë që krijon fenomeni i përjetuar.

Etapa II: Analiza tematike e relacioneve.

Pasi u zhvilluan intervistat individuale me drejtuesit e rrjeteve u analizuan transkriptet. Pastaj u analizuan raportet përmbledhëse dhe planet vjetore për takimet që kanë zhvilluar. Analiza u fokusua te temat e takimeve, rezultatet dhe sugjerimet që mësueset e edukimit parashkollor jepnin çdo takim në lidhje me tematikën në raport me zhvillimin e tyre profesional. Kjo analizë na ndihmoi që të strukturonim guidën për fokus grupin që do të zhvillohej me katër drejtueset.

Etapa III: Fokus grupi.

Në këtë etapë drejtueset diskutuan rreth përfitimeve dhe vështirësive të cilat ato ishin ndeshur përgjatë viteve në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale. Intervista e fokus grupit lejon që pjesëmarrësit të pyeten për perceptimet, mendimet, besimet dhe qëndrimet e tyre për një temë dhe situata të caktuara. Gjatë fokus grupit u diskutuan sfidat për të hartuar dhe realizuar takimet, benefitet që mendonin se mësueset përfitonin, si e

vlerësonin dobishmërinë e takimeve të këtij viti në krahasim me vitet e tjera për shkak të pandemisë etj.

Faza e pestë: Analizimi terësor i të dhënave

Temat dhe nëntema relevante për pyetjet kërkimore u caktuan dhe u përfaqësuan sipas citateve që janë zgjedhur për t'u paraqitur në seksionin e gjetjeve. Ky proces u përsërit për çdo intervistë në mënyrë për të kapur gjerësinë e plotë dhe diversitetin e pikëpamjeve dhe përvojave të drejtuesve (Ritchie & Leëis, 2003). Faza përmbyllet me dhënien e rezultateve dhe rekomandimet përkatëse.

Ku bazohet veprimtaria e rrjetit profesional? Cila është baza ligjore? Cili është dokumentacioni mbi të cilin ngrihet veprimtaria e funksionimi i tij?

Në udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017, "*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*", në Nenin 3 "*Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë*", thuhet: "Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë: a) zhvillimi i brendshëm profesional; b) trajnime c) rrjetet profesionale; d) këshillime e) kurset afatshkurtra dhe kurset afatgata."

Po në këtë udhëzim në Kreun XII "*Rrjetet profesionale*", Neni 37 përcakton qëllimin e ngritjes së rrjeteve profesionale: "Rrjeti profesional ngrihet në nivel DAR/ZA-ve dhe ka për qëllim zhvillimin profesional të punonjësve të institucioneve arsimore përmes informimit, këshillimit, trajnimit, shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve të anëtarëve të tij për tematika të punës së tyre të përditshme".

Po në këtë udhëzim në Nenin 38 "*Pjesëmarrja në rrjet*": 1. Në një rrjet profesional (rrjet), bëjnë pjesë punonjës arsimorë, si më poshtë: a) drejtues të shkollave; b) mësues të arsimit fillor; c) mësues të një lënde në një nivel arsimor; d) mësues të së njëjtës fushë të nxëni në një nivel arsimor; e) mësues kujdestarë etj. 2. Anëtarët e rrjetit, që e kanë të mundur, formojnë gjithashtu, një rrjet në internet, nëpërmjet të cilit, ndërmjet dy takimeve të rrjetit, shkëmbejnë përvoja, parashtrojnë pyetje dhe marrin përgjigje nga kolegë.

Neni 39 përcakton "Takimet e rrjetit ": 1. Në çdo takim të rrjetit shtjellohet një temë për praktikën e punës së përditshme, e cila planifikohet nga drejtuesi i rrjetit në bashkëpunim me anëtarët e tij; 2. Gjatë një viti shkollor, sipas rolit të tij, një rrjet mund të takohet disa herë në një vit shkollor, por jo më pak se një herë në muaj; 3. Në varësi të tematikave të rrjetit shpeshësia e takimeve përcaktohet nga DAR/ZA-ja; 4. Takimet e një rrjeti

zhvillohen në mjediset e një institucioni arsimor ose mund të organizohen edhe online nëpërmjet forumeve.

Ndërsa Neni 42 "Përgjegjësitë e drejtuesit të rrjetit": Drejtuesi i rrjetit: a) harton në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të rrjetit planin vjetor të veprimtarisë së rrjetit; b) ka përgjegjësi për zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit, nëpërmjet organizimit të përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit; c) organizon dhe drejton takimet e rrjetit me një tematikë të caktuar; d) realizon takime të rrjetit dhe përcjell informacionet që merr nga institucione të tjera, si: DAR/ ZA-te, IZHA, ISHA, AKP-ja etj.; e) plotëson listën e pjesëmarrësve me nënshkrimin e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i DAR/ ZA-së; f) përgatit raport të shkurtër për çdo takim të rrjetit, si dhe raport vjetor për veprimtarinë e rrjetit përkatës. Drejtuesi i rrjetit luan edhe rolin e trajnerit për tematika të ndryshme në rrjetin që ai drejton.

Për realizimin e studimit pas konsultimit me bazën ligjore të ngritjes dhe funksionimit të rrjeteve profesionale, puna jonë u përqendrua në analizimin e dosjeve të drejtuesve të rrjeteve profesionale, rezultatet e së cilës po i prezantojmë më poshtë:

Tabela 1. Database e rrjetit të arsimit parashkollor.

Emri mbiemri	Gjinia	Shkolla	Institucioni arsimor ZVA	Njësia administrative	Pozicioni	Lënda	Cikli	Kategoria	Nr. i tel	Email

Siç edhe shihet nga tabela, database na jep një informacion të detajuar mbi pjesëmarrësit e rrjeteve profesionale.

Tabela 2. Të dhëna për rrjetet profesionale, arsim parashkollor.

Drejtues Rrjeti	Total	Meshkuj	Femra	Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III	Kategoria IV	Kopshtet që mbulon
AB	24	-	24	7	9	5	3	Kopshti Muriqan, "Hasan Dardhanjori", Zogaj, Shirokë, Ajasëm, Liria, Njësia Ana e Malit, Elbacë, Oblikë, Koplik, "Bep Tusha "Aneksi lagje

								1,
AR.B	30	-	30	17	6	3	4	Dobraç, Mes, Mes-Myselim, Guci e Re, Shtoj i Vjetër, Shtoj i Ri, Hot i Ri, Kullaj, Dragoç, Drisht, "F. Barbullushi", "A. Laçej", "1 Qershori", "T. Alimhilli", "Ngjyrat"
ML	34	-	34	14	7	6	7	"Ngjyrat", Veterinare, "Edith Durham", "D. e Prishtinës", "N. Mazi", "P. Vasa", "T. Alimhilli", "A. Hajdari", Golem, Shirq
AM	38	-	38	20	9	5	4	"I.S.Bruçaj", "F. Barbullushi", "A. Hajdari", "I. Qemali", "Xh. Jukni", Gur i Zi, Vukatanë, Rrenc, Kuç, Gjuhët e Huaja, Grudë e Re, Bardhaj, Trush, Bërdicë e Sipërme, Zues
	126	-	126	58	31	19	18	

Kjo tabelë na jep një informacion më të detajuar në lidhje me numrin e mësuesve të përfshirë në këto rrjete profesionale, ndërtimin, raportin meshkuj/femra, kategoritë që i përkasin mësuesit e përfshirë në të etj. Konkretisht, numri i mësuesve pjesëmarrës në rrjet varion nga 24 deri 38 persona. Të gjithë mësuesit janë femra (N=126). Numrin më të madh e përbëjnë mësueset që i përkasin kategorisë së parë (N=58), më pas renditen mësueset që i përkasin kategorisë së dytë (N=31). Mësueset që i përkasin kategorisë së tretë (N=19) janë në një numër gati të barabartë me ato mësuese që i përkasin kategorisë së katërt (N=18). Rrjetet profesionale, siç tregohet edhe nga tabela, mbulojnë kopshte të fshatit edhe të qytetit.

Tabela 3. Struktura e planit vjetor të drejtuesit të rrjetit profesional.

Tematikat e takimit rrjetit	Rezultatet e pritshme	Veprimtaritë	Personi përgjegjës për realizimin e veprimtarisë	Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë

Në këtë tabelë pasqyrohet struktura e planit vjetor të drejtuesit të rrjetit. Në rubrikën "*Tematikat e takimeve të rrjetit*" drejtuesit në bashkëpunim me mësuesit kanë hartuar tematikat sipas interesit dhe nevojave të tyre.

Në rubrikën "*Rezultatet e pritshme në përputhje me secilën tematikë*", drejtuesit kanë përcaktuar edhe rezultatet e pritshme në fund të takimit.

Në rubrikën "*Veprimtaritë nga drejtuesit e rrjetit*", janë përcaktuar të gjitha veprimtaritë që do të zhvillohen për realizimin e tematikave, përgatitjen e materialeve për takimin e rrallës, përcaktimin e ditës, orës dhe vendit, si dhe hartimin e raportit për ecurinë e takimit.

Në rubrikën "*Personi përgjegjës për realizimin e veprimtarisë*", janë përcaktuar personat të cilët do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë në përputhje me tematikën. Për t'u theksuar është fakti se në të gjitha takimet është vetëm drejtuesi i rrjetit përgjegjës për realizimin e veprimtarive.

Në rubrikën "*Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë*", përcaktohet qartë java (kryesisht java e fundit e muajit), vendi dhe ora e zhvillimit të takimit.

Një tjetër dokument mjaft i rëndësishëm, pjesë e dosjes së rrjetit profesional, është edhe "*Raporti i takimit të rrjetit profesional*". Ky dokument përmban rubrika të tilla, si: *Data e takimit; Tema e takimit-vendoset data e zhvillimit të takimit; Drejtuesi/ emri i drejtuesit të rrjetit;*

Rrjeti- Arsim parashkollor; *Numri i anëtarëve në rrje t*- numri i anëtarëve sipas database *Numri i anëtarëve present* - numri i anëtarëve pjesëmarrës në takim; *Rezultatet e pritshme* - renditen rezultatet sipas rezultateve të përcaktuara edhe në planin vjetor; *Çështje të diskutuara në takim*-këtu janë të përcaktuara të gjitha çështjet e lidhura me tematikën; *Materiale burimore* - drejtuesit kanë përcaktuar materialet burimore të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarive; *Sugjerime e rekomandime* - në këtë rubrikë janë vendosur sugjerimet dhe rekomandimet e shprehura nga mësuesit në fletën e vlerësimit.

Rezultatet e studimit

Tabela 4. Tematikat e takimeve të rrjeteve profesionale.

Nr.	TEMATIKAT	AB	AB	ML	AM
1.	Diskutim mbi njohuritë tematike të marra nga viti i kaluar	X	X	X	X
2.	Vlerësimi në AP. Planifikim për vlerësim.	X	X	X	X
3.	Vlerësimi diagnostikues.	X	X	X	X
4.	Bashkëpunimi me prind, me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht e shtëpi të plotësojnë e përforcojnë njëra - tjetrën.	X	X	X	X
5.	Portofoli i të nxënësve	X	X	X	X
6.	Vlerësimi tremujor i regjistrit.	X	X	X	X
7.	Vlerësimi përmbljedhës i regjistrit.	X	X	X	X
8.	Mjete dhe strategji vlerësimi.	X	X	X	X
9.	Përmbledhje e vlerësimit.	X	X	X	X

Siç edhe shihet nga tabela tematikat e trajtuara në takimet e rrjetit janë të lidhura direkt me ato problematika që shqetësojnë mësuesit në veprimtarinë e tyre të përvitshme. Tematikat më të trajtuara në takimet e rrjeteve profesionale janë ato të lidhura me hartimin e planit mujor, hartimin e planit ditor, vlerësimi diagnostikues në arsimin parashkollor, portofoli i të

nxënit, vlerësimi tremujor i regjistrit, vlerësimi përmbledhës i regjistrit, mjete dhe strategji vlerësimi etj.

Në planin vjetor të drejtuesit të rrjetit rrezultatet e pritshme janë të përcaktuara dhe i përshtaten çdo tematike. Në rubrikën "Veprimtaritë" drejtuesit, në përputhje me tematikat e përcaktuara, të cilat përcaktojnë ditën dhe orën për secilin takim, materialet për takimin, diskutime sipas tematikave, organizimin e takimit, hartimin e raportit për ecurinë e takimit. Në rubrikën "Personi përgjegjës" kemi të shënuar vetëm emrin e drejtuesit të rrjetit, i cili përgatit materialet për çdo takim. Në rubrikën "Afati kohor" nga drejtuesit është përcaktuar java e takimit, vendi dhe ora e zhvillimit. Nga analiza e planeve vjetore në këtë rubrikë vërehet se takimet e rrjetit janë përcaktuar të zhvillohen javën e fundit të çdo muaji, në ditën e premte. Gjithashtu takimet zhvillohen pas përfundimit të procesit mësimor, ora 16.00, si dhe vendi ku do mbahen takimet e rrjetit: Kopshti "Ismet Sali Bruçaj", "Njomzat", "Bep Tusha" dhe "Ngjyrat".

Në raportet e takimeve marrim të dhëna në lidhje me pjesëmarrjen e mësuesve në takimet e rrjetit. Pjesëmarrja në këto takime është relativisht e lartë. Rezulton një pjesëmarrje që varion nga 90-94% e mësuesve. Kjo justifikohet me faktin se një pjesë e takimeve të rrjetit janë zhvilluar online dhe mund të ketë pasur problematika me internetin, ose edhe me orarin e zhvillimit të takimit të rrjetit. Gjithashtu në raportet e takimeve informohemi me atë se çfarë i shqetësojnë mësuesit në punën e tyre, si: *Si ta ndërtojme portofolin e të nxënit? Si të punojmë me fëmijë me aftësi ndryshe? Cilat janë ushtrimet që mund të bëj me fëmijët me ç'rregullime të sjelljes si ta vlerësoj fëmijën? A duhet ta vlerësojmë fëmijën me nivele? A mund të kemi një plan vjetor model sipas periudhave? A mund të hartohen tekste në mbështetje të planifikimit dhe mbarëvajtjes së punës në klasë? Si mund të bëjmë vëzhgimin e fëmijës, në cilin moment të ditës është më eficient, e lidhur kjo me kompetencat që ka fituar fëmija.*

Në raportet e takimeve gjejmë edhe rekomandime të nevojshme për veprimtarinë e mësuesve: *"Prania e psikologut në kopshte konsiderohet një domosdoshmëri; të hartohen tekste edhe për arsimin parashkollor, pasi lehtësojnë punën e mësuesit; të hartohen plane model; të bëhen pjesë e rrjetit edhe psikologët; të ftohen në takimet e rrjetit edhe prindërit; të ftohet psikologu; të ftohet logopedi etj.*

Të dhëna të grumbulluara nga fokus grupet.

1. A mendoni se zhvillimi profesional është i rëndësishëm dhe si e vlerësoni ndikimin e tij te mësuesit?

Drejtuesit e rrjeteve profesionale ndajnë të njëjtin mendim: "Zhvillimi profesional është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për mësuesin. Nëpërmjet zhvillimit profesional mësuesi rrit dhe përsos aftësitë e tij arsimore, mundëson qasjen e tij me risitë dhe është

bashkëkohor në fushën e mësimdhënies dhe edukimit.” Ata vlerësojnë “Zhvillimi profesional ka një ndikim të lartë tek mësuesit, ndikim i kushtëzuar nga ndryshimi i kërkesave të fëmijëve, përballimi më me sukses i sfidave që përmban procesi mësimdhënës dhe i nxënies, përshtatja e mësuesve me ndryshimet në sistemin arsimor”.

2. Pjesëmarrja në rrjetet profesionale a sjell përfitime për mësuesit në aspektin e rritjes dhe të zhvillimit të tyre profesional?

“Pjesëmarrja e mësuesve në rrjetet profesionale sjell përfitime në aspektin e rritjes dhe zhvillimit profesional të tij, pasi shkëmbehen eksperiencat dhe përvoja të ndryshme, nga të cilat gjithmonë ka përfitime. Gjithashtu rrjeti profesional bashkon punonjësit arsimorë me interesa të përbashkëta. Asnjë nga drejtuesit nuk mendon se pjesëmarrja e mësuesve në rrjetet profesionale nuk u shërben fare ose u shërben pak në zhvillimin profesional”.

3. A janë përshtatur dhe si ndihen mësuesit me ndryshimin e kurrikulës?

“Sa i takon përshtatjes me kurrikulën, drejtueset e rrjeteve mendojnë se mësuesit kanë patur vështirësi, ku vështirësitë më të mëdha janë në zbatimin e kurrikulës, në përshtatjen me terminologjinë e re, të kuptuarit e saj, në mënyrën e re të vlerësimit etj. Pjesëmarrja në rrjete ka bërë që këto risi të diskutohen e të kuptohen, pasi bëhet fjalë për dokumentim dhe mësimdhënie”.

4. Sa i ndihmojnë mësuesit rrjetet profesionale në informimin dhe këshillimin në lidhje me risitë dhe zhvillimet në fushën e reformave në arsimin parashkollor?

“Drejtueset e rrjeteve profesionale shprehen se duke njohur mirë legjislacionin që ka të bëjë jo vetëm drejtpërdrejt me mbarëvajtjen dhe veprimtaritë në rrjet, qëndrojnë në kontakt të vazhdueshëm me materialet, udhëzuesit dhe produktet që MAS dhe ACAP ofron në dobi të funksionimit të rrjeteve. Të gjitha këto diskutohen në takimet mujore që zhvillohen. Gjithashtu ato theksojnë se aftësitë drejtuese, menaxhuese, idetë novatore, qëndrimi etik dhe aftësitë komunikuese me kolegët, korrektesia në kryerjen e detyrave, gatishmëria për të bashkëpunuar me kolegë, aftësitë profesionale të transmetimit saktë dhe qartë të informacionit shkencor dhe didaktik të kolegët gjatë takimeve, çon në mirëfunksionimin e rrjetit”.

5. Një pikë shumë e rëndësishme në trajtimin e kësaj teme është edhe evidentimi i nevojave që mësuesit kanë për përmirësimin e punës së tyre në ushtrimin e profesionit duke qenë vazhdimisht në koherencë me risitë. Për këtë shërbeu pyetja se “Cilat tematika janë në interes të mësuesit për të diskutuar në rrjetet profesionale?

“Drejtuesit e rrjetit janë shprehur që mësuesit kanë shumë interes në diskutimin e tematikave të tilla, si: Etika dhe Komunikimi, Plani tremujor, mujor, javor dhe ditor sipas kurrikulës së re, Kompetencat, Vlerësimi i fëmijëve, Zgjidhja e një situatë konflikti në grup (praktika e punës)etj”.

“Njëra nga drejtueset shprehet referuar vitit të vështirë gjatë pandemisë Covid -19 që u përballëm me një realitet krejtësisht të pakëndshëm na mësoi platforma të reja ku gjetëm mundësinë të mbajmë lidhje me vogëlushët tanë dhe tematika kryesore ishte: Çfarë mund t'i mësojmë dhe si mund t'ua mësojmë fëmijëve veprimtaritë e planifikuara?”

6. Sa i realizueshëm është feedback-u i takimeve në rrjetin profesional në punën e përditshme të mësuesve?

Kësaj pyetjeje drejtuesit ndonëse shprehen se është "Plotësisht i realizueshëm, pasi fokusi i takimeve të tyre në rrjetin profesional është puna e tyre e përditshme, por ato vënë theksin se kjo varet edhe nga përkushtimi i mësuesit".

7. Me çfarë sfidash janë përballur drejtuesit e rrjeteve profesionale në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19?

Njëra nga drejtueset shprehet: "Pandemia Covid-19 na përballi me shumë sfida, por ajo që ishte më e rëndësishmja, pamundësia e takimeve të grupit fizikisht për shkak të protokollit të masave. Shumë mësuese kishin vështirësi në përdorimin e rrjeteve sociale. Jemi përprjekur të zhvillojmë takime me grupe të vogla, por që nuk e kanë dhënë rezultatin e pritshëm". Ndërsa një tjetër drejtuese thotë: "Si çdo veprimtari tjetër pandemia në fillim e paralizoi edhe funksionimin e rrjeteve profesionale, por zhvillimi online i mësimit bëri që edhe rrjeti të funksiononte në mënyrë të tillë, megjithë vështirësitë e dala (mungesë interneti, celulari, kushte fizike të papërshtatshme etj.)."

8. Si e vlerësoni dobishmërinë e takimeve të këtij viti në krahasim me vitet e tjera për shkak të pandemisë?

"Drejtuesit shprehen se takimet e realizuara në vitin akademik 2020-2021 janë realizuar në kushtë me të vështira se vitet e tjera, por interesimi ka qenë i madh, pasi edhe vështirësitë kanë qenë të mëdha. Në situatën e krijuar, ato janë bërë më të vetëdijshëm për ndryshimet e kurrikulës, kanë kuptuar se pjesëmarrja në takime, shkëmbimi i eksperiencave sjell përmirësimin e cilësisë në punën e tyre, por ka shumë për të bërë."

PËRFUNDIME

Rezultatet e studimit treguan se ngritja dhe funksionimi i rrjetit profesional bazohet në udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017, "Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë".

Rrjetet profesionale, si një nga format e zhvillimit profesional të mësuesve, shihen si domosdoshmëri dhe nevojë për mësuesit e arsimit parashkollor. Nëpërmjet zhvillimit profesional mësuesi rrit dhe përsos aftësitë e tij arsimore, mundëson qasjen e tij me risitë dhe është bashkëkohor në fushën e mësimdhënies dhe edukimit.

Roli i rrjeteve është konsideruar jo vetëm i nevojshëm, por edhe shumë efektiv. Veprimtaria e tyre mbështetet në interesat dhe nevojat e mësuesve në shumë aspekte. Takimet e rregullta të përbashkëta me mësuesit, niveli i bashkëpunimit, klima pozitive, diskutimet konstruktive, krijimi i një ambienti në të cilin mësimdhënësit shkëmbejnë informacionet, ndajnë përvojat me njëri-tjetrin, janë tregues të funksionimit dhe të parit të tyre si vendi ku mund të ndajnë shqetësimet dhe arritjet e tyre.

Tematikat si hartimi dhe diskutimi i planit mujor dhe ditor, vëzhgimi dhe vlerësimi i nxënësve, përgatitja e portofolit të të nxënësve, bashkëpunimi me prindërit, plotësimi i dokumentacionit, janë mjaft interesante, të cilat ndihmojnë mësuesit e arsimit parashkollor në realizimin e mësimit, në realizimin me cilësi të kurrikulës dhe në vlerësimin e zotërimit të kompetencave të fëmijëve.

Pjesëmarrja e lartë e mësuesve të arsimit parashkollor dëshmon se ka patur interes për këto takime, gjithashtu edhe tematikat janë në funksion të vështirësive dhe problemeve të hasura gjatë punës së tyre të përditshme. Tematikat e propozuara dhe të trajtuara dëshmojnë se dobishmëria dhe vlera e tyre ka qenë akoma më e madhe në kushtet e pandemisë COVID-19.

REKOMANDIME

Stimulimi i mësuesve të arsimit parashkollor përmes shtimit të numrit të krediteve do t'i shërbente më mirë motivimit, efektivitetit dhe cilësisë dhe mbarëvajtjes së punës në rrjet.

Fakultetet e Shkencave të Edukimit, psikologu dhe logopedi të jenë pjesë e rrjeteve profesionale në funksion të bashkëpunimit më të mirë kopshte-universitet.

Ngritja e qendrave në funksion të rrjeteve profesionale, të cilat të shërbejë jo vetëm për takimet, por edhe për përhapjen e përvojave pozitive si për mësuesit e arsimit parashkollor anëtarë të rrjeteve profesionale, ashtu për mësuesit e arsimit parashkollor praktikantë.

BIBLIOGRAFIA

- Bridges, E. M. (1996). Evaluation for tenure and dismissal. In Millman, J. & Darling Hammond, L. (Eds.), *The New Handbook of Teacher Evaluation* (pp. 147-157). Neëbury Park: Sage Publications.
- European Commission (2012a). *Supporting the Teaching Professions for Better Learning Outcomes*. Strasbourg, 20.11.2012. SËD (2012) 374 final.
- European Commission (2013a). *Supporting teacher competence development for better learning outcomes*. Brussels: EC.
- European Commission/EACEA/Eurydice (2013). *Key Data on Teachers and School Leaders in Europe. 2013 Edition. Eurydice Report*. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- Eurydice (2006). *Quality Assurance in Teacher Education in Europe*. Brussels: EACEA.
- Jupp, V. (2006). *The SAGE dictionary of social research methods* (Vols. 1-0). London,: SAGE Publications, Ltd doi: 10.4135/9780857020116
- Matthews. B, & Ross. L, (2010). "*Metodat e hulumtimit*", Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, Botim i CDE, Tiranë.
- Musset P. (2009). *Initial Teacher Education and Continuing Training Policies in a Comparative Perspective: Current Practices in OECD Countries and a Literature Review on Potential Effects*, OECD Education Working Papers, No. 48, OECD Publishing.
- Ritchie, J., & Leëis, J. (2003). *Qualitative Research Practice—A Guide for Social Science Students and Researchers*. London, Thousand Oaks, CA: Sage Publications Ltd.
- Willig, Carla. *Introducing Qualitative Research in Psychology, 3rd edition*. Maidenhead: Open University Press, 2013.
- Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017, "*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*".

PRINDËRIMI POZITIV DHE ASPEKTE PRAKTIKE TË ZBATIMIT TË TIJ

Brilanda Lumanaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Në kohët e sotme gjithnjë e më tepër prindërimi ngelet një proces i vështirë dhe tepër sfidues. Zhvillimi shoqëror u mundëson fëmijëve të përcaktojnë midis të drejtës dhe të gabuarit në marrëdhëniet e tyre shoqërore. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe prindërit në rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Artikulli është një trajtim teorik i realizuar përmes analizës së studimeve dhe kontributeve të autorëve të ndryshëm si dhe artikujve shkencorë lidhur me prindërimin pozitiv. Artikulli ka si qëllim kryesor të paraqesë fillimisht një vështrim të përgjithshëm të konceptit të prindërimin pozitiv. Punimi, gjithashtu, ka si objektiv të eksplorojë principet kryesore, përfitimet nga prindërimi pozitiv dhe synon të përshkruajë një model praktik tepër bashkëkohor. Artikulli thekson faktin se prindërimi pozitiv është procesi që ndihmon fëmijën dhe adoleshentin të rritet dhe zhvillohet në një atmosferë dashurie dhe mirëkuptimi. Prindërimi pozitiv ndihmon procesin e të mësuarit të fëmijës duke përdorur një disiplinë efektive dhe duke u bazuar në principe dhe elemente të shëndetshme për mirërritjen e fëmijëve. Hulumtime të shumta përshkruajnë programin Triple P si një model efikas me zbatueshmëri në kontekste të ndryshme kulturore, i cili ndihmon prindërit të krijojnë një mjedis të sigurt si dhe promovon marrëdhënie pozitive.

Fjalët kyç: prindërimi pozitiv, principet, përfitimet, implikime praktike, modeli Triple P.

Positive parenting and practical aspects of its implementation

ABSTRACT

Nowadays, parenting remains an increasingly difficult and challenging process. Social development enables children to distinguish between right and wrong in their social relationships. An important contribution in this regard is played by parents in the upbringing and education of children. The article is a theoretical treatment realized through the analysis of studies and contributions of various authors as well as scientific articles related to positive parenting. The main purpose of the article is to present an overview of the concept of positive parenting. The paper also aims to explore the key principles, benefits of positive parenting and aims to describe a highly contemporary practical model. The article emphasizes the fact that positive parenting is the process that helps the child and adolescent grow and develop in an atmosphere of love and understanding. Positive parenting aids the child's learning process by using effective discipline and based on healthy principles and elements for child rearing. Numerous researches describe the Triple P program as an effective model with applicability in different cultural contexts, which helps parents to create a safe environment as well as to promote positive relationships.

Keywords: positive parenting, principles, benefits, practical implications, Triple P model.

Hyrje

Në përgjithësi pranojmë që mjedisi familjar ka një ndikim të fortë në mirëqenien e tanishme dhe zgjedhjet e ardhshme të fëmijëve. Prindërimi i mirë, gjithashtu, ka efekte afatgjata për fëmijët përmes shkollës dhe mirëqenies në adoleshencë dhe moshë të rritur.

Alfred Adler studioi psikologjinë njerëzore në fillim të viteve 1900 kur njerëzit mbanin një këndvështrim shumë tradicional për fëmijët "ata duhet të shihen dhe jo të dëgjohen". Megjithë ndjenjat e zakonshme shoqërore të kohës, Adler pohoi rrënjësisht: "*Fëmijët meritojnë të trajtohen me dinjitet dhe respekt.*" Sot, kjo ndjenjë duket se është pranuar gjerësisht, edhe pse jo gjithmonë praktikohet, por ky mendim ishte antikulturor gjatë kohës së Adlerit. Së bashku me psikiatrin Rudolf Dreikers, Adler argumentoi që fëmijët të trajtohen me respekt, por gjithashtu këshilloi

prindërit që të shmangin llastimin e fëmijëve, sepse krijojnë vetëm çështje më emocionale dhe probleme të sjelljes. Ndërsa këto dy besime mund të jenë kontradiktore për disa, me pak fjalë, prindërimi pozitiv thjesht i nxit prindërit të jenë të dhembshur dhe të vendosur. Ishte kjo ide “prindërit të ishin të dhembshur dhe të vendosur” që çoi Jane Nelsen, për të zhvilluar metodologjinë e disiplinës pozitive të përdorur nga prindërit në të gjithë botën. Kjo ide themelore u bë themeli i prindërimit pozitiv.

Sipas Gray (1999, f. 21) qasjet e mëparshme të prindërimit kishin për qëllim krijimin e fëmijëve të mirë. Prindërimi pozitiv krijon fëmijë të dhembshur, të cilët nuk duhet të kërcënohen për të ndjekur rregulla, por të veprojnë spontanisht dhe të marrin vendime me një zemër të hapur. Qasjet e shkuara të prindërimit ishin të përqendruara në krijimin e nënshtrimit. Prindërimi pozitiv synon të zhvillojë udhëheqës të sigurt, të cilët janë të aftë të krijojnë fatin e tyre, jo vetëm duke ndjekur pasivisht gjurmët e të tjerëve para tyre.

Veçanërisht për kontekstin shqiptar ky artikull vjen si një kontribut teorik për literaturën e lidhur me prindërimin pozitiv. Artikulli, gjithashtu, ndihmon profesionistët e shërbimeve psiko-sociale, që punojnë në sistemin e shërbimeve me fokus fëmijët dhe bashkëpunimin me prindërit, me qëllim krijimin e një panorame më të qartë të kuptimit dhe implikimeve praktike të prindërimit pozitiv. Qëllimi i këtij artikulli është që të përshkruajë fillimisht konceptin e prindërimit pozitiv dhe më tej të paraqesë në mënyrë të përmbledhur disa prej principeve kryesore të këtij procesi si dhe të evidentojë përfitimet e këtij modeli. Në përputhje me qëllimin kryesor, njëkohësisht, do të prezantohet edhe një model bashkëkohor i prindërimit pozitiv.

1. Kuptimi dhe principet kryesore të prindërimit pozitiv

Rritja e fëmijëve është sfiduese. Sfidat dhe realitetet e rritjes së fëmijëve ndryshojnë nga njëri brez në tjetrin. Rritja e fëmijëve dhe krijimi i kushteve të nevojshme që ata të zhvillojnë potencialin e tyre në maksimum janë përgjegjësi sfiduese (Council of Europe, 2006 f. 1).

Prindërimi është sa një gëzim aq edhe një udhëtim frustrues, ngacmues dhe rraskapitës. Ka raste në jetën e të gjithë prindërve kur sfida duket mjaft e madhe. Ndonjëherë ne thjesht nuk dimë çfarë të bëjmë. Ndonjëherë nuk bëjmë asgjë dhe na duket se është e drejtë (Durrant, 2016, f. 1).

Prindërimi pozitiv përcaktohet nga Këshilli i Evropës si: “*Sjellje prindërore bazuar në interesat më të mira të fëmijës. Ai siguron edukimin,*

fuqizimin, njohjen dhe udhëzimin, i cili përfshin përcaktimin e kufijve për të mundësuar zhvillimin e plotë të fëmijës. Prindërimi pozitiv supozon respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe një mjedis jo të dhunshëm, kur prindërit nuk përdorin ndëshkime trupore/fizike ose psikologjike për të zgjidhur konfliktin ose për të mësuar disiplinën dhe respektin”.

Prindërimi pozitiv, gjithashtu, përshkruhet si një sërë veprimesh ashtu si edhe një qasje e përgjithshme. Çdo bashkëveprim pozitiv që prindërit kanë me fëmijët e tyre kontribuon në vetëvlerësimin, besimin, përshtatjen dhe suksesin e përgjithshëm dhe mirëqenien e fëmijës. Një komponent thelbësor i prindërimit pozitiv është udhëzimi i fëmijëve që të rriten “nxënës” të shëndetshëm, të lumtur dhe të aftë. Është e rëndësishme që prindërimi pozitiv të përfshijë ndjeshmërinë gjinore dhe moshore dhe trajtimin e barabartë të të gjithë fëmijëve, përfshirë vajzat dhe djemtë, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e grupmoshave të ndryshme.¹

Zhvillimi i fëmijëve është një proces i ndryshimit në të cilin fëmijët kalojnë nga nivele të thjeshta në më komplekse aftësish të lëvizjes, mendimit, ndjenjës dhe ndërveprimit shoqëror. Këndvështrimet mbi zhvillimin e fëmijëve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Para viteve 1970, shumë njerëz i shikonin fëmijët si një pllakë pasive, boshe dhe të varur nga të rriturit për mbrojtje dhe edukim. Me kalimin e viteve, kjo pikëpamje ka ndryshuar, tani pranohet se fëmijët kanë potencial dhe që kontribuojnë pozitivisht në shoqëri (cituar nga Hao, 2015, f. 17).

Prindërimi pozitiv i referohet mbështetjes së prindërve për të ofruar përkujdes emocional dhe fizik në mënyrë të përshtatshme, sipas nevojave të fëmijës së tyre, për të promovuar mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës dhe për të mbështetur fëmijët në arritjen e potencialit të tyre maksimal. Kjo përfshin disiplinimin e fëmijëve, por mbulon edhe mirëqenien e tyre fizike, emocionale dhe psikologjike (Tahsini, 2018, f. 149).

Sipas Gray (1999, f. 21) bazuar në qasjen e prindërimit pozitiv, ushqimi i një vullneti të fortë është baza e krijimit të besimit, bashkëpunimit dhe dhembshurisë tek fëmijët. Qasjet e mëparshme të prindërimit u përpoqën të krijonin fëmijë të bindur. Qëllimi i prindërimit pozitiv është krijimi i fëmijëve të fortë dhe bashkëpunues.

Principet e modelit të prindërimit pozitiv janë në përputhje edhe me parimet e mbrojtjes së fëmijëve të cilat përbëjnë bazën filozofike për ngritjen e shërbimeve të mbrojtjes si dhe përcaktojnë qëllimin e punës të çdo profesionisti. Ligji nr.18, 2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, gjithashtu, në nenin 5 të tij parashikon disa parime të përgjithshme mbi të

¹ https://www.unicef.org/about/partnerships/files/Note_on_Positive_Parenting_and_Non-Violent_Discipline.pdf

cilat bazohet mbrojtja e fëmijës dhe garantimi i të drejtave të tyre. Një nga parimet lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me elementët e prindërimit pozitiv. Kështu në pikën 2 të këtij ligji theksohet se interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën dhe vijon me pikën 4 ku evidentohet përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar fëmijës kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin.

Hartup (1985) shpjegon se prindërit kanë të paktën tri funksione në zhvillimin e kompetencës sociale të fëmijës. Së pari, bashkëveprimi prindër - fëmijë është një kontekst brenda të cilit zhvillohen shumë kompetenca të nevojshme për bashkëveprim shoqëror. Së dyti, marrëdhënia prind-fëmijë përbën burime emocionale dhe njohëse që i lejojnë fëmijës të eksplorojë mjediset sociale dhe josociale. Së treti, marrëdhënia e hershme prind-fëmijë është pararendëse e të gjitha marrëdhënieve familjare të formuara më pas. Brenda këtyre marrëdhënieve fëmija fillon të zhvillojë pritshmëritë dhe supozimet në lidhje me bashkëveprimet me njerëzit e tjerë dhe të hartojë strategji për arritjen e qëllimeve personale dhe sociale (cituar nga Bornstein, 2002, f. 387).

Sipas Daly (2007) prindërimi pozitiv i referohet "*sjelljes prindërore bazuar në interesat më të larta të fëmijës që është duke ushqyer, fuqizuar, jo duke e dhunuar si dhe siguron njohje dhe udhëzim që përfshin përcaktimin e kufijve për mundësinë e zhvillimit të plotë të fëmijës*". Është thelbësore të theksohet se nuk bëhet dallim midis një mashkulli dhe një prindi femër, gjithashtu, pranohet që secili prind duhet të jetë po aq përgjegjës për edukimin e fëmijëve (cituar nga Abela, Lanfranco, 2016, f.8).

2. Përfitimet nga prindërimi pozitiv dhe promovimi i modelit

Prindërimi pozitiv rrit vetëbesimin e fëmijëve dhe suksesin në jetë, dhe ndihmon që t'i bëjë ata të fortë në aspektin psikologjik, social, intelektual, shpirtëror dhe moral.²

Mbështetja e familjeve, prindërve dhe kujdestarëve për të aplikuar prindërimin pozitiv mund të parandalojë ndarjen e fëmijëve nga familjet, rrezikun e keqtrajtimit të fëmijëve në shtëpi, të dëshmojë dhunën e partnerit ndaj nënave ose njerëzës, dhe sjelljes së dhunshme midis fëmijëve dhe adoleshentëve (OBSh, 2016, f. 51).

Sanders (et al., 2008) në studimin e tyre "*Çdo familje: Një përjasje*

² https://www.unicef.org/about/partnerships/files/Note_on_Positive_Parenting_and_Non-Violent_Discipline.pdf

e popullsisë në zvogëlimin e problemeve të sjelljes dhe emocioneve te fëmijët që kalojnë tranzicion në shkollë” treguan se programet e prindërimit pozitiv premtajnë posaçërisht në zvogëlimin e problemeve të sjelljes dhe atyre emocionale. Studimi ka vlerësuar një gjykim në shkallë të gjerë të popullatës duke përdorur Programin Triple P-Pozitiv të Prindërimit (TPS). Rezultatet u vlerësuan duke përdorur një intervistë telefonike të ndihmuar nga kompjuteri, me një kampion rastësor prej 3000 familjesh në secilin komunitet si para ndërhyrjes ashtu edhe 2 vjet pas ndërhyrjes. Rezultatet treguan ulje më të madhe të numrit të fëmijëve me probleme të sjelljes dhe emocione të ngritura klinike dhe kufitare. Për më tepër, prindërit raportuan një zvogëlim më të madh të përhapjes së depresionit, stresit dhe prindërimit shtrëngues. Duhet të theksohet se ky është studimi i parë i aplikimit të programit të prindërimit pozitiv, për të demonstruar efekte afatgjata si për prindërit ashtu edhe për fëmijët.³

Rezultati i aplikimit të prindërimit pozitiv është se fëmijët do të jenë më bashkëpunues në të ardhmen. Kur fëmijët udhëzohen të përdorin emocione, logjikë, arsye, argumente ose kërcënim, kjo jo vetëm dobëson pozicionin e prindit, por dhe forcon rezistencën e fëmijëve në plan afatgjatë. Mësimi i ndonjë aftësie të re mund të jetë pak mbythës, por me pak praktikë bëhet e lehtë dhe automatike (Gray, 1999, f. 156).

Disa nga përfitimet e aplikimit të prindërimit pozitiv përfshijnë:

- fëmijët e vegjël që rriten në një lidhje të sigurt dhe të shëndetshme me prindërit e tyre kanë një shans më të madh që në jetën e tyre të zhvillojnë marrëdhënie të lumtura dhe të përmbajtura me të tjerët;
- një fëmijë që ka një marrëdhënie të sigurt me prindin mëson të rregullojë emocionet nën stres dhe në situata të vështira;
- promovimin e zhvillimit mendor, gjuhësor dhe emocional të fëmijës;
- fëmija ndihmohet të shfaqë sjellje sociale optimiste dhe të sigurta;
- përfshirja dhe ndërhyrja e shëndetshme e prindërve në jetën e përditshme të fëmijës, përbëjnë themelet për aftësi më të mira sociale dhe akademike;
- sigurimin e një zhvillimi të shëndetshëm shoqëror, emocional, njohës dhe motivues. Fëmijët, gjithashtu, fitojnë aftësi të forta për zgjidhjen e problemeve kur kanë një marrëdhënie pozitive me prindërit e tyre.⁴

Si përfundim, nisur nga analiza e mësipërme, paraqitet si domosdoshmëri që të punohet në drejtim të promovimit të prindërimit pozitiv. Kjo mund të realizohet përmes të ndihmuarit të prindërve që ata të ndihen me vetëbesim dhe të aftë, gjë që mund të arrihet nëpërmjet një sërë

³<http://www.psy.gla.ac.uk/~steve/courses/pospsydocs/oldwikis/5.%20Parenthood.pdf>

⁴ <https://www.parentingni.org/blog/parent-child-relationship-why-its-important/>

metodash, duke përfshirë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit rreth çështjeve të lidhura me prindërimin.
- Programe të strukturuar të mbështetjes dhe edukimit prindëror.
- Seanca formale dhe joformale të mbështetjes përfshi grupet e mbështetjes rreth tematikave specifike si prindërimi, apo më të përgjithshme, si grupet e grave, të baballarëve etj.
- Modelimi i sjelljes.
- Seanca këshillash individuale për familjet lidhur me probleme specifike.
- Ofrimin e materialeve për lexim dhe burimeve të tjera të referimit.
- Krijimin e mundësive që prindërit të praktikojnë marrëdhëniet e tyre me fëmijët përmes aktiviteteve dhe programeve argëtuese/të kohës së lirë (Tahsini, 2018, f. 155).

Promovimi dhe suporti ndaj prindërimin pozitiv për vetë rëndësinë që ka është pjesë e Rekomandimeve Rec (2006)19 të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare evropiane mbi politikën për të mbështetur prindërimin pozitiv të Këshillit të Evropës (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 13 dhjetor 2006 në mbledhjen e 983-të të Zëvendësve të Ministrave). Në këto rekomandime ndër të tjera prezantohen edhe disa objektiva kryesore lidhur me prindërimin pozitiv.

Qëllimi i politikave dhe masave duhet të jetë zhvillimi harmonik (në të gjitha dimensionet e tij) dhe trajtimi i duhur i fëmijëve, duke pasur parasysh respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të tyre njerëzor. Si përparësi, duhet të merren masa për të eliminuar të gjitha neglizhencat, abuzimet e fëmijëve si dhe dhunën fizike ose psikologjike (përfshirë trajtimin poshtërues dhe ndëshkimin fizik).⁵

3. Programi Triple P si një model praktik i prindërimin pozitiv

Triple P (Program i Prindërimin Pozitiv) u krijua në Australi dhe përfshin pesë faza të ndryshme sipas moshës së fëmijës. Qëllimi i përgjithshëm i programit është rritja e autonomisë dhe kompetencës së prindërve ku adresohen problemet e sjelljes së fëmijëve të tyre.⁶ Triple P u zhvillua në Universitetin e Queensland në Australi si një sistem shumëplanësh i ndërhyrjes së prindërve i dizenuar për të përmirësuar cilësinë e këshillave për prindërit (Sanders, 1999; Sanders, Markie-Dadds, & Turner, 2003) (cituar nga Sanders, 2008, f. 506).

⁵ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d6dda

⁶ <http://www.praxis.ee/wp-content/uploads/2014/03/2012-Parenting-support.pdf>

Programi Triple P është një nga programet më të efektshme të prindërimit në botë, mbështetur nga më shumë se 35 vjet kërkimesh. Triple P u jep prindërve strategji të thjeshta dhe praktike për t'i ndihmuar ata të krijojnë marrëdhënie të forta, të shëndetshme, të menaxhojnë me vetëbesim sjelljen e fëmijëve të tyre dhe të parandalojnë zhvillimin e problemeve. Triple P aktualisht përdoret në më shumë se 25 vende dhe është treguar se funksionon në kultura, grupe socio-ekonomike dhe në shumë lloje të ndryshme të strukturave familjare.⁷ Sanders është themeluesi, autori kryesor dhe konsulenti ndërkombëtar i programit Triple P (Sanders, 2018).

Triple P është një qasje shumë-nivelëshe e shëndetit publik ndaj prindërimit. Ajo synon të promovojë strategjitë dhe mendimet e prindërimit pozitiv. Qëllimet dhe parimet e Triple P synojnë si më poshtë: (Turner et al, 2002):

- ✓ të krijojë një mjedis të sigurt, të mbikëqyrur dhe mbrojtës të nevojshëm për zhvillim të shëndetshëm;
- ✓ të krijojë një mjedis pozitiv të të nxënit, ku prindërit reagojnë në mënyrë konstruktive ndaj ndërveprimeve të nisura nga fëmija;
- ✓ të përdorë disiplinën pohuese/asertive: të qenit konsistent, të përgjigjesh shpejt dhe me vendosmëri;
- ✓ të ketë pritshmëri realiste, të përshtatshme me zhvillimin e fëmijës;
- ✓ të promovojë aftësitë e fëmijëve për zgjidhjen e problemeve;
- ✓ të zhvillojë aftësinë për vetërregullim si prind;
- ✓ kujdesi i prindit për veten si individ (citar nga Fives, Pursell, Heary, Nic Gabhainn, and Canavan, 2014, f. 5).

Programi i prezantuar nga Sanders (2008, f. 508) përfshin pesë nivele të ndërhyrjes për prindërit e fëmijëve nga lindja deri në moshën 16 vjeç. Ai në mënyrë specifike synon kontekstet sociale që ndikojnë prindërit në baza ditore. Pesë nivelet e ndërhyrjes janë të dizenuara për të përputhur nevojat e fëmijëve dhe të familjes bazuar në gravitetin e problemit. Këto kontekste përfshijnë median, shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, kujdesin për fëmijët dhe sistemin e shkollave, vendet e punës, organizatat fetare dhe më gjerë sistemin politik.

Programi Triple P i prindërimit pozitiv udhëhiqet nga hulumtime të shumta dhe prova të efikasitetit që vazhdojnë të testojnë përshtatshmërinë e tij në shumë vende të botës. Ai përfshin strategji të shumta që synojnë lloje të ndryshme të familjeve për të ndihmuar prindërit në krijimin e një mjedisi të sigurt, ushqyes, duke promovuar marrëdhënie pozitive, të kujdesshme familjare dhe duke zhvilluar strategji efektive, jo të dhunshme për

⁷ <https://www.triplep.net/glo-en/home/>

promovimin e zhvillimit të fëmijëve dhe që kanë të bëjnë me problemet e zakonshme të sjelljes dhe çështjet e zhvillimit. Më e rëndësishmja, strategjitë e prindërimit dhe përkrahjes së familjes të programit janë krijuar për të parandaluar problemet e sjelljes, emocionale dhe zhvillimore të fëmijët, si dhe për të zvogëluar ashpërsinë e tyre (Gitau, Ogeda, dhe të tjerë 2016, f. 19).

Morawska, Sanders, dhe të tjerë (2010, f. 1, 7) realizuan një studim me 137 prindër, lidhur me pranueshmërinë kulturore dhe vlerësimin e programit Triple P. Pjesëmarrësit ishin nga vende të ndryshme, dy më kryesorët ishin Australia dhe Vietnami që përfaqësojnë një larmishmëri prejardhjeje etnike. Ato shikuan një video ku përshkruante 17 strategjitë e programit Triple P. Në përgjithësi programi u vlerësua pozitivisht. Rezultatet zbuluan se prindërit i gjetën strategjitë shumë të pranueshme dhe të dobishme. Ata, gjithashtu, e vlerësuan programin si shumë të përshtatshëm edhe në kontekstin kulturor.

Në këtë kontekst theksojmë se aplikimi i programit Triple P sjell një sërë përfitimesh për fëmijët. Prinz, Perou dhe Visserm (2013, f. 31) prezantojnë përfitimet e fëmijëve nga aplikimi i programit Triple P. Ato përfshijnë përfitime për sjellje dhe probleme të tilla, si: sjelljet problematike, sjelljet që lidhen me rrezikun e abuzimit me substanca, ADHD, brendësimet e problemit, problemet me bashkëmoshatarët, problemet shkollore, ato të lidhura me shëndetin, përmirësimin e aftësive sociale dhe emocionale, marrëdhëniet pozitive me prindërit, motrat dhe vëllezërit si dhe bashkëmoshatarët, përmirëson rregullimin e emocioneve si dhe predispozitën më të madhe ndaj shkollës.

KONKLUSIONE

Bazuar në analizën e mësipërme vlen të theksohet se prindërimi pozitiv është një proces që ndikon në zhvillimin e fëmijës në mënyra thelbësore. Siç u evidentua edhe më lart, ndërveprime të tilla pozitive janë, gjithashtu, të gëzueshme dhe vetëpërmbushëse edhe për vetë prindërit. Artikulli tregoi se prindërimi pozitiv bazohet kryesisht në teorinë e të mësuarit social dhe psikologjinë e zhvillimit. Theksi i saj është tek marrëdhënia harmonike prind-fëmijë, mirëqenia e fëmijëve, prindërve dhe të gjithë familjes.

Në mënyrë të përmbledhur mund të evidentojmë se koncepti i prindërimit pozitiv bazohet në parimet themelore me fokus përkujdesjen, elementë të lidhur me strukturimin, njohjen dhe vlerësimin e fëmijës, fuqizimin e tyre si dhe edukimin jo të dhunshëm në respekt të integritetit

fizik dhe dinjitetit të tyre njerëzor.

Nevojiten modele praktike për të promovuar aplikimin e prindërimit pozitiv. Një model i tillë mjaft bashkëkohor është edhe modeli Triple P. Ky model, në mënyrë të përmbledhur, bazohet në faktin se fëmijët zhvillojnë njohuritë e tyre në mënyra specifike dhe se të rriturit përreth tyre kanë një ndikim të rëndësishëm në atë zhvillim.

Përfitimet nga aplikimi i prindërimit pozitiv janë të shumta. Ato lidhen kryesisht me mundësinë e rritjes së vetëbesimit dhe suksesit në jetë të fëmijëve, fuqizimin e familjes dhe marrëdhënies prind-fëmijë. Kështu fëmijët ndihen më të sigurt, kanë vetëdije se kush janë ata dhe çfarë duan të arrijnë. Prindërimi pozitiv, gjithashtu, ndihmon në zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës në aspektin psikologjik, social, intelektual, shpirtëror dhe moral.

Si përfundim, mund të themi se të gjitha këto mund të arrihen nga aplikimi i prindërimit pozitiv përmes respektit të ndërsjellë, lehtësimit të zhvillimit social dhe emocional të fëmijës, komunikimit miqësor dhe sjelljes së drejtë.

REFERENCA:

- Abela, A., Grech Lanfranco, I. (2016). Positive parenting. National strategic policy 2016 – 2024. Ministry for the Family and Social Solidarity. Malta. Aksesuar nga: https://www.researchgate.net/publication/311674493_POSITIVE_PARENTING_National_Strategic_Policy_2016-2024
- Bornstein, M. (2002). Handbook of Parenting. Second Edition. Volume 1. Children and Parenting. Edited by National Institute of Child Health and Human Development. Lawrence Erlbaum Associates, Inc., Publishers. London. Aksesuar nga: https://www.researchgate.net/profile/Wyndol_Furman/publication/232485435_Parenting_siblings/links/0deec53c5811fda61d000000.pdf
- Durrant, J. (2016). Positive discipline in everyday parenting. Fourth edition. Save the Children Sweden. ISBN: 978-1-927612-04-0. Otava, Canada. Aksesuar nga: http://js-advocacy.ca/pdf/JS_Positive_Discipline_English_4th_edition.pdf
- Council of Europe. (2006). Policy to support positive parenting. Aksesuar nga: <https://rm.coe.int/168046d340>
- Fives, A., Pursell, L., Heary, C., Nic Gabhainn, S. and Canavan, J. (2014) Parenting support for every parent: A population-level evaluation of Triple P in Longford Westmeath. Summary Report. Athlone: Longford Westmeath Parenting Partnership (LWPP).
Aksesuar nga: http://www.childandfamilyresearch.ie/media/unescochildandfamilyresearchcentre/documentspdf/parenting_support-summary_report_inside_pgs_0.pdf
- Gitau, S., Ogeda, J., Ndugire-Mbugua, S., Muthui, I., Okoth. E. (2016). Good Practices from Positive Discipline and Family Strengthening Interventions. Parenting in Africa Network (PAN). ISBN: 978-9966-1786-4-0. Aksesuar nga:

- https://bettercarenetwork.org/sites/default/files/Good%20Practices%20from%20Positive%20Discipline%20and%20Family%20Strengthening%20Interventions_0.pdf
- Gray, J. (1999). *Children are from heaven. Positive Parenting Skills for Raising Cooperative, Confident, and Compassionate Children.* Harper Collins e-books.
 - Hao, V. (2015). *Positive disciplines. Training manual.* Plan International Vietnam. Luck house Graphics Company. Aksesuar nga: <https://plan-international.org/publications/positive-disciplines-training-manual>.
 - Morawska, A., Sanders, M., Goadby, E., et.al (2010). *Is the Triple P-Positive Parenting Program Acceptable to Parents from Culturally Diverse Backgrounds?* *J Child Fam Stud* (2011) 20:614–622 DOI 10.1007/s10826-010-9436-x. Springer Science+Business Media.
Aksesuar nga:
http://cssr.berkeley.edu/cwscmsreports/LatinoPracticeAdvisory/PRACTICE_Evidence_Based_Parent_Training/Triple%20P/2010%20Morawska.pdf
 - Tahsini, I. (2018). *Modele dhe shprehi të punës me familjet.* West Print. ISBN: 9789928249357. Tiranë.
 - OBSH (2016). *INSPIRE Seven Strategies for Ending Violence Against Children.* Aksesuar nga:
<https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/207717/9789241565356-eng.pdf;jsessionid=43E1697BFCBCF3EC401EB63B82713E04?sequence=1>
 - Prinz, R., Perou, R., Visser, S. (2013). *The Triple P System as a Prevention and Intervention Strategy with Parents.* R. Prinz. Aksesuar nga:
<https://www.nasmhpd.org/sites/default/files/Triple%20P%20systems%20and%20CDC%20ppts.pdf>
 - Sanders, Mr. (2008). *Triple P-Positive Parenting Program as a Public Health Approach to Strengthening Parenting.* *Journal of Family Psychology.* Vol. 22, No. 3, 506–517. DOI: 10.1037/0893-3200.22.3.506.
Aksesuar nga:
https://espace.library.uq.edu.au/data/UQ_176221/UQ176221.pdf?Expires=1577563451&Key-Pair-Id=APKAJKNB4MJB4JNC6NLQ&Signature=Awde3aayZdXu2hpc0J78YdtIU~juAzld6h2nXBznvwLuigJZY7kBwo-5XHlr3uNKTMWie~QS02vYWtd4JkJR33zMJd911GIJadDIFhnItvQpQkdVbPBnyWxCxRNXJhUMGsc5qa528L5Xv7EgB0ydFbVNQ8fUycYZP~CYNFNBBira10hEioCZ7Dq7Rrkudr~gVibibnTwZeKFKAwNlp38I2gHz8kQqo~kqR8FB1WECia6GQIKZCAF8Idn2CJyGByy805LjcCcDKJq9zFLHlpQItKFaCYtp8smiZzvc~l8znQu4XsI9CMAZmCEejj9hZgoy5U2Cv1DrjUP-IOvAOVG5A__
 - Sanders, Mr. (2018). *Transforming lives through positive parenting.* Santa Rosa, CA, US.
Aksesura nga:
<http://helpingfamilieschange.org/wpcontent/uploads/2018/04/Transforming-lives-through-positive-parenting-Matthew-Sanders.pdf>

WEBLIOGRAFI:

- <http://www.coe.int/t/dg3/familypolicy/Source/Plaquette%20positive%20parenting%20ENG.pdf>
- https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Per_te_drejtat_dhe_mbrotjen_e_femijes.pdf
- https://www.unicef.org/about/partnerships/files/Note_on_Positive_Parenting_and_Non-Violent_Discipline.pdf
- <https://www.positiveparentingsolutions.com/parenting/what-is-positive-parenting>
- <https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/1360.pdf>
- <http://www.psy.gla.ac.uk/~steve/courses/pospsydocs/oldwikis/5.%20Parenthood.pdf>
- https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d6dda
- <http://www.praxis.ee/wp-content/uploads/2014/03/2012-Parenting-support.pdf>
- <https://www.triplep.net/glo-en/home/>
- <http://opti-solutions.com/staging/wp-content/uploads/2011/06/Overview-of-Triple-P-and-17-Strategies-Rev-3-15-11.pdf>

VARFËRIA URBANE DHE PËRJASHTIMI SOCIAL

Erika Bejko, Rudina Rama

Universiteti i Tiranës

ABSTRAKT

Ky artikull synon të hulumtojë problematikën e varfërisë dhe të përjashtimit social. Qëllimi i këtij studimi është eksplorimi në thellësi i literaturës rreth varfërisë urbane dhe përjashtimit social. Cilat janë vështirësitë në matjen dhe shpjegimin e varfërisë urbane, cilët janë treguesit. Janë studiuar një numër i konsiderueshëm artikujsh shkencorë. Në këtë artikull është bërë edhe një përjasje krahasuese midis disa shkollave në lidhje me matjen e varfërisë siç janë shkolla ekonomike, shkolla e përjashtimit social dhe shkolla e kapitalit njerëzor. Studiuëset synojnë të hulumtojnë si e plotësojnë njëra - tjetrën dhe cilat janë mangësitë e tyre.

Fjalë kyç: varfëria, përjashtimi social, tregues, kapital njerëzor.

Urban poverty and Social Exclusion

ABSTRACT

This article aims to analyse different approaches than analyze urban poverty like monetary approach, capability approach and social exclusion approach and to make a comparative overview

Data's regarding urban poverty show that this one is more sustainable in rural areas than urban ones. The UNDP reports that two third of poor people live in rural areas. But many countries are facing a growing tendency of migration from rural areas to urban areas.

Unfortunately those people very often become the poor community in the suburban areas.

Poverty takes many forms and it is a very complex concept. For more than 20 years a new concept trying to explain the urban poverty is the concept of Social Exclusion.

There are many studies focused on poverty most of them analyze poverty on the basis of the economic terms ignoring the important role of social relations and their impact on urban poverty. The concept of Social

Exclusion analyses poverty based on the above mentioned indicators.

Key words: urban poverty, capability school, social exclusion, monetary school.

I. Problemi i studimit

Fillimet e studimeve mbi varfërinë filluan me studimet e kryera nga Booth, 1887 dhe Rowntee, 1901 në Angli. Këta ishin të parët në përcaktimin e varfërisë nisur nga parametra ekonomike. Por sidomos këto 50 vjetët e fundit debati në lidhje me varfërinë nuk ka përfunduar, madje ai ka evoluar nga përcaktimi i varfërisë bazuar në tregues ekonomikë në një koncept më të gjerë me më shumë tregues për të përcaktuar varfërinë. Ky debat ka evoluar nga përcaktimi i nevojave në identifikim e të drejtave.

Ndërkohë që diskutimet mbi varfërinë urbane janë pjesë e debateve midis kërkuesve qoftë të shkencave të sakta, por edhe kërkuesve socialë së paku në 40 vjetët e fundit. Por në të vërtetë koncepti i varfërisë urbane daton më vonë. Kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me faktin se sidomos vendet në zhvillim ku bën pjesë edhe Shqipëria kanë qenë të banuara kryesisht në zonat rurale dhe më pak në ato urbane. Por pikërisht në dekadat e fundit këto vende po përballen me një proces urbanizimi të vrullshëm. Shqipëria për herë të parë në 2011 u dominua nga një popullatë urbane ku pati dhe një migrim masiv të popullatave nga zonat rurale.

Sipas UNDP¹ (25) një e treta e popullatës në botë jeton në zonat urbane dhe sërish sipas shifrave më shumë se gjysma e tyre janë të varfër. Pa dyshim që ky urbanizim i vrullshëm edhe në Shqipëri, por edhe në vende të tjera ka ndodhur si rezultat i lëvizjes së lirë, fakt plotësisht i pamundur në sistemin e mëparshëm gjatë periudhës së regjimit komunist. Por edhe mundësitë më të mëdha për punësim që ofrojnë qytetet më të mëdha e më të zhvilluara janë një faktor i rëndësishëm gjithashtu. Sigurisht nëse urbanizimi i vrullshëm dhe roli i tij në favor apo jo të zhvillimit ekonomik është një çështje më vete që kërkon një diskutim të veçantë, fakt mbetet që varfëria urbane, e shqyrtuar gjerësisht në literaturë ku edhe mbështetet ky artikull ka një lidhje direkte me urbanizimin e vrullshëm sidomos të vendeve në zhvillim.

¹ UNDP (2004b). *Millennium Development Goals: Reducing Poverty and Social Exclusion (Hungary, Slovenia, Slovak Republic, Czech Republic) – Millennium Development Goals Report*

Në literaturën bashkëkohore mbi varfërinë urbane kjo e fundit shoqërohet me nivele të ulëta të rritjes ekonomike, shifra të larta të papunësisë dhe politika sociale shpesh joefikase për t'iu përgjigjur nevojave të këtyre shtresave. Një përjasje për analizimin e varfërisë urbane e shpjegon këtë të lidhur ngushtësisht me politikat që ndërmerr shteti në nivel makro dhe e shpjegon varfërinë urbane si dështim i politikave të punësimit të të gjitha politikave që gjenerojnë të ardhura. Por ka edhe një këndvështrim tjetër që shpjegon varfërinë urbane të lidhur ngushtësisht me funksionimin e institucioneve. Ka argumente të shumta në lidhje me përcaktimin e saktë dhe rolin që duhet të kenë këto institucione: “*A duhet të ndërhyjnë në nivel individ apo duhet të ndërhyjnë në përmirësimin e dinamikave sociale?*”

II. Qëllimi dhe pyetja kërkimore

Qëllimi i këtij studimi është eksplorimi në thellësi i literaturës rreth varfërisë urbane dhe përjashtimit social. Për këtë arsye janë shqyrtuar mbi tridhjetë artikuj dhe raporte studimore.

Cilat janë vështirësitë në matjen dhe shpjegimin e varfërisë urbane, cilët janë treguesit. Janë studiuar, sikundër edhe përmendëm më sipër, një numër i konsiderueshëm artikujsh shkencorë. Në këtë artikull është bërë edhe një përjasje krahasuese midis disa shkollave në lidhje me matjen e varfërisë, siç janë: shkolla ekonomike, shkolla e përjashtimit social dhe shkolla e kapitalit njerëzor. Studiueset synojnë të hulumtojnë si e plotësojnë njëra - tjetrën dhe cilat janë mangësitë e tyre.

Objektivat e kërkimit

Ky kërkim ka patur dy objektiva kërkimore:

1. Të pasqyrojë teorinë më bashkëkohore në lidhje me matjen dhe shpjegimin e varfërisë urbane.
2. Shpjegimin bazuar në këto teori të konceptit të përjashtimit social dhe përse ky i fundit është një koncept më gjithëpërshirës në shpjegimin e varfërisë.

III. Hulumtimi i literaturës

Sipas Room, ²(10) të ardhurat në zonat urbane lidhen dhe fitohen

² Room, G. (ed.) (1995). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom.

kryesisht nga punësimi duke qenë se shumë të varfër në zonat urbane përveç krahut të punës nuk zotërojnë pasuri të tjera, të tëra të ardhurat e tyre janë rezultat i punës. Kështu që niveli i tyre ekonomik mundet të përcaktohet duke përdorur të ardhurat.

Studimet tregojnë se jetesa në zonat urbane është më e shtrenjtë, çmimet janë më të shtrenjta e rrjedhimisht kostoja e jetesës më e lartë. Të varfërit në zonat urbane kanë një konsum ushqimor i cili nuk qëndron në raport të drejtë me nevojat e tyre e duke i krahasuar me zonat rurale ky është shumë më inferior.³ (2).

Studimet tregojnë se të varfërit e zonave urbane, ushqehen keq dhe jetojnë në kushte shumë të vështira⁴ (6).

Pabarazia në të ardhura dhe krijimi i shtresave të varfëra rritet paralelisht me procesin e urbanizimit.⁵ (11). Duke qenë se migrimi nga zonat rurale ka lidhje me urbanizimin, çështjet e varfërisë urbane dhe të varfërisë rurale kanë lidhje me njëra - tjetrën.

Zonat urbane padyshim ofrojnë mundësi të shumta për të gjeneruar të ardhura. Zonat rurale kanë krahu pune të pakualifikuar ose pak të kualifikuar. Duke qenë se kostoja e jetesës është më e lartë në zonat urbane, atëherë këta punëtorë pak të kualifikuar me të ardhurat që do të fitojnë, përbëjnë një mundësi relativisht të madhe që të përballen me problematikën e varfërisë pas zhvendosjes së tyre. Pra literatura e vë theksin në marrëdhënien dinamike midis lëvizjes nga zonat rurale në atë urbane.⁶(12).

Kështu që me rritjen e migrimit kemi gjithashtu edhe krijimin e zonave apo periferive ku migrantët nga zonat e njëjta gjeografike zgjedhin për të jetuar. Faktorët që siç është përmendur lidhen me mungesën e kualifikimit të nevojshëm, nivelit arsimor, mungesën e zotërimit të të mirave materiale që mundet të gjenerojnë të ardhurave veç të ardhurave të cilat vijnë nga krahu i punës, marrëdhëniet e kufizuara me rritet shoqërore kontribuojnë në krijimin e këtyre komuniteteve të periferive urbane.

Këto komunitete shpesh jetojnë në kushte të papërshtatshme ku mungon infrastruktura e nevojshme dhe shërbimet sociale të nevojshme. Këta të varfër pavarësisht nëse janë migrantë të ardhur rishtas apo banorë prej kohësh në këto zona formojnë shtresën më të ulët në pikëpamjen e të

³ Duncan, G., & Hill, J.. (1989). Assessing the Quality of Household Panel Survey Data. *Journal of Business and Economic Statistics*, 7(4), 441-451.

⁴ Sen A. (1997). Inequality, unemployment and contemporary Europe. *International Labour Review*, Vol. 136, No. 2, 1997, pp. 155-171.

⁵ Castel, R. (1995). *Les métamorphoses de la question sociale, une chronique du salariat*. Fayard. Paris, France.

⁶ Castells M. (2012) *The Power of Identity* (Vol.2 of 'The Information Age: Economy, Society and Culture') Blackwell, Oxford.

ardhurave, aftësive dhe kualifikimeve që zotërojnë dhe kontakteve sociale. Duke u vendosur në një zonë të caktuar ato formojnë edhe komunitetet me karakteristika të ndryshme.⁷ (14).

Banesat e tyre janë kryesisht të palegalizuara apo edhe të marra përkohësisht me qira e kuptohet që këto të fundit nuk ofrojnë kushtet e nevojshme për të jetuar si rezultat i qirave të ulëta që këta individë mundet të paguajnë.

Ekonomia formale thith kryesisht fuqinë punëtore të kualifikuar dhe të arsimuar, ndërkohë që ekonomia joformale absorbon fuqinë e pa ose pak të kualifikuar. Çështjet e migrimit, segmentizimit dhe lidhjet e kufizuara sociale janë elemente shumë të rëndësishme për trajtimin e problemit të përjashtimit social dhe marrëdhënies së saj me varfërinë.

Pjesa më e madhe e të varfërve të zonave urbane sidomos në shoqëritë e zhvilluara janë të përfshira në aktivitete joformale, shitje, transport i mallrave, shërbime riparimi etj. Këto aktivitete nuk kërkojnë kualifikimet e nevojshme e këtu mundet të punojë çdokush. Studimet, gjithashtu tregojnë, se të ardhurat që fitojnë nga puna e tyre këta individë, të cilët janë përfshirë në aktivitete, janë tepër të ulëta⁸ (14). Kjo dinamikë është shumë e rëndësishme në shpjegimin e varfërisë.

IV. Analizimi i shkollave

Qëllimi i këtij studimi është eksplorimi i literaturës në lidhje me kuptimin e konceptit të varfërisë dhe të përjashtimit social, përcaktimin e treguesve të matjes së tyre. Është synuar të realizohet një përjashtim krahasues midis shkollave të ndryshme në analizimin e varfërisë urbane. Koncepti i varfërisë urbane dhe varfërisë rurale është shumë i rëndësishëm në shpjegimin e dinamikave të ndërsjella që kanë me njëra - tjetrën.

Përjashtimi monetar dhe varfëria urbane

Në bazë të kësaj përjashtimi varfëria përcaktohet në bazë të të ardhurave dhe të konsumit kur këto të fundit janë nën kufirin e përcaktuar si kufiri i varfërisë. Mirëqenia përcaktohet sipas totalit të të ardhurave. Sidoqoftë janë bërë avancime në lidhje me standardizimin e kësaj përjashtimi në mënyrë që të krijohen treguesit e duhur për matjen e varfërisë⁹(29) kritikën që i bëhen kësaj përjashtimi kanë të bëjnë me

⁷ Opel A.E.O (2012) 'The Social Context of Labour Markets in Dhaka Slums' Journal of International Development 12, 5 735-750.

⁸ Castells M. (2012) The Power of Identity (Vol.2 of 'The Information Age: Economy, Society and Culture') Blackwell, Oxford.

⁹ OECD/ Eurostat (2009). *PPP and Real Expenditures*. 2002 Benchmark Year.

‘objektivitetin’ e saj dhe vendosjen e theksit sidomos në dimensionin ekonomik të varfërisë. Sipas kësaj pikëpamjeje janë burimet ekonomike sidomos të ardhurat që përcaktojnë nivelin e jetesës. Sipas një numri të konsiderueshëm të literaturës që studion kryesisht varfërinë urbane, kjo shpjegohet kryesisht me migrimin nga zonat rurale.

Migrantët nga zona të ndryshme përqendrohen në komunitete të caktuara ose lagje të cilat janë relativisht homogjene. Të varfërit e zonave urbane janë shpeshherë ata që punojnë në sektorin joformal dhe që shpesh konsiderohen edhe nga politikëbërësit si një kategori e ndryshme nga popullata lokale¹⁰(17). Por të varfërit e zonave urbane përfshihen gjithashtu në sektorin formal, por serish jetojnë në kushtet e varfërisë dhe mungesës se kushteve të nevojshme të jetesës, sepse ata përfaqësojnë shpesh ‘shtresën e pakualifikuar’. Kështu, ndonëse janë të punësuar, puna nuk siguron të ardhura të mjaftueshme, pasi punëtorët e pakualifikuar janë shpesh edhe me të shfrytëzuarit¹¹(7). Studimet tregojnë se liberalizimi ekonomik dhe politikat e tregut të lirë tregojnë se kanë një ndikim në uljen e pagave të punonjësve me kualifikim të ulët/¹²(13).

Jetesa në zonat urbane është më e shtrenjtë në krahasim me zonat rurale, por kjo karakterizohet me shkallë të lartë pabarazie, pasi një kategori e caktuar mundet të përfitojë të ardhura shumë të konsiderueshme. Ndaj sipas kësaj përjasjeje problematika e varfërisë urbane lidhet me mungesën e të ardhurave dhe rezultat i saj një nivel mirëqenieje të përpjesëta të ulët¹³(10).

Shkolla e kapitalit njerëzor

Përjasja e aftësive ose fuqizimi i kapitalit njerëzor përbën një alternativë tjetër që synon konceptimin e varfërisë urbane. Sipas kësaj përjasjeje është mungesa e aftësive të domosdoshme për të qenë forcë aktive në tregun e punës e cila shkakton varfërinë urbane. Këta shpjegojnë se të varfërit e zonave urbane janë të tillë si rezultat i mungesës së aftësive të tyre për të fituar të ardhura të mjaftueshme.

Sen i cili është edhe pionieri i kësaj përjasjeje, ndër të tjera thotë: “*Zhvillimi duhet parë si një eksperiment afërsisht njerëzor dhe jo si maksimizimi i të ardhurave*”¹⁴(5). Sipas kësaj përjasjeje nuk janë të

¹⁰ Paugam, S. (1991). *La disqualification sociale*. Presses Universitaires de France. Paris, France

¹¹ Gore, C. (2003) Entitlement relations and ‘unruly’ social practices: a comment on the work of Amartya

¹² Fukuyama F. (1995) *Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity* Penguin London

¹³ Room, G. (ed.) (2005). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom

¹⁴ Sen, A. (1999) *Development as Freedom* (Oxford: Oxford University Press

ardhurat treguesi i mirëqenies, por ata e vënë theksin në të tërë ata tregues të quajtur treguesit e lirisë apo të drejtat për të bërë një jetë të vlefshme dhe cilësore. Pra sipas Sen varfëria përcaktohet si një privim i aftësive apo si një dështim për të arritur aftësitë bazë. Sen me aftësitë bazë do të quajë aftësinë për të plotësuar funksionimin dhe arttjen e niveleve të përshtatshme dhe adekuate për një jetë cilësore.

Gjithashtu studimet në nivel makro tregojnë se vendet e varfëra shënojnë edhe jetëgjatësinë më të ulët dhe shkallë të lartë analfabetizmi tek gratë¹⁵(24). Po kështu, këto studime tregojnë, se edhe në vendet e zhvilluara të varfërve të këtyre zonave urbane u mungon aksesit për përkujdesjen shëndetësore, arsimimin apo dhe probleme që lidhen me infrastrukturën si p.sh., lehtësira të transportit, elektricitetit etj.

Autorët e kësaj shkollë shpjegojnë se migrimi është një faktor që ndikon në krijimin apo jo të një rrjeti shoqëror dhe mundet të jenë faktor që individit të ndihet i përjashtuar. Po sipas tyre këta ‘migrantë’ që vijnë nga zonat ruarale dhe me kalimin e kohës zhvillojnë strategji bashkëpunimi shumë efektive që shpesh shpjegojnë edhe punësimin e tyre në tregun joformal të punës, por edhe në vendosjen dhe krijimin e rezidencave të tyre. Migrantët me nivel të ulët arsimor shpesh vendosen në zonat më të varfëra.

Këto ‘disavantazhe’ do të bëjnë edhe më të vështirë nxjerrjen në pah të aftësive të tyre. Kjo shtresë migrantësh në zonat urbane për fat të keq është shumë pak e përfaqësuar politikisht si rezultat, së pari i paaftësisë së tyre për t’u organizuar, por më së shumti edhe një mungesë vëmendjeje nga ana e partive politike dhe qeverisë¹⁶(18). Një pjesë e rëndësishme e literaturës mbështet idenë se shpeshherë varfëria mbetet për një periudhë tranzitore¹⁷(21), por sërish mbetet shqetësues fakti se këta të varfër shpeshherë migrantë punojnë në tregun informal për breza të tërë¹⁸(18).

Shpesh problemet e varfërisë shoqërohen edhe me probleme të diskriminimit gjinor dhe studimet e kryera sidomos në vendet e zhvilluara tregojnë se gratë janë shpesh më të ‘diskriminuarat’. Kjo edhe për faktin se për të njëjtën punë gratë rezultojnë se paguhen më pak. Problematika e problemeve brenda familjes si rezultat i mungesës së të ardhurave dhe nivelit joadekuat të jetesës është edhe më i ndjeshëm kur niveli i

¹⁵ UNDP (2018). *Human Development Report/Millennium Development Goals 2018*

¹⁶ White, M. (2011). *Against Unemployment*. Policy Studies Institute. London, United Kingdom

¹⁷ Richard, D. (1976). *Dependency and Poverty in Short and Long Run*, University of Michigan pp.273-296

¹⁸ White, M. (2011). *Against Unemployment*. Policy Studies Institute. London, United Kingdom

analfabetizmit është më i lartë¹⁹ (24).

Sipas përjasjes sociale e cila u zhvillua fillimisht në vendet e industrializuara për të nxjerrë në pah procesin e marginalizimit dhe të privimit të cilët janë të pranishëm edhe në vendet e industrializuara. Koncepti i përjashtimit social po përdoret shpesh si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet në zhvillim falë edhe punës së madhe të bërë sidomos nga agjencitë e UN. Sipas përcaktimit të dalë nga **Bashkimi Evropian** përcaktimi i përjashtimit social është një proces nëpërmjet të cilit individët apo grupet janë pjesërisht apo totalisht të përjashtuar nga pjesëmarrja e plotë në shoqërinë në të cilën bëjnë pjesë²⁰(22). Është vërejtur se përjashtimi social është një proces dinamik i cili çon drejt përjashtimit nga shoqëria së bashku me shumë disavantazhe të tjera.

V. Analiza dhe diskutimi

Shpjegimi i varfërisë sipas shkollës së përjashtimit social

Përveç varfërisë që është një pjesë përbërëse e rëndësishme për përjashtimin social autorë, si Sen²¹(6), Room²²(10), shpjegojnë që përjashtimi social është shumë më tëpër së të qenurit të varfër. Room²³(10) kur shpjegon se përjashtimi social është disa shkallë më lart se varfëria vë theksin pikërisht në “shkëputjen e marrëdhënieve me familjen, shoqërinë si rezultat i përjashtimit social. Madje as ushtrimi i të drejtave të plota si qytetar dhe pjesë e një shoqërie nuk është më i mundur. Kontrata sociale midis individit dhe shoqërisë nuk ekziston më”, citon Sen²⁴ (6).

Në rastet e përjashtimit social do të përfshijmë edhe individët që në një farë mënyre kanë qenë pjesë e këtij përjashtimi, por edhe ata që janë bërë pjesë. Si në njërin rast edhe në tjetrin individit nuk është pjesëmarrës aktiv në shoqërinë në të cilën bën pjesë.

Një autor i rëndësishëm Paugam²⁵(17) thekson se përjashtimi i cili është pasojë e deprivimit apo diskriminimit social ekonomik nuk mundëson

¹⁹ UNDP (2018). *Human Development Report/Millennium Development Goals 2018*.

²⁰ UNDP (2012a). *The Albanian Response to the Millennium Development Goals*

²¹ Sen A. (1997). Inequality, unemployment and contemporary Europe. *International Labour Review*, Vol. 136, No. 2, 1997, pp. 155-171

²² Room, G. (ed.) (2005). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom.

²³ Room, G. (ed.) (2005). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom.

²⁴ Room, G. (ed.) (2005). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom.

²⁵ Paugam, S. (1991). *La disqualification sociale*. Presses Universitaires de France. Paris, France

pjesëmarrjen në aktivitete. I njëjti autor thekson se këta banorë sidomos ata që banojnë në lagje tejet të varfëra nuk njihen si banorë apo rezidentë të lagjeve ku banojnë. Kjo pra është një pasqyrë e cila tregon se se sa të përjashtuar mundet të jenë këta individë nga të drejtat e tyre sociale dhe politike.

Siç e kemi shpjeguar edhe më sipër problematika e varfërisë urbane fillon me migrimin. Këta migrantë shpesh me nivel të ulët arsimor, njohje dhe lidhje shoqërore të pakta, zhvendosen në 'periferi të caktuara'. Migrantët, por edhe individë të tjerë, me karakteristikat e sipërpërmenduar janë shtresa që përballen me përjashtimin ekonomik social, kulturor dhe politik. Duke filluar së pari me 'barrierën ekonomike' pamundësi që këto grupe të jenë pjesë e tregut të punës.

Një nga mënyrat pse ndodh përjashtimi social është pikërisht me anën e diskriminimit qoftë ky gjinor, etnik apo edhe forma të tjera dhe kjo bëhet 'barriera' kryesore për të pasur akses në burimet ekonomike të shpjeguara edhe më lart. Por efektet e përjashtimit nga tregu i punës mundet të shkaktojnë edhe përjashtimin social ²⁶(11).

Një mënyrë tjetër se si mundet të ndodhe ky proces është edhe me anën e vështirësive për të qenë pjesë e ekonomisë formale, si rrjedhojë këta individë do të jenë pjesë e tregut apo punësimit informal rezultat i të cilës është pasiguria në punë, por ka edhe pasoja të rëndësishme që japin rezultat më vonë siç është mungesa e pensionit etj. Papunësia së bashku me punësimin në tregun joformal janë aspekti më themeltar në problematikën e varfërisë urbane duke i shndërruar këta individë apo grupe të përjashtuar nga tregu i punës. Sipas White ²⁷(18) të varfërit e zonave urbane edhe në rastet kur punojnë paguhen keq, punojnë në ambiente të papërshtatshme dhe mbi të gjitha përjetojnë pasigurinë e punës që mundet të ndërpritet në çdo moment.

Është papunësia dhe mungesa e pjesëmarrjes në aktivitete formale arsyeja që çon drejt varfërisë. Nga ky këndvështrim, nuk është vetëm fakti, që të ardhurat e pamjaftueshme bëhen shkak i një jetese në kushtet e varfërisë, por pasojat e këtyre të fundit, siç janë pasojat socio-psikologjike të papunësisë apo punësimi në tregun joformal të cilat kanë ndikime serioze.

Së dyti individë apo grupe individësh mundet të përjashtohen nga

²⁶ Castel, R. (1995). *Les métamorphoses de la question sociale, une chronique du salariat*. Fayard. Paris, France

²⁷ White, M. (2011). *Against Unemployment*. Policy Studies Institute. London, United Kingdom.

‘ushtrimi’ i të drejtavë civile dhe politike që iu takojnë.²⁸ (25). Mendoj se i duhet kushtuar një vëmendje e rëndësishme ‘përjashtimit’ politik siç është pjesëmarrja në aktivitete politike. Barrierat për mospjesëmarrje janë të ndryshme duke filluar nga mungesa e burimeve financiare, por pse jo edhe fizike për të marrë pjesë në aktivitete politike, fushata elektorale që shoqërohen edhe me mospjesëmarrje në votim. Shifrat tregojnë se edhe në vende me demokraci të konsoliduar pjesëmarrja politike në shtresat e varfra është shumë më e ulët në krahasim me shtresat e tjera.²⁹(7).

Sipas këtyre autorëve pjesëmarrja e ulët në votim është një tregues i qartë i mospjesëmarrjes në aktivitete politike që më pas do të shoqërohet me një mospërfaqësim në nivel politikash për këtë shtresë.

Përjashtimi politik shpjegon arsyen e mosadresimit adekuat të nevojave nga politikëbërësit. Shpesh fakti se zonat, lagjet ku banojnë këto shtresa, kanë mungesa të dallueshme edhe përsa i përket infrastrukturës, flet për mënyrën së si ‘shihen’ nga politikanët, politikëbërësit apo edhe vetë qeveria.

Sipas Room³⁰(15) organizimi politik i shtresave të varfëra është shumë problematik edhe si rezultat i një lidërshipi shpesh joefektiv, por edhe të ‘xhelozisë’ midis individëve udhëheqës dhe pasuesve të tyre. Por edhe politikanët apo qeveritë shpesh mundet të mos mbështesin të varfërit e zonave urbane për faktin se këta të fundit shpesh jetojnë në zona që mundet edhe të mos përfaqësohen në nivel politik, si rezultat i banesave jo të legalizuara ku ata banojnë.

Kështu përfaqësimi i dobët politik bën që këto shtresa të mos përfitojnë shërbimet të cilat u takojnë në bazë të të drejtave të tyre.

Së treti, përjashtimi social, ndodh kur individëve apo grupeve u mohohet akses në aktivitete kulturore, shoqata, rrjete sociale. Roli i përkatësisë sociale dhe integritit social është themeltar, pasi fuqizon kapitalin social në nivel individual apo grupi me anën e procesit të fuqizimit dhe mobilizimit të këtyre shtresave.

Nocioni dhe rëndësia e kapitalit social buron nga fakti se bashkëpunimi, solidariteti, shkëmbimi reciprok prodhojnë efektet e një sinergjie të domosdoshme (4). Nevoja për të marrë pjesë në aktivitete sociokulturore dhe për të pasur akses në rrjete sociale rritet në shoqëritë ku

²⁸ UNDP (2014b). *Millennium Development Goals: Reducing Poverty and Social Exclusion*

²⁹ Gore, C. (2013): Entitlement relations and ‘unruly’ social practices: a comment on the work of Amartya

³⁰ Room, G (2000): ‘Commodification and Decommodification: A Developmental Critique’, Policy and Politics, Vol 28, No.3.

problemet ekonomike janë më të thella dhe mohimi i të drejtatve shoqërore dhe mbrojtjes sociale është më i pranishëm³¹.(12).Të gjitha këto shtresa që janë të përjashtuara nga rrjetet sociale e kulturore do të kenë më shumë shanse për të mbetur të varfër.

Në shoqëritë në zhvillim rrjetet shoqërore janë shpesh një parakusht për të gjetur një punë.

Kapitali social është i rëndësishëm edhe në demokratizimin e shoqërisë, pasi shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në politikëbërje³²(5).

Fakt është që të varfrit e zonave urbane kanë tendencë të marrin pak ose aspak pjesë në aktivitete sociokulturore. Si rezultat i kësaj pjesëmarrjeje të ulët ata nuk 'përfitojnë' edhe benefitet e kapitalit social të shpjeguar më sipër³³(13, 14).

Por kapitali social është shumë i rëndësishëm sepse shumë burime duke përfshirë këtu edhe kapitalin njerëzor dhe financiar varen dhe kanë një lidhje me kapitalin social³⁵(13).

Aspekte të tilla të kapitalit social siç janë mbështetja, ndihma apo edhe kryerja e aktiviteteve të përbashkëta luajnë rol në përmirësimin e situatës së varfërsë urbane, por edhe prodhon mbështetje e shpesh nxit drejt pjesëmarrjes politike me ndikime të rëndësishme në vendimmarrje³⁶(1).

Duhet theksuar se pjesëmarrja sociale e ulët dhe fakti që shpesh të varfërit e zonave urbane janë të përjashtuar në pikëpamjen sociale dhe kulturore ka lidhje me problematikën e migrimit dhe përfaqësimit e tyre në politikëbërje. Së pari, këta individë kanë lidhje të dobëta sociale, pasi qëllimi kryesor i tyre janë të ardhurat më shumë se marrëdhëniet sociale³⁷ (13). Së dyti, duke qenë se kanë prejardhje të ndryshme kulturore, gjeografike një arsye kjo që ndikon të jenë më pak të organizuar politikisht apo edhe në aspektin socio-kulturor.³⁸(6).

Së treti, edhe në rastet kur këta janë të organizuar, organizma të

³¹ Castells M. (2012): The Power of Identity (Vol.2 of 'The Information Age: Economy, Society and Culture') Blackwell, Oxford.

³² Sen, A. (1999) Development as Freedom (Oxford: Oxford University Press

³³ Opel A.E.O (2012) ' The Social Context of Labour Markets in Dhaka Slums' Journal of International Development 12, 5 735-750

³⁴ Fukuyama F. (1995) Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity PenguinLondon

³⁵ Oxford Fukuyama F. (1995) Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity PenguinLondon

³⁶ Adams , K... (2000). *Closing the Gap: Theory,Metro-Nonmetro Differences in Long Term Poverty Among Balks*: University of Michigan

³⁷ Fukuyama F. (1995) Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity PenguinLondon

³⁸ Sen A. (1997). Inequality, unemployment and contemporary Europe. *International Labour Review*, Vol. 136, No. 2, 1997, pp. 155-171

tillë, si sindikatat janë shpesh joefektive, këto të fundit mbrojnë interesat e partive politike.³⁹(9)

Për të përmbyllur si rezultat i një organizimi të ulët socio - kulturor nevojat dhe kërkesat e tyre nuk pasqyrohen dhe nuk përfaqësohen në politikëbërje⁴⁰ (14).

VI. Konkluzionet

Disa procese sociale bëjnë që varfëria dhe pabarazia në periferitë urbane kanë efekte identitare.

Deri tani pak vëmendje i është kushtuar përshkrimit të përjashtimit social më tepër është synuar të shpjegohen shkaqet e tij. Janë parë shkaqet e varfërisë dhe sidomos mekanizmat socialë që e bëjnë atë afatgjatë.

Ka një rëndësi të madhe edhe klasifikimi i shkollave të ndryshme që shpjegojnë konceptin e varfërisë. Në varësi të kësaj tipologjie mundet të ndërtohen edhe strategjitë dhe politikat sociale që do të ndërmerren nga shteti dhe nga institucionet përkatëse

Sa më efektive të jetë ndërhyrja për zbutjen e varfërisë urbane aq më të mëdha janë mundësitë që këto bashkësi apo individë të dalin jashtë rrethit vicioz të varfërisë.

Por efektiviteti i kësaj ndërhyrjeje do të varet edhe nga aftësia që shteti të identifikojë këto familje dhe të ndërhyjë në kohën e duhur. Sipas statistikave arsyet kryesore të varfërisë në zonat urbane rezultojnë të jenë papunësia dhe të ardhurat e pamjaftueshme. Kjo shpesh lidhet me arsimimin e pamjaftueshëm. Politikat efektive të ndërhyrjes mundet të jenë trajnimet profesionale që mundet t'iu ofrohen sigurimi dhe mbrojtja shëndetësore e tyre duke bërë kështu që kapitali njerëzor të këtë të gjitha aftësitë e nevojshme për të punuar.

Sigurisht në vendet perëndimore kryhet një punë e konsiderueshme 'identifikuese' në mënyrë që të përcaktohen shkaqet e varfërisë së këtyre familjeve në zonat periferike dhe faktorëve që i përjashtojnë nga tregu i punës. Në vendin tonë i cili karakterizohet nga shifra të larta të papunësisë dhe siç është përmendur pagesa më të ulëta në krahasim me burrat, mungesa e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore janë një shkak për shtrirjen e mëtejshme të varfërisë urbane e cila shpesh ka ndikim të drejtpërdrejtë në varfërinë tek fëmijët si kategoria më e pambrojtur.

³⁹ Hills, J., Le Grand, J., Piachaud, D. (2012). *Understanding Social Exclusion*. Oxford University Press, Oxford, United Kingdom

⁴⁰ Opel A.E.O (2012) ' The Social Context of Labour Markets in Dhaka Slums' Journal of International Development 12, 5 735-750

Kështu që të gjitha strategjitë për të luftuar këtë të fundit duhet të synojnë ngritjen e vendeve të reja të punës dhe një legjislacion që duhet të parashikojë mbrojtjen e punëmarrësve duke parashikuar kështu edhe punën me kohë të pjesshme etj. Duke qenë se tregu i punës është gjithashtu i ndarë midis tregut formal dhe joformal kjo ndikon në mungesën e mbrojtjes për të tërë atë kategori që punon në tregun informal.

Për të gjitha vendet evropiane edukimi dhe përmirësimi i tij është shndërruar në strategji zhvillimi. Në vendet e Ballkanit Perëndimor mosndjekja e arsimit fillor ka shifra serioze. Detyrimi i ndjekjes së arsimit fillor dhe koncepti i arsimit gjithëpërfshirës është një domosdoshmëri. Rreziku i ciklit të varfërisë ka një marrëdhënie direkte me nivelin e edukimit.

BIBLIOGRAFIA

1. Adams , K.,. (2000). *Closing the Gap: Theory, Metro-Nonmetro Differences in Long Term Poverty Among Balks*: University of Michigan.
2. Duncan, G., & Hill, J.. (1989). Assessing the Quality of Household Panel Survey Data. *Journal of Business and Economic Statistic*, 7(4), 441-451.
3. Sen , A . *Journal of Development Studies*, 29(3), pp. 429.
4. Silver, H. (1994). Social Exclusion and Social Solidarity: Three Paradigms. *International Labour Review*, Vol. 133, No. 5-6,1994, pp. 531-578.
5. Sen, A. (1999) *Development as Freedom* (Oxford: Oxford University Press.
6. Sen A. (1997). Inequality, unemployment and contemporary Europe. *International Labour Review*, Vol. 136, No. 2, 1997, pp. 155-171.
7. Gore, C. (2013) Entitlement relations and ‘unruly’ social practices: a comment on the work of Amartya.
8. Ashworth,K., & Hill, M. (1992). Economic Disadvantage during Childhood .Working paper 170.
9. Hills, J., Le Grand, J., Piachaud, D. (2012). *Understanding Social Exclusion*. Oxford University Press. Oxford, United Kingdom.
10. Room, G. (ed.) (2005). *Beyond the Threshold: The Measurement and Analysis of Social Exclusion*. The Policy Press. Bristol, United Kingdom.
11. Castel, R. (1995). *Les métamorphoses de la question social, une chronique du salariat*. Fayard. Paris, France.
12. Castells M. (2012) *The Power of Identity* (Vol.2 of 'The Information Age: Economy, Society and Culture') Blackwell, Oxford.
13. Fukuyama F. (1995) *Trust: The Social Virtues and the Creation of Prosperity* PenguinLondon.
14. Opel A.E.O (2012) ' The Social Context of Labour Markets in Dhaka Slums' *Journal of International Development* 12, 5 735-750.
15. Room, G (2000), 'Commodification and Decommodification: A Developmental Critique', *Policy and Politics*, Vol 28, No.3.
16. Room G. (2000) 'Trajectories of Social Exclusion: the Wider Context' in David Gordon and

17. Paugam, S. (1991). *La disqualification sociale*. Presses Universitaires de France. Paris, France.
18. White, M. (2011). *Against Unemployment*. Policy Studies Institute. London, United Kingdom.
19. Republic Albania (2004). *Albania National Report on Progress report towards Achieving the Millennium Development Goals*, (Tirana)
20. Republic Albania (2001). *National Strategy for Socio-Economic Development (PRSP)*. (Tirana).
21. Richard, D. (1976). *Dependency and Poverty in Short and Long Run*, University of Michigan pp.273-296.
22. UNDP (2012a). *The Albanian Response to the Millennium Development Goals*.
23. UNDP (2002b). *Avoiding the Dependency Trap, Roma Human Development Report*.
24. UNDP (2018). *Human Development Report/Millennium Development Goals 2018*
25. UNDP (2014b). *Millennium Development Goals: Reducing Poverty and Social Exclusion (Hungary, Slovenia, Slovak Republic, Czech Republic) – Millennium Development Goals Report*.
26. UNDP (2004c). *Human Development Report 2004 – Cultural Liberty in Today's Diverse World*.
27. Albania Double Dividend of Gender and Equality “Women and Children in Albania’ 2007.
28. OECD (2019). *Education Policy Analysis*.
29. OECD/ Eurostat (2019). *PPP and Real Expenditures*. 2002 Benchmark Year.

TEKNOLOGJIA DIGJITALE NË NDIHMË TË PËRSHTATJES SË MËSIMDHËNIES NË KLASAT GJITHËPËRFSHIRËSE

Ambera Duka, Shqipe Haxhihyseni

*Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Edukimit,
departamenti i Pedagogjisë*

ABSTRAKT

Përfshirja e teknologjisë digjitale në mësimin e diferencuar (të përshtatur) për fëmijët me aftësi ndryshe dhe mundësitë që ofron kjo teknologji në mësimdhënie janë fokusi i këtij punimi. Teknologjia digjitale është risi në mësimdhënie në shkollat tona dhe përdorimi i saj në mësimdhënie e individualizuar përbën një sfidë si për mësuesit ashtu dhe për nxënësit me aftësi ndryshe.

Ky studim ka si qëllim që të evidetojë mundësi e problematika në mësimdhënie në lidhje me përdorimin e teknologjisë digjitale. Për të arritur qëllimin e këtij studimi është përdorur metoda cilësore e kërkimit. Për grumbullimin e të dhënave janë përdorur intervista dhe grupet e fokusit, me mësuesit e ciklit parashkollor dhe atij fillor. Kampionimi ka qenë i qëllimshëm dhe përbëhet nga mësuesit që kanë në klasat e tyre edhe fëmijë me aftësi ndryshe.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë që tabelat smart mund të sugjerohen si një zgjedhje e mirë për realizimin e mësimdhënies së përshtatur për nxënësit me aftësi ndryshe dhe që duhet të merren në konsideratë nga mësuesit për të motivuar këta nxënës e për të arritur rezultatet sa më të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: teknologji digjitale, tabelë smart, nxënës me aftësi ndryshe, mësimdhënie e përshtatur.

Digital technology assisting teaching adaptation to inclusive education

ABSTRACT

The inclusion of digital technology in differentiated (adapted) learning for children with different abilities and the opportunities that this

technology offers in teaching are the focus of this paper. Digital technology is an innovation in teaching in our schools and its use in individualized teaching poses a challenge for both teachers and students with different abilities.

This study aims to identify opportunities and problems in teaching related to the use of digital technology. Qualitative research method was used to achieve the purpose of this study. Interviews and focus groups with preschool and primary school teachers were used for data collection. The sampling was intentional, and consisted of teachers who also have children with different abilities in their classrooms.

The findings of this study show that smart boards can be suggested as a good choice for the realization of teaching tailored to students with different abilities and that should be considered by teachers to motivate these students and achieve the most sustainable results.

Keywords: digital technology, smart board, students with different abilities, adapted teaching.

Hyrje

Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi ndryshe në klasë (në shkollën shqiptare), ka shfaqur sfida të reja jo vetëm për mësuesit, të cilët me punën e tyre janë të lidhur direkt me këta fëmijë, por edhe të vetë sitemit tonë arsimor. Shtimi i numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta po vërehet dukshëm edhe në sistemin parashkollor.

Karakteristikat që kanë këta fëmijë i bëjnë ata më “specifikë” dhe si një sfidë më vete për sa i përket menaxhimit të tyre në klasat gjithëpërfshirëse. Kjo bën që edhe stafi i cili do të punojë me ta duhet të jetë më “i specializuar” dhe puna me ta duhet të jetë më konkrete në lidhje me nevojat dhe aftësitë që ka gjithsecili për të nxënë.

Metodat e reja bashkëkohore në mësimdhënie, siç është edhe mësimdhënia e digjitalizuar, kanë gjetur një përdorim edhe në klasat gjithëpërfshirëse. Këto metoda të reja kanë gjetur një terren të përshtatshëm edhe në shkollat shqiptare. Si një praktikë e re dhe e përparuar, përdorimi i këtyre metodave dhe teknikave të reja mbështetur edhe nga teknologjia digjitale, kanë bërë që mësimdhënia shqiptare të ndryshojë si në formë ashtu edhe në përmbajtje.

Përdorimi dhe aplikimi i teknologjisë digjitale në mësimdhënie, si risi për shkollat shqiptare, mund dhe duhet masivizuar në të gjithë sistemin tonë arsimor, si në sistemin parashkollor edhe në atë fillor. Përfshirja e

tabelave smart në klasë, krijon një klimë të re në klasë, e cila bën që mësimdhënia të jetë e mirëpërshtatur dhe e asimilueshme edhe për fëmijët me aftësi ndryshe.

Kjo “Tabelë magjike” ofron avantazhin e të qenurit një dritare e hapur e mësimdhënies enciklopedike bashkëkohore. Ajo rrit përfshirjen aktive të nxënësve në mësimdhënie si dhe ndikon ndjeshëm për një të nxënë më të qëndrueshëm për të gjithë nxënësit duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta.

Ky studim merr përsipër të analizojë se sa të përgatitur ndihen mësuesit të punojnë në drejtim të realizimit të programeve nëpërmjet një mësimdhënieje të përshtatur për nxënësit me aftësi ndryshe duke u mbështetur nga kjo teknologji.

Ndërgjegjësimi i prindërve për ta pranuar fëmijën e tij, ashtu siç ai është, si dhe diagnostikimi i saktë i fëmijës për këto “karakteristika” që në fëmijërinë e hershme, e bën më pak të vështirë edhe punën e edukatorit. Pasi ne jemi të ndërgjegjshëm që numri i fëmijëve të diagnostikuar është më i vogël se numri real i këtyre fëmijëve nëpër klasat tona.

Ky duket si një problem “i parë”, por ajo çka duhet të theksohet në këtë punim janë mundësitë që kanë mësuesit tanë për përshtatjen e kësaj mësimdhënieje, në lidhje me aftësitë dhe nevojat e gjithsecilit. Pasi përdorimi i metodave dhe teknikave bashkëkohore si dhe e teknologjisë digjitale në mësimdhënie, apo edhe përdorimi i tabelave Smart në klasë, i bënë njohuritë akademike më të lehta për t’u asimiluar edhe për këtë kategori fëmijësh.

Kjo përbën dhe një nga sfidat që ne kemi në lidhje me edukimin e këtyre fëmijëve në arsimin gjithpërfshirës. Pasi ne shohim se disa mësues nuk kanë as formimin e mjaftueshëm mbi Aftësinë e Kufizuar ose mbi “problemet” që kanë fëmijë të ndryshëm. Por ka edhe nga ata mësues që i “braktisin” këta fëmijë duke i ulur në fund të klasës ose duke mos i integruar në orën mësimore.

Prindërit nuk duhet të kënaqen vetëm me faktin që fëmijët e tyre janë të përfshirë nëpër shkolla normale, por të jenë mjaft këmbëngulës në përfshirjen dhe integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin mësimor. Ata duhet të jenë mjaft aktivë e të luajnë një rol ndihmues në punën me këta fëmijë duke pasur një informacion të përditshëm mbi ‘zhvillimin’ ose ‘ndryshimet’ që pëson fëmija i tij, madje të jenë pjesë aktive në hartimin e planeve të punës për zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Këto “sfida” lidhen me mundësinë e përshtatjes së shërbimeve, që në rastin konkret nënkupton përshtatjen e mësimdhënies në lidhje me aftësitë dhe nevojat që kanë këta nxënës. Si dhe me përshtatje të kurrikulës

me të cilën këta nxënës punojnë. Kjo ‘përshtatje’ duhet të kuptohet e të veprojë me programe ‘speciale’ që në fëmijërinë e hershme.

Qëllimi i studimit:

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë sfidat që ofron teknologjia digjitale në mësimdhënie e për më tepër në klasat gjithëpërfshirëse. Kjo mësimdhënie duhet përshtatur bazuar në nevojat dhe aftësitë që ka çdo fëmijë për një të nxënë. Ndërgjegjësimi dhe trajnimet e vazhdueshme të stafit pedagogjik drejt përdorimit të metodave dhe strategjive bashkëkohore në mësimdhënie do ta bënte këtë mësimdhënie gjithmonë edhe më të vlefshme. Por, sa të përgatitur ndihen dhe janë mësuesit për të mundësuar një mësimdhënie bashkëkohore e mbështetur edhe nga teknologjia.

Ky studim do të mundësojë një informacion vërtet të vlefshëm, në ndihmë të atyre që janë përgjegjës për marrjen e vendimeve lidhur me sistemin dhe mbështetjen që duhet të kenë mësuesit e klasave gjithëpërfshirëse. Një mbështetje do të mund të jetë edhe për mësuesit e rinj si edhe për studentët praktikantë që zhvillojnë praktikat profesionale nëpër shkolla. Pavarësisht se studimi është kufizuar vetëm në rrethin e Durrësit, rezultatet mund të jenë të vlefshme edhe për qytetet e tjera të vendit, pasi përfshirja e nxënësve me aftësi ndryshe nëpër klasa është pothuajse e ngjashme si në qarkun e Durrësit.

Pyetjet kërkimore

Pyetjet e studimit adresuar perceptimit të punës mësimore mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe në klasat gjithëpërfshirëse janë:

- Sa ndikon përdorimi i teknologjisë digjitale në mësimdhënie në lidhje me integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në orën mësimore?
- Cilat janë sfidat me të cilat përballen mësuesit gjatë përdorimit të teknologjisë në klasat gjithëpërfshirëse?

Shqyrtimi i literaturës

Shtimi i numrit të nxënësve me nevoja të veçanta, e në veçanti të fëmijëve me autizëm, përbën jo vetëm problem kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Prandaj duhet që të ndalemi më me detaje për të bërë një përmbledhje të këtij “problemi global”.

Kjo reflekton edhe në përpjekjet e studiuesve të shumtë, për t’iu përgjigjur kërkesave që shtron kjo situatë.

Është provuar se nxënësit me aftësi ndryshe mund të përfitojnë nëse në mësimdhënien e tyre përdoret teknologji bashkëkohore. Përdorimi i teknologjisë asistuese për nxënësit me aftësi ndryshe në klasat

gjithëpërfshirëse ka dhenë rezultate në arritjet e tyre¹. Përfshirja e teknologjisë rrit motivimin e nxënësve për të mësuar duke e organizuar mësimdhënien “individuale” nëpërmjet personalizimit të mësimin në bazë të nevojave individuale të nxënësve.

Shkalla e besimit tek mësuesit në këtë integrim përcakton shkallën e suksesit të programit gjithëpërfshirës (Prakash, S.S. 2012). Sipas Subban, P & Sharma, U. (2005) shkalla e besimit tek mësuesit, për një integrim dhe përfshirje të nxënësve me aftësi ndryshe në orën mësimore në këto klasa, ndikohet nga perceptimi i mësuesit, nga ku varet dhe sukcesi i këtij integrimi, por duke u mbështetur edhe nga teknologjia në mësimdhënie.

Gatishmëria e mësuesve për një mësimdhënie sa më pranë nevojave dhe aftësive të nxënësve, e cila kërkon angazhim, të menduar krijues dhe strategji efektive në klasë, është ndikuese në mësimdhënien e mbështetur nga teknologjia (Villa & Thousand 2003).

Metodat e reja në mësimdhënie si dhe përdorimi i teknikave të ndryshme me teknologji bashkëkohore, bën të mundur interaktivitetin në klasë, që realizohet si një bashkëveprim mësues-nxënës, e për më tepër kur në klasë janë të përfshirë edhe nxënës me aftësi ndryshe. Këta nxënës, me individualitetin e tyre, si dhe me mundësitë dhe aftësitë që ata paraqesin, përbëjnë bazat e një pune të diferencuar ose individuale.

Sfidat e mësimdhënies bashkëkohore për shkollën shqiptare

Aplikimi i metodave dhe i teknologjive të reja bashkëkohore që përdoren sot gjerësisht kudo në mësimdhënie, kanë hyrë dhe janë bërë pjesë e mësimdhënies edhe në shkollat shqiptare. Si një praktikë e re dhe e përparuar, përdorimi i këtyre metodave dhe teknikave të reja, kanë bërë që mësimdhënia shqiptare të ndryshojë si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Përdorimi dhe aplikimi i metodës së GBL-së (Të mësuarin me Bazë Lojën), si një risi, mund dhe duhet masivizuar në të gjithë sistemin arsimor e sidomos në lëndën e Gjuhës shqipe e veçanërisht në ciklin fillor, që të jetë i mirëpërshtatur dhe i asimilueshëm edhe për fëmijët më nevojat të veçanta.

Smartboard-i, i lidhur me internetin, i vendosur përballë nxënësve mes dy tabelave klasike, është një ëndërr sa e afërt dhe e largët për nxënësit, të etur për dije globale.

“Tabela magjike” ofron avantazhin e të qenurit një dritare e hapur e enciklopedisë bashkëkohore botërore që drejtohet çdo çast nga web, një asistente e palodhur e çdo mësuesi dhe për më tepër mik dhe shok lojërash për fëmijët.

¹ Zorigian. K & Jennifer (2010).

Implementimi i kësaj teknologjie bashkëkohore ka disavantazh koston e lartë financiare dhe mospërputhjen në nivelin e duhur të mësuesve me këtë teknologji mësimore të avancuar të mësuesve.

Modeli i mësimdhënies bashkëkohore duke përfshirë TD (Teknologji digjitale)

Smart-boardet janë: kombinimi i një table klase me fuqinë e një kompjuteri, të cilat kanë rritur angazhimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve e në veçanti edhe të nxënësve me nevoja të veçanta. Aktivitetet mësimore mund të ndërthuren dhe strukturohen për të krijuar interes dhe që nxënësit mund të përdorin idetë dhe aftësitë e mësuarat e në veçanti për ilustrime të ndryshme në orën e Gjuhës shqipe duke patur si bazë të punës GBL-në.

Për Tabelat smart në klasë mund të themi se është shumë e rëndësishme lehtësia që Smart Board-i u jep mësuesve të cilët zhvillojnë metodën e mësimdhënies me në qendër nxënësin:

- ku mësuesi në orën e Gjuhës shqipe do të ketë shumë lehtësira për ilustrime të ndryshme gjatë orës së mësimin (duke përdorur edhe figura të gatshme nga përralla të ndryshme ose nga personazhe shumë të pëlqyeshme nga fëmijët e kësaj moshe),

- ku nxënësit duhet të marrin një rol kryesor gjatë orës së mësimin dhe mësuesit duhet të largohen nga ligjëratat e tepërta, por të shkojnë në drejtim të aktiviteteve që ngjallin kureshtje.

Para së gjithash, “çfarë është një tabelë interaktive elektronike (smart board)”?

Ajo është një pajisje prezantuese që lidhet me një kompjuter. Imazhet kompjuterike shfaqen në tabelën e bardhë me anë të një videoprojektori digjital, ku ata mund të shihen dhe të manipulohen (ndryshohen/përpunohen). Përdoruesit mund të kontrollojnë software-in në dy mënyra: nga kompjuteri dhe nga bordi (tabela e bardhë). Pjesëmarrësit mund të shtojnë zëra (shenja, shënime) ose mund të theksojnë, ose nënvizojnë duke përdorur një stilolaps dhe/ose mjet theksues. Duke përdorur shkopin (një shkop i gjatë që komandohet me një klik) në vend të mouse-it, është shumë më i thjeshtë dhe më i komandueshëm edhe për fëmijët me nevoja të veçanta. Mësuesit ose nxënësit mund të veprojnë ose punojnë në tabelë direkt nga bordi. Pra mund të punohet paralelisht nga tabela e bardhë smart, por edhe nga kompjuteri. Çdo shënim ose vizatim gjatë shpjegimit mund të ruhet ose mund të printohet dhe t’u shpërndahet anëtarëve të grupit.

Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është që të analizojë mësimdhënien në klasat gjithëpërfshirëse, parë kjo në këndvështrimin e gatishmërisë, shkallën e besimit të mësuesve si dhe aksesin që kanë mësuesit/et shqiptarë për një mësimdhënie të mbështetur edhe nga teknologji digjitale në lidhje me përshtatjen e saj në varësi të nevojave dhe aftësive që kanë nxënësit me aftësi ndryshe në klasat gjithëpërfshirëse.

Studimi për nga natyra e grumbullimit dhe analizimit të të dhënave, është një studim cilësor mbështetur nga metoda cilësore në kërkim. Kjo lloj përjasjeje metodologjike, i bën më të qëndrueshme argumentet që dalin në përfundim të tij në lidhje me faktorët ndikues në këtë mësimdhënie. Instrumentet e përdorur në kërkim, janë: *Intervista* dhe *Fokus-Grupi*.

Mbledhja e të dhënave: Informacioni u mbodh nëpërmjet intervistave, vëzhgimeve dhe grupeve të fokusit me mësuesit e sitemit parashkollor dhe atij fillor. Intervistat janë zhvilluar në shkollat e qarkut Durrës. Një ndihmesë në grumbullimin e informacionit në drejtim të numrit të nxënësve me nevoja të veçanta të shpërndarë nëpër klasat respektive në bazë të moshës, kanë dhënë: Zyra e statistikës pranë ZVA-Durrës, ZVA Krujë dhe ZVA Fushë-Krujë. Nga vëzhgimet e kryera rezulton se numri i këtyre nxënësve nëpër klasa është më i madh se numri që deklarohet nga zyra e statistikës, pasi jo të gjithë nxënësit paraqiten me raport mjekësor në bazë të “problemit” që ata kanë.

Popullata dhe kampioni: Studimi është i kufizuar vetëm në sistemin parashkollor dhe në atë fillor në qarkun Durrës (përfshihen klasat e qytetit dhe të fshatrave të Durrësit si dhe Fushë-Krujës dhe Krujës). Kampioni i qëllimshëm: *mësuesit dhe klasat gjithëpërfshirëse*. Qëllimi i kësaj përzgjedhjeje është që të studiohet puna e këtyre mësuesve e sesi ata e perceptojnë punën me këta nxënës. Punimi për nga natyra do të jetë cilësor, ku do të sillen raste studimore (klasa ku janë të intergruar fëmijë me nevoja të veçanta).

Menaxhimi i të dhënave: Korniza kohore e mbledhjes së të dhënave përfshin kohëzgjatjen: Sem. II Viti akademik 2018-2019 si dhe Viti akademik 2019-2020, duke përfshirë punën kërkimore të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Leja për këtë studim për të zhvilluar intervistat, vëzhgimet dhe grupet e fokusit është miratuar nga ZVA-Durrës. Analiza e të dhënave u zhvillua paralelisht me zhvillimin e intervistave (evidencat mbi intervistat).

Nuk mund të klasifikohen të dhënat pa ditur se çfarë kuptimi ka çdo klasifikim/kategori, kështu që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë

interpretimi i të dhënave nga intervistat, vëzhgimet dhe nga grupet e fokusit, ka bërë të mundur klasifikimin e këtyre të dhënave. Të dhënat e mbledhura për këtë studim, u interpretuan me qëllim që të analizonin temat dhe konceptet e përgjithshme. Ky ishte një proces që zhvillohej paralelisht me procesin e mbledhjes së të dhënave.

Nga intervistat dhe takimet e grupeve të fokusit që janë organizuar, janë grumbulluar informacione mjaft të vlefshme nga puna konkrete e mësuesve të cilët i kanë patur ose i kanë këta nxënës në klasat e tyre. Eksperiencat e sjella janë një dëshmi shumë interesante të punës plot pasion dhe përkushtim, por dhe shumë të vështirë të disa mësueseve. Qëndrimet e mësuesve ndaj punës së tyre me këta fëmijë do t'i gruponim në dy grupe. Në grupin e parë do të përfshihen ata mësues që punojnë me pasion ku këta fëmijë kanë gjetur një "sukses" sado të vogël, por shumë premtues. Në grupin e dytë do të përfshinim ata mësues që këta nxënës i "braktisin" duke i ulur në fund të klasës ose duke mos i integruar në orën mësimore.

Kampioni i qëllimshëm i zgjedhur për plotësimin e *Intervistave*, mbi rëndësinë në përzgjedhjen e pjesëmarrësve duke mos i paragjykuar (Gerson & Horowitz 2002). Ata theksojnë se "në përzgjedhje, të intervistuarit duhet të jenë pjesë e fushës së studimit". Qëllimi në këtë përzgjedhje është: të përzgjidhen incidentet, e më pas të mblidhen të dhëna për të siguruar kuptimin e dukurive që studiohen. Numri i mësuesve të intervistuar nga tri shkollat ishte 51 mësues, (n=51), nga ku 49 ishin mësuese femra dhe 2 ishin mësues.

Qëllimi organizues i fokus-grupit në këtë studim, ishte *konsultues* dhe *vlerësues*. Ky *Fokus-Grup* u përdor për marrjen e informacionit në lidhje me qëndrimet e mësuesve si dhe çfarë mendojnë ata në lidhje me vështirësitë që kanë me përfshirjen e nxënësve me aftësi ndryshe. *Fokus-grupi* u organizua në mënyrë të tillë që të grumbullonte një informacion më të detajuar në lidhje me mësimdhënien në klasat gjithëpërfshirëse.

Kampioni i përzgjedhur për *Fokus-Grupin*, u organizua me pjesëmarrës, të cilët kishin eksperiencën në mësimdhënien me nxënës me aftësi ndryshe. Pjesëmarrësit ishin mësues të ciklit Parashkollor dhe Fillor, nën/drejtorë si dhe inspektorë të ZVA-ve. Ato u përzgjedhën në mënyrë të qëllimshme, pasi ishin mësues që kishin në klasat e tyre nxënës me aftësi ndryshe apo kishin patur më parë eksperiencën me këta nxënës. Prania e 16 pjesëmarrësve (n=16) e bëri takimin shumë interesant nga ku: 2-ishin përfaqësuese të ZVA (Durrësit); 3- Nën/Drejtorë që mbulojnë Arsimin Fillor në shkollë (Durrës-Shijak); 1- Mësuese e Arsimit Parashkollor; 10- Mësuese të Arsimit Fillor,

Tabela e mëposhtme do të japë një përmbledhje të eksperiencës në mësimdhënie të pjesëmarrësve në: *intervista* dhe *fokus-grup*.

Tabela 1. Eksperienca në mësimdhënie.

Pjesëmarrës:	Intervista	Fokus-Grup
	n=51	n=16
deri në 5 vjet	12 %	12 %
6 - 10 vjet	4 %	12 %
11 – 20 vjet	27 %	38 %
Mbi 20 vjet	57 %	38 %

Metoda e analizës së të dhënave cilësore

Për analizën me të dhënat cilësore të grumbulluara nga *Intervistat* dhe *Fokus-Grupi*, u veprua si më poshtë: *së pari*, u krijua një tregues ku me lehtësi mund të shihen të dhënat e papërpunuara; *së dyti*, u krijuan kodet për secilin respondent; *së treti*, u krijuan disa seksione ku u bë e realizueshme përmbledhja e të dhënave sipas disa çështjeve që u identifikuan që në fillim si pjesë përbërëse e intervistës dhe fokus-grupit; *së fundmi*, krijimi i tabelave përmbledhëse, ku secili shikon me lehtësi të gjitha kategoritë ose çështjet në të gjitha rastet.

Gjetjet e studimit

Rezultatet e intervistave

Duke u bazuar në interpretimet e përgjigjeve të të intervistuarve, u bë kategorizimi i temave, më pas u bë edhe përshkrimi dhe interpretimi i këtyre kategorive nëpërmjet diagramave, grafikëve sipas seksioneve mbi të cilat është hartuar intervista.

Tabela 2. Interpretimi dhe identifikimi i kategorive të temave.

Tema paraprake - Komentet mbi arsimin gjithëpërfshirës	Interpretimi fillestar	Kategoritë
Int. (1)- “Unë jam pro idesë së integritit dhe përfshirjes së fëmijëve në klasat e	Pro gjithëpërfshirjes, por s’ka kushte të përshtatshme. Mësuesit duhen trajnuar për përdorimin e teknologjisë	Pro gjithëpërfshirjes, por me plotësim të kushteve.
përgjithshme mirëpo kushtet janë të papërshtatshme për fëmijët me aftësi ndryshe. S’kemi trajnime të mjaftueshme” ; Int. (2)- “Unë personalisht nuk jam dakord, pasi këta lloj nxënësish injorohen dhe tallen më shumë në këto mjedise”;	digjitale dhe klasat duhet të jenë të përshtatshme. Jo gjithëpërfshirje, pasi nxënësit i venë në lojë.	Trajnim mësuesve. Jo gjithëpërfshirjes.
Int. (3)- “Sipas përcaktimit të shkallës së diagnostikimit duhet të ingranohen në klasa të përgjithshme”;	Të kihet parasysh shkalla e rëndesës e cila përcakton llojin e klasës (speciale apo e përgjithshme).	Shkalla e rëndesës është përcaktuese.
Int. (4)- “Për nxënësit me aftësi ndryshe është anë pozitive, por për nxënësit e tjerë është problem (nëse nxënësi është nga ana mendore) se i ngacmon apo i shqetëson. Këtë e kam nga përvoja ime, megjithatë për mua si mësuese jam dakord për përfshirjen e nxënësve të tillë”;	Nxënësit me aftësi ndryshe pësojnë progres akademik. Pro gjithëpërfshirjes.	Gjithëpërfshirja progres akademik për nxënësit me aftësi ndryshe

<p>Int. (5)- “Jam dakord të përfshihen këto nxënës me A.K. në shkolla publike. Por mos të harrojmë shteti, vështirësia e mësueses dhe nxënësve lë për të të dëshiruar. Prandaj një mësues asistent është shumë i domosdoshëm në klasat ku këta nxënës frekuentojnë”.</p>	<p>Pro gjithpërfshirjes.</p> <p>Shteti të kujdeset më shumë.</p> <p>Prania e mësuesit asistent në klasë.</p>	<p>Pro gjithpërfshirjes.</p> <p>Kujdesi i shtetit për këto klasa.</p> <p>Mësues mbështetës.</p>
--	--	---

Për pyetjen: “Kush ju mbështet nëse keni edhe nxënës që janë me aftësi ndryshe?” ja disa nga përgjigjet, Int.(1) shk. (2) “Më mbështet vetëm një kolege e grupit tjetër, ndërsa prindi, jo”; Int.(1) shk. (1) “Nuk është i diagnostikuar, do të më ndihmonte shume nëse do të ishte i tillë. Nuk më ndihmon askush”; Ja si përgjigjet një mësues tjetër, Int. (4) shk. (1) “Jo askush nuk të mbështet, çdo mësues duhet të hartojë një PEI ose të arrijë i vetëm realizimin e programit”; apo Int. (2) shk. (2) “kam mbështetje nga mësuesi ndihmës”; Int.(3) shk. (2) “Nuk na mbështet askush”; Int.(5) shk. (2) “Mbështetje të plotë kam pasur nga psikologu i shkollës”.

Grafiku 1. Mbështetja që i jepet mësuesve kur kanë në klasë nxënës me aftësi ndryshe të (pa)diagnostikuar.




Në lidhje me trajnimet kemi këtë panoramë: 60.9% e mësuesve deklarojnë se janë të patrajnuar në lidhje me përdorimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënie; 17.4% janë të trajnuar dhe 21.7% nuk janë përgjigjur. Le të njihemi me disa prej përgjigjeve: Int. (1) “Po, në Universitet kam marrë njohuri, por jo trajnime. Nuk jam trajnuar as për mësimdhënien e diferencuar. E ndiej shumë domosdoshmërinë për këta lloj nxënësish”; Int. (2) “Trajnimi është shumë i domosdoshëm”; Int. (17) “Po jam trajnuar për përdorimin e teknologjisë në klasë, por është e domosdoshme trajnimi në vazhdimësi’.

Grafiku 2. Mbi trajnimin e mësuesve sipas shkollave.



Pjesëmarrësit në fokus-grup mbulonin këto detyra: përfaqësues të ZVA; nën/drejtor; mësuese të parashkollorit si dhe mësuese të arsimit fillor.

Grafiku 3. Detyrat që mbulojnë pjesëmarrësit e fokus-grupit.



Në lidhje me informacionin mbi domosdoshmërinë e trajnimeve si dhe për “mësimdhënien e përshtatur duke u mbështetur edhe nga teknologjia” mund të analizojmë përgjigjet: (15) *“Duke qenë se jam nën/drejtorëshë dhe mbuloj arsimin fillor, marr pjesë në të gjitha trajnimet. Por kjo nuk duhet të mjaftohet vetëm me trajnime teorike, kemi nevojë për trajnime më konkrete në lidhje me mësimdhënien me këta nxënës, pasi mësuesit tregojnë gatishmëri për të punuar, por nuk dinë “se si” të punojnë me këta nxënës. Në trajnime, nuk duhet të jetë i kufizuar numri i pjesëmarrësve, në këto trajnime duhet të marrin pjesë në mënyrë të pashmangshme të gjithë mësuesit që kanë në klasë nxënës me aftësi ndryshe si dhe të shtohet numri i trajnimeve që organizohen”.*

Rezultatet nga fokus-grupi

Nga interpretimi i fokus-grupit, në lidhje me avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të teknologjisë në klasat gjithëpërfshirëse, mund të themi që:

Tabela 3. Avantazhet dhe disavantazhet e tabelave smart.

Avantazhet	Disavantazhet
Nxënësit me aftësi ndryshe e lexojnë më qartë sepse është shkrim kompjuterik dhe manipulohet në zmadhim/zvogëlimin e shronjave (në varësi të “problemit” që shfaq nxënësi.	Shkëputja e internetit është një problem.
Ndihmon të kuptuarin sa më mirë të mësimin për shkak të prezantimeve me powerpoint. Gjithashtu mund të prezantojmë më së miri projekte të ndryshme.	Jo e lehtë për t’u përdorur nga çdo anëtar i stafit, rreziku i prishjes dhe kostot e larta të riparimit, vështirësitë dhe problemet e softuerit.
Rrit zhvillimin mendor dhe fizik të nxënësve, përmirëson bashkëpunimin dhe ndërveprimin nxënës-mësues, përparësitë pa letra, inkurajon mësuesit të japin mësim në kohë reale me orë mësimore me audio, video etj.	Mund të krijojë probleme me shikimin.
Zgjat kohën e shpjegimit, pasi mësuesi nuk harxhon kohë duke shkruajtur në tabelë; gjithashtu nuk	Smartboard kërkon një mjedis jo shumë të ndriçuar dhe nxënësi

harxhohet kohë nga pyetjet e nxënësve për fjalët të cilat nuk mund t'i kuptojnë nga shkrimi i mësuesit.	mund të ndihet i lodhur apo edhe i përgjumur.
Të aftësojë mënyrën e të folurit, pasi i dëgjon fjalët e reja me shqiptim shumë të mirë. Në mënyrë më specifike nxënësit me disleksi).	
Mësimi bëhet më interesant dhe më i qartë.	

Avantazh tjetër i tabela smart në klasë është përdorimi i ngjyrave, vizatimi i pjesëve të ndryshme të skemave gjatë shpjegimit e cila përshatet në varësi të karakteristikave që paraqet nxënësi etj. Avantazhi i dërrasës së zezë: është më praktike dhe e shpejtë për të shkruar. Në smartboard ke më shumë kohë në dispozicion për të shpjeguar dhe nuk ke nevojë të shkruash, ndërsa pluhuri i shkumësit të shqetëson.

Smartboard-i të lejon me tepër aktivitete dhe ora e mësimit është më e gjallë për nxënësin me aftësi ndryshe dhe më pak e mërzitshme dhe shumë me tepër interaktive nëse përdoret shumë mirë nga mësuesi. Pasi disa nxënës kanë aftësi shumë të mira në përdorimin e teknologjisë, si p.sh. nxënësit autik.

Nëpërmjet Smartboard mësimi bëhet me interesant dhe më i qartë, paraqitet mendimi i mësuesve në lidhje me motivimin që Smartboard ka në të mësuarit e nxënësit. Kur u pyetën nëse mendonin se përdorimi i Smartboard-it ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësit shumica e mësuesve u përgjigjën "po". Sipas eksperiencës së tyre është parë që kjo pajisje mund ta motivojë më tepër nxënësin në procesin mësimor. Nga përgjigjet e mësuesve shohim se 92% mendojnë se kjo pajisje ndikon në motivimin e nxënësve dhe vetëm 8% nuk përputhen me këtë ide.

Përdorimi i kësaj pajisjeje teknologjike paraqet vështirësi në lidhje me familjarizimin me të, por trajnimet e vazhdueshme e zëvendësojnë këtë vështirësi. *"Nëse më parë duhet të shpenzoja shumë kohë me përdorimin e dërrasës së zezë duke shkruar çdo fjalë të re, me anë të programit Interaktiv të cilin librat e ofronin enkas për përdorim në këto tabela çdo gjë u bë më e lehtë"* - thotë një mësuese. *"Përdorimi i shkumësit gjatë gjithë kohës, i cili me shkakonte edhe alergji herë pas herë, nuk ishte më i nevojshëm. Mësimi bëhej më interesant, mund të mbaroja më shpejt shumë"*

nga ushtrimet dhe nxënësit mund të kuptonin më mirë”.

Po të krahasohen përgjigjet e mësuesve të intervistuar, përputhen me përgjigjet e pjesëmarrësve në fokus-grup, pasi tregohet një interesim gati në një “etje” në lidhje me trajnimet e mësuesve për “Mësimdhënien mbështetur në teknologji” duke parë si domosdoshmëri përshtatjen e mësimdhënies në varësi të nevojave dhe aftësive që kanë nxënësit. Nga ky studim del se tabelat smart janë një pajisje shumë e vlefshme dhe me shumë përfitime gjatë procesit mësimor.

REKOMANDIME:

- Ngritja e komisioneve shumëdisiplinore në mënyrë që të bëjnë përcaktimin e nevojave arsimore për fëmijët me aftësi ndryshe, në lidhje me përshtatjen e programit në bazë të nevojave dhe aftësive të gjithsecilit, mbështetur nga teknologjia digjitale;
- Përshtatja e mësimdhënies në varësi të nevojave dhe aftësisë për të nxënë;
- Trajtime të vazhdueshme për mësuesit në lidhje me mësimdhënien dhe pëdorimin e teknologjisë digjitale;
- Ndërgjegjësim mbi pëdorimin dhe zbatimin me korrektësi të PEI-ve;
- Pajisje sa më e gjerë e shkollave me tabela smart, pasi janë mjete shumë lehtësuese në integrimin e nxënësve me aftësi ndryshe në orën mësimore etj.

BIBLIOGRAFIA

- Duka.A. (2010). *Probleme të punës mësimore me fëmijët me nevoja të veçanta Media/Print*.Tiranë.
- Zaqellari, S. (2011). *Autizmi në këndvështrimin psikoedukativ*. Shtëpia botuese Onufri.Tiranë.
- Warnock, M (2005). *Special Educational Needs: a New Look*. Philosophy of Education Society of Great Britain, No.11 in a series of policy discussion, London: Impact.
- Turku, A. (2002). *Hyrje në edukimin Special’* Sejko, Elbasan.
- Hegarty, S. (1993) *Educating children and young people with disabilities: principles and the review of practice*. UNESCO.
- Meijer, C.J, & Hegarty.S. (1997). *Inclusive Education: a global agenda*, pp. 115-130, London: Routledge.
- Hegarty, S (1997). *Inclusion: Implementation and Approaches*. In S. J. Pilj, C.J.W.Meijer & S.Hegarty (Eds.) *Inclusive Education: a global agenda*, pp. 150-162, London: Routledge.
- Kruse, D. & Hale, Th. (2003). *Disability and Employment: Industrial Relations*, Vol. 42, No.1, pp. 2-11.
- Cruickshand W. & Hallahon D. (1973) “*Psychoeducationnal Foundations of Learning*

- Disabilities*". Prentice-Hall, Englewood cliffs, New Jersey.
- Harding, L. (1986) *Learning Disabilities in the primary classroom*. UK.
 - Samuel, A. & James J. Gallagher. (1986). *Educating Exceptional Children*. Houghton Mifflin Company, Boston, USA.
 - Webster, A. & McConnell, C. (1987). *Children with Speech and Language Difficulties*. Cassell. London.
 - Jeffree, D. & McMonkey, R. & Hewson, S (1993). *Teaching The Handicapped Child*. Redwood Press Limited, Melksham, Wiltshire, UK.
 - Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar, Tiranë, 2002.
 - .Ligji Nr.7952, Për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Tiranë, 1995.
 - Ainsworth, M. (1994). *Special need in the clasrrom. A teacher education guide*. Unesco Publishing, GB.
 - Drakos, J. (2003). *Sinhrona themata tis idhikis pedagogikis*. "Atrapos" Athinë.
 - Pallant.J. (2010). *SPSS Survival Manual*. 4th edn). McGraë-Hill Companies
 - Cohen, L. & Manion, L. (2000) *Research Methods In Education* (5th edn).
 - Cone, J & Foster, S. (2006). *Dissertations and theses from start to finish* (2nd edn). Washington: APA.
 - Adelman, H.S. & Taylor, L. (1987). *An Introduction to Learning Disability*, London: Scott Foresman.
 - Brennan, W.K. (1985). *Curriculum for Special Needs*, Milton Keynes: Open University Press.
 - Elkins, J. (1991). 'Current perspectives on learning difficulties', *Australian Journal of Remedial Education* 23, 4:201-14.
 - Graham, S. & MacArthur, C. (1988) 'Improving learning disabled students' skills at revising essays on word processor', *Journal of Special Education* 22:133-52.
 - Cook, R., Tessier, A. & Armbruster, V.B. (1987). *Adapting Early Childhood Curricula for Children with Special Needs* (2nd edn), Columbus: Merrill.
 - Ekwall, E. (1985). *Locating and Correcting Reading Difficulties* (4th edn), Columbus: Merrill.

Webliografia:

- <http://www.disability-europe.net/en/home;>
- <http://www.teachervision.fen.com/special-education/resource/2973;>
- http://www.teach-nology.com/teachers/special_ed/inclusion/
- http://www.suite101.com/article.cfm/special_education/117322;

BALANCA EMOCIONALE PËR NJË SHËNDET TË MIRË

Lediana Xhakollari, Adelina Kakija, Entela Xhakollari

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Punës Sociale

ABSTRAKT

Tashmë dimë që emocionet influencojnë shumë aspektin tonë të mirëqenies. Fakti që emocionet përfshijnë sjellje, mendime dhe kulturë lind pyetja: "Nëse apo deri në çfarë masë emocionet janë racionale"? Sipas Aristotelit problemi nuk është tek emocionet, por tek mënyra dhe masa e shprehjes së tyre.

Në këtë punim do të përpiqemi t'u japim përgjigje pyetjeve si vijon: "A mundet që emocionet të jenë të kontrollueshme"? "Çfarë ndodh kur ne kemi një emocion apo mbi emocion jo pozitiv si stres, ankth etj"? "A mundet kjo gjendje të zhvillojë sëmundje"? "Cilat janë emocionet, situatat emocionale armike të shëndetit tonë"? "Cili është kapaciteti/aftësia ku ne duhet të priremi, tentojmë për të menaxhuar mirëqenien tonë"? Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve më lart do të shërbejnë një rrjet i madh studimesh të cilat po zbulojnë dita-ditës se lëndët kimike që shërbejnë për përçimin e emocioneve dhe që veprojnë kryesisht në tru dhe në sistemin imunitar janë pikërisht ato që gjenden në zonat neurologjike dhe që rregullojnë emocionet. Duke qenë se shëndeti emocional është më shumë një proces sesa një qëllim, njohja dhe përdorimi tashmë i teknikave do të ndihmonte në forcimin e balancës emocionale.

Konkluzione: shumë vendime që ne marrim mbështeten mbi një bazë emotive. Mendja vjen më vonë për të shpjeguar psenë dhe për të justifikuar. Emocionet në vetvete nuk janë sjellëse të sëmundjeve. Emocioni i represuar ose i bllokuar i cili nuk mund të derdhet, rrjedh në një mënyrë të lirë sipas vijës së tij të shkarkimit mund të bëhet shkak i shfaqjes së problematikave të ndryshme. Situatat emocionale të cilat dëmtojnë mirëqenien tonë janë: gjendja e pakënaqësisë, zemërimi i shtypur/armiqësia, izolimi dhe emocione të shtypura në tërësi. Për të menaxhuar më mirë mirëqenien tonë duhet të zhvillojmë aftësinë "let it go" ose "lëre të shkojë" i cili është përkthim i një veprimi normal, fiziologjik në përgjigje të emocionit.

Fjalët kyçe: emocion, mirëqenie, fiziologji, aftësi/kapacitet, racionalitet.

Emotional balance for good health

ABSTRACT

We already know that emotions greatly influence our aspect of well-being. The fact that emotions involve behavior, thoughts, and culture raises the question of whether or to what extent emotions are rational? According to Aristotle the problem is not with emotions but with the way and extent of their expression.

In this paper we will try to answer the questions: Can emotions be controllable? What happens when we have an emotion or over non-positive emotion like stress, anxiety etc? Can this condition develop disease? What are the emotions, the emotional situations of our health? What is the capacity / ability where we should lean, try to manage our well-being?. To answer the above questions will serve a large network of studies which are discovering day by day that chemicals that serve to convey emotions and that act mainly on the brain and immune system are exactly the ones found most in neurological areas that regulate emotions. Since emotional health is more a process than a goal, already knowing and using the techniques would help strengthen emotional balance.

Conclusions: Many of the decisions we make are based on an emotional basis. The mind comes later to explain why and to justify. Emotions in themselves are not disease-causing. Repressed or trapped emotion which cannot be poured, flows in a free way according to its discharge line can cause the emergence of various problems. Emotional situations which harm our well-being are: state of dissatisfaction, anger repressed / hostility, isolation and emotions suppressed as a whole. To better manage our well-being we need to develop the ability to "let it go" which is a translation of a normal, physiological action in response to emotion.

Keywords: emotion, well-being, physiology, ability / capacity, rationality.

"Midis stimulit dhe reagimit ka një hapësirë. Në atë hapësirë është fuqia jonë për të zgjedhur përgjigjen tonë. Në përgjigjen tonë qëndron rritja dhe liria jonë".

Viktor Frankl

Hyrje

Ndryshe nga më parë kur nuk mund të bëhej fjalë për emocione humane gjë e cila i përkiste më shumë anës artistike, muzikës, pikurës, poezisë, romancave, tashmë dimë që emocionet janë të rrënjosura thellë në trup duke zënë një vend të rëndësishëm në të. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit janë shtuar studimet në fushën e emocioneve. Teknologjia e re e imazherisë së trurit ka zbuluar një prej mistereve më të mëdha: si funksionon saktësisht kjo masë e ngatërruar qelizash kur ne mendojmë, ndiejmë, fantazojmë dhe ëndërrojmë, si qendra e kontrollit të emocioneve në tru na bën të shpërthejmë në zemërim apo të shkrehemi në lot (Goleman, 1995, fq. 11). Ne dimë dhe njohim rrugën e shkarkimit fiziologjik të emocionit në trupin tonë. Dimë gjithashtu që nga ana afektive çdo emocioni i korrespondon e gjitha një neurokimi. Ekziston një kimi e mërzitjes, një kimi e gëzimit, frikës etj. Emocionet janë fakte fizike të lidhura me muskulaturën, sistemin nervor si dhe me sistemin e organeve të brendshme. Sistemi imunitar i përgjigjet emocioneve pozitive dhe negative në mënyra të ndryshme. Një pikëpamje e gjatë e traditës tregon shfaqjen e emocioneve si kërcënim të racionalitetit. Pavarësisht që Aristoteli sugjeroi se njerëzit janë “kafshë rationale”, ai në asnjë mënyrë nuk përjashtoi emocionet nga natyra njerëzore. Fakti që emocionet përfshijnë sjellje, mendime dhe kulturë ngre pyetjen nëse apo deri në çfarë mase emocionet janë rationale. Për filozofët e tillë si Platoni (rreth 428 deri 348 pes) dhe David Hume (1711-76) të cilët konceptuan emocionet dhe racionalizmin si kontradiktore, një pyetje e tillë ishte e papërshtatshme që nga fillimi. Psikologët i konsiderojnë emocionet si gjendje komplekse që përfshijnë aspekte të ndryshme. Nga njëra anë një emociion është një gjendje fiziologjike e zgjimit nga ana tjetër ai përfshin një objekt që ka një domethënie të caktuar ose vlerë për individin. Frojd (1915) i quante emocionet shkarkime fiziologjike që shfaqen në formën e ndjenjave. Sipas Watson (1924) emocionet janë model reagimi i trashëguar, i lidhur ngusht me sistemin e organeve. Reagim trupor i modeluar shkaktuar nga ngacmues të ndryshëm të brendshëm apo të jashtëm i përcaktonte Plutchik. Ndërsa sipas Izard (1972) emocionet janë aspekte neurofiziologjike, lëvizore dhe sjellore. Teoria më e freskët mëton se nuk kemi një tru emocional të mirëvendosur dhe mirëpërcaktuar, por kemi një

sistem qarqesh të mirëkoordinuar të përhapur në të gjithë trupin (Goleman, 1995, fq. 369). Debate të shumta mbi veçoritë biologjike të çdo emocioni vazhdojnë (p.sh. Paul Ekman dhe Richard Davidson). Megjithatë shkencë sot është në gjendje të flasë me autoritet për këto çështje sa urgjente aq të vështira të mendjes irracionale.

Teoritë për emocionin

Shumë autorë kanë zhvilluar teori dhe eksperimente në përpjekje për të shpjeguar se si funksionojnë emocionet.

Një nga autorët e parë në shpjegimin e emocioneve është **Charl Darwin**. Teoritë e tij rreth emocioneve janë të përshkruara në librin “Shprehja e emocioneve te njeriu dhe kafshët” (Darvini, 1872).

Kjo teori bazohet në dy premisa:

Mënyra në të cilën speciet aktualisht shprehin emocionet e tyre (gjestet e fytyrës dhe trupit) ka evoluar nga sjelljet e thjeshta treguese të përgjigjes që zakonisht jep individi.

Përgjigjet emocionale janë adoptuese dhe përmbushin një funksion komunikues, në mënyrë që ato të shërbejnë për të komunikuar tek individët e tjerë se çfarë ndiejmë dhe cilat sjellje do të kryejmë. Ndërsa emocionet janë rezultat i evolucionit, ato do të vazhdojnë të evoluojnë duke iu përshtatur rrethanave dhe do të zgjasin me kalimin e kohës.

Më vonë, dy psikologë zhvilluan dy teori për emocionin. I pari ishte psikologu amerikan William James (1884) dhe i dyti psikologu danez Carl Lange. Këto teori u kombinuan në një dhe sot njihet si teoria e James-Lange.

Teoria James-Lange shtjellon se nxitshmëria fiziologjike dhe sjellja paraprijnë eksperiencën subjektive të emocionit. Trupat tanë reagojnë automatikisht ndaj disa ngacmuesve mjedisorë dhe ne bëhemi të vetëdijshëm se këto reagime formojnë një emocion të caktuar, të cilin më pas e ndiejmë. William James më 1884 dhe Carl Lange më 1885 duke punuar secili më vete arritën në përfundimin e ngjashëm sipas së cilës sjellja i paraprin emocionit. Në qoftë se ndërgjegjësimi për një emocion të caktuar është i njëjtë me ndërgjegjësimin për një gjendje fizike të trupit, atëherë mund të thuhet se për një emocion ekzistojnë gjendje fiziologjike të ndryshme dhe krejt të përcaktuara.

Teoria e Cannon-Bard i përket studiuesve Walter Cannon (1927) dhe Philip Bard (1928) të cilët nuk ishin dakord me teorinë e James-Lange, pikërisht për faktin se shumica e emocioneve kanë pothuajse të njëjtën nxitshmëri fiziologjike. Sipas kësaj teorie emocioni dhe nxitshmëria fiziologjike ndodhin në të njëjtën kohë, por në mënyrë të pavarur.

Teoria e eksitim-kognicionit e Schachter-Singer thekson rolin e faktorëve kognitivë mbi emocionet. Kur përjetojmë emocion, para së gjithash, ne jemi të eksituar fiziologjikisht. Më pas kërkojmë një shpjegim mjedisor për eksitim që kemi. Ne e interpretojmë kognitivisht situatën dhe e emërtojmë eksitim si emocion përkatës.

Teoria funksionale e **Plutchik** (1980). Ai e konsideronte emocionin si një zinxhir reagimesh që vijnë njëri pas tjetrit: ngjarja ngacmuese (stimuluese), kognicioni, ndjenja dhe sjellja për të mbijetuar. P.sh., në qoftë se ju afrohet një i panjohur në një vendparkim, zinxhiri do të jetë: pikasja e të huajit (ngjarja ngacmuese), të menduarit e rrezikut (kognicioni), përjetimi i frikës (ndjenja) dhe largimi me nxitim (sjellja). Kjo seri reagimesh do të ndodhë gjatë atyre emocioneve që kanë funksion mbrojtës. Plutchik shfaq mendimin se emocioni siguron mbijetesën e individit. Ai e vë theksin te kognicioni duke shprehur idenë se individ mund ta parashikojë të ardhmen duke përdorur të menduarit.

A mundet emocionet të jenë të kontrollueshme?

Natyrisht në realitet siç dhe emri i tyre tregon emovere nga latinishtja janë kryesisht reagime apo reaksione të stimujve janë përgjigje ndër të tjera, përgjigje që janë programuar në sistemin tonë në memorien tonë në mënyrë arkaike. (Emocion-*emotionem* nga *emotus-emovere*- që ka kuptimin të lëvizë, tund, të nxjerrë jashtë, ngritje shpirtërore, entuziazëm). Emocionet bazë janë identike si në qeniet njerëzore ashtu dhe tek kafshët (gjitarët). *Cilat janë emocionet bazë:*

Profesor Pol Ekman një nga ekspertët më të famshëm të emocioneve ka përcaktuar emocionet e Gëzimit, Mërzitjes, Frikës, Surprizës, Trishtimit, Neverisë dhe që i bashkëngjitet dhe një i shtatë që në realitet është Mospërfillja apo Përçmimi. Robert Plutchik (1980), arriti t'i klasifikonte në një rreth, në tetë emocione bazë, si: **gëzimi, frika, pranimi, habia, trishtimi, neveria, zemërimi dhe kundërveprimi**. Këto emocione që quhen parësore, kombinohen për të formuar emocionet e tjera që janë: dashuria, përlulja, tmerri, zhgënjimi, keqardhja, përbuzja, agresiviteti, optimizmi etj.

Sipas studimeve të fundit emociomet nuk mund të jenë të kontrollueshme sepse i përgjigjen programeve afektive të cilat janë fiksuar nga evolucioni dhe që në anën tjetër janë të lidhura me mbijetesën. Ne kemi një tru emotiv që i përgjigjet stimujve shumë shpejt, në mënyrë të menjëhershme në një mënyrë të programuar dhe automatike respektuar korteksin cerebral. Ai është impulsiv, i fuqishëm dhe nganjëherë nuk ka asgjë të përbashkët me logjikën. *Shembull:*

Jemi në makinë duke guiduar dhe papritur një mace na pret rrugën. Në

fraksionin e pak sekondave ne jemi në gjendje të frenojmë duke shtypur frenat në mënyrë që të evitojmë macen ndërkohë që gjithë trupi ynë po reagon. Kemi një reagim simpatik, zemra që rreh fort, jemi të tensionuar. E gjitha kjo vjen totalisht nga jashtë pjesës racionale, vjen instiktivisht fiksuar nga evolucioni. Truri ynë emotiv që është sistemi limbik, amigdala, hipokampusi, talamus i të gjitha këto struktura, por dhe të tjera i duhen të paktën 15 mijë sekonda për të aktivizuar në trurin tonë përgjigjen dhe korteksi për ta ripunuar i duhet 25 mijë e cila tregon që mendimet të cilat ne kemi macja më preu rrugën, fatmirësisht nuk ndodhi asgjë vijnë/arrijnë gjithmonë pas. Mendimi është gjithmonë retrospektiv në lidhje me emocionet. Kështu që trupi ynë është teatër i emocioneve tona shumë më përpara se mendimet tona ta kuptojnë.

Çfarë ndodh:

Ndodh që ne jemi qenie që jetojmë një jetë psikike e cila është një sforco konstante të simbiozave ndërmjet një pjese që është racionale që mendon dhe që i vendos mendimet në rend që ndjekin njëra-tjetrën dhe i kontrollon, që kërkon të dijë se cilat gjëra janë të drejta apo të gabuara dhe një pjese emotive që përkundrazi reagon sipas programeve antike, të lashta që janë në trup e që nëse ne nuk i njohim nuk mësojmë t'i dëgjojmë realiteti do të dominojë. Shumë vendime që ne marrim i marrim mbi një bazë emotive. Mendja vjen më vonë për të shpjeguar psenë dhe për të justifikuar. Sipas Sigmund Frojd *“njeriu nuk është padron në shtëpinë e tij është dikush tjetër që bën atë çfarë don dhe kjo është e pandërgjegjshmja, por nga ana tjetër është një pasuri sepse atje gjendet mundësia e të diturit se kush funksionon para mendjes sime duke rilidhur një vetvete që është naturale e lidhur me natyrën fillestare, instiktive e cila din se çfarë është e mirë për mua”*. Shpesh personat ngjallin telashe ose situata të vështira sepse ata nuk kanë dëgjuar pikërisht emocionet dhe të ndjerit i gatshëm.

Çfarë ndodh kur ne kemi një emocion apo mbi emocion jopozitiv stress, ankth? Mund të zhvillojë sëmundje?

Duhet konsideruar që emocionet në vetvete nuk janë sjellëse të sëmundjeve. Emocioni i represuar ose i bllokuar një emocion i cili nuk mund të derdhet, rrjedh në një mënyrë të lirë sipas vijës së tij të shkarkimit. P.sh. ndjehemi të zemëruar ku zemërimi ka një vijë shkarkimi një model somatik fillon në fund të barkut (abdome) ngjitet si një sensacion i të nxehtit si një vulkan dhe e ndiejmë është gati të shpërthejë arrin deri në gjoks, kraharor në qoftë se nuk është bllokuar ndjek rrugën e tij naturale fiziologjike zbret në duar duke reaguar me mbylljen e dorës pozicion i cili

tregon që ne jemi të gatshëm për të transferuar një goditje. Kjo ka një shpjegim evolucionist duke qenë se zemërimi si emocion shërben si një reagim ndaj një pengese. Kështu që në vetvete zemërimi ka dobishmërinë e tij.

Nëse ne e lejojmë të rrjedhë dhe e dëgjojmë ky emocion është si një valë deti ngjitet manifestohet në trup dhe zbret. Dhe nuk jep asnjë problem përkundrazi është një fenomen natyral.

Kur ngrihet problemi?

Problemi buron kur nuk e lejojmë të ndjehet emocionin e cila ndodh për disa arsye p.sh. kam mësuar se nuk duhesh të zemërohesh, sepse kur kam qenë fëmi isha i kastruar rreptësisht, kam frikë të mërzitem se mos i bëj këq dikujt etj., si rrjedhojë e bllokuj duke mos e lejuar që të ndjekë rrugën e tij natyrale, por duke devijuar. Kështu që çlirohet një reaksion që pa dyshim ka lidhje elektrike, biokimike në të cilin aktivizimi energjistik, çlirimi i energjisë i cili duhet realizuar nëpërmjet krahëve nuk ndodh duke u përqendruar mbi muskulaturën dhe si rrjedhojë shkaktimin p.sh. e një cefali të një muskuli intensiv ose mbi muskulaturën e trupit. Persona p.sh. me lomborgji kronike e shkarkojnë emocionin në këtë pjesë.

Cilat janë emocionet, situatat emocionale armike të shëndetit tonë ?

Sipas Poli, P. (2014) janë katër situatat emocionale të cilat më së shumti dëmtojnë mirëqenien tonë.

- Gjendja e pakënaqësisë

Të gjithë ne kemi provuar se në ditët e sotme fjala krizë vazhdon të jetë refren i përditshëm gjë e cila përforcohet nga media, gazetatat të cilat vazhdojnë të na i rikujtojnë këto mesazhe kështu që sensi i insodisfaksionit i sensit të mungesës, mospasja e asaj çka t'i do të dëshirojë besoj që është "nën pëlhurën e përditshme" dhe absolutisht e rrezikshme për shëndetin tonë.

- Armiqësia, zemërimi ishtypur (inat, mëri)

Armiqësia është derivat i zemërimit të represuar. Zemërimi është një emocion i nxehtë që kur represohet fillon të kristalizohet, ngurtësohet para në zemërim pastaj në urrejtje dhe kur brenda nesh kjo ndodh kemi të gjithë ndryshimet hormonale, neurofiziologjike dhe të sistemit imunitar.

- Izolimi

Izolimi është sensacioni i të qenit vetëm, i privuar nga ndihma, mbështetja. Shpesh kjo vihet re tek pacientët me sëmundje tumorale eksperiencia e vetmisë apo të pasurit e një gjeje e cila nuk është e ndashme me të tjerët dhe që nuk mund të kenë të mundur asnjë lloj ndihme është mjaft prezente gjë e cila bën që dhe përgjigjet ndaj terapive të jenë minimale.

-Emocione të shtypura në tërësi

Janë të gjitha situatat në të cilën ne me marrëdhëniet e kundërta me të tjerët ose me sensacionet e pozicioneve sfidante ose me shmangien, durimin, cinizmin në një farë mënyre evitojmë të hyjmë në kontakt me atë që ndiejmë. Vendosim të marrim një pozicion të pavarur që efektivisht është i ndryshëm nga ai për të cilin ndiejmë. Kjo është shumë e dëmshme sepse siç edhe e dimë emocionet janë evente fizike dhe janë të lidhur në të gjitha nivelet sistemin nervor, sistemin indokrin, sistemin imunitar.

Cili është kapaciteti ku ne duhet të priremi, tentojmë për ta menaxhuar mirëqenien tonë?

Për të menaxhuar më mirë mirëqenien tonë duhet të zhvillojnë aftësinë "*lëre të shkojë*". Përse është përzgjedhur kjo teknikë. Siç kemi përmendur më lart emocionet janë fakte fizike të cilat përkthehen në "kaskada biokimike" në trup. Për arsye se janë ngjarje, por mbi të gjitha fjala emocion vjen nga latinishtja emovere që do të thotë reagim ndaj një stimuli i cili mund të jetë i jashtëm, një ditë e bukur me diell ose i brendshëm unë kujtoj një ditë të bukur me diell në të cilin provoj këtë emocion. Duke qenë përgjigje ndaj një stimuli duhen të ngrihen t'i ndiejmë që rriten dhe në mënyrë të paevitueshme apo të pashmangshme nëse ne jemi në gjendje që t'i lemë të rrjedhin të lëvizin ata do të zbresin. Emocioni është si një valë deti rritet, arrin pikën e saj maksimale dhe pastaj zbret e zhduket. Përkundrazi nëse ne nuk bëjmë këtë veprim nuk i lejojmë të rrjedhin e kështu në një farë mënyre i mbajmë atëherë fillojnë problemet. Kjo gjendje alarmi aktivizimi kur ndiejmë një emocion dhe nuk e lejojmë të shkojë, gjithë kjo kaskadë hormonale do të jetë prezente dukë dhënë një sërë efektsh. Kështu që kapaciteti i të lënit të rrjedhë është përkthim i një veprimi normal, fiziologjike në përgjigje të emocionit. Rritet-e ndiej-e ndiej komplet- zbret- mbaron. Lërë të rrjedhë mund të realizohet në shumë mënyra të cilat mund të jenë të ndryshme për secilin nga ne.

Ushtrim: Provoni vetëm për një minutë se çfarë mund të jetë për ju "lëre të rrjedhë" të krijoni një imazh ose nëse dëshironi një fjalë apo një sensacion. Për shembull për dikë "lëre të rrjedhë" do të thotë dhënia e flakës, djegia reduktimi i saj në hi, për dikë tjetër mund të jetë thënia e një fraze p.sh. "në rregull është gjithçka perfekt", apo mund të imagjinojë fluturimin, jam lodhur nga kjo gjë dua të shkëputem dhe largohem, për dikë dua të ndahem ta heq nga duart njëlloj siç lëshohet fara për t'u mbjellë. Provoni për një moment, ndoshta duke mbyllur sytë si të dëshironi ju duke zgjedhur imazhin tuaj, fjalën tuaj, veprimin tuaj që e lidhni me lërë të rrjedhë apo të shkojë dhe kjo do të jetë e juaja nga ky moment e më pas.

Po dhimbja?

Një person mund të ketë një dhimbje të madhe një ngjarje të vështirë dhe do të ketë më shumë intensitet valësh dhimbjesh, por nëse do t'i lërë të rrjedhin do të mbarojnë, mund të rikthehen, por siç ndodh në det valët do të ndryshojnë, do të ndryshojnë formë, lartësi etj. Në këtë sens mendja është një mjet i fuqishëm shërimi që ne kemi, pasi ajo është në gjendje për të shoqëruar procesin emocional. Nëse mendja (psika/koshenca) jonë është në gjendje që të shoqërojë procesin në mënyrë natyrale shprehjen e një emocioni atëherë mendja jonë është një instrument shërimi në lidhje me çdo lloj situatë apo ngjarje.

Thich Nhat Hanh mësues, autor, poet dhe aktivist paqeje vietnamez Zen Budist, i cili konsiderohet nga shumë si babai i ndërgjegjes thotë: Mos krijoni në mendjen tuaj një fushëbetejë, mos i shpallni luftë. Çdo gjë që ju ndjeni, (gëzimi, trishtimi, zemërimi, urrejtja) është pjesë e saj. Opozicioni në mes të mirës dhe të keqes është përshkruar shpesh me luftën midis dritës dhe errësirës, por nëse ne shikojmë në mënyrë të ndryshme do të shohim se edhe kur drita shkëlqen, errësira nuk zhduket. Përkundrazi në vend të largimit, shkrihen me dritën. Ata do të bëhen dritë.

Ideja është që të mos jemi opozitar me atë që provojmë. Kur ne bëjmë këtë, ne ballafaqohemi me një ndarje të plotë, një thyerje të brendshme në këtë mënyrë mbajmë brenda nesh atë që po provojmë.

KONKLuzion

Shumë vendime që ne marrim mbështeten mbi një bazë emotive. Mendja vjen më vonë për të shpjeguar psenë dhe për të justifikuar. Emocionet në vetvete nuk janë sjellëse të sëmundjeve. Emocioni i represuar ose i bllokuar i cili nuk mund të derdhet, rrjedh në një mënyrë të lirë sipas vijës së tij të shkarkimit mund të bëhet shkak i shfaqjes së problematikave të ndryshme. Situatat emocionale të cilat dëmtojnë mirëqenien tonë janë: gjendja e pakënaqësisë, zemërimi i shtypur/armiqësia, izolimi dhe emocione të shtypura në tërësi.

Emocionet janë një sinjal. Shmangia e tyre nënkupton shpërfilljen e një mesazhi kuptimplotë nga truri ynë. Çdokush mund të bëhet më i mirë në rregullimin e emocioneve. Ashtu si çdo aftësi tjetër menaxhimi i emocioneve kërkon praktikë dhe përkushtim.

Një nga aftësitë rregulluese të emocioneve është kapaciteti "lëre të shkojë" i cili është përkthim i një veprimi normal, fiziologjik në përgjigje të emocionit.

Humbja e mendjes dhe drejtimi i qenies nga emocionet e furishme sjell rrjedhoja nga më shkatërrueset jo vetëm për "shpërthyesin e

emocioneve”, por edhe për njerëzit e tjerë. Vetëm një person i balancuar dhe i sigurt mund të kontrollojë emocionet e tij. Nëse do të ishte vetëm një situatë fizike e cila mund të shkaktonte emocione, atëherë të gjithë njerëzit do të ndiheshin në të njëjtën mënyrë. Të tjerët nuk i shkaktojnë ndjenjat tona, jemi ne që i krijojmë ato. Kjo do të thotë që ne kemi kontrollin e ndjenjave tona, ashtu sikurse kemi kontroll mbi zgjedhjet e tjera që bëjmë. Oscar Wilde poet dhe dramaturg Irlandez është shprehur: *"Unë nuk dua të jem në mëshirën e emocioneve të mia. Unë dua t'i përdor, të kënaqem dhe t'i dominoj ato"*.

REFERENCA

1. Darwin, C. (1859). On the origin of species by means of natural selection Murray. London, UK.
2. Ekman, P., & Cordaro, D. (2011). What is meant by calling emotions basic. *Emotion review*, 3(4), 364-370.
3. Ekman, P. (1992). An argument for basic emotions. *Cognition & emotion*, 6(3-4), 169-200.
4. Ekman, P. (1999). "Basic Emotions". In: T. Dalgleish and M. Power (Eds.). *Handbook of Cognition and Emotion*. John Wiley & Sons Ltd, Sussex, UK.
5. Poli, E. F. (2017). *The Anatomy of Healing: The Seven Principles of the New Integrated Medicine*.
6. Poli, E. F. (2014). *Anatomia della guarigione: i sette principi della nuova medicina integrata*. Anima Srl.
7. Gross, D. M. (2010). Defending the humanities with Charles Darëin's *The Expression of the Emotions in Man and Animals* (1872). *Critical Inquiry*, 37(1), 34-59.
8. Goleman, D. (1995). Inteligjenca emocionale. Pse mund të ketë më shumë rëndësi se IQ-ja? Prishtinë: Pema.
9. LeDoux, J. E., & Hirst, W. (1986). *Mind and brain: Dialogues in cognitive neuroscience*.
10. LeDoux, J. E. (1986). Sensory systems and emotion: a model of affective processing. *Integrative psychiatry*.
11. Plutchik, R. (1980). *Emotion: A psycho evolutionary synthesis*. New York: Harper & Row.
12. Plutchik, R. (1980). A general psychoevolutionary theory of emotion. In *Theories of emotion* (pp. 3-33). Academic press.
13. Terry, F. Pettijohn (1996). *Psikologjia*, Tiranë.
14. Orhani, Z. (2003) *Psikologjia e emocioneve*, Tiranë.

PREVALENCA E VARËSISË NGA INTERNETI NË PERIUdhËN E PANDEMISË COVID-19 TE STUDENTËT E UNIVERSITETEVE SHQIPTARE

Elona Hasmujaj

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Psikologjisë dhe
Punës Sociale*

ABSTRAKT

Si rezultat i periudhës së pandemisë së COVID-19 njerëzit u përballën me ndryshime të menjëhershme të stilit të jetesës, gjë që u shoqërua me izolim social dhe limitim të kontakteve të drejtpërdrejta. Sigurisht që kjo situatë nuk kaloi pa pasoja në nivel psikologjik, një pjesë e të cilave janë studiuar nga autorë vendas dhe të huaj, ku ndër problematikat e spikatura janë edhe ato që lidhen me varësinë nga interneti. Rrjedhimisht, qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë prevalencën e varësisë nga interneti dhe të identifikojë marrëdhënien e saj me disa variabla demografikë. Ky studim sasior ndërseksional, u realizua në periudhen janar – mars të vitit 2021, duke përdorur Testin e Varësisë nga Interneti (IAT), i administruar online. Kampioni përbëhet nga 274 studentë (102 meshkuj dhe 172 femra) të përzgjedhur përmes metodës së kampionimit joprobabilitar të qëllimtë. Rezultatet treguan se pjesa më e madhe e studentëve, 53.3% e tyre shfaqin nivele të ndryshme të simptomave të varësisë nga interneti, ndërsa nivel të rëndë shfaqin vetëm 1.5% e tyre. Nivelin më të lartë të varësisë e raportojnë studentët e gjinisë mashkullore, grupmosha 18 – 19 vjeç, ata që studiojnë në universitetin e Elbasanit dhe që ndjekin studimet në vitin e parë. Gjetjet e këtij kërkimi mund të shërbejnë si një bazë e mirë për ndërtimin e protokolleve të ndërhyrjes, si dhe për studime të mëtejshme shkencore me të njëjtin fokus.

Fjalët kyçe: COVID-19, IAT, varësi nga interneti, studim sasior, studentë.

**Prevalence of internet addiction during COVID-19 pandemic among
students of Albania’s universities**

ABSTRACT

As a result of the COVID-19 pandemic people faced unexpected lifestyle changes, accompanied by social isolation and limitation of direct

contact. Certainly, this situation did not pass without consequences at the psychological level, some of which have been studied by local and foreign authors, where one of the reported problems are those related to Internet addiction. Consequently, this study aims to investigate the prevalence of Internet addiction and to identify its relationship with several demographic variables. This cross-sectional quantitative study was conducted between January and March 2021, using the Internet Addiction Test (IAT), administered online. The sample of this study consists of 274 students (102 males and 172 females) selected through the purposive sampling method. The results showed that about 53.3% of the students experienced low to extreme levels of internet addiction and the prevalence rate of heavy internet addiction is about 1.5%. Male students, age group of 18 – 19 years, those who study at the University of Elbasan and attend studies in the first year are more prone to be addicted to the internet. The findings from the current study will help to develop appropriate interventions and inform future research.

Keywords: COVID-19, IAT, internet addiction, quantitative research, students.

1. Hyrje

Izolimi social për shkak të periudhës së pandemisë së COVID-19 u shoqërua me mbylljen e institucioneve arsimore dhe atyre sociale, gjë që ndikoi në një ndryshim të rëndësishëm në rutinën e përditshme dhe mirëqenien psikologjike të personave. Ndikimi i plotë i kësaj mase parandaluese ende nuk dihet, megjithatë studimet vetëm tani kanë filluar të nxjerrin në pah pasojat mbi shëndetin mendor të të rinjve (Fegert, Vitiello, Plener, & Clemens, 2020). Studime të tjera tregojnë për pasoja sociale, ekonomike dhe shëndetësore si dhe probleme të përhapura psikologjike, ku përfshihen shkallë relativisht të larta të simptomave të ankthit dhe të çrregullimit të stresit posttraumatik. Këto përgjigje emocionale të lidhura me traumën janë faktorë risku për zhvillimin e sjelljeve të varësisë, përfshirë këtu varësitë ndaj substancave dhe ato të sjelljes (Sun, Li, Bao dhe të tjerë, 2020).

Bazuar në literaturën ekzistuese dhe gjetjet nga kërkimet shkencore të realizuara në vende të ndryshme përgjatë dhe pas periudhave të katastrofave natyrore dhe epidemive të mëparshme, flitet për ritme të shpejta të rritjes së sjelljeve të varësisë, përfshirë duhanin, përdorimin e tepruar të alkoolit dhe varësinë nga Interneti (DiMaggio dhe të tjerë, 2009;

Lee dhe të tjerë, 2017). Në krahasim me të rriturit, vulnerabiliteti ndaj varësisë duket të jetë një çështje më problematike në mesin e të rinjve dhe adoleshentëve. Ekziston një tendencë e natyrshme që kjo grupmoshë të përdorë internetin dhe kështu të zhvillojë lehtësisht sjelljen e varësisë (Pallanti dhe të tjerë, 2006). Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet se si ka ndikuar pandemia e COVID-19 në përdorimin e teknologjisë gjatë kësaj periudhe emergjente dhe nëse ka një ndryshim në prevalencën e varësisë nga interneti krahasuar me periudhen para pandemike. Për më tepër, fitimi i një kuptimi të plotë të procesit të zhvillimit të varësisë nga interneti është gjithnjë e më i rëndësishëm në mënyrë që studiuesit, profesionistët e sistemit arsimor dhe organizatat e shëndetit mendor të mund të zbulojnë mekanizmat e mundshëm themelore në bazë të kësaj problematike psikologjike (Eastin, 2005).

Duke u bazuar në literaturën ekzistuese, varësia nga interneti zotëron gjashtë komponentë, të cilët janë teorikisht dhe empirikisht të lidhur me varësitë e sjelljes (Pontes dhe të tjerë, 2014). Këta komponentë janë: (i) shtim, (ii) tolerancë, (iii) ndryshim i humorit, (iv) tërheqje, (v) relaps, dhe (vi) konflikt (Griffiths, 2005; Marks, 1990). Duke parë shpejtësinë e përhapjes së këtij fenomeni, Shoqata Amerikane e Psikiatrisë (APA, 2013) vendosi përfshirjen e varësisë nga interneti në Shtojcën e Manualit Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore [DSM-5]. Katër komponentë u sugjeruan fillimisht si thelbësore për diagnozën e çrregullimit të varësisë nga interneti dhe përshirjen e saj në DSM-5 (Block, 2008): (1) përdorim i tepruar i internetit, shpesh i shoqëruar me humbje të sensit të kohës ose lënie pasdore e detyrimeve të jetës së përditshme; (2) tërheqje, përfshirë këtu ndjenja zemërimi, tensioni, dhe/ ose depresion kur aksesimi në internet është i pamundur; (3) tolerancë, përfshirë nevojën për pajisje më të mira, për më shumë software, ose më shumë orë të përdorimit të internetit dhe (4) pasojat negative, përfshirë grindjet, gënjeshttrat, rënien e rendimentit akademik apo profesional, izolimin social dhe lodhjen. Por, pavarësisht propozimit për përfshirje në DSM-5, varësia nga interneti ende nuk është njohur si çrregullim i mirëfilltë psikologjik (APA, 2013).

Kështu, ky studim u krijua për të dokumentuar shtrirjen e simptomave të varësisë nga interneti gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19 në kampionin e studentëve të disa prej universiteteve të Shqipërisë. Vlerësimi në kohë të prevalencës dhe i rrezikut të varësisë në mesin e studentëve, mund të sigurojë informacion kritik që ndikon në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme të shëndetit mendor në këtë periudhë. Si i tillë, qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë nivelin e varësisë nga interneti gjatë periudhës së pandemisë si dhe lidhjen e tij me variabla të

tjerë demografikë në mesin e studentëve të universiteteve shqiptare.

1.1 Pyetje kërkimore

- Si paraqitet niveli i varësisë nga interneti gjatë pandemisë te studentët e universiteteve shqiptare?
- A ekzistojnë diferenca gjinore dhe moshore në lidhje me nivelin e varësisë nga interneti gjatë pandemisë te studentët e universiteteve shqiptare?
- A ekzistojnë diferenca të varësisë nga interneti në lidhje me vitin e studimit dhe universitetin ku këta individë studiojnë?

2. Metodologjia

2.1 Dizajni i studimit

Ky studim mbështetet kryesisht mbi parimet e dizajnit sasior përshkrues. Studimet përshkruese raportojnë të dhëna përmbledhëse të tilla si matje të tendencës qendrore, duke përfshirë mesataren, medianën, moden, devijimin standard, variacionin, përqindjen dhe korrelacionin midis variablave (Borg dhe Gall, 1989).

2.2 Subjektet e studimit

Kampioni i këtij studimi përfshin 274 subjekte ku 37.2% (n = 102) e tyre janë meshkuj dhe 62.8% (n = 172) janë femra, në intervalin moshor 18 deri në 25 vjeç, me një moshë mesatare 20.8. Subjektet e studimit janë studentë të nivelit Bachelor të disa prej universiteteve publike të Shqipërisë, përfshirë universitetin e Shkodrës, të Tiranës, të Durrësit, të Elbasanit dhe të Vlorës. Përzgjedhja e kampionit u realizua përmes metodave joprobabilitare të kampionimit.

- Si fillim u siguroa një listë e e-mail-ve te një pjesë të mirë të studentëve të universiteteve të sipërpërmendura.
- Pyetësi në version elektronik, bashkë me miratimin e informuar kërkimor iu dërgua rreth 500 studentëve, ku të plotësuar u rikthyen më shumë se gjysma e tyre.

2.3 Instrumentët e studimit

A. Pyetje demografike.

Para se të fillohej me plotësimin e IAT pjesëmarrësit duhej t'i përgjigjeshin një pyetjeje filtruese: "A jeni përdorues të internetit?", ku mundësitë e përgjigjes ishin "Po" dhe "Jo". Nëse përgjigja ishte "Po" atëherë procedohej me plotësimin e pyetjeve demografike që përfshinin kategori standarde të tilla, si: gjinia, mosha, viti i studimit dhe universiteti përkatës.

B. Testi i varësisë nga interneti (IAT - Young, 1997).

Ky test i zhvilluar nga Young (1997) përfshin 20 pyetje me 6 pikë të shkallës Likert që tentojnë të vlerësojnë përdorimin normal të internetit si dhe nivele të lehta, të moderuara dhe të rënda të varësisë nga Interneti. Pra, subjekti duhet të përgjigjet në një shkallë nga 0 = kurrë, 1 = rrallë, 2 = herë pas herë, 3 = shpesh, 4 = shumë shpesh dhe 5 = gjithmonë.

Të gjitha përgjigjet mbledhen duke na dhënë një pikëzim që varion nga 0 deri në 100 pikë. Përkatësisht: 0-19 pikë (përdoruesit nuk shfaqin asnjë shenjë varësie), 20-49 pikë (nivel i ulët i varësisë nga interneti, ku përdoruesit pavarësisht se mund të lundrojnë pak më shpesh në internet, ata janë në gjendje të mbajnë nën kontroll sasinë e kohës dhe mënyrën e përdorimit të internetit), 50-79 pikë (nivel i moderuar i varësisë nga interneti dhe njëkohësisht probleme të shpeshta psiko-sociale) dhe 80-100 pikë (nivel i lartë varësie, ku përdorimi i internetit shkakton probleme serioze në jetën e përdoruesve). Alfa e Cronbach për këtë test rezulton të jetë $a = .913$.

3. Rezultatet e studimit

3.1 Të dhëna përshkruese

3.1.1 Shtrirja e variablave demografikë

Kampioni përfundimtar, që iu nënshtrua analizës statistikore përfshin 274 subjekte, studentë të disa prej universiteteve të Shqipërisë. Shpërndarja e të dhënave demografike paraqitet në Tabelen 1, nga ku mund të shihet qartë se përqindjen më të lartë e shënojnë subjektet e gjinisë femërore (37.2%), grupmosha 18 - 19 vjeç (36.5%), studentë të vitit të parë (39.1%) dhe të Universitetit të Shkodrës (40.9 %).

Tabela 1. Shpërndarja e variablave demografikë në kampionin e studimit.

Variablat	Grupet	Frekuenca	Përqindja
Gjinia	Femra	172	37.2
	Meshkuj	102	62.8
Grupmosha	18 – 19 vjeç	100	36.5
	20 – 21 vjeç	96	35
	22 – 23 vjeç	61	22.3
	24 – 25 vjeç	17	6.2
Viti i studimit	Vit i parë	107	39.1
	Vit i dytë	101	36.9
	Vit i tretë	66	24.1
	Universiteti i Shkodrës	112	40.9

Universiteti	Universiteti i Tiranës	74	27
	Universiteti i Durrësit	25	9.1
	Universiteti i Elbasanit	37	13.5
	Universiteti i Vlorës	26	9.5

3.1.2 Shtrirja e variablit të varësisë nga interneti

Përsa i përket ndryshorës së varësisë nga interneti [$M = 33.91$, $SD = 16.39$], nga Tabela 2 mund të vihet re që rreth 46.7% e studentëve raportojnë për përdorim normal të internetit gjatë periudhës së pandemisë. Nivel të ulët të varësisë nga interneti shfaqin 33.6% e studentëve, nivel të moderuar 18.2% dhe me nivel të lartë të varësisë rezultojnë 1.5% e tyre.

Tabela 2. Statistikë deskriptive (frekuencë, përqindje, mesatare, devijim standard) i varësisë nga interneti.

	Grupet	Frekuenca	Përqindja (%)	Mesatarja	Devijimi standard	Totali
Varësia nga interneti	Përdorues normalë			33.91	16.39	274
	Nivel i ulët	128	46.7			
	Nivel i moderuar	92	33.6			
	Nivel i lartë	50	18.2			
		4	1.5			

3.2 Marrëdhënia mes varësisë nga interneti në periudhën e pandemisë me variablat demografikë

3.2.1 Diferenca gjinore në lidhje me nivelin e varësisë nga interneti

Homogjeniteti i variancës sipas testit të Levinit rezultoi statistikisht jodomethënës, gjë që mundësoi vazhdimin e mëtejshëm të analizës ($p = .568 > .05$). Nga pikëpamja statistikore vihen re diferenca të rëndësishme mes studentëve meshkuj dhe kolegeve të tyre femra në raportimin e nivelit të varësisë nga interneti në periudhën e pandemisë. Vlera mesatare e varësisë për studentët meshkuj ($M = 46.45$, $SD = 16.94$) është më e lartë se sa për femrat ($M = 36.73$, $SD = 15.49$), pra vlerat e testit flasin për rezultate statistikisht domethënëse ndërmjet grupeve [$t(272) = 4.850$, $p = .000 < .05$].

Tabela 3. Mesataret, F dhe t për nivelin e varësisë nga interneti në lidhje me gjininë.

	Variabli i gjinisë	Nr.	Mesatar e	D. Standard	t (272)	F	p
Varësia nga interneti	Meshkuj	102	46.45	16.94	4.850	.326	.000
	Femra	172	36.73	15.49			

3.2.2 Diferenca moshore në lidhje me nivelin e varësisë nga interneti

Për të bërë një krahasim mes grupeve, në këtë rast u procedua me analizen e variancës (ANOVA). Homogjeniteti i variancës sipas testit të Levinit rezultoi statistikisht jodomethënës ($p = .223 > .05$).

Siç mund të shihet nga Tabela 4, mesatarja e nivelit të varësisë nga interneti është më e lartë në grupmoshën 18 – 19 vjeç ($M = 51.4$, $SD = 13.05$), pasuar nga grupmosha 24 – 25 vjeç ($M = 39.82$, $SD = 16.69$), ndërsa nivelin më të ulët të varësisë nga interneti e shfaq grupmosha 22-23 vjeç ($M = 29.59$, $SD = 17.81$). Rezultatet janë statistikisht të rëndësishme [$F(3, 270) = 34.993$, $p = .000 < .05$].

Tabela 4. Mesataret, devijimi standard, F dhe P për grupmoshen në lidhje me varësinë nga interneti përgjatë pandemisë

Grupi	Nr.	Mesatare	D. Standard	F (3, 270)	p
18 - 19	100	51.40	13.05	34.993	.000
20 - 21	96	35.76	12.32		
22 - 23	61	29.59	17.81		
24 - 25	17	39.82	16.69		

3.2.2 Marrëdhënia mes varësisë nga interneti me vitin e studimit dhe universitetin përkatës

Për të bërë një krahasim mes grupeve, edhe në këtë rast u procedua me analizen e variancës (ANOVA). Testi i Levinit zbuloi se variancat e grupeve nuk janë të ndryshme mes tyre (vlera e domethënies statistikore është $p = .128 > .05$), kështu që u vazhdua me realizimin e analizës së variancës.

Tabela 5. Mesataret, F dhe p për nivelin e varësisë nga interneti në lidhje me vitin e studimit

Grupi	Nr.	Mesatare	D.Standard	F (2, 271)	P
I parë	107	51.45	13.03	60.96	.000
I dytë	101	36.00	12.12		
I tretë	66	28.98	17.45		

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, rezultatet tregojnë se ekzistojnë diferenca statistikisht të rëndësishme ndërmjet grupeve $F [(2, 271) = 60.96, p = .000 < .05]$, ku nivelin më të lartë të varësisë nga interneti e shfaqin studentët e vitit të parë ($M = 51.45, SD = 13.05$).

Siç shihet nga Tabela 6, ekzistojnë diferenca statistikisht të rëndësishme edhe përsa i përket universitetit të studimit në raport me varësinë nga interneti përgjatë periudhës së pandemisë [$F (4, 269) = 6.976, p = .000 < .05]$, ku mund të shihet që mesatarën më të lartë të pikëve të varësisë nga interneti e shfaqin studentët e universitetit të Elbasanit ($M = 44.05, SD = 16.55$) ndërsa nivelin më të ulët studentët e universitetit të Vlorës ($M = 28.92, SD = 12.05$).

Tabela 6. Mesataret, F dhe t për nivelin e varësisë nga interneti në lidhje me universitetin e studimit.

Grupi	Nr.	Mesatare	D. Standard	F (4, 269)	P
Universiteti i Shkodrës	112	30.53	14.45	6.976	.000
Universiteti i Tiranës	74	33.41	18.52		
Universiteti i Durrësit	25	40.68	14.12		
Universiteti i Elbasanit	37	44.05	16.55		
Universiteti i Vlorës	26	28.92	12.05		

4. Diskutime

Një ndër gjetjet më të rëndësishme të këtij studimi është se përqindja e niveleve të ndryshme të varësisë nga interneti në kampionin e studentëve të universiteteve shqiptare rezulton të jetë 53.3%, shifra këto shumë më të larta sesa ato të studimeve të periudhës parapandemike të realizuara me studentë të universiteteve të Polonisë 16.2% (Lidwinko, Krajewska-Kulak, dhe Łukaszuk, 2011) dhe të Britanisë së Madhe me 18.3% (Niemz, Griffiths, dhe Banyard, 2005). Po ashtu, përqindja e varësisë së rëndë nga interneti rezulton të jetë 1.5% (mbi 80 pikë të grumbulluara në IAT), ndërsa studime të tjera të hershme dhe të vona të realizuara në periudhën parapandemike tregojnë për shifra pak më të ulëta. Kështu, te studentët e

universiteteve të Shqipërisë është vlerësuar një prevalencë prej 0.7% (Hasmujaj, 2017), te studentët e universiteteve të Italisë 0.8% (Poli & Agrimi, 2012) dhe 0.9% në Jordani (Al-Qudah, 2001). Duke qenë se pjesa më e madhe e studimeve parapandemike raportojnë për nivele më të ulëta të varësisë së rëndë nga interneti, atëherë arsyeja kryesore e këtyre rezultateve në studimin aktual mund të lidhet pikërisht me izolimin social dhe limitimin e kontaktit fizik të drejtpërdrejtë gjë që mund të çojë në një përdorim të pakontrolluar të internetit nga të rinjtë.

Po ashtu rezulton që studentët e gjinisë mashkullore shfaqin nivel më të lartë të simptomave të varësisë nga interneti, në raport me koleget e tyre femra. Këto rezultate janë në të njëjtën linjë me studime të realizuara në periudhën parapandemike (Buranuy dhe të tjerë, 2013; Nurten dhe të tjerë, 2013). Së pari, këto diferenca mund të vijnë si pasojë e stereotipeve tradicionale të roleve gjinore, ku pretendohet që femrat nuk janë aq të orientuara teknologjikisht në krahasim me meshkujt. Përshembull, kompjuteri është një mjet që mban etiketën e stereotipeve mashkullore (Papastergiou dhe Solomonidou, 2005) dhe femrat mësohen të kultivojnë një mungesë interesi ndaj tij dhe mjeteve të tjera teknologjike, pasi në mënyrë të pavetëdijshme mund t'i shohin të lidhura me gjininë tjetër (Durndell & Haag, 2002). Në kontrast me rezultatet e këtij studimi janë ato të Ali dhe të tjerë (2012), të cilët raportojnë për nivele më të larta të varësisë nga interneti te studentët e gjinisë femërore.

Një tjetër gjetje është se studentët e grupmoshës 18-19 vjeç janë më të predispozuar të shfaqin simptoma të varësisë nga interneti në krahasim me grupmoshat e tjera. Në të njëjtën linjë, Cengizet dhe të tjerë (2011) treguan se individët nën moshën 19 vjeç, shfaqin nivele më të larta të varësisë nga interneti. Po ashtu, Hahn dhe Jerusalem (2001) raportuan që e përdorin internetin më shumë individët e grupmoshës 20-29 vjeç, kurse niveli i varësisë ishte më i lartë tek 19 vjeçarët. Po ashtu, autorë të ndryshëm raportojnë që individët më të mëdhenj në moshë kanë më pak gjasa të vuajnë nga përdorimi problematik i internetit (Thatcher dhe Goolam, 2005), madje Brenner (1997) vë në dukje se më të rriturit përjetojnë më pak probleme, pavarësisht sasisë së kohës që shpenzojnë në internet. Në kundërshtim me gjetjet e këtij studimi, Shakeelet dhe të tjerë (2011) treguan se shumica e studentëve të varur nga interneti i përkasin grupmoshës 20-25 vjeç. Po ashtu, Öztürk dhe të tjerë (2007) raportojnë se varësia nga interneti është një rrezik i veçantë për adoleshentët e grupmoshës 12-18 vjeç, duke e vënë theksin në thellimin e mëtejshëm të gjetjeve për këtë kategori të rinjsh.

Rezultatet e këtij studimi gjithashtu tregojnë se studentët e vitit të parë janë më të rrezikuar për të shfaqur varësi nga interneti, në krahasim me studentët e viteve të tjera. Arsyet e këtyre rezultateve mund t'i kërkojmë në faktin se studentët e grupmoshës 18 – 19 vjeç dhe të vitit të parë përballen për herë të parë me mësimdhënien online në universitetet, gjë që shënon në njëfarë mënyre distancimin e detyruar social nga miqtë e shkollës së mesme, por nga ana tjetër shoqërohet edhe me një mungesë kontakti real me studentët e klasave të tyre, gjë që rrit mundësinë e përdorimit të internetit për të ruajtur kontaktet me miqësitë e vjetra, por mund të shihet edhe si një tentativë për të zhvilluar më tej virtualisht miqësitë e reja të sapokrijuara në klasat virtuale të universiteteve.

Kufizimet e studimit

Sidoqoftë është e rëndësishme të theksohen edhe limitet e këtij studimi. Së pari, si rezultat i numrit të kufizuar të kampionit dhe faktit që subjektet janë të gjithë studentë, gjetjet mund të mos jenë të zbatueshme për popullatën e përgjithshme jashtë këtij target-grupi. Së dyti, shpërndarja dhe plotësimi i pyetësorëve përmes internetit mund të shoqërohet me mungesë serioziteti dhe përgjegjshmërie gjë që mund të cënojë besueshmërinë e rezultateve të studimit.

Përveç kufizimeve, duhet pranuar se ky studim mund të ofrojë një bazë të vlefshme për realizimin e kërkimeve të mëtejshme mbi çështjet e shëndetit mendor të lidhura me përjetimin e periudhes së pandemisë, si dhe të ndihmojë në hartimin e programeve të ndërhyrjes për këtë kategori individësh.

5. Konkluzione

Ky studim arriti në zbulimin e rezultateve të vlefshme mbi shtrirjen e varësisë nga interneti në periudhen e pandemisë në kampionin e studentëve të disa prej universiteteve shqiptare. Pavarësisht faktit se një përqindje e ulët e kampionit (1.5%) raportojnë nivele të larta të varësisë nga interneti, nuk duhet të neglizhojmë faktin se në grupin e të rrezikuarve për të shfaqur varësi (duke filluar nga niveli më i ulët deri tek ai më i larti) janë 53.3% e subjekteve të studimit. Përsa u përket variablave demografikë, studentët e gjinisë mashkullore shfaqin nivel më të lartë të simptomave të varësisë nga interneti në krahasim me ata të gjinisë femërore. Subjektet e grupmoshës 18-19 vjeç dhe ata që studiojnë në vitin e parë, shfaqin dukshmërisht nivel më të lartë të varësisë nga interneti në krahasim me grupet e tjera. Po ashtu, studentët e universitetit të Elbasanit shfaqin nivelin më të lartë të simptomave të varësisë në krahasim me studentët e universiteteve të tjera.

6. Rekomandime

Universitetet duhet të merren me organizimin e workshop-eve dhe seminareve informuese në lidhje me parandalimin dhe reduktimin e problematikave psikologjike që vijnë si rezultat i pandemisë COVID-19. Nga ana tjetër psikologët duhet të nxisin klientët që hezitojnë për të kërkuar ndihmë. Prandaj, reklamimi si online ashtu edhe në komunitetin lokal i programeve mbi trajtimin e problematikave psikologjike si pasojë e COVID-19 mund të inkurajojë individët skeptikë dhe të turpshëm që të kërkojnë ndihmë te profesionistët.

Individët duhet të pranojnë shqetësimin që kanë dhe në momentin kur ndihen nervozë ose të tensionuar mund të punojnë me veten duke aplikuar edhe teknika të posaçme të meditimit dhe të relaksimit muskolor. Një mundësi tjetër është të dalin dhe të ecin në natyrë, duke iu larguar stresorëve të mundshëm, si lajmet apo informacionet e ndryshme në lidhje me situatën e pandemisë që serviren kyesisht përmes rrjeteve sociale.

BIBLIOGRAFIA

- Al-Qudah, K. (2001). Internet addiction among students at Jordanian universities. *Journal of Arabic and Human Sciences*, 4(2), 71-88.
- Ali, M. Marouf, K. (2012). Relationship between Internet Addiction and mental health in male and female University Students. *Annals of Biological Research*; 3(9): 4362-4366.
- American Psychological Association. (2013). Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (5th ed.). Arlington, VA: American Psychiatric Publishing.
- Block, J. J. (2008). Issues for DSM-V: Internet addiction. *American Journal of Psychiatry*, 165, 306–307.
- Borg, W. R. and Gall, M. D. (1989). Educational Research: An Introduction 5th. edn. New York: Longman
- Brenner, E., Van den Berg, A. V., & Van Damme, W. J. (1996). Perceived motion in depth. *Vision Research*, 36, 699-706.
- Buranuy, I., Fu Yuan, Ch., Chiu, H.S. (2013). Analysis on the correlation and gender difference between college students' internet addiction and mobile phone addiction in Taiwan. ISRN Addiction Volume, Article ID 360607.
- Cengiz, Y., Eger, T., Muzaffer, B and Eker, T. (2011). Source characteristics and Advertising Effectiveness: The roles of Message Processing Motivation and Product Category Knowledge, *International Journal of Advertising*, Vol. 30 (5), pp. 889.
- DiMaggio, C., Galea, S., Li, G. (2009). Substance use and misuse in the aftermath of terrorism. A Bayesian meta-analysis. *Addiction*, 104, 894–904. [CrossRef] [PubMed].
- Durndell, A. and Haag, Z. (2002). 'Computer Self Efficacy, Computer Anxiety, Attitudes towards the Internet and Reported Experience with the Internet by Gender, in an East European Sample'. *Computers in Human Behavior* 18(5): 521-536.
- Eastin, M.S. (2005). Teen Internet use: Relating social perceptions and cognitive models to behavior. *Cyberpsychol. Behav. Soc. Netw.*, 8, 62–75. [CrossRef] [PubMed].
- Eastin, M.S. (2005). Teen Internet use: Relating social perceptions and cognitive models to behavior. *Cyberpsychol. Behav. Soc. Netw.* 8, 62–75. [CrossRef] [PubMed].

- Fegert, J. M., Vitiello, B., Plener, P. L., & Clemens, V. (2020). Challenges and burden of the Coronavirus 2019 (COVID-19) pandemic for child and adolescent mental health: a narrative review to highlight clinical and research needs in the acute phase and the long return to normality. *Child Adolesc Psychiatry Ment Health*, 14, 20. <https://doi.org/10.1186/s13034-020-00329-3>.
- Griffiths, M. D. (2005). A "components" model of addiction within a biopsychosocial framework. *Journal of Substance Use*, 10, 191-197.
- Hahn, A. & Jerusalem, M. (2001). Internet addiction: Reliability and validity in online research. (Internet addiction: reliability and validity in the online research) Online: http://psilab.educat.huberlin.de/ssi/publikationen/internetsucht_Onlineforschung_2001b.pdf [15.04.2011].
- Hasmuajaj, E. (2017). Marrëdhënia mes varësisë nga interneti me vetminë, depresionin, ankthin dhe stresin. Disertacion i mbrojtës së gradës "doktor". Universiteti i Tiranës.
- Lee, J.Y., Kim, S.W., Kang, H.J., Kim, S.Y., Bae, K.Y., Kim, J.M., Shin, I.S., Yoon, J.S. (2017) Relationship between problematic internet use and post-traumatic stress disorder symptoms among students following the Sewol ferry disaster in South Korea. *Psychiatry Investig*, 14, 871–875. [CrossRef].
- Lidwinko, J., Krajewska-Kulak, E., & Lukaszuk, C. (2011). Internet addiction among academic youth in Białystok. *Progress in Health Sciences*, 1(1), 124-130
- Marks, I. (1990). Behaviour (non-chemical) addictions. *British Journal of Addiction*. ;85:1389–1394 [PubMed].
- Niemz, K., Griffiths, M., & Banyard, P. (2005). Prevalence of pathological Internet use among university students and correlations with self-esteem, the General Health Questionnaire (GHQ) and disinhibition. *Cyberpsychology and Behavior*, 8(6), 562–570.
- Nurten, S. (2013). Internet Addiction among adolescence. *African Journal of Adult Education*, 2013; 1(5): 089-093.
- Öztürk, Ö. Odabaşoğlu, G., Eraslan, D., Genç, Y. ve Kalyoncu, Ö. (2007). Internet addiction: Clinical aspects and treatment strategies. *Journal of Dependence*, 8: 36-41.
- Pallanti, S. Bernardi, S. & Quercioli, L. (2006). Questionnaire and the Internet Addiction Scale in the assessment of multiple addictions in a high- school population: Prevalence and related disability. *CNS Spectrum*, 11(12), 966–974.
- Papastergiou, M. & Solomonidou, C., (2005). Gender issues in Internet use and favourite Internet activities among Greek high school pupils inside and outside schools. *Computers and Education*, 44(4), pp. 377-393.
- Poli, R., & Agrimi, E. (2012). Internet addiction disorder: Prevalence in an Italian student population. *Nordic Journal of Psychiatry*, 66(1), 55-59. doi:10.3109/08039488.2011.605169.
- Pontes, H.M, Griffiths, M.D, Patrão, I. M. (2014). Internet addiction and loneliness among children and adolescents in the education setting: an empirical pilot study. *Aloma Rev Psicol Ciències Educ Esport*; 32: 91–98.
- Sun, Y., Li, Y., Bao, Y. (2020). Brief report: increased addictive Internet and substance use behavior during the COVID-19 pandemic in China. *Am J Addict*.;29:268-270.
- Sun, Y., Li, Y., Bao, Y., Meng, S., Sun, Y., Schumann, G., ... Shi, J. (2020). Brief Report: Increased Addictive Internet and Substance Use Behavior During the COVID-19 Pandemic in China. *The American Journal on Addictions*, 29(4), 268–270. <https://doi.org/10.1111/ajad.13066>.
- Thatcher, A., & Goolam, S. (2005). Development and psychometric properties of the Problematic Internet Use Questionnaire. *South African Journal of Psychology*, 35(4), 793–809.

TË DREJTAT E PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR BRENDË SISTEMIT PENITENCIAR

Migena Haxhi

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji -Punë Sociale

ABSTRAKT

Personat me probleme të shëndetit mendor, duke qenë një target grup vulnerabël, shpeshherë mund të përballen me situata ku të drejtat e tyre të sanksionuara si në legjislacionin tonë ashtu edhe në konventa të ndryshme të Këshillit të BE-së, mund të çenohen fare lehtë. Ky studim ka në fokus pasqyrimin e të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor brenda një sistemi të mbyllur, siç është sistemi i burgjeve. Me anë të këtij studimi kërkohet që të pasqyrohen të drejtat e personave me probleme të shëndetit mendor të sanksionuara nga konventat e ratifikuara nga vendi ynë dhe përshtatja që i është bërë në legjislacionin shqiptar të të drejtave për këtë kategori. Me sa është arritur në këtë punim, nga shqyrtimi i literaturës konkluzioni përfundimtar është që situata e të drejtave të këtij target grupi është përmirësuar, por nuk është akoma në nivelin e duhur, megjithë rekomandimet e shumta si të palëve të huaja ashtu edhe të atyre kombëtare. Situata paraqitet akoma në fazën e ligjeve që nuk përcaktojnë qartë mënyrën se si duhet të implementohen. Realisht nuk janë marrë masat e duhura për sistemimin e këtyre personave në ambiente të posaçme konform asaj që përcaktohet edhe në legjislacionin tonë. Aktualisht në IEV-të penale ndodhen të burgosur me probleme të shëndetit mendor. Për shkak të mungesës së stafit të shëndetit mendor, këta të burgosur janë vendosur edhe në institucione të pakategorizuara, ku mungon infrastruktura e nevojshme dhe aksesit në një trajtim të specializuar të kësaj kategorie. Edhe pse, janë ngritur institucione brenda sistemit të burgjeve, për sistemimin e personave që diagnostikohen me probleme të shëndetit mendor. Rezultatet e arritura janë në përputhje me objektivat dhe pyetjet kërkimore të ngritura në këtë studim. Asnjëri nga këto institucione nuk rezultojnë brenda standardeve të kërkuara, së pari për arsyen se janë të përfshirë brenda sistemit të burgjeve ndërkohë që kërkohet një trajtim i specializuar jashtë sistemit penitenciar, dhe së dyti evidentohen shkelje edhe sa i takon infrastrukturës të ambienteve të vëna në dispozicion, numrit të kufizuar të specialistëve të

shëndetit mendor që punon për to.

Fjalët kyçe: : të burgosur, shëndet mendor, të drejta, trajtim.

**The rights of people with mental health problems within
penitentiary system**

ABSTRACT

Persons with mental health problems, being themselves a very vulnerable target group can often face situations where their rights, sanctioned both in our legislation and in various conventions of the EU Council, can be violated quite easily. The purpose of this study is focused on reflecting the rights of persons with mental health problems within a closed system, such as the prison system. This study seeks to reflect the rights of persons with mental health problems sanctioned by the conventions ratified by our country and the adjustment made to the Albanian legislation of the rights for this category. From what has been achieved in this study, from the literature reviews the final conclusion is that the situation of the rights of this target group has improved, but is not yet at the right level. Despite numerous recommendations from both foreign and national sides. As it turns out in this study, the situation still presents itself at the stage of laws that do not define how they should be implemented. In reality, the necessary measures have not been taken for the accommodation of these persons in special facilities in accordance with what is defined in our legislation. There are currently prisoners with mental health problems in the Criminal Institutions. Due to the lack of mental health staff, these prisoners are placed in uncategorized institutions, lacking the necessary infrastructure and access to specialized treatment of this category. Although, institutions have been set up within the prison system to accommodate people diagnosed with mental health problems. The results achieved are in line with the research objectives and questions raised in this study. None of these institutions results within the required standards, firstly because they are included within the prison system while requiring specialized treatment outside the penitentiary system, and secondly, violations are identified in terms of the infrastructure of the facilities made available, and a limited number of mental health specialists working for them.

Keywords: prisoner, mental health, rights, treatment.

1.Hyrje

Duke qenë se trajtimi i të burgosurve vazhdon të mbetet një problem shqetësues jo vetëm për vendet e pazhvilluara dhe ato në tranzicion, por edhe për vetë vendet e "zhvilluara perëndimore", shoqëria është përpjekur të vendosë disa rregulla, standarde minimale të detyrueshme për zbatim, për të gjitha shtetet, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të tyre, nivelit ekonomik dhe kulturor. Këto rregulla kanë gjetur sanksionim në një sërë aktesh dhe dokumentesh ndërkombëtare (QSHRT, 2013) të cilat janë ratifikuar edhe nga vendi ynë, prandaj është obligim ligjor i detyrueshëm që këto konventa të jenë pjesë e legjislacionit shqiptar dhe të zbatohen.

Bashkimi Evropian është një organizëm specifik ndërkombëtar me 27 shtete anëtare. Parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian, të njohura si e drejta komunitare, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rendin ligjor kombëtar, sepse këto të drejta në vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë përparësi ndaj të drejtës kombëtare. Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Bashkimi Evropian lejon individët dhe grupet t'i paraqesin Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian ankesa dhe peticione rreth shkeljeve specifike të të drejtave të njeriut dhe mospërputhjen me të drejtën komunitare. Hyrja në BE nuk është thjesht një dëshirë pa detyrime të caktuara. Procesi i integritimit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Megjithëse instrumentet e BE-së janë të lidhura vetëm me shtetet anëtare, vendet evropiane joanëtare (siç është rasti i vendit tonë kandidat për anëtarësim) duhet të harmonizojnë legjislacionin me standardet e BE-së. Plani kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe zbatimin të Marrëveshjes së Stabilizim –Asociimit parashikon një sërë masash legjislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë që një kuadër i tërë ligjor do të jetë në një proces analize, për t'u harmonizuar me standardet e BE-së (OSCE, 2010).

Një nga 12 pikat që duhet të plotësojë Shqipëria për anëtarësimin e saj në BE, si dhe një nga rekomandimet e përfshira në planin e veprimit, si detyrim për t'u zbatuar, ka qenë trajtimi i personave të ndaluar me probleme të shëndetit mendor në një ambient më vete dhe të ndarë nga institucionet klasike të riedukimit¹.

E vërteta qëndron se në shumicën e tyre, idetë për zgjidhjen e shumë mangësive në këtë shërbim kanë mbetur thjesht dhe vetëm në fazën e hartimit të programeve dhe strategjive përkatëse.

¹ Faqja zyrtare e drejtorisë së përgjithshme të burgjve, për më shumë shih Ref. Link.

Në çështjen “Dybeku kundër Shqipërisë,”² Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e quajti trajtimin e kësaj kategorie shkelje e të drejtave të personave me probleme mendore dhe kërkoi që të merreshin masa për ndryshimin e situatës. Qeveria shqiptare në përgjithësi është justifikuar me mungesën e fondeve për të përmirësuar situatën, ndërkohë që në konventat e ratifikuara është e shprehur qartë që asnjë shtet nuk mund të justifikohet duke lënë në kushte të papërshtatshme personat me probleme të shëndetit mendor thjesht me arsyen e mungesës së fondeve.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit gëzojnë të njëjtat të drejta si çdo qytetar tjetër.

Neni 1 i Rregullave Evropiane të Burgjeve thotë se “*Personat të cilëve u është hequr liria, duhet të trajtohen me respekt për të drejtat e tyre të njeriut. Burgimi, domethënë heqja e lirisë është një dënim në vetvete dhe si rezultat, regjimi për të burgosurit e dënuar nuk duhet të përkeqësojë vuajtjen e vetë burgimit*”³.

Misioni aktual i shërbimit modern të burgjeve përmban këto fjalë kyçe: sigurinë, humanizmin, rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri. Trajtimi i të dënuarit me qëllim riedukimi kërkon që në përzgjedhjen e institucionit të dënimit, të merret parasysh personaliteti i të dënuarit, sjelljet dhe qëndrimet e shfaqura në kohën e kryerjes së krimit dhe gjatë vuajtjes së dënimit, gjendja shëndetësore, fizike dhe mendore e tij.

Edhe pse ligjet tona (në përputhje me direktivat e BE-së) parashikojnë sistemimin në ambiente të posaçme për këtë target grup, sistemi i burgjeve në vendin tonë është kritikuar në shumë raporte si nga palë të brendshme ashtu edhe nga ato ndërkombëtare, sidomos për sa i takon infrastrukturës së papërshtatshme të sistemit të burgjeve, ku mbahen pa të drejtë kjo kategori e personave me probleme të shëndetit mendor.

Në këto raporte thuhet se personat me probleme të shëndetit mendor duhet të transferohen, sipas ligjit, në spitale të specializuara për kujdesin e shëndetit mendor. Edhe një person me probleme të shëndetit mendor duhet të gëzojë të drejta të njëjta si të gjithë të tjerët. Për këtë arsye kjo kategori ka nevojë për më shumë vëmendje jo vetëm në aspektin ligjor, por edhe në politikat që ndiqen për to. Standardet e kërkuara përcaktojnë se kësaj kategorie duhet t’i sigurohet një trajtim sa më human me qëllim rehabilitimin e tyre, përmes ofrimit të shërbimeve të duhura.

Ndërkohë që në raportet e avokatit të popullit theksohet se “*ka edhe shumë persona që kanë probleme të shëndetit mendor, por që mungesa e*

² Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane të burgjeve- parimet bazë, f. 2. Ref. Link

³ Po aty.

stafit në IEVP-të tjera shqiptare krijon mungesën e diagnostifikimit dhe evidentimit të tyre". Për këto arsye, përveç faktit që këto persona janë të sistemuar në institucione në shkelje me të drejtat e tyre, ka akoma edhe të tjerë që janë të pakategorizuar dhe ndodhen në sistemin e IEVP-ve, pa përfituar asnjë lloj kujdesi dhe trajtimi të nevojshëm. Prandaj ky studim është me vlerë për evidentimin dhe pasqyrimin e asaj që ofrohet në Shqipëri për personat me probleme të shëndetit mendor, asaj që duhet të ofrohet, dhe mënyrës se si janë të përshtatura këto dy pika.

Qëllimet e studimit

Qëllimet kryesore të këtij studimi janë:

- Të evidentojë se sa dhe si janë përshtatur ligjet shqiptare me konventat ndërkombëtare, në lidhje me personat me sjellje kriminale që kanë një çrregullim të shëndetit mendor.
- Të evidentojë se si dhe sa janë përshtatur të drejtat e personave me probleme të shëndetit mendor brenda sistemit penitenciar.

Pyetjet kërkimore të këtij studimi janë në lidhje me:

- Si paraqitet situata reale e personave me probleme të shëndetit mendor në sistemin penitenciar?
- Si janë përshtatur të drejtat e përcaktuara nga standardet evropiane në legjislacionin shqiptar?

1. Metodologjia e punimit

Për realizimin e këtij punimi u morën për bazë raportet e shumta dhe standardet që BE-ja ka vendosur, lidhur me rëndësinë e trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor. Në këto raporte vihet re fakti që një nga 12 pikat që duhet të plotësojë Shqipëria për anëtarësimin e saj në BE, si dhe një nga rekomandimet e përfshira në planin e veprimit, si detyrim për t'u zbatuar, ka qenë trajtimi i personave të ndaluar me probleme të shëndetit mendor në një ambient më vete dhe të ndarë nga institucionet klasike të riedukimit.⁴

Metoda kryesore e përdorur konsiston në analizën e literaturës. U zgjodh kjo metodologji për ta parë problematikën më në thellësi, pasi është përdorur analiza e të gjitha konventave që vendi ynë ka ratifikuar dhe legjislacioni shqiptar, sa i takon të drejtave të këtij target grupi. Është përdorur vështrimi krahasues mes asaj që detyrojnë konventat e ratifikuara dhe studimit të mënyrës se si janë përshtatur me ligjet shqiptare. Nga ky

⁴ Faqja Zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
Ref. Link

studim del qartë se një pjesë e mirë e këtyre konventave janë përkthyer në ligje, dhe se ajo që kërkojnë marrëveshjet ndërkombëtare janë deri diku të përshtatura edhe me legjislacionin tonë, duke përmendur këtu që nga Kushtetuta e Shqipërisë, Procedura e Kodit Penal, Kodi Penal, dhe ligjet e posaçme bashkë me VKM-të si edhe rregulloret e miratuara. (Duke filluar që nga Ligji i ri i shëndetit mendor 2012, VKM 303 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” dt.03.04.2009, ligji nr.9888 dt.10.03.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgim”).

“Rregullat standard minimum të Kombeve të Bashkuara”, si rregulla me karakter absolut dhe themelore në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut, të cilat paraqesin çfarë është pranuar me konsensus të përgjithshëm si element thelbësor, si dhe konventat e tjera të ratifikuara nga vendi ynë siç janë : “Deklarata universale e Kombeve të Bashkuara të të drejtave të njeriut”, “Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese “(CAT) “Protokollin fakultativ të konventës kundër trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”, të gjitha këto të ratifikuara nga vendi ynë.

Gjithashtu pjesë e rëndësishme është edhe ajo që ka të përcaktuar rregullorja e përgjithshme e burgjeve në lidhje me trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor në sistemin petineciar, miratuar me VKM-në Nr.303 dt.2009 nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe pjesë të tjera nga legjislacioni, dhe botime të ndryshme shqiptare.

Është zgjedhur të studiohet situata reale e këtij target grupi për të bërë një krahasim mes asaj që duhet të ofrohet sipas konventave të ratifikuara dhe asaj që ofrohet realisht për këtë kategori.

Procedura e përdorur për realizimin e këtij studimi konsiston në shqyrtimin e ligjeve dhe raporteve të hartuara në harkun kohor të pesë viteve 2007-2012 duke iu referuar situatës së pasqyruar në raportin e veçantë që avokati i popullit i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2008. Kjo periudhë studimi e zgjedhur përkon me përmirësimin e situatës në disa aspekte, duke filluar që me ngritjen e mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës pranë Avokatit të Popullit, deri në nxjerrjen e ligjit të ri 2012 për shëndetin mendor, miratimin e VKM-së Nr.303 për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve dt.03.04.2009 duke qenë që në shumë IEVP-nuk kishte një rregullore të posaçme siç është e përcaktuar]. Ligji nr.9888, dt.10.03.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgim”.Të gjitha këto ndryshime kanë bërë që pjesa e kuadrit ligjor të përshtatet deri diku me konventat e ratifikuara nga vendi ynë, konventa të cilat vendosin kriteret e trajtimit të personave

brenda sistemit penitenciar.

Qëllimet e studimit janë nxjerrë duke u bazuar në disa studime dhe raporte që mekanizma vendas dhe të huaj kanë nxjerrë nga monitorimet që kanë realizuar. Në këto raporte është evidentuar se situata e personave me probleme mendore në sistemin penitenciar shqiptar është jo e përshtatshme për këtë target grup, dhe përbën shpeshherë shkelje të të drejtave të tyre si qenie njerëzore, me mungesën e mundësisë së rehabilitimit. Ndërkohë që trajtimi i tyre duhet të jetë në funksion të rehabilitimit dhe trajtimit sa më njerëzor, situata aktuale e tyre nuk është në funksion të kësaj kërkesë, përkundrazi mund të thuhet se ajo shpesh herë ndikon për përkeqësimin e shëndetit mendor të të burgosurve. Në një studim të realizuar në burgjet shqiptare (“Burgjet shqiptare një shikim nga brenda”, botimet QSHRT 2007), ka rezultuar se të burgosurit kanë shumë më mundësi të zhvillojnë simptoma të traumës, depresionit dhe të ankthit në krahasim me ato që kanë kushte më të mira trajtimi. Duke qenë se në këtë studim rezultoi se individët që vuanin nga simptoma të ankthit, depresionit dhe shqetësimeve emocionale kanë qenë në një numër të madh, është shumë e rëndësishme që t’u kushtohet një vëmendje e veçantë personave që vuajnë dënimin nëpër burgje dhe programeve të trajnimit të stafit që të aftësohen që të zbulojnë çrregullimet e shëndetit mendor, prandaj duhet që në këto institucione të ketë staf të mjaftueshëm të shëndetit mendor, në mënyrë që të ofrojnë asistencë dhe ndihmën e duhur.

2. Shqyrtimi i leteraturës

3.1 Detyrimet e qeverisë shqiptare nga konventat e ratifikuara

Heqja e lirisë së personit për shkak të arrestimit ose të burgosjes së tij shkakton pasoja të karakterit psikologjik, shpirtëror dhe psikik. Për këtë arsye, që nga viti 1945, janë krijuar shumë konventa me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Standardet e këtyre të drejtave janë miratuar nga qeveritë dhe i referohen të drejtave që gëzon një person dhe që duhet të respektohen nga shtetet. Këto janë të kodifikuara në traktatet dhe konventat ndërkombëtare dhe të plotësuara me udhëzimet, parimet dhe deklaratat. (QSHRT 2013)

Në kuadrin e angazhimeve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Republika e Shqipërisë, ka nënshkruar dhe ratifikuar pjesën më të madhe të Konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës në fushën penale.

Statuti i Këshillit të Evropës u ratifikua dhe hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 13.7.1995. Konventa “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, u nënshkrua më 13.07.1995, dhe u

ratifikua e hyri në fuqi më 02.10.1996” (CAT, 2003).

Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar edhe protokollet shtesë nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8, të kësaj konvente të cilat janë nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi gjithashtu më 02.10.1996.

Protokolli 1 i Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” është nënshkruar më 13.07.1995, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi më 01.11.1998. Krahas Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, Shqipëria ka nënshkruar një pjesë të madhe të Konventave të Këshillit të Evropës në fushën penale, (për më shumë shih konventa kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (CAT, 2003)).

Një ndër dokumentet më me rëndësi në këtë fushë i cili ka zënë vend edhe në legjislacionin tonë është dokumenti i emëruar “*Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve*” (Avokati i Popullit, 2002), Neni 1 i të cilit, thotë se personat të cilëve u është hequr liria duhet të trajtohen me respekt për të drejtat e tyre të njeriut. Burgimi, heqja e lirisë është një dënim në vetvete. Si rezultat i kësaj, regjimi për të burgosurit e dënuar nuk duhet të përkeqësojë vuajtjen e vetëburgimit. Jeta në burg duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në komunitet. E gjithë koha e ndalimit menaxhohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë riintegrimin në një shoqëri të lirë të personave të cilëve u është mohuar liria. Bashkëpunimi me shërbime të jashtme shoqërore dhe përfshirja e shoqërisë civile në jetën e burgjeve inkurajohet sa më shumë të jetë e mundur.

Gjithashtu në rekomadimin e Këshillit të Evropës mbi rregullat evropiane të burgut⁵ përcaktohet se personat që vuajnë nga sëmundje të shëndetit mendor dhe shëndeti mendor i të cilëve nuk është i përshtatshëm me ndalimin në burg, vuajnë dënimin në një vend të ndërtuar posaçërisht për këtë kategori të dënuarish. Ndërsa kur këto persona me raste përjashtimore mbahen në burgje duhet të ketë rregulla të posaçme që parashikojnë statusin dhe nevojat e tyre.⁶

Konventa evropiane për të drejtat e njeriut, është pjesë e sistemit tonë ligjor, dhe dispozitat e saj janë të detyrueshme për t’u zbatuar për gjykatat vendase dhe të gjithë autoritetet publike.

Detyrimet e Nenit 3 janë ndoshta më thelbësore e të qarta veçanërisht me pacientët që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Këto

⁵ Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 12.1, f.19. Ref. Link

⁶ Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 12.2, f.19. Ref. Link

detyrime i japin përparësi kushteve të ndalimit sa i përket mbingakesës, ambienteve të papërshtatshme për higjenën, fjetjen, ushqimin, kushte për kalimin e kohës së lirë e për kontaktet me botën e jashtme. Kushte të tilla, veçanërisht kur përfshihet çështja e mbingarkesës së burgjeve, përbëjnë ende problem dhe vazhdojnë të çenojnë standardet e kërkuara nga konventa. Sistemi ligjor duhet të strukturohet në mënyrën e përshtatshme për të siguruar mbrojtje efektive. Boshllëqet në sistemin ligjor do t'i lënë autoritetet gjyqësore të ekspozuara ndaj shkeljeve të mundshme të Nenit 3⁷.

3.2 Përshtatja e legjislacionit Shqiptar

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë miratuar në nëntor të vitit 1998 (neni 122) thuhet se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (CAT 2003)

Ambientet ku liria e personit është e kufizuar janë konsideruar gjithmonë si vende ku të drejtat e njeriut ndihen më shumë të kërcënuara. Për këtë arsye vlen të përmendet se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë në nenin 45 të tij ka përcaktuar se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, të cilat janë mjekimi i detyruar ambulator dhe mjekim i detyruar në një institucion mjekësor. Pra në një institucion mjekësor, por jo në burgje, ku aktualisht një pjesë e mirë e personave më sëmundje mendore janë duke kryer dënimet e tyre, shpeshherë edhe pa asistencën e duhur (QSHRT, 2010).

Ndërsa Ligji nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në nenin 45 të tij përcakton midis të tjerash se vendimet që jep gjykata për mjekim të detyruar ekzekutohen në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Edhe neni 28, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ju garanton këtyre personave një trajtim njerëzor. Kurse në nenet 93 dhe 94 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 96 dt.09.03.2000 është përcaktuar në

⁷ Manualet e të drejtave të njeriut, nr.6.

Ref link

mënyrë eksplicite ndarja e qartë e personave me sëmundje mendore që bëhen të tillë gjatë vuajtjes së dënimit dhe personave të papërgjegjshëm të shpallur të tillë nga gjykata, e cila i ka përjashtuar nga burgimi, por ka vendosur mbylljen e tyre në institucione të posaçme psikiatrike. (Avokati i Popullit, 2008).

Mbas kërkesash të shumta si nga mekanizma vendase ashtu edhe të huaja në vitin 2012 kemi nxjerrjen e Ligjit të Ri të Shëndetit Mendor, i cili parashikon pjesë që ligji i vjetër nuk i kishte të parashikuara. Në bazë të këtij ligji theksi vihet tek rëndësia e ekipit multidisiplinar dhe rëndësia e kujdesit për “shëndetin mendor” megjithatë nuk ka akoma diçka specifike se si ky target grup duhet të trajtohet, dhe nuk i ka të detajuara shumë specifika të tjera. Që të bëhet i implementueshëm ky ligj ka akoma nevojë për miratimin e disa akteve nënligjore, që rregullojnë mënyrën e implementimit të tij.

Në raportin e tij kryetari i OSCE-së, shtator 2012 shprehet si më poshtë: *“Ka, gjithashtu, shqetësime sa u përket të burgosurve me sëmundje mendore. Ndonëse tashmë është miratuar një ligj për shëndetin mendor, çështja e atyre personave që nuk janë në gjendje të mbajnë përgjegjësi penale dhe që, me urdhër të gjykatës, duhet t’i nënshtrohen një trajtimi të detyruar, është një çështje që ende nuk është adresuar si duhet. Statusi dhe sistemimi i këtyre personave kërkon vëmendje të menjëhershme, pasi ata nuk duhet të mbahen në sistemin penitenciar”* (OSBE 2012).

Ndërsa një e përditshme në Shqipëri raporton si më poshtë: *“Një problem i rëndësishëm dhe i prekshëm ishte ai i monitorimit dhe përmirësimit të kushteve për personat me çrregullime mendore që kanë kryer vepër penale (personat që vuajnë dënimin me burg) është pritur një trajtim më serioz dhe më profesional për këtë kategori personash, të cilët janë më vulnerabël ndaj problemeve të shëndetit mendor. Ligji i ri pothuajse e anashkalon këtë kategori duke përmendur thjesht emra të përgjithshëm, pa specifikuar probleme apo trajtime të veçanta. Megjithë përprjekjet e OJF-ve të ndryshme si edhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës, kjo kategori nuk është përmendur sa duhet në ligj”*.⁸

Ndërsa lidhur me monitorimin e situatës së të drejtave të njeriut, konstatojmë se tashmë vendi ynë ka ngritur një mekanizëm të veçantë, siç është ai i parandalimit të torturës pranë Avokatit të Popullit, (detyrim ky që buron nga Protokolli Opsional i Konventës për Parandalimin e Torturës dhe Akteve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, i ratifikuar me anë të Ligjit Nr.

Gazeta Dita, Mbi Ligjin E Ri Per Shëndetin Mendor 2012.

⁸ Ref. link

9094 dt.03.07.2003). Avokati i Popullit krahas monitorimit të ambienteve të burgjeve, paraburgimit etj., ka mandat të plotë nga aktet ndërkombëtare dhe legjislati ynë në fuqi për të ndjekur nga afër edhe respektimin e të drejtave dhe trajtimit të të sëmurëve mendorë (Avokati i Popullit, 2008).

Ligji nr 8328, dt 16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", i ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 9939, në nenet 13-17 përcakton kategoritë e personave të dënuar që mund të vendosen në burgjet e klasifikuara sipas regjimeve të ndryshme ose në institucione të veçanta. Në të kundërt kjo përbën një shkelje të të drejtave të njeriut, dhe këtu mund të përmendim si shembull çështjen e trajtuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut e Këshillit të Evropës me qendër në Strasburg (Dybeku kundër Shtetit Shqiptar, 2007) ku mbajtja e këtij të burgosuri me të meta mendore në ambientet e burgut u quajt si shkelje e Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Për këtë arsye, iu bë thirrje shtetit shqiptar për një sërë ndryshimesh në sjelljen me të burgosurit, duke e quajtur të pavend justifikimin në lidhje me mungesën e të ardhurave, dhe u kërkua që të bëhej ngritja e institucioneve të përshtatshme dhe sigurimi i një trajtimi më human për këtë kategori njerëzish. (Për më shumë shih ⁹).

3.3 Raportet për trajtimin e personave të dënuar me burgim

Gjithnjë e më shumë, organizmat monitoruese vendase dhe të huaja dhe Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, i kushtojnë rëndësi trajtimit të personave të dënuar dhe të paraburgosur në institucionet e vuajtjes së dënimit. Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është e pasur me fakte të gjykimeve të cilësuar si torturë ose trajtime çnjerëzore ose poshtëruese dhe për rrjedhojë, shkelje e nenit 3 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, si dhe me rastet kur personave të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar nuk u ofrohet trajtimi i duhur (botim i Qendrës Evropiane, 2005).

Në raportin e 2008 Avokati i Popullit si pjesë e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, shprehet se në Shqipëri situata e të sëmurëve mendorë në sistemin e institucioneve të ekzekutimit të veprave penale është totalisht jashtë standardeve të kërkuara, të cilat shpesh ndikojnë në agravimin e gjendjes të të sëmurëve mendorë. Me anë të kësaj letre dërguar Kuvendit të Shqipërisë ai kërkon ndryshimin e situatës.

Në përmbajtjen e këtij dokumenti bien në sy disa përfundime siç janë:

- Mosrishikimi i kuadrit ligjor për shëndetin mendor;
- Nevoja e përmirësimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut ndaj personave me probleme të shëndetit mendor;

⁹ (Ankimi Nr. 41153/06) Çështja "Dybeku Kundër Shqipërisë" Strasburg 18 dhjetor 2007.

- Mungesa e një buxheti të konsiderueshëm për të përballuar nevojat e kësaj kategorie pacientësh dhe këtij shërbimi në përgjithësi, sipas strategjisë së caktuar;
- Mosnjohja dhe moszbatimi i vazhdueshëm i legjislacionit në fuqi që trajton shëndetin mendor nga ana e organeve kompetente shtetërore;
- Mungesa e aktiviteteve promovuese dhe parandaluese të shëndetit mendor.

Po në këtë raport theksohet se problemi më i madh që haset në këtë fushë lidhur me shëndetin mendor është se, brenda sistemit të burgjeve mbahen pa të drejtë dy kategori të personave me probleme të shëndetit mendor, të cilët duhet të transferohen sipas ligjit në spitale të specializuara për shëndetin mendor (Avokati i Popullit, 2008).

Ndërsa në raportin e 2010-ës sërish sa i takon sistemit penitenciar avokati i popullit shprehet si më poshtë: *“Megjithatë, vijojnë të mbeten ende problem amortizimi i disa institucioneve penitenciare, mungesa e fondeve financiare për investime, mungesa e përmirësimit të kushteve në burgje, krijimi i hapësirave për jetesë, eliminimi i plotë i mbipopullimit, si dhe një standardizim i plotë i shërbimeve penitenciare në të gjitha IEVP-të në vend”* (Avokati i popullit, 2010).

Ndërsa në raportin e fundit atë të vitit 2012 avokati i popullit vazhdon të theksojë rëndësinë e krijimit të një institucioni që plotëson standardet e kërkuara, ku citohet: *“Avokati i Popullit ka rekomanduar dhe insiston që të vazhdojnë të transferohen personat me probleme të shëndetit mendor nga Burgu Krujë etj., në një institucion të specializuar shëndetësor, sepse nuk plotësojnë standardet përkatëse”* Më poshtë në këtë raport theksohet: *“Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për Avokatin e Popullit është mosgjethja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar me gjithë hapjen e një sektori të veçantë në paraburgimin e Durrësit. Avokati i Popullit e ka ngritur çdo vit këtë çështje dhe nuk është pajtuar me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambienteve të sistemit të burgjeve”* (Avokati i Popullit, 2012).

Në raportin e OSCE -së sa i përket reformave penitenciare që vendi ynë ka bërë deri tani shohim që ka, gjithashtu, shqetësime sa u përket të burgosurve me sëmundje mendore. Ndonëse tashmë është miratuar një ligj për shëndetin mendor, çështja e atyre personave që nuk janë në gjendje të mbajnë përgjegjësi penale dhe që, me urdhër të gjykatës, duhet t'i nënshtrohen një trajtimi të detyruar, është një çështje që ende nuk është

adresuar si duhet. Statusi dhe sistemimi i këtyre personave kërkon vëmendje të menjëhershme, pasi ata nuk duhet të mbahen në sistemin penitenciar (Raport i OSBE-së, 2012).

Instituti Evropian i Tiranës ka bërë një monitorim në të gjithë burgjet në vend dhe ka paraqitur një raport të detajuar. Studimi përqendrohej te mënyra se si trajtohen personat me probleme të shëndetit mendor të cilët janë duke kryer dënimin në burgje. Raportohet se 70% e të burgosurve vuajnë nga çrregullime mendore, të cilat ose i kanë pasur ose i kanë fituar gjatë qëndrimit në burg. Këta persona nuk kanë personelin e duhur për t'u trajtuar nga ana mjekësore, mungojnë punonjës socialë dhe psikologë. Në Krujë është një institucion i veçantë në të cilin kryejnë dënimin disa target grupe, mes të cilëve edhe persona me probleme të shëndetit mendor. Në kartelat e të semurëve ka të përcaktuara diagnoza të cilat nuk ekzistojnë si: “Çrregullim karakteri”, “Skizofreni me defekt”, apo “Skizofreni” pa përcaktuar nëntipin, përcaktimi i të cilit është i detyrueshëm gjatë përcaktimit të diagnozës.¹⁰

4. Konkluzione

- Duke iu referuar pyetjes kërkimore të këtij punimi, në lidhje me përshtatjen e ligjeve shqiptare me konventat ndërkombëtare në lidhje me personat me sjellje kriminale që kanë një çrregullim mendor, rezulton që janë përshtatur pjesa më e madhe e konventave ndërkombëtare.
- Në vitin 2008 është realizuar përmbushja e Protokollit të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës i cili thekson, se çdo shtet palë që e ratifikon këtë protokoll duhet krijojë një ose disa mekanizma të pavarura kombëtare për parandalimin e torturës. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është ngritur Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, i cili monitoron situatën e të drejtave të burgosurve në përgjithësi dhe për çdo vit realizon një raport vjetor për situatën e monitoruar gjatë vitit.
- Janë krijuar dhe përmirësuar rregulloret dhe ligjet shqiptare në lidhje me trajnimin e të dënuarve dhe trajtimin e këtij target grupi.
- Ndërsa për sa i takon mënyrës se si janë përshtatur rezulton që këto ligje janë përkthyer dhe janë miratuar duke u marrë për bazë vetëm kërkesat dhe jo mundësitë reale të vendit tonë.

¹⁰ Raport monitorimi nga Instituti Evropian i Tiranës Ref. Link

5. Rekomandime

- Në mënyrë që ligjet të jenë të implementueshme në radhë të parë duhet që të ngrihen grupe ekspertësh shqiptarë që të merren me studimin dhe hartimin e normativave të realizueshme në Shqipëri dhe jo thjesht kopjimi i konventave dhe standardeve të përcaktuara nga ndërkombëtarët.
- Këto ligje duhet të krijojnë grupe me specialistë dhe ekspertë shqiptarë që të merren me studimin dhe hartimin e normativave të realizueshme në Shqipëri dhe jo kopjimin direkt të konventave dhe ligjeve ndërkombëtare dhe për pasojë, të ngelen vetëm në planin teorik.
- Ambientet si nga kërkesat e legjislacionit shqiptar ashtu edhe nga kërkesat e konventave ndërkombëtare, duhet të jenë jashtë sistemit penitenciar dhe t'i kalojnë në varësi Ministrisë së Shëndetësisë e cila mund dhe duhet të hartojë dhe të ndjekë politika të posaçme për trajtimin e këtij target grupi si dhe ngritjen e spitaleve të posaçme psikiatrike ku aksesimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor është më i madh.

REFERENCA

- Avokati i Popullit , Raport i Veçantë Nr.2 *Për gjendjen e shëndetit mendor në Shqipëri*, 2008, fq. 6, 7, 9, 11.
- Avokatit të Popullit (2010): Raport *Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit*, fq. 141.
- Ankimi Nr. 41153/06 (2007): *ÇËSHTJA “DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË” STRASBURG*
- Botim i Qendrës Evropiane, Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian, Tiranë, 2005, fq. 95-167.
- Botimet QSHRT (2007): *Burgjet një shikim nga brenda*, fq. 84.
- Botimet QSHRT vol9. (2010): *SISTEMI I BURGJEVE NË SHQIPËRI “Roli i mekanizmave monitorues dhe detyrimet ndërkombëtare”*, f. 6, 43.
- CPT Shqipëria (2003): *Konventa Kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese*, f. 8.
- Faqja zyrtare e drejtorisë së përgjithshme të burgjeve, për më shumë shih Ref. Link
- Gazeta Dita (2012): *Mbi ligjin e ri për shëndetin mendor*. Ref. link
- Instituti Evropian i Tiranës (2012): Raporti i vizitës monitoruese–Qendra Spitalore e Burgjeve Ref. Link
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, pika 5 Neni 28.
- Ligji nr. 47, datë 19.4.2012 për Shëndetin Mendor Pika 6, 9, neni 3.
- Ndalimi i torturës një udhëzues për zbatimin e Nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Manuallet e të drejtave të njeriut, Nr. 6.
- OSCE 2010: “Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim”, Tiranë, f. 36.
- QSHRT, Tiranë (vol15.2013 Nr.1): Shëndeti Mendor dhe të Drejtat e Njeriut, f. 6.
- Raport për veprimtarinë e Avokatit të Popullit 2013, f. 195, 211.
- Raporti i kryetarit të prezencës së OSBE-së në Shqipëri (2012) në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së, f. 5, 7.
- Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve- Parimet Bazë, f. 2, 19. Ref. Link

**SHËRBIMET SOCIALE NË QENDRAT DITORE PAK
(RASTI I BANDËS MUZIKORE
“THE DOOR-ALBANIA”)**

Bujane Topalli, Stelina Shabi

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji- Punë Sociale
Studente e diplomuar në degën Punë Sociale*

ABSTRAKT

Puna sociale është një profesion i ri në vendin tonë, si rrjedhojë dhe shërbimet në këtë sektor janë të krijuara rishtazi. Në fushën e shërbimeve sociale, në rajonin e Shkodrës ushtron veprimtarinë e saj e para trupë muzikore për persona me aftësi ndryshe, e vetjma e këtij lloji në rajonin e Ballkanit. Kjo trupë muzikore, përfaqëson një tipologji të re shërbimi social, e cila ka sjellë risi, ndryshim dhe përfitime tek ata të cilët kanë më nevojë. OJF The Door në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare Kiwanis (dega- Norvegji) ka mundësuar dhe mbështetur krijimin e të parës trupë muzikore për persona me aftësi ndryshe (me probleme të shëndetit mendor), e cila përfaqëson dhe fillimin e funksionimit të një shërbimi të ri social për intergrimin e të rinjve që i përkasin target grupit të lartpërmendur. Nëpërmjet këtij studimi, autorët synojnë që të njihen me eksperiencën dhe opinionet e të rinjve pjesë e bandës muzikore, prindërve dhe instruktorëve të muzikës që punojnë me ta, lidhur me përfshirjen e tyre në Bandën Muzikore dhe faktit sesi jeta e tyre ka ndryshuar pas angazhimit në këtë grup. Për të realizuar këtë punim është përdorë qasja cilësore (intervista dhe fokus grupe) për të kuptuar më në detaje këtë shërbim social. Studimi tregon që ndryshimet që ka sjellë ky shërbim tek personat e përfshirë në “skuadrën e madhe” të Bandës Muzikore, janë pozitive dhe krejt ndryshe nga pritshmëritë që ata kanë pasur në fillim.

**Day care social services for people with disability
(Case of musical of band “The door – Albania”)**

ABSTRACT

Social work is a new profession in our country, the same are the services they provide. In the field of the social services in Shkodra region is

established the first musical troupe for mental disabled people in the Balkan region. This is a new service, which has brought innovation, change and benefits to those who really need it. Ngo The Door in collaboration with the International Organization Kiwanis (branch-Norway) provided support for the establishment of the first musical troupe for persons with disabilities (mental health problems), which expanded and established a new social service for the integration of these young people. Through this study, authors aim to see through the experiences and opinions of the youth, their parents and musical instructors regarding their participation in the Musical Band, how their life have changed after joining the group. The study has used qualitative method (interviews and focus groups) to understand the social services in details. Research shows that the changes of all the people involved in this “big team” as Musical Band, are in positive feedbacks and different from the expectations of each of them.

Hyrje

Profesioni i Punës sociale, ndonëse i ushtruar në vendin tonë vetëm pas viteve 90-të, ka njohur mjaft zhvillime pozitive, ndër të cilat evidetohet dhe tendenca për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në qendra ditore, sidomos për target grupin e personave me aftësi ndryshe.

Evolime të tilla, janë paraprirë nga ligje të miratuara, si ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, i cili garanton nxitjen dhe integrimin e personave me aftësi ndryshe në grupe komunitare apo dhe socializim në shoqëri. Për këtë arsye bashkitë, organizatat e ndryshme dhe të tjera agjenci apo fondacione që kontribuojnë për këtë çështje, udhëhiqen në konceptimin e shërbimeve të tyre, nga objektivat e këtij ligji.

Pikërisht, në këtë studim do të fokusohemi në rastin unik të shërbimit social ditor, të “Bandës Muzikore” për persona me aftësi ndryshe, që ofrohet në Shkodër nga OJF The Door.

Ndonëse ka 17 vjet që është krijuar, ky shërbim konsiderohet shumë unik, pasi për herë të parë aplikohet perspektiva e pikave të forta, në punën me persona me probleme të shëndetit mendor. Në fokus të këtij shërbimi është krijimi i sa më shumë mundësive për përfshirje dhe integrim të rinjve me probleme të shëndetit mendor, në jetën socialkulturore. Kështu, angazhimi i tyre në një formacion muzikor për instrumentë frymorë, ku performohet së bashku muzikë në grup, i nxit ata të eksplorojnë dhe tregojnë aftësitë e tyre më të mira artistike.

Aktualisht, ky shërbim, ka gjetur mbështetje financiare nga Bashkia Shkodër dhe po ofrohet në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”. Kjo ka bërë që komuniteti muzikor i bandës “The Door-Albania” të jetë pjesë e çdo aktiviteti që shkolla organizon dhe gjithashtu që fëmijë me aftësi ndryshe nga kjo shkollë të jenë gjithashtu përfitues.

Modeli i këtij shërbimi social, ndonëse është huazuar nga vendet nordike, ka gjetur një përshtatshmëri mjaft të mirë dhe në kulturën tonë, duke kontribuar në zbutjen e stigmës sociale, rritjen e mundësive për socializim të të rinjve me probleme të shëndetit mendor dhe mbi të gjitha promovimit të konceptit të Komunitetit Muzikor shumë pak i njohur e i lëvruar në vendin tonë.

Ishte pikërisht risia e sjellë nga ky shërbim social, në trajtimin e personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, që motivoi në ndërmarrjen e këtij studimi.

Historiku i komuniteteve muzikore

Muzika në komunitet është një qasje ndaj krijimit të muzikës të të gjitha llojeve (interpretim, improvizim dhe krijim), që thekson bashkëpunimin aktiv midis individëve që luajnë, krijojnë, improvizojnë dhe interpretojnë muzikë së bashku. Komunitete të tilla performojnë në ngjarje të ndryshme kulturore, rrugë duke ndërvepruar kështu dhe me gjini të tjera arti. Komunitetet muzikore shfaqen në forma të ndryshme, si rrjedhojë e synimeve që kanë, për të pasqyruar jetën kulturore të një komuniteti të caktuar.

Anëtarësia në shumë grupe muzikore është vullnetare. Individidi ka liri brenda grupit për të eksploruar role të reja, nga vëzhguesi te krijuesi, duke gjetur mënyra të ndryshme për të marrë pjesë. Në vende të ndryshme të botës njihet dhe është i konsoliduar roli komunitar i grupeve muzikore, megjithëse qëllimet e tyre komunitare janë të ndryshme në secilën kulturë. (Veblen, K., & Olsson, B., 2002)

Në thelbin e vëmendjes së komuniteteve muzikore, qëndron fuqizimi i zërit të individëve që jetojnë në kushte të pafavorshme sociale, kulturore dhe fizike. Pikërisht përveç edukimit formal (arsimit gjithëpërfshirës), komunitetet muzikore konsiderohen si pjesë e edukimit joformal dhe që ndihmojnë mjaft mirë në kauzën e përfshirjes sociale të personave me aftësi ndryshe. Avantazhet që sjell ekzistenca e komuniteteve muzikore, konsiston në faktin që këto grupe janë organizime joformale që nuk kanë nevojë për shumë kushte për të performuar. Skena e tyre mund të jetë shumë mirë një garazh, një skenë e improvizuar në rrugë etj. Gjithashtu

muzika e komunitetit mund të krijohet dhe interpretohet dhe jashtë skenës, si dhe me ose pa një audiencë. Higgins pohon se muzika e komunitetit promovon pjesëmarrjen aktive, stimulon kontekstin për më shumë barazi e mundësi të reja (Boon, 2015).

Vlera e organizimit dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar mendore në komunitetet muzikore, paraqet mjaft avantazhe për përmirësimin e mirëqenies së tyre. Sipas, Moceviciene, matja e cilësisë së jetës përbëhet nga faktorë të gjithanshëm, por ndër më kryesorët janë: shëndeti personal (fizik, mendor dhe shoqëror) si nevoja për të komunikuar, me qëllim arritjen e potencialeve personale në mjedisin përreth (Moceviciene, 2016).

Pjesëmarrja e të rinjve me probleme të shëndetit mendor në komunitetin muzikor të Bandës “The Door-Albania” si dhe përdorimi i terapisë muzikore aktive (apo gjuhës universale të muzikës), i ndihmon ata në mbajtjen e kontakteve sociale apo rritjen e mundësive për komunikim duke sjellë dhe përfitime pozitive në mirëqenien e tyre.

Terapia muzikore me individët psikiatrikë


Terapia muzikore është një mënyrë shumë efektive për të rritur aftësitë shoqërore. Ajo përdor muzikën si mjet terapeutik për të adresuar qëllimet zhvillimore, adoptuese dhe rehabilituese në fushat e sjelljes motorike psikosociale, njohëse dhe shqisore të individëve me aftësi të kufizuara (Oh, 2003).

Improvizimi i muzikës dhe ndërveprimi muzikor mund të përdoret për të lehtësuar vetëshprehjen, kontaktet emocionale me të tjerët dhe ndërveprimin (Pavlicevic, M., & Trevarthen, C., 1989). Roli i terapisë muzikore në zhvillimin e individëve me problem të shëndetit mendor konsiderohet si mjaft rezultativ në disa aspekte.

Muzika përdoret si një mjet për të arritur qëllime jomuzikale si përshembull: rritjen e kujtesës, përmirësimin e koordinimit motorik, rritjen e vëmendjes ndaj detyrës, përmirësimin e qëndrueshmërisë së ecjes, përmirësimin e komunikimit, rritjen e të menduarit të bazuar në realitet, uljen e ankthit, rregullimin e humorit, rritjen e aftësive të përballimit të situatave stresuese dhe përmirësimin e të mësuarit (Lim, 2019).

Kështu pra vërehet një lidhje mjaft e fortë dhe domethënëse, ndërmjet terapisë dhe komuniteteve muzikore e cila në rastin tonë konkretizohet me shërbimin e Bandës Muzikore “The Door-Albania”.

Figura 1 Komuniteti i terapisë muzikore (Pavlicevic, M., & Ansdell, G., 2004).



Metodologjia

Metodologjia e përzgjedhur për realizimin e këtij punimi është ajo cilësore, ku sipas autorit Mason, konsiderohet si emocionuese, por njëkohësisht dhe sfiduese (Mason, 2002).

Referuar pyetjeve kërkimore të ngritura për këtë studim, nga autorët është menduar se kjo metodë është më e përshtatshme për t'u aplikuar, pasi me anë të saj mund të kuptojmë e të njohim eksperiencat, opinionet dhe përjetimet e individëve të cilët angazhohen dhe janë pjesë e bandës muzikore.

Pyetjet kërkimore të adresuara nga ky punim janë:

1. Cila është lidhja ndërmjet komuniteteve muzikore dhe integritit të personave me aftësi ndryshe?
2. Çfarë ndryshimesh ka sjellë përfshirja dhe aktivizimi, i të rinjve me probleme të shëndetit mendor, në Bandën Muzikore të "The Door-Albania"?

Për realizimin e këtij studimi është përdorur kampioni i qëllimshëm, pasi anë të këtij kampioni ishte e mundur të përzgjidheshin subjektet të cilat kishin cilësi që i përshtateshin temës së kërkimit dhe që mund të jepnin informacion të bollshëm dhe të detajuar për çështjen në studim.

Numri i pjesëmarrësve gjithsej ishte: 17 (3 instruktorë muzike; 6 prindër; 8 pjesëtarë të Bandës Muzikore).

Instrumentet e kërkimit të përdorura, përbëhen nga: intervista gjysmë e strukturuar realizuar me instruktorët e muzikës dhe nga dy fokus grupe të realizuara me prindërit dhe të rinjtë e bandës.

Procedura e përdorur në këtë kërkim ishte informimi paraprak i pjesëmarrësve lidhur me qëllimet e këtij studimi, pra marrja e pëlqimit apo dakordësisë së tyre për përfshirje në këtë studim.

Rezultatet

Bazuar tek përgjigjet e dhëna nga të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në fokus grup kemi arritur në këto katër rezultate të studimit, të cilat i kemi pasqyruar dhe me pjesëza të shkëputura nga intervistat dhe fokus grupet e pjesëmarrësve në studim.

1. Ndikimi i bandës në socializimin dhe integrimin e të rinjve në komunitet.

“Unë jam shumë i kënaqur dhe nuk mund të largohem nga kjo bandë. Kam qenë pjesë që kur isha nxënës te shkolla speciale “3 Dhjetori”. Fillimin me dukej i vështirë por ma vonë, me kalimin e kohës, me durim e punë, kam arritë të luaj muzikë në grup”. Pjesëmarrësi 2-Fokus Grup- Anëtar të Bandës Muzikore

“Pjesëmarrja në Bandë i ka ndihmu me u zhvillu në të shprehun e me mësu me qëndru në grup. Janë ba ma korrektë me kalimin e kohës; në orare, veshje dhe në sjellje. Prindi 1

“Dashnia për njeri-tjetrin, respekti për prindin e shoku/-shoqes së grupit. Korrektesa në bindjen ndaj drejtuesve. Egoja pozitive, se kush po e ban ma mirë pjesën muzikore”. Prindi 4

“Dalja e tyre në TV është dicka e jashtëzakonshme sepse njoftojnë të afërmit që ti shohin në TV apo dhe kur marrin pjesë në koncerte i ftojnë si spektarorë”. Prindi 2

2. Mirëqenia e të rinjëve bazuar te eksperiencat e angazhimit në bandë.

“-Unë, kur kam ardhë për herë të parë te banda, faktikisht nuk kam dashtë për me vazhdu, sepse kam pasë vështirë me përballu paragjykimet; duke pasë parasysh se unë nuk jam mirë me shëndet. Por më vullnet dhe pasion gjithcka bahet” **Pjesëmarrësi 4-Fokus Grup- Anëtar të Bandës Muzikore**

“- Kur kam ardhë te banda, kam fillu me zbulu që kam talent në instrumentat e ritmit”. **Pjesëmarrësi 3**

“-Fëmijët tanë kan gjetur vetveten, kanë gjetë shoqni, kanë gjet dashni, kanë gjetë përkrahjen që i bahet prej stafit”. **Prindi 2**

3. Sfidat, strategjitë dhe pritshmëritë e prindërve dhe mësuesve në marrëdhënie me anëtarësimin e të rinjëve në bandë.

“-Pjesë sfiduese ka shumë, duke fillu nga target grupi me aftësi ndryshe që nuk janë në formën e duhur për të luajtur pjesë muzikore ose duke filluar nga fakti që shpesh herë janë konfliktualë për arsye të çregullimeve që kanë, krijojnë situata të papritura të cilat menaxhohen nga punonjësi social, por që ndonjëherë dhe të pamundura, sepse janë shpërthime të momentit”. **Instruktor muzike 1**

“-Asht dashtë me thy dy koncepte. Fëmija me thy konceptin e vet, pra që “-une di të luaj muzikë” dhe se dyti asht dashtë që prindi, me thy konceptin e vet që ka për fëmijën e tij; pra që ai mund të arrijë të angazhohet në muzikë, pasi ka aftësi”. **Prindi 4**

“-Një ndër vështirësi të më të mëdha në aspektin e muzikës qëndron tek fakti se kjo kategori ka raste kur e realizon shumë mirë pjesën muzikore në klasë-në prova, ndërkohë që kur dalin në koncert mund të bllokohen”.

Instruktor muzike 3

4.Menaxhimi i marrëdhënieve prind, staf të rinj.

“-Ndërkohë ne mësuesit e muzikës i kena detyrat e ndame sipas sektorëve”.

Instruktor Muzike 2

“-Ne jemi të fokusuar tek provat dhe rezultati i performancave muzikore, organizimi i grupit i takon stafit te The Door (pjesës tjetër), pasi puna e

ndarë është ma efektive". **Instruktor Muzike 3**

"-Kur shkojmë në koncerte gjithë bashkë, shohim me e ndihmu njëri-tjetrit, gjithsecili vërejmë çka duhet dhe çka asht për me u ba, për me dalë sa ma rregullt dhe korrekt para publikut të rinjë e grupit. Mësusit tonë janë taman shpirtmirë". **Prindi 1**

"-Vajza ime rrin ma mirë kur nuk e shoqëroj unë në aktivitetet. Pasi kur i shoqërojmë ne prindërit, janë si nën kontroll, jo lirshëm". **Prindi 2**

"-Ndjehena si në familje. Jena shumë të kënaqun me profesorat edhe në fakt mua instrumentin ma ka mësu profesori X". **Pjesëmarrësi 8-Fokus Grup- Anëtar të Bandës Muzikore**

KONKLUZIONE

Nga shqyrtimi i literaturës dhe rezultatet e studimit arrijmë në përfundimet që:

- Komunitetet muzikore përkufizohen si komunitete që bëjnë muzikë dhe bashkëpunojnë me njëri - tjetrit, luajnë, krijojnë dhe interpretojnë së bashku duke synuar angazhimin dhe fuqizimin e individëve me probleme të ndryshme emocionale, intelektuale, fizike dhe psikologjike.
- Komunitetet muzikore ndikojnë në mirëqenien e personave me probleme të shëndetit mendor, në aspekte biopsikosociale. Angazhimi i të rinjve në mjedisin shoqëror, i bën të ndihen më të lirshëm në krijimin e marrëdhënieve me të tjerët, i ndihmon në lëvizjet motorike në mënyrë që të ndihen shumë më mirë psikologjikisht.
- Trupa Muzikore pjesë e "The Door" Albania është pjesë e rrjetit të komuniteteve muzikore dhe e vetmja në llojin e saj në Republikën e Shqipërisë dhe ka si pikësynim improvizimin e muzikës, performancën muzikore në grup si dhe socializimin e të rinjve me aftësi të kufizuara, anëtarëve të këtij shërbimi.
- Këta të rinj luajnë një rol shumë të madh si shembull apo model suksesi për të gjithë bashkëmoshatarët e tyre, që janë pjesë e target grupit të personave me aftësi ndryshe, duke qenë se ia kanë dalë mbanë të thyejnë barrierat e paragjytimeve.
- Duke u bazuar tek studimi, aktivizimi në Trupën Muzikore ka bërë që këta të rinj të gjejnë veten dhe të arrijnë nivele të mira përmirësimi në

aspektin emocional dhe psikologjik. Së pari, janë bërë më komunikues dhe pranues të njëri - tjetrit. Së dyti, japin dhe pranojnë kritika, bashkëveprojnë dhe ndërveprojnë me stafin dhe të rinjtë e tjerë. Së treti, janë integruar më shumë në komunitet dhe kanë kurajon dhe dëshirën për të qenë pjesë e aktiviteteve që zhvillohen jo vetëm në lidhje me muzikën.

- Gjatë studimit është evidentuar që dhe në aspektin fizik dhe fiziologjik të kenë përmirësime të ndjeshme në krahasim me fillesat e tyre në bandë. Sa i përket lëvizjeve motorike janë bërë më të shkathët, kanë fituar zhdërvjelltësi, mbajnë shumë më lehtë instrumentët frymorë, të tjerët që kanë probleme me të folurën janë bërë më të lirshëm në komunikim. Pikë tjetër pozitive është dhe përmirësimi i anës konjitive: mbajnë mend mirë partiturat, notat, gjithashtu kuptojnë më shpejt njohuritë e reja.
- Aktivizimi në Trupën Muzikore të të rinjve ka ndikuar pozitivisht edhe tek prindërit. Përpos përkujdesit për fëmijët e tyre, ata arrijnë të koordinohen dhe me punët e angazhimet e tjera. Fakti që fëmijët e tyre janë pjesë e Trupës së Bandës Muzikore dhe angazhohen aty, për këta prindër është gjithashtu një arritje e madhe, sepse këta të rinj nuk i mbyj monotonia dhe izolimi, por ndihen të barabartë mes të barabartëve.

BIBLIOGRAFI

1. Boon, E. T. (2015). Të gjithë janë muzikantë; Gjithkush është një orkestër: dialog muzikor dhe trupor me fëmijë të gjymtuar fizikisht, në Turqi. *International Journal of Community Music*, 8, 149-161.
2. Lim, H. (2019). Shërimi me anë të terapisë muzikore. *ORU Journal of Theology*, 4(2), 215.
3. Mason, J. (2002). Kërkimi cilësor. In J. Mason, *Qualitative researching*. London UK: Sage publications LTD.
4. Moceviciene, A. (2016). Koncepti i vlerësimit subjektiv të cilësisë së jetës në arsimin gjithëpërfshirës. *Education Reform in Comprehensive School: Education Content Research & Implementation Problems*, 70-76.
5. Oh, J. (2003). Efektet e terapisë muzikore në rehabilitimin profesional të banorëve në shtëpitë psikiatrike, 14-16.

6. Pavlicevic, M., & Trevarthen, C. (1989). Një vlerësim muzikor i gjendjeve psikiatrike tek të rriturit. *Psychopathology*, 22(6), 325-334.
7. Pavlicevic, M., & Ansdell, G. (2004). *Terapia muzikore e komunitetit*. Jessica Kingsley Publishers.
8. Veblen, K., & Olsson, B. (2002). Muzika e komunitetit: *Drejt një pamjeje të përgjithshme ndërkombëtare. Manuali i ri i hulumtimit mbi mësimdhënien dhe mësimin e muzikës*, 730-753.

NDËRMARRJET SOCIALE:SI NJË MEKANIZËM AKTIV I MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE NË SHQIPËRI

Suela Kusi Drita, Zyhrada Kongoli

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

ABSTRAKT

Koncepti i ndërmarrjeve sociale është një koncept i ri në legjislacionin shqiptar, i prezantuar për herë të parë me rastin e miratimit të ligjit “Për ndërmarrjet sociale¹”, në qershor të vitit 2016. Ligji shënoi një hap përpara në vendosjen e rregullimeve ligjore dhe mekanizmave për themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale, i cili sot është një koncept me kuptim juridik. Me miratimin e ligjit, qeveria synon të sigurojë mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e grupeve vulnerabël përmes punësimit për integrimin ekonomik dhe social të individëve që përballen me vështirësi për një punësim aktiv për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore të rrethanave familjare. Një marrëveshje e tillë ofron mundësi për një mbrojtje dhe përfshirje sociale gjithëpërfshirëse nëpërmjet promovimit të barazisë gjinore dhe përmirësimit të situatës ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël në veçanti, por edhe të vendit në përgjithësi. Një ndërmarrje sociale është tipikisht një organizatë që zbaton parimet e aktivitetit tregtar për të realizuar integrimin social dhe ekonomik të individëve, të cilëve moshë, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës. Aktiviteti i tyre është i natyrës ekonomike për ofrimin në mënyrë të vazhdueshme të mallrave ose shërbimeve nga të cilat realizohen të ardhura që mundësohet vazhdimi e shtimi i volumit të aktivitetit. Ndërmarrjet sociale jo vetëm luajnë një rol të rëndësishëm për angazhimin e grupeve të pafavorizuara në tregun e punës dhe zhvendosjen e tyre nga skemat pasive të ndihmës, por ato gjithashtu sjellin në treg mallra dhe shërbime të një natyre të veçantë. Bëhet fjalë për mallra e shërbime që mungojnë, të cilat janë në formë të larmishme dhe të përshtatura për individë me nevojë të veçanta ose që janë të përballueshme financiarisht për grupet e pafavorizuara. Ky artikull synon të prezantojë nëpërmjet një përshkrimi joshtrues, duke nxitur frymën e

¹ Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.

përgjegjshmërisë, solidaritetit dhe kohezionit social konceptet bazë mbi ndërmarrjet sociale, përvojat e vendeve anëtare të BE-së dhe të rajonit në rregullimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale, si dhe të bëjë një prezantim me modelin shqiptar bazuar në Ligjin Nr. 65 "Për ndërmarrjet sociale" 2016.

Social enterprises: an active mechanism to ensure the social protection and social inclusion in Albania

ABSTRACT

The concept of social enterprises is still in an early stage in Albania, introduced for the first time by the Law „On social enterprises“ in June 2016, The law marked a step forward on setting the legal arrangements and mechanisms for the establishment and functioning of the social enterprises, which nowadays is a concept with a legal meaning. With adoption of the law, the Government aims at ensuring the social protection and inclusion of the vulnerable groups through employment for the economic and social integration of individuals facing difficulties for an active employment due to age, health of family situation circumstances. Such arrangement provides opportunities for a comprehensive social protection and inclusion through promoting the gender equality and improving the economic and social situation of the vulnerable groups in particular but also of the country at large. Social enterprise is a way of doing business that takes innovative approaches to the development of products and services and to meeting social and environmental challenges. Social enterprises can achieve their aims through the running of their business and/or by investing their profits into social or environmental good. Besides to the important role that social enterprises play in involving disadvantaged groups in labor work and changing them from passive aid schemes, they usually bring to the markets of goods and services of a special nature. It becomes the merchandise of missing services, which are in diverse form and adapted to the things that are necessary or disadvantaged.

This article aims to present a non-exhaustive description of how realistic it can be to be involved in society, promoting a spirit of responsibility, solidarity and social cohesion. The article contains a presentation of the basic concepts of Social Enterprise, an introduction with EU and Regional experiences on how the SE are regulated and function in EU member states and Balcan Region, and introduces as well the Albanian model based on the Law No 65 “On Social Enterprises.

Hyrje

Ndërmarrjet sociale synojnë arritjen e objektivave sociale dhe i alternojnë këto objektiva me iniciativën sipërmarrëse. Krijimi dhe rregullimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale është edhe një nga prioritetet e Komisionit Evropian, nëpërmjet të cilit KE ka për qëllim të krijojë një mjedis të favorshëm financiar dhe ligjor që t'i mundësojë këtyre subjekteve të futen në treg në kushte të barabarta me ndërmarrje të tjera të ngjashme të të njëjtit sektor. Në këtë frymë, Komisioni Evropian, ka promovuar që nga viti 2011 Iniciativën për Biznes Social, iniciativë e cila identifikoi veprimtari që do të sillnin përmirësimin e situatës në praktikë të funksionimit të ndërmarrjeve sociale.

Iniciativa për krijimin e ndërmarrjeve sociale ka ardhur si rezultat i nevojave të tregut për rritje të punësimit dhe gjithëpërfshirje, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për vende pune të lidhura me objektivat dhe parimet sociale. Në vitet e fundit koncepti i ndërmarrjeve sociale ka tërhequr vëmendje gjithnjë e më të madhe, pavarësisht se nuk ka të njëjtin rregullim në të gjithë vendet e Bashkimit Evropian, madje në disa prej tyre nuk është rregulluar as në nivel ligjor.

Shqipëria është një prej atyre vendeve që prej kohësh aspiron anëtarësimin e saj në BE dhe ku termi “Ndërmarrje sociale” përdoret gjithnjë e më shpesh pavarësisht se nuk kishte një rregullim ligjor që të përcaktonte qartë karakteristikat e tij dhe kushtet ligjore që një subjekt të konsiderohej ligjërish si i tillë.

Nevoja për një rregullim ligjor të ndërmarrjeve sociale në vendin tonë është identifikuar edhe nga strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit miratuar nga ana e qeverisë për vitet 2013–2020. Kjo strategji ka trajtuar çështjen e riintegritimit në shoqëri të grupeve vulnerabël duke evidentuar kështu edhe nevojën për krijimin e një ligji të ri që rregullon organizimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale. Rolin për riintegritimin në shoqëri të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit si pjesë e grupeve vulnerabël strategjia ia ka adresuar organizatave jofitimpruese. Strategjia më tej identifikon dhe faktorët të cilët ndikojnë në riintegritimin e suksesshëm të viktimave të trafikimit, ku përfshihen profili individual i personit, mjedisi ku do të riintegrohet, mekanizmat e ndryshëm mbështetës për riintegritim, roli i shtetit, shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale. Punësimi, mbetet një nga faktorët më të rëndësishëm në procesin e riintegritimit, që mundëson pavarësinë ekonomike të grave për të plotësuar nevojat e tyre në periudhën afatgjatë. Në këtë këndvështrim, organizatat jofitimpruese kanë marrë një rol informues, këshillues dhe ndërgjegjësues

për personat që kërkojnë të futen në tregun e punës duke ndihmuar në rekrutimin e personave që janë pjesë e grupeve vulnerabël, negociojnë kushte pune të favorshme dhe ndjekin vijueshmërinë në punë të personave pjesë e grupeve në nevojë. Qartësisht evidentohet rëndësia e ndërmarrjeve sociale në rregullimin e tregut të punës për këto grupe.

Ndodhur në këto kushte, duke evidentuar rëndësinë e krijimit të këtyre subjekteve u miratua ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë” i cili synon rregullimin ligjor për subjektet “Ndërmarrje sociale”.

Rregullimi dhe themelimi i ndërmarrjeve sociale është një parakusht për nxitjen e kohezionit social dhe përmban potenciale të konsiderueshme për krijimin e vendeve dhe roleve të reja të punës në përputhje me Strategjinë e Lisbonës. Ky akt shënon një hap përpara në kuadër të modernizimit të mbrojtjes shoqërore, promovimit të barazisë gjinore dhe në përgjithësi përmirësimit të situatës ekonomike dhe sociale në vend si edhe në mënyrë të qartë përcakton formën juridike të këtyre subjekteve.

Ky artikull synon të paraqesë një përshkrim jo shterues të mundësive reale të angazhimit të ndërmarrjeve sociale në shoqëri, duke nxitur frymën e përgjegjshmërisë, solidaritetit dhe kohezionit social.

Çfarë janë "Ndërmarrjet sociale"?

Ndërmarrjet Sociale janë organizata jofitimpruese të cilat që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duhet të fitojnë statusin “Ndërmarrje sociale”. Statusi “Ndërmarrje sociale” fitohet me anë të përmbushjes së disa kriterëve ekonomike dhe sociale.

Ndërmarrjet sociale evidentojnë problemet e grupeve vulnerabël dhe japin kontributin e tyre me paraqitjen e zgjidhjeve inovative për kapërcimin e tyre duke pasur qëllim primar mirëqenien sociale dhe qëllim sekondar fitimin e të ardhurave të cilat përdoren sërish në funksion të qëllimit kryesor. Ndërmarrjet sociale indukojnë një nivel të lartë të motivimit, udhëhiqen nga vizioni si edhe janë vazhdimisht nën ndikimin e prurjeve të reja që synojnë të sjellin një ndryshim në mënyrën e përfitimit ekonomik dhe social në komunitet. Këto subjekte punojnë drejt përmirësimit të vazhdueshëm të veprimtarive të tyre, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve të pafavorizuara.

Parimet e organizimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve sociale.

Organizimi dhe funksionimi i ndërmarrjeve sociale në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë në dobi të komunitetit bazohet në parime të gjithëpranuara, si në:

- Transparencën - ndërmarrjet sociale dhe organet e tyre vendimmarrëse veprojnë në mënyrë transparente dhe të parashikueshme, duke promovuar pjesëmarrjen dhe llogaridhënien;
 - Qëndrueshmërinë - themeluesit e ndërmarrjeve sociale marrin përsipër rrezikun e qëndrueshmërisë financiare dhe planifikojnë me maturi realizimin e të ardhurave, në bashkëpunim me anëtarët dhe punonjësit;
 - Autonominë dhe llogaridhënien - ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në vendimet e organeve drejtuese, të cilat i marrin vendimet për organizimin, funksionimin dhe administrimin e subjektit në mënyrë autonome dhe pa u ndikuar nga organet shtetërore, edhe pse përfitojnë subvencione publike. Organet publike kanë të drejtë të mbikëqyrin mënyrën e përdorimit të fondeve që ndërmarrjet sociale përfitojnë nga subvencionet publike;
 - Dimensionin kolektiv - ndërmarrjet sociale ruajnë dhe promovojnë dimensionin kolektiv, duke përfshirë në anëtarësi dhe vendimmarrje aktorë të tjerë, të tillë si punonjësit, vullnetarët, përdoruesit e shërbimeve dhe blerësit e mallrave, organet e qeverisjes vendore dhe çdo aktor tjetër të interesuar për të kontribuar në realizimin e një projekti të zhvillimit lokal;
- Efektivitetin - ndërmarrjet sociale planifikojnë dhe përdorin me efektivitet burimet financiare, duke siguruar përfitimin maksimal social të mundshëm.

Etapat e krijimit të ndërmarrjeve sociale

Evidentimi i problemit dhe i zgjidhjes përkatëse

Ndërmarrjet sociale evidentojnë në mënyrë të qartë problemet sociale dhe metodat për zgjidhjen e tyre, pasi në këtë mënyrë është më e lehtë për personat e interesuar të angazhohen dhe të bëhen pjesë e kësaj veprimtarie. Sfida më e madhe qëndron në faktin se si duhet të prezantohet ideja mbi zgjidhjen e një problemi social dhe të shpjegohet se përkrahja e kësaj ideje mund të ndryshojë jetën e një individi dhe komunitetit në tërësi. Ndërmarrjet sociale duhet të bindin të gjithë aktorët që të besojnë dhe të motivohen nga këto iniciativa, të financojnë, të investojnë kohën e tyre dhe të bëjnë pjesë të axhendës angazhimet në mbështetje të çështjeve sociale.

Mbështetja nga partnerët

Ndërmarrjet sociale duhet të përkrahen dhe të mbështeten nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të cilët besojnë në misionin e tyre, i mbështesin fort kauzat sociale, kanë impakt në komunitet dhe kanë eksperiencën e duhur për të kontribuar në ngritjen dhe implementimin e

praktikave më të mira për rritjen e cilësisë së jetës së grupeve të pafavorizuara. Vëmendja jo vetëm e këtyre aktorëve, por edhe e medias gjithashtu, është një mbështetje potenciale dhe tepër e dobishme për promovimin e qëllimeve sociale. Publiciteti sinjalizon dhe ndërgjegjëson shoqërinë në tërësi për rëndësinë e ndërmarrjeve sociale, qëllimin e krijimit të tyre, përfitimet si edhe identifikimin e grupeve të cilat kanë nevojë për vëmendje dhe përkrahje duke shfaqur shembuj realë të historive të tyre.

Përfshirja e një stafi të motivuar

Ndërmarrjet sociale duhet të drejtohen nga individë energjikë, vizionarë të cilët u përkasin fushave të ndryshme profesionale dhe vazhdimisht janë në kërkim të perspektivave të reja që mund të ndihmojnë ndërmarrjet sociale të diversifikojnë strukturën e saj. Ata kontribuojnë edhe në krijimin e urave të komunikimit me aktorë të tjerë potencialë të cilët mund të kenë interes të mbështesin këto ndërmarrje. Ndërmarrjet sociale duhet të angazhojnë grupe pune të motivuara të cilat kanë qasje pragmatiste. Punonjësit e ndërmarrjes sociale duhet të karakterizohen nga fryma e bashkëpunimit dhe të kontribuojnë në arritjen e një qëllimi të përbashkët për përmbushjen e objektivave sociale.

Garantimi i përmbushjes së misionit dhe objektivave sociale

Shoqëria, grupet e pafavorizuara, donatorët dhe organet përkatëse kërkojnë garanci për eficiencën e nismave të ndërmarrjeve sociale. Këto ndërmarrje duhet të pasqyrojnë në mënyrë të detajuar çdo hap të veprimtarisë e tyre duke nisur nga shpenzimet, numri i grupeve vunerabël përfitues nga skemat dhe arritjet e tyre në integrimin social të këtyre grupeve. Në këtë mënyrë dëshmohet qartësisht se këto nisma sjellin rezultate të arritshme. Duke pasur tregues të matshëm, rritet besimi për mbështetjen dhe vazhdimësinë e ndërmarrjeve sociale.

Statusi i ndërmarrjeve sociale dhe kriteret për marrjen e tij

Krijimi i ndërmarrjeve sociale në vendet anëtare të BE-së nuk kërkon domosdoshmërisht miratimin e një formë të veçantë ligjore. Këto ndërmarrje marrin forma të ndryshme ligjore në vende të ndryshme të Evropës. Ndërmarrjet sociale, si organizata, në shumicën e rasteve kanë operuar duke përdorur format ligjore ekzistuese "jofitimprurëse".

Në Belgjikë dhe në Francë, forma më e përhapur ligjore për krijimin e ndërmarrjeve sociale, mbetet ajo e "shoqatës", pasi lejon një shkallë të konsiderueshme lirie në kryerjen e aktiviteteve sipërmarrëse në treg, veçanërisht në lidhje me shitjen e mallrave dhe shërbimeve. Në të kundërt, në vendet ku veprimtaria ekonomike e shoqatave është e kufizuar, siç është

rasti i vendeve nordike si Suedia, ndërmarrjet sociale janë krijuar më shpesh në formën ligjore tradicionale të kooperativave.

Bazuar në përvojën e vendeve të BE-së dhe mbështetur në praktikat më të mira evropiane, në legjislacionin shqiptar është parashikuar që vetëm organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të marrin statusin “Ndërmarrje sociale”. Pas përfitimit të këtij statusi është i detyrueshëm përdorimi i emërimit “Ndërmarrje sociale” në krah të emrit të organizatës.

Një subjekt duhet të plotësojë një minimum kriteresh ekonomike dhe sociale të përcaktuara nga ligji, për të përfituar dhe mbajtur statusin e “Ndërmarrjes sociale”:

Kriteret sociale që duhet të përmbushë një subjekt për të fituar statusin janë:

- Të synojë nxitjen e objektivave sociale në një fushë veprimtarie të mirëpërcaktuar;
- Të punësojë punëmarrës nga grupet e pafavorizuara, të paktën 30% të personelit.

Kriteret ekonomike që duhet të përmbushë një subjekt për të fituar statusin janë:

- Të ushtrojë në mënyrë të vazhdueshme një veprimtari ekonomike në fushën e prodhimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve;
- Të realizojë të paktën 20 % të të ardhurave, pas vitit të dytë të aktivitetit, dhe të paktën 30 % të të ardhurave, pas vitit të tretë e në vijim të aktivitetit, nga shitja e mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve sipas fushave të përcaktuara të veprimtarisë;
- Të punësojë të paktën 3 punonjës me pagesë;
- Të ardhurat t’i përdorë për zgjerimin e veprimtarisë.

Burimet e financimit të ndërmarrjeve sociale

Një prioritet për politikën e çdo vendi në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve sociale është krijimi i përkufizimeve të qarta ligjore të ndërmarrjeve sociale, pasi ato i nënshtrohen zbatimit të legjislacionit fiskal për kategoritë e tatimpaguesve që i përkasin. Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është shumë i lidhur me kontekstin kulturor dhe historik të një vendi dhe ndodhur në këto kushte, zhvillimi i kornizave të përshtatshme ligjore dhe fiskale duhet të dalë nga mjedisi kombëtar dhe lokal në të cilin veprojnë këto ndërmarrje sociale. Në të njëjtën kohë, këto korniza duhet të përshtaten me formën organizative ose format, që ndërmarrjet sociale mund të marrin.

Politikat vendase gjithashtu duhet të njohin fokusin e dyfishtë të ndërmarrjeve sociale, dimensionet ekonomike dhe sociale. Masat

rregullative duhet të hartohen për të lejuar ndërmarrjet sociale të përmbushin qëllimet e tyre sociale dhe ekonomike dhe të zhvillojnë qëndrueshmërinë afatmesme dhe afatgjatë. Gjithashtu, është i nevojshëm një kuadër fiskal që mundëson dhe favorizon misionin social të ndërmarrjeve sociale, pasi për shumë organizata të tjera të ekonomisë sociale, siç janë organizatat bamirëse, janë mundësuar lehtësime fiskale, ndërsa ndërmarrjet sociale shpesh e gjejnë veten të përjashtuara nga përfitime të tilla.

Një numër i konsiderueshëm vendesh evropiane kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme të biznesit duke investuar për një shumëllojshmëri shërbimesh dhe skemash mbështetëse të projektuara posaçërisht për ndërmarrjet sociale dhe më gjerësisht për subjekte të ekonomisë sociale. Këtu përfshihen vendet, si: Belgjika, Kroacia, Danimarka, Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu, Polonia, Portugalia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra dhe Britania e Madhe.

Gjithashtu ka edhe një numër vendesh evropiane të cilat kanë shumë pak ose nuk kanë fare skema të hartuara posaçërisht për ndërmarrjet sociale të cilat financohen publikisht. Ky fenomen ka ndodhur kryesisht në vendet e reja anëtare të BE-së, si: Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Sllovenia, Sllovakia dhe Rumania.

Ekzistojnë edhe disa shembuj të shteteve anëtare të BE-së të anëtarësuar më herët, ku skemat e ndërmarrjeve sociale të financuara publikisht janë shumë të kufizuara ose joekzistuese, përfshirë vendet, si: Austria, Finlanda, Gjermania, Irlanda dhe Holanda. Në disa vende (Finlanda, Holanda) ka qenë një zgjedhje e qëllimshme politike për të mos zhvilluar skema të besueshme për ndërmarrjet sociale.

Grupet e pafavorizuara në fokus të ndërmarrjeve sociale

Ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen sociale dhe mbështetjen e personave të pafavorizuar duke përfshirë specifikisht kategoritë e mëposhtme.

Personat të cilët u përkasin grupeve në nevojë dhe përfitojnë ndihmë ekonomike:

- Personat me aftësi të kufizuara;
- Gratë kryefamiljare;
- Personat me nivel të ulët arsimor;
- Personat në zonat rurale që nuk kanë tokë ose kanë shumë pak tokë;
- Personat e papunësuar që rezultojnë të tillë për më shumë se gjashtë muaj;

- Persona të cilët i përkasin grupmohës 15 deri në 24 vjeçare;
- Persona të cilët nuk kanë kryer një arsim të mesëm ose kualifikim profesional;
- Persona të cilët jetojnë si të rritur më vete dhe kanë në ngarkim një ose më shumë persona;
- Persona të cilët janë anëtar i një minoriteti etnik brenda vendit;
- Gratë dhe vajzat viktime ose viktime të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje;
- Refugjatët, të cilësuar si të tillë sipas legjislacionit për azilin;
- Personat pa shtetësi të cilësuar si të tillë sipas ligjit për të huajt;
- Ish - të burgosurit;
- Anëtarët e komunitetit Rom dhe LGBTI etj.

Modele të ndërmarrjeve sociale në vendet evropiane

Veprimtaritë e ushtruara nga ndërmarrjet sociale krijojnë mundësi të reja për punësim dhe një mjedis inkurajues për integrimin social dhe riintegrimin profesional të grupeve të pafavorizuara në tregun e punës konkretisht në fushat e shërbimeve shoqërore, shërbimeve shëndetësore, shërbimeve në arsim, punësimin të të rinjve, promovimin të turizmit, veprimtarive kulturore, veprimtarive sportive, mbrojtjes mjedisore, kualifikimit dhe ndërmjetësimit për punësim për grupet e pafavorizuara, veprimtarive të tregtimit të mallrave apo shërbimeve, promovim i zhvillimit të komuniteteve lokale, prodhimit etj.

Duke iu referuar kategorive të grupeve të pafavorizuara dhe fushave të ndryshme të veprimtarisë së këtyre ndërmarrjeve sociale po sjellim disa modele të suksesshme të krijimit të ndërmarrjeve sociale që operojnë në disa vende të BE-së.

1. Në Itali, një qendër mjekësore ofron ndihmë të specializuar të nivelit të lartë, veçanërisht në zonat ku ofrohen shërbime publike të dobëta, duke pasur në fokus njerëzit që gjenden në një situatë të vështirë socialekonomike (emigrantët).
2. Në Francë, një biznes në 2004 promovoi një koncept inovativ, atë të shërbimit të larjes së makinave pa ujë, por vetëm duke përdorur produkte specifike dhe punësoi në këtë iniciativë staf të pakualifikuar ose persona nga gupe të pafavorizuara me qëllim riintegrimin e tyre në tregun e punës.
3. Në Hungari, një fondacion, hapi një restorant ku punësoi personel me aftësi të kufizuara (40 punonjës) dhe ofroi trajnime dhe përkujdesje ndaj tyre për t'iu siguruar punësim të

qëndrueshëm.

4. Në Hollandë, një kompani u mëson personave të lexojnë me anë të një metode të bazuar në një lojë duke përdorur mjete inovative digjitale. Kjo metodë është veçanërisht e përshtatshme për fëmijët hiperaktivë ose autikë, por gjithashtu mund të përdoret për njerëzit analfabetë dhe emigrantët.
5. Në Poloni, një ndërmarrje sociale që përfshin dy shoqata punëson në personel njerëz të papunë dhe me aftësi të kufizuara dhe ofron një sërë shërbimesh, si: katering, ndërtime dhe riparime, punime artizanale dhe trajnim për punësim për personat e pafavorizuar.

Ndërmarrjet sociale në shumicën e shteteve anëtare të BE-së, si edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor përbëjnë një sektor të rëndësishëm dhe në zhvillim. Megjithatë, në rastin kur këto ndërmarrje sociale kanë patur një histori të gjatë krijimi dhe janë njohur dhe përkrahur gjerësisht nga politika të qëndrueshme, kanë arritur të shndërrohen në një fenomen të rëndësishëm dhe fleksibël, qoftë nga perspektiva sociale ashtu edhe nga ajo ekonomike apo e punësimit.

Qeveritë vendase luajnë një rol kyç në hartimin e instrumenteve financiare (duke përdorur fonde publike për të siguruar hua ose investime (kapital)). Shembuj të qeverive të cilat realizojnë financime publike i gjejmë në vendet, si: Belgjika, Gjermania, Polonia, Kroacia dhe Britania e Madhe.

Përveç kësaj, fondet e BE-së, janë gjithashtu burim i rëndësishëm për financimin e ndërmarrjeve sociale sidomos në vendet e reja anëtare, si: Kroacia, Hungaria dhe Rumania si edhe vendet candidate për anëtarësim në BE, si Serbia dhe Mali i Zi.

Ndërmarrjet sociale në Shqipëri

Me iniciativën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes shoqërore dhe nëpërmjet një organizimi të një konsultimi të gjerë publik u hartua dhe u miratua në vitin **2016 Ligji nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”**² i cili synon rregullimin ligjor për subjektet “Ndërmarrje sociale”. Zbatimi i ligjit synon **standardizimin e metodave të administrimit të ndërmarrjeve sociale** pavarësisht larmishmërisë së fushës së veprimtarisë dhe objektivave të tyre sociale. Fokusi i tyre është arritja e objektivave sociale dhe jo realizimi i fitimeve dhe për këtë arsye

² Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf

lidhja e tyre me punonjësit, klientët, komunitetin dhe institucionet publike, veçanërisht njësitë e qeverisjes vendore bazohet në bashkëpunim e jo në parimet e tregut. Është plotësisht e mundur dhe e pritshme që ndërmarrjet sociale të themelohen nga vetë personat e pafavorizuar ose të afërmit e tyre.

Për herë të parë në mjedisin ligjor shqiptar termi **“ndërmarrje sociale”** ka marrë një formë ligjore e cila konsiston në disa kriteret të cilat ofrojnë mundësi reale për krijimin e roleve të përshtatura të punës për individë të cilëve mosha, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës. Ligji parashikon që një subjekt duhet të plotësojë një minimum kriteresh ekonomike dhe sociale për përfituar dhe mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale. Kriteret sociale konsistojnë në punësimin e punëmarrësve nga grupet e pafavorizuara ku të paktën 30% të personelit duhet t’u përkasin këtyre kategorive. Në ligj janë përshkruar vetëm grupet shoqërore që konsiderohen si të pafavorizuara për efekt të këtij ligji. Aty përfshihen grupet me probleme të varfërisë ekstreme, përjashtimit social, pabarazisë për shkak të vendndodhjes, papunësisë afatgjatë, përjashtimit për shkak të përkatësisë në minoritete etnike, vështirësive për shkak të të qenit i dënuar apo ose nën varësinë e drogës dhe alkoolit dhe personat e shpërngulur. Për të ofruar më shumë fleksibilitet me qëllim adresimin e politikave afatshkurtra dhe afatmesme qeveritare, kategoritë konkrete të personave të pafavorizuar do të përcaktohen me vendim të Këshillit i Ministrave.

Fushat në të cilat ushtrojnë veprimtarinë ndërmarrjet sociale janë:

- shërbimet shoqërore,
- ndërmjetësimi për punësim të personave të pafavorizuar,
- punësimi i të rinjve,
- shërbimet shëndetësore,
- shërbimet në arsim,
- mbrojtja mjedisore,
- promovimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore,
- veprimtaria sportive me qëllim argëtimin dhe socializimin dhe promovimin e zhvillimit të komuniteteve lokale dhe të tjera si këto.

Një ndërmarrje sociale është tipikisht një organizatë që zbaton parimet e aktivitetit tregtar për të realizuar integrimin social dhe ekonomik të individëve, të cilët mosha, shëndeti dhe gjendja familjare nuk u lejon një disponueshmëri aktive në tregun e punës. Aktiviteti i tyre është i natyrës ekonomike për ofrimin në mënyrë të vazhdueshme të mallrave ose

shërbimeve nga të cilat realizohen të ardhura që mundësohet vazhdimi dhe shtimi i volumit të aktivitetit.

Përveç rolit të rëndësishëm që ndërmarrjet sociale luajnë për angazhimin e grupeve të pafavorizuara në tregun e punës dhe zhvendosjen e tyre nga skemat pasive të ndihmës, ato zakonisht sjellin në treg mallra dhe shërbime të një natyre të veçantë. Bëhet fjalë për mallra e shërbime që mungojnë, që janë në forma të larmishme dhe të përshtatura për individë me nevoja të veçanta ose që janë të përballueshme financiarisht për grupet e pafavorizuara.

Në Shqipëri UN Women ka mbështetur **Nismën për Krijimin e Ndërmarrjeve Sociale (NIS)**³ si një alternativë për të avancuar riintegrimin social dhe ekonomik të individëve të pafavorizuar, sidomos gratë që janë përfituesit kryesorë të programit të kujdesit social, në përputhje me “Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale⁴”, politikën kombëtare mbi përfshirjen sociale dhe ligjin e miratuar kohët e fundit për ndërmarrjet sociale.

Nisma për krijimin e ndërmarrjeve sociale ka ardhur si rezultat i nevojave të tregut për rritje të punësimit dhe gjithëpërfshirje, me fokus rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për vende pune të lidhura me objektivat dhe parimet sociale. Në vitet e fundit koncepti i ndërmarrjeve sociale ka tërhequr vëmendje gjithnjë e më të madhe, pavarësisht se nuk ka patur **një rregullim ligjor që të përcaktonte qartë karakteristikat e një ndërmarrjeje të tillë dhe kushtet ligjore që një subjekt të konsiderohej ligjorisht si një ndërmarrje sociale**. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Shoqërore ka hartuar dhe miratuar të gjitha projektaktet nënligjore të urdhëruara nga ligji. Këto akte përbëhen nga 4 vendime të Këshillit të Ministrave⁵ dhe 5 akte të ministrit përgjegjës

³ Suela KUSI DRITA, Raimonda Duka. Zyhrada KONGOLI, Florjana ÇAUSHI, Jonida RUDAJ (2017) Manuali “Nisma për ndërmarrjet sociale: Një instrument i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Shqipëri » UNWOMEN, Tiranë.

⁴ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019) “Strategjia kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020- 2023”. <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Strategjia-kombetare-2020-2023-okay.pdf>

⁵ - VKM, Nr. 16, datw 12.1.2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale” http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2018/PDF-2018/3-2018.pdf.

- VKM Nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.

<http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Vendim%20i%20KM:56:31.01.2018>

- VKM Nr. 716, datw 1.12.2017 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale".

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/218-2017.pdf

për çështjet sociale⁶.

Pavarësisht punës së bërë deri tani ndërmarrjet sociale dhe veprimtaria e tyre janë shumë pak të njohura për institucionet e pushtetit qendror dhe vendor, për aktorët e tjerë socialë dhe për komunitetin në përgjithësi. Në mungesë të një sistemi arsimor formal të përhapur për ndërmarrjet sociale, të mësuarit nga përvoja ka qenë shtytësi kryesor i njohurive.

Në këtë drejtim shtyllat kryesore nëpërmjet të cilave duhet të promovohen ndërmarrjet sociale në Shqipëri, bazohen në:

- a) Ofrimin e shërbimeve në mbështetjen e krijimit dhe regjistrimit të ndërmarrjeve sociale porse edhe për zgjerimin e veprimtarisë së tyre,
- b) Rritjen e vizibilitetit të ndërmarrjeve sociale,
- c) Mbështetjes së qëndrueshmërisë së veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale,
- ç) Rritjes së rëndësisë së ndërmarrjeve sociale dhe promovimit të arritjeve të tyre,
- d) Forcimit të partneritetit me njësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetet lokale.

⁶ ⁴³ - UDHËZIM Nr. 602, datë 1.8.2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”.

- Udhëzim nr. 677, datë 27.09.2018 “Për përcaktimin e formave, afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale. Udhëzim nr.677, datë 27.07.2018 Për Personat e Punësuar nga Ndërmarrjet Sociale

- Udhëzim nr. 2, datë 04.01.2019 “Për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve sociale dhe rregullat për mbajtjen e tij”.

- Urdhër nr. 636, datë 03.09.2018 “Për miratimin e rregullores tip të funksionimit të ndërmarrjeve sociale” http://www.shendetesia.gov.al/urdher_rregullore-ns/

- Udhëzues mbi “Thirrjen për aplikim për regjistrim dhe marrjen e statusit të ndërmarrjeve sociale”

- Urdhër për miratimin e “Planit të komunikimit mbi ndërmarrjet sociale”.

KONKLUSIONE

Ndërmarrjet sociale po zhvillohen në mbarë botën dhe po sfidojnë gjithnjë e më tepër idenë tradicionale e të bërit biznes vetëm për qëllime fitimi edhe pse në aspektin statistikor ata janë ende një formë e veçantë e biznesit. Ndërmarrjet sociale kontribuojnë duke dhënë ndihmën e tyre për grupet e rrezikuara për përjashtim social përmes ofrimit të trajnimeve dhe aktiviteteve për integrimin e tyre në tregun e punës. Ata gjithashtu adresojnë në strukturat institucionale, nevoja dhe probleme sociale të cilat janë të vështirë për t'u identifikuar.

Promovimi i qëndrimeve pozitive ndaj sipërmarrjes sociale mund të jetë një hap paraprak drejt krijimit të ndërmarrjeve sociale. Një nga mënyrat për të arritur këtë dhe për të tërhequr talentet e reja në këtë sektor është gjithashtu përfshirja e këtyre subjekteve në aktivitetet e edukimit në shkollë, universitete dhe arsimin profesional. Ky mund të jetë një element kyç në strategjitë më të gjera për nxitjen e sipërmarrjes sociale në mesin e të rinjve në shoqëri.

Ndërmarrjet sociale nuk janë zgjidhja dhe mundësia e vetme për sfidat sociale dhe ekonomike në shoqëri, megjithatë, ato japin një kontribut tepër të rëndësishëm në përmbushjen e këtyre sfidave.

Ndërmarrjet sociale nuk kanë imunitet ndaj ndikimit të krizës ekonomike me të cilën ballafaqohet Evropa dhe krijuesit e politikave nuk duhet ta marrin të mirëqenë se ndërmarrjet sociale mund të plotësojnë të gjitha boshllëqet e krijuara nga kriza në ofrimin e shërbimeve apo në krijimin e vendeve të punës për grupet e pafavorizuara.

Veprimtaria e ndërmarrjeve sociale dhe nxitja e zhvillimit të tyre mund të sjellë përfitime afatshkurtra dhe afatgjata për buxhetin publik, përmes shpenzimeve publike të reduktuara dhe rritjes së të ardhurave tatimore krahasuar me metodat e tjera të trajtimit të nevojave sociale. Ndërmarrjet sociale shpesh mund të jenë edhe më efektive se aktorët e tjerë privatë ose të sektorit publik në përmbushjen e qëllimeve sociale për shkak të njohurive të tyre lokale dhe misioneve të qarta sociale.

Kontributi i ndërmarrjeve sociale mund të rritet me ndihmën e politikave që favorizojnë zhvillimin, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e këtij sektori. Fokusi i këtyre politikave duhet të jetë në sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm në të cilin ndërmarrjet sociale mund të zhvillohen, duke përfshirë veprime që promovojnë sipërmarrjen sociale, për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe financiar si edhe qasjen në tregje. E rëndësishme është që qeveritë të punojnë në krijimin e politikave të cilat rrisin kapacitetin e ndërmarrjeve sociale për të kontribuar më efektivisht në

ritjen e gjithëpërfshirjes sociale.

Nuk ka dyshim që vazhdimësia e ndërmarrjeve sociale mbetet një sfidë, megjithatë besojmë se hapat që janë bërë jo vetëm në vendin tonë përmes miratimit të ligjit, por edhe në të gjitha vendet e Evropës si edhe ato që janë projektuar për të ardhmen, janë një tregues i rëndësishëm për vullnetin e aktorëve nga të gjitha sfondet për të maksimizuar potencialin e ndërmarrjeve sociale.

BIBLIOGRAFIA

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019) “Strategjia kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020- 2023” miratuar me VKM Nr. 866, datë 24.12.2019.

<http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Strategjia-kombetare-2020-2023-okay.pdf>

- Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/118-2016.pdf
- Suela KUSI, Raimonda Duka. Zyhrada KONGOLI, Florjana ÇAUSHI, Jonida RUDAJ (2017) Manuali “Nisma për Ndërmarrjet Sociale: Një mekanizëm aktiv i mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Shqipëri” UNWOMEN, Tiranë.
- Konventa e ILO 122 “Konventa për Politikën e Punësimit” (1964) No.122.
- Komisioni Europian (2017) “Nxitja e Zhvillimit të Ndërmarrjeve Sociale-Përmblendhje e Praktikave më të mira” botim i KE & OECD ISBN, 978-92-64-26850-0 *Boosting social enterprise development - Good practice compendium*.
- VKM, Nr. 16, datë 12.1.2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale” http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2018/PDF-2018/3-2018.pdf.
- VKM Nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.
<http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Vendim%20i%20KM:56:31.01.2018>
- VKM Nr. 716, datë 1.12.2017 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale".
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/218-2017.pdf
- UDHËZIM Nr. 602, datë 1.8.2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”.
- VKM 789, datë 26.12.2018 për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale.
<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20192/VKM%20nr.%20789,%20date%2026.12.2018.pdf>
- Udhëzim nr. 677, datë 27.09.2018 “Për përcaktimin e formave, afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale. Udhëzim nr.677, datë 27.07.2018 Për Personat e Punësuar nga Ndërmarrjet Sociale
- Udhëzim nr. 2, datë 04.01.2019 “Për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve sociale dhe rregullat për mbajtjen e tij”.
- Urdhër nr. 636, datë 03.09.2018 “Për miratimin e rregullores tip të funksionimit të ndërmarrjeve sociale” http://www.shendetesia.gov.al/urdher_rregullore-ns/

- Udhëzues mbi “Thirrjen për aplikim për regjistrim dhe marrjen e statusit të ndërmarrjeve sociale”.
- Urdhër për miratimin e “Planit të komunikimit mbi ndërmarrjet sociale”.

BASHKIMI EVROPIAN DHE E DREJTA PËR NJË JETË FAMILJARE NË DITËT E SOTME

Shkëlqim Xeka, Arjana Muçaj

*Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Shkencave
Politiko- Juridike, departamenti i Drejtësisë
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti
i Pedagogji-Psikologjisë*

ABSTRAKT

Në aspektin shoqëror në Evropë ka pasur dukuri të një spektri të gjerë, të cilat kanë ndikuar në një unifikim të disa rregullave me natyrë juridike në fushën familjare, si evolucioni i familjes patriarkale apo me shumë breza në familje bërthamë apo kalimi nga autoriteti i kryefamiljarit (burrit) në njohjen e parimit të barazisë së bashkëshortëve; apo kalimi nga pushteti prindëror në theksimin e detyrave prindërore, e cila është shfaqur plotësisht në konceptin e përgjegjësisë prindërore. Sistemi Evropian në fushën familjare është më kompleks për faktin se kompetencat ekskluzive për normimin e kësaj fushe u përkasin shteteve dhe si pasojë se cili prej shteteve ka sistem të ndryshëm të së Drejtës Familjare. Për më tepër edhe brenda vetë shteteve ka realitete të ndryshme për shkak të përbërjes së tyre, p.sh.: Britania e Madhe ka një rregullim të ndryshëm në pjesët përbërëse të saj (në Angli, Irlandën e Veriut, Uells dhe Skoci). Në fokus të analizës janë aktet e BE-së për respektimin e jetës familjare në drejtim të qëndrueshmërisë së familjes dhe bashkimit familjar, *Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Traktati i Lisbonës* dhe propozimet që janë bërë nga institucionet e BE-së për të forcuar qëndrueshmërinë dhe pacënueshmërinë e jetës familjare nga ana e shteteve anëtare të BE-së.

The European Union and the right to a family life nowadays

ABSTRACT

In the social aspect in Europe there have been phenomena of a wide spectrum, which have influenced a unification of some rules of legal nature in the family field, such as the evolution of the patriarchal family or many generations in the nucleus family or the transition from the authority of the

head (husband) in recognizing the principle of equality of spouses; or the transition from parental power to the emphasis on parental duties, which is fully reflected in the concept of parental responsibility. The European system in the family field is more complex due to the fact that the exclusive competencies for the regulation of this field belong to the states and consequently to which of the states different casework systems of Family Law. Moreover, even within the states themselves, there are different realities due to their composition, for example: Great Britain has a different arrangement in its constituent parts (in England, Northern Ireland, Wales and Scotland). The focus of the analysis is the EU acts on respect for family life in terms of family stability and family reunification, the Charter of Fundamental Rights of the European Union, the Lisbon Treaty and the proposals made by the EU institutions to strengthen sustainability and inviolability family life by EU member states

Keywords: Europe, Family law, institutions, acts, family.

Hyrje

Për shkak të ndryshimeve sociale që kanë prekur jetën tonë, ka ndryshuar dhe kuptimi mbi familjen. Koha që po jetojmë është një kohë veçanërisht e rëndësishme për të konsideruar se si ndërtohet koncepti i familjes në jurisprudencën ndërkombëtare. Familja tradicionale në Evropë përfaqësohet nga ‘familja bërthamë: një çift i martuar i dy personave me përkatësi seksuale të kundërt, si dhe fëmijët e tyre. Por ajo që ne shohim është një ndryshim rrënjësor i asaj çfarë quhej familje në lashtësi dhe atë çfarë quhet familje në ditët e sotme. Kjo ka sjellë ndryshime në rregullimin e politikave dhe marrëdhënieve njerëzore ndërpersonale. Sot ky koncept po distancohet gjithnjë e më shumë nga realiteti në të cilin jetojnë sot. Shumë familje evropiane, kanë një jurisprudencë të gjerë në lidhje me zgjerimin e konceptit të familjes e për më tepër ky lloj koncepti nuk ofron një bazë ligjore për përjashtimin e formave të tjera të familjes. Sot jemi dëshmitarë të zhvillimeve të rëndësishme sociale, të cilat kanë filluar të rimodelojnë konceptet themelore të familjes ideale. Në ditët e sotme divorci është bërë i zakonshëm, duke çuar kështu në rritjen e numrit të familjeve me një prind dhe familjeve birësuese. Një numër gjithnjë e në rritje çiftesh po zgjedhin që të mos martohen, gjë që ka sjellë rritjen e numrit të fëmijëve të lindur jashtë martese. Sot janë të disponueshme teknologji gjithnjë e më të sofistikuara të riprodhimit, që po sfidojnë konceptin tradicional të të qenit prind. Të gjitha këto zhvillime dëshmojnë se familja është në fakt një strukturë fleksibël dhe e adoptueshme. Evolimi dhe zhvillimi i familjes ka

sjellë dhe problematika të ndryshme nga ato që ishin më parë, si rrjedhojë ka dhe një zhvillim të legjislacionit kombëtar dhe atë ndërkombëtar si dhe është krijuar një jurisprudencë e jashtëzakonshme nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatat të tjera Kombëtare e Ndërkombëtare.

Mes atyre familjeve që sot po paraprijnë ripërkufizimin e jetës familjare në Evropë, janë edhe familjet LGBT. Struktura dhe koncepti i familjes po ndryshon. Ka koncepte dhe realitete të ndryshme në shtete të ndryshme, kështu që, është e vështirë të formulosh një politikë të përbashkët në nivel evropian, qoftë brenda gjirit të KE-së qoftë brenda BE-së. Krijimi i një hapësire juridike të përbashkët, ku normat ligjore, të njihen dhe zbatohen në secilin prej shteteve duke garantuar vazhdimësinë dhe zbatimin e të drejtës, është një operacion kompleks i bazuar në një seri mekanizmash të lidhura ngushtësisht midis tyre. Thelbi i së drejtës për martesë është formimi i raporteve juridike të detyrueshme midis një burri e një gruaje dhe e drejta për të lidhur martesë bën pjesë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Njeriu lind me këto të drejta dhe i mbart ato gjatë gjithë jetës së tij dhe është pikërisht shteti ai që duhet të sigurojë garantimin e tyre nëpërmjet ligjit. Që prej vitit 1974, me vendimin ¹Marchx kundër Belgjikës, GJEDNJ-ja ka shtrirë konceptin e jetës familjare edhe në rastin e familjeve të krijuara jo nga martesë apo familja e krijuar nga forma të tjera bashkimi duke arritur të pranojë dhe të afirmojë pas 20- vjetësh, në rastin Keegan kundër Irlandës, se nocioni i familjes i kalon kufijtë e marrëdhënieve të krijuara në bazë të martesës. E drejta për t'u martuar është një premisë për krijimin e jetës familjare, dhe për shumë kohë është konsideruar si i vetmi mjet me anë të së cilës mund të krijohet një jetë familjare. Me kalimin e viteve, në çështjen Kroon e Johnsto kundër Irlandës, u pranua se jeta familjare nuk krijohet vetëm nëpërmjet martesës, por ajo përfshin edhe lidhje të tjera de facto të krijuara jashtë martesë.

Duhet theksuar se e drejta për martesë dhe e drejta familjare janë dy koncepte të ndryshme, pavarësisht se janë të lidhura midis tyre. E drejta për një jetë familjare rrjedh nga raportet e krijuara nga martesë, por jo çdo raport që krijon jetë familjare krijohet nga martesë. (Neni 8 I KEDNJ-së Vendimi Marchx kundër Belgjikës GJEDNJE-se Vendimi Keegan kundër Irlandës GJEDNJE-së).

Rregullimi ndërkombëtar i drejtës për një jetë familjare

Kështu Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ka parashikuar mbrojtjen e jetës familjare në nenet 12 dhe 16 të saj. Konkretisht neni 12 parashikon se *“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në*

¹ Vendimi Marchx kundër Belgjikës GJEDNJE-se.

jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla”.

Ndërsa neni 16 i DUDNJ parashikon të drejtën për të formuar familje dhe të drejtën për martesë. Ajo parashikon se, 1. Burrat dhe gratë në moshë të pjekur kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi. 2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen. 3. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Një akt tjetër i cili parashikon mbrojtjen e jetës familjare është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili në nenin 17 parashikon si më poshtë:

1. Askush nuk duhet të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose letërkëmbim, e as duhet t'i shkelet nderi dhe reputacioni i tij në mënyrë të paligjshme.

2. Secili ka të drejtë të ketë mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve dhe shkeljeve të tilla.

Gjithashtu Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut në artikullin 11 garanton jetën familjare duke parashikuar si më poshtë:

1. Çdokush ka të drejtën të respektohet në nderin e tij dhe të njihet dinjiteti i tij.

2. Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjes arbitrare ose abuzive me jetën e tij private, familjen e tij, shtëpinë e tij ose korrespondencën e tij, ose sulme të paligjshme ndaj nderit ose reputacionit të tij.

3. Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla. Edhe Karta Afrikane e të Drejtave të Njeriut i jep një rëndësi të madhe jetës familjare dhe familjes. Në nenin 18 të saj parashikohet: 1. Familja duhet të jetë njësi natyrore dhe baza e shoqërisë. Ajo duhet të mbrohet nga shteti, i cili duhet të kujdeset për shëndetin fizik dhe moral të tij. 2. Shteti ka për detyrë të ndihmojë familjen që është kujdestare e moralit dhe vlerave tradicionale të njohura nga komuniteti. 3. Shteti duhet të sigurojë eliminimin e çdo diskriminimi ndaj grave dhe gjithashtu të censurojë mbrojtjen e të drejtave të gruas dhe fëmijës siç është përcaktuar në deklaratat dhe konventat ndërkombëtare. 4. Të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara gjithashtu kanë të drejtën e masave të veçanta të mbrojtjes në përputhje me nevojat e tyre fizike ose morale.

Ajo që na bie në sy është rëndësia që Karta Afrikane për të drejtat e Njeriut i jep familjes duke e konsideruar atë kujdestare të moralit dhe vlerave të njohura nga komuniteti. Gjithashtu Karta Afrikane parashikon edhe kujdes të veçantë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara duke qenë se dhe ata janë pjesë e jetës familjare që i rrethon në mjedisin ku jetojnë.

Dhe së fundmi Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikon në nenin 8 të saj të drejtën për jetë familjare; se kjo e drejtë nuk është absolute, pasi autoriteti publik mund të ndërhyjë në këtë të drejtë vetëm në disa raste specifike që paragrafi i dytë i ka parashikuar. Koncepti i jetës familjare është zhvilluar gjatë jurisprudencës së larmishme të GJEDNJ-së duke e zhvilluar dhe zgjeruar ndjeshëm atë.

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës [KDF] (1989)

Në² lidhje me zhvillimin e jetës familjare dhe të drejtat për një jetë familjare, kjo konventë ka një rëndësi të veçantë. Në mënyrë të veçantë, rregullimet e parashikuara në nenet 9, 10, 20, 21, 22 të kësaj konvente janë të rëndësishme për t'u theksuar. Kështu, neni 9 parashikon çështje që kanë të bëjnë me ndarjen e fëmijëve nga prindërit duke nënvizuar se fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit kundër dëshirës me përjashtim kur kjo vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës. Ndarja mund të jetë e nevojshme kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija. Në rastet e ndarjes, fëmija ka të drejtë të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me prindërit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës. Neni 10 dhe neni 22 trajtojnë çështje të ribashkimit familjar parë edhe nga pozita e fëmijës refugjat duke nxitur që këto kërkesa për ribashkim të familjes, të trajtohen në një frymë pozitive, të njerëzishme dhe me shpejtësi. Neni 20 dhe neni 21 trajtojnë masat që duhen marrë ndaj fëmijëve që u mungon kujdesi familjar përmes instituteve të kujdestarisë dhe birësimit.

³Rregullimet në lidhje me jetën familjare në të drejtën e BE-së

Procesi i integritimit evropian ka çuar në identifikimin e disa parimeve të së drejtës familjare evropiane, të cilat kanë ndryshuar konceptin e marrëdhënieve familjare. Në ditët e sotme, legjislacioni i

² Roberto Cippitani e Stefania Stefanell. La parificazione degli status di filiazione, Atti del Convegno di Assisi, Itali, Maj, 2013. Përmbledhje e bërë nga. Faqe 310-312.

³ S. Patti, "Diritto privato e codificazioni Europe". Fq. 231.

BE-së ka në veçanti disa parime, si: ndalimi i diskriminimit, parimi i përgjegjësisë prindërore, parimi i lëvizjes së lirë të personave dhe lirisë në statusin e tyre. Gjithashtu, legjislacioni evropian, bazohet mbi konceptin se marrëdhëniet familjare duhet të shihen në tërësinë e tyre dhe jo të trajtohen të ndara. Jetesa e përbashkët përcaktohet si kriter thelbësor nga legjislacioni komunitar për krijimin e jetës familjare duke lënë të hapur llojin, përbërjen, mënyrën dhe formate të organizimit të kësaj jetese të përbashkët.⁴ Shtetet anëtare duhet të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm se cilat janë format dhe mënyrat e krijimit të jetës familjare. Kuadri i ligjit evropian, nga pikëpamja e rregullave, sot është ende mjaft kompleks. Bashkimi Evropian është zgjeruar dhe në ditët e sotme ka 27 vende anëtare, por nuk ka një të drejtë familjare unike. Çdo shtet e rregullon këtë të drejtë në mënyrë të pavarur, për më tepër edhe brenda vetë shteteve anëtare ka realitete të ndryshme për shkak të përbërjes së tyre, p.sh.: në Britaninë e Madhe ka një rregullim të ndryshëm në pjesët përbërëse të saj (në Angli, Irlandën e Veriut, Uellsin dhe Skocinë), për më tepër në pjesën më të madhe të vendeve, përveç Austrisë, Danimarkës, Estonisë, Maltës dhe Sllovenisë, përkrah martesës civile është edhe martesë fetare. Disa shtete anëtare, midis të cilave Franca, Spanja, Danimarka, Holanda, Belgjika, Finlanda, Gjermania, Britania e Madhe, Zvicra, Luksemburgu kanë parashikuar forma të reja të bashkimit familjar, madje janë të hapura edhe për bashkimin e çifteve të të njëjtit seks. Shtete të tjera si Italia, Austria, Greqia, Malta, Polonia e Republika Çeke njohin vetëm familjen që ngrihet në bazë të martesës. Në jurisprudencë apo në ligje të veçanta, familjet që ngrihen mbi bashkëjetesën u njihen disa të drejta dhe disa detyrime të njëjta me martesën.

Traktati i Lisbonës dhe e drejta për jetë familjare

Traktati i Lisbonës përfaqëson zhvillimin më të afërt të procesit të njohjes së të drejtave themelore të njeriut në përgjithësi, dhe e vetë së drejtës për një jetë familjare. Traktati i⁵ Lisbonës nënvizon nevojën e ekzistencës së një sistemi legjislativ të bazuar mbi të drejtat e njeriut dhe i

⁴ G. Ferrando, *Le relazioni familiari nella Carta dei diritti dell'Unione europea*. Fq 347.

⁵ Andrea Ciccarelli dhe Pietro Gargiulo, *I diritti sociali nell'Unione Europea dopo il Trattato di Lisbona*, in Guida al Lavoro, Itali, 2010.

Luigi Daniele, *Carta dei diritti fondamentali dell'Unione europea e Trattato di Lisbona*, Itali 2008, Fq 660-669.

Rosanna De Meo, *La tutela del minore e del suo interesse nella cultura giuridica italiana ed europea*, në revistën *Famiglia e diritto*, Itali 2013, Fq 230.

Traktati i Bashkimit Evropian Neni 81.

shtyrë drejt integritit të të drejtave njësoj si ai i lirisë së lëvizjes së mallrave, njerëzve dhe kapitaleve. Ai konfirmon se universaliteti dhe patjetërsueshmëria janë vlera të përbashkëta të shteteve anëtare mbi të cilat bazohet Bashkimi Evropian, vlera të cilat kërkon t'i promovojë edhe në pjesën tjetër të botës duke bashkëpunuar me vendet e treta për konsolidimin dhe mbështetjen e të drejtave të njeriut. Neni 6 i TBE-së është neni në lidhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ai jo vetëm që parimet e përgjithshme të së drejtës dhe traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare i konsideron si parime kryesore të strukturës evropiane, por i jep mundësinë BE-së për të aderuar në KEDNJ si dhe i jep Kartës një vlerë juridike të njëjtë me atë të Traktateve të BE-së. Karta mbron familjen dhe jetën familjare në disa aspekte, në atë juridik, ekonomik dhe moral duke mbrojtur individin, si subjekt të së drejtës. Ajo mbron çdo lloj jete familjare të qytetarit evropian, pavarësisht mënyrës sesi është krijuar ajo. Në strukturën evropiane nuk mbrohet familja në vetvete, por e drejta e individit për të krijuar familje dhe jetë familjare. E drejta e individit për ta ruajtur dhe për ta respektuar atë. Personi individualisht, si një subjekt pjesëmarrës në familje, është subjekti përfitues nga nenet që rregullojnë jetën familjare dhe respektimin e saj. Sipas traktatit të Lisbonës, BE-ja pajiset me mjetet e nevojshme normative për ndjekjen e qëllimit të krijimit të një tregu të brendshëm, term i cili nuk ka kuptim vetëm ekonomik. Krijimi i tregut të brendshëm krijoi dhe një hapësirë brenda komunitetit pa kufij, i cili arrihet, ndër të tjera, duke krijuar një liri në lëvizjen e qytetarëve evropianë. Kjo ndikon drejtpërdrejt në jetën familjare, sidomos të punëtorëve, pasi liria e lëvizjes është e lidhur ngusht me jetën e anëtarëve të familjes të punëtorëve. Pavarësisht faktit se Bashkimi Evropian veprimtarinë e tij e kryen mbi bazën e parimit të delegimit, që rregullohet nga parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit dhe e drejta familjare nuk është në kompetencat që i delegohen BE-së, ajo sërish ndikon në këtë sektor. Traktati i Lisbonës i jep BE-së të drejtën që me politikën dhe veprimet e saj të ndikojë në këtë sektor. Akti i parë evropian në lidhje me lëvizjen e lirë është Rregullorja 1612/68, e cila rregullonte të drejtat e qëndrimit dhe lëvizjes të punëtorëve dhe familjarëve të personave që punonin në hapësirën komunitare. Kjo Rregullore e përcaktonte lirinë e qarkullimit të punëtorëve dhe familjarëve të tyre si një të drejtë themelore. E drejta e lëvizjes së lirë, sipas objektivave të Rregullores, ndër të tjera, përcaktohej si një mjet për eliminimin e pengesave për lëvizjen e punëtorëve, në veçanti për sa i përket kushteve për integrimin e familjes së tij në shoqërinë e vendit pritës. Familja e mbetur në vendin e

originës, konsiderohej se banonte në vendin ku ishte vendosur punëtori, në atë masë që ky prezumim të ishte i vlefshëm edhe për punëtorët kombëtarë. Rregullorja, në nenin 1, përcaktonte se subjekte të saj ishin personat që hynin në territorin e një shteti anëtar me qëllim kryerjen e një aktiviteti si nëpunës, pra një qëllim ekonomik. Ajo garantonte të drejtën e punëtorit për t'u vendosur aty së bashku me bashkëshortin apo bashkëshorten, pasardhësit nën 21 vjeç dhe personat në ngarkim të tij apo të bashkëshortit apo bashkëshortes, për shkakun e ruajtjes së jetës familjare dhe rrethit të familjarëve të përfshirë në të. Por, jeta familjare, synohet të mbrohet në tërësi duke e shtrirë mbrojtjen edhe ndaj personave të tjerë të cilët janë familjarë “të tjerë” nga ata të përmendur më lart. Kjo kategori personash mund të hynte dhe të qëndronte në territorin komunitar. Njëri prej akteve i cili parashikon dhe mbron të drejtën për jetën familjare në Bashkimin Evropian është Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Në nenin 7 të Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore sanksionohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare nëpërmjet formulimit: *“Gjithkush ka të drejtën që të respektohet jeta e tij private dhe familjare, shtëpia dhe korrespondenca e tij. Nuk duhet të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte përveç rasteve të përcaktuara në ligj për ruajtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, parandalimit të krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”*. Kështu neni 7 afirmon në mënyrë të veçantë të drejtën për jetë familjare, lirinë e lidhjes së martesës dhe për të formuar një familje. Është e rëndësishme të theksohet se përdorimi i lidhëzës “dhe” mund të interpretohet si garanci që shtrihet edhe në bashkëjetesat e lindura jo mbi bazën e martesës. Në sistemin aktual të së drejtës evropiane objekt i mbrojtjes nuk është familja në vetvete, por e drejta e individit për të formuar një bashkim familjar, e cila nënkupton mbrojtjen e interesave të dy individëve të cilët formojnë një familje. Në këtë rast kemi një përcaktim të gjerë të nocionit të familjes e cila nuk shihet më në formën tradicionale të saj. Pikërisht, për mbrojtjen e familjes dhe për respektimin e jetës familjare, një e drejtë e qytetarëve evropianë dhe atyre rezidentë në të, është e drejta e bashkimit familjar. Masat duhet të merren në përputhje të plotë me nenin 7 të Kartës Evropiane të Drejtave Themelore, në mënyrë që të mos cënohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Autorizimi i bashkimit familjar varet nga shtetet anëtare dhe legjislacioni apo rregullat e nxjerra prej

⁶ Rregullorja e KEE-së Nr.1612/68, Pjesa hyrëse. Rregullorja 1612/68 të KE-së, Neni 10 paragrafi i parë, e miratur në 15 tetor 1968.

tyre. Autorizimi për bashkim familjar i dhënë nga një shtet nuk është i detyruar të aplikohet i tillë edhe në shtetet e tjera, të cilat nuk i njohin ato marrëdhënie familjare që janë përcaktuar si kriter për bashkimin familjar. Neni 9 i Kartës Evropiane të Drejtave Themelore garanton më tej të drejtën për t'u martuar dhe krijuar një familje. Kjo e drejtë garantohet në përputhje të plotë me ligjet kombëtare që rregullojnë ushtrimin e këtyre të drejtave. Në dallim nga neni 12 i KEDNJ-së, ky formulim është një garanci më shumë, pasi duket qartë që hiqet kufizimi që i bëhej kësaj të drejte në baza gjinore pra duke mos u kufizuar vetëm në lidhjen midis një burri dhe një gruaje. Nga ana e Bashkimit Evropian janë marrë masa të cilat synojnë një unifikim të së drejtës, por kjo është ndaluar vetëm në aspektin e rekomandimeve. Në bazë të nenit 308 të TBE-së, Bashkimi Evropian duhet të pajiset me kompetenca për të ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në fushën familjare në mënyrë që vendimet të jenë të detyrueshme dhe mos të jenë më rekomandime të thjeshta. E drejta për një jetë familjare duhet të lexohet duke mbajtur parasysh të drejtat e fëmijëve, nenin 24 të Kartës, me vëmendje parësore tek interesi më i lartë i fëmijës. Duhet mbajtur parasysh nevoja e fëmijës për të mbajtur marrëdhënie personale sistematike dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit e tij, përveçse kur kjo bie ndesh me interesat e tij ose të saj. Duhet pranuar, se nenet 7 dhe 24 të Kartës, të cilët theksojnë rëndësinë e jetës familjare sidomos për fëmijët, nuk mund të interpretohen si privilegje, për shtetet anëtare, të pushtetit diskrecional të tyre në rastet kur gjykojnë kërkesat për bashkim familjar. Shtetet duhet që gjatë këtyre gjykimeve, kur janë fëmijë të përfshirë, duhet të mbajnë parasysh interesin me të lartë të fëmijës, në mënyrë që të favorizojnë dhe të mbrojnë sa më mirë jetën familjare të tyre. Rezoluta e Këshillit të Ministrave dhe e Komisionit për Politikën Sociale dhe të Punësimit, në lidhje me balancimin e pjesëmarrjes së burrave dhe grave në jetën familjare dhe jetën profesionale solli si risi kërkesën që BE-ja u bën shteteve anëtare për njohjen e të drejtës së lejes së lindjes edhe baballarëve. Gjithashtu, Rezoluta, synon dhe propozon marrjen e masave për rritjen e pjesëmarrjes së burrave në jetën familjare duke mbështetur familjen dhe punësimin e grave. Ekuilibrimi i punës dhe jetës familjare është një nga katër objektivat në kuadër të veprimtari mbi barazinë gjinore.

Metoda

Qëllimet e studimit

Ky studim analizon të drejtën për një jetë private dhe familjare në sferën e të drejtës evropiane, duke analizuar aktet, rregulloret dhe

direktivat kryesore të BE-së në lidhje me mbrojtjen e jetës familjare dhe private, pa lënë pas dhe akte të tjera ndërkombëtare në veçanti, Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e jetës private dhe familjare.

Objektivat e studimit

- a. Të shikohen standardet e rregullimit të së drejtës për jetë private dhe familjare brenda të drejtës komunitare të Bashkimit Evropian.
- b. Të aplikohet zbatimi praktik i garancive që lidhen me këto të drejta. Rrjedhimisht është një proces sfidues përkundër vështirësisë për të parashikuar zbatimin e tyre në situata të ndryshme shoqërore dhe gjithashtu fushës së gjerë të veprimit të tyre.

Metoda kërkimore

Metoda kërkimore e përdorur në studim është metoda e shqyrtimit të literaturës të akteve ligjore dhe nënligjore me qasje të fenomenologjisë të së drejtës së jetës familjare. Hulumtimi i akteve ligjore në Bashkimin Evropian na lejon që të bëjmë një këndvështrim të gjerë për sa u takon të drejtave midis burrit dhe gruas në një martesë, por edhe të martesave që rrjedhin nga e njëjta gjini.

Rezultatet e studimit

Pasi u shqyrtuan një seri materialesh dhe u krahasuan me ato ligje të cilat janë përshtatur së fundmi dhe nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë u vu re se kemi: Akte komunitare të lidhura me jetën familjare. *Direktiva 2010/18/BE* për lejen prindërore-synon një balancim të jetës familjare dhe profesionale duke rregulluar lejen prindërore dhe mundësinë e llojeve të reja të lejes familjare duke përfshirë edhe lejen e babait. Parashikimet e kësaj Direktive gjenden të pasqyruara edhe në Kodin e Punës të RSH-së, pas ndryshimeve të bëra në vitin 2015. Objekt i kësaj direktive janë prindërit që punojnë, të cilët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Masa të tjera që janë marrë nga shtetet për ekuilibrimin e jetës familjare dhe profesionale i takon kohëzgjatjes së punës apo politika e orareve fleksibël, duke i dhënë mundësinë punëtorëve që jo vetëm të zgjedhin oraret më të përshtatshme, por edhe kohëzgjatjen e tyre. Kjo politikë zbatohet vetëm për prindërit dhe personat që kanë një kujdestari ligjore të një të mituri. Kështu, Holanda, i garanton çdo punonjësi të

drejtën ligjore për të rregulluar orët e tyre të punës. Një punëtor me kohë të pjesshme mund të rrisë numrin e orëve të tij të punës dhe, anasjelltas, një punëtor me kohë të plotë mund t'i zvogëlojë ato.⁷ Kjo kërkesë mund të refuzohet nga punëdhënësi vetëm për interesa të përligjura. Direktivat e vitit 1990 janë disa prej akteve të tjera të cilat kanë patur ndikim mbi jetën familjare. Rregullime me rëndësi gjenden në *Direktivën nr. 90/364/KEE*, në lidhje me lirinë e qëndrimit të qytetarëve komunitarë, *Direktivë nr. 366/90/KEE* në lidhje me lirinë e qëndrimit të studentëve dhe *Direktivën nr. 90/365/KEE* në lidhje me lirinë e qëndrimit të personave të cilët nuk janë më të punësuar. Këto tri Direktiva e zgjeruan rrethin e personave të cilët mund të lëviznin lirisht në hapësirën komunitare edhe ndaj atyre të cilët nuk ishin punëtorë. Ata vendosnin si kusht se përfituesit e Direktivave dhe familjarët e tyre duhet të ishin të siguruar në rast sëmundjeje dhe të ardhurat e tyre të ishin mbi nivelin e ndihmës sociale të vendit ku ata vendoseshin. Kjo do të thotë se këta persona dhe familjarët e tyre duhet të kishin të ardhura të mjaftueshme për jetesë në mënyrë që të mos rëndonin mbi financat e vendit pritës. Sot këto Direktiva janë anuluar dhe në fuqi është Direktiva nr.2004/38/KE. Qytetarët evropianë dhe familjarët e tyre mund të lëvizin dhe të qëndrojnë lirisht në territorin e një prej shteteve anëtare të BE-së në saj të Direktivës 2004/38/KE e cila unifikoi dhe thjeshtëzoi këtë sektor duke krijuar një regjim të vetëm ligjor për lëvizjen e lirë dhe të qëndrimit në të gjithë territorin e Bashkimit Evropian. Këto të drejta njihen jo vetëm për qytetarin evropian, por edhe për familjarët e tij, të cilët nuk gëzojnë statusin e shtetasit të një prej shteteve anëtare. Direktiva 2004/38/KE bëri të mundur krijimin e një akti të vetëm në lidhje me të drejtën e lëvizjes të qytetarit evropian dhe familjarëve të tij, përcakton kushtet mbi bazën e të cilave mund të ushtrohet kjo e drejtë, si dhe sqaron statusin që kanë kategori të ndryshme si punëtorët e pavarur apo studentët. Personat të cilët përfshihen në konceptin e familjarëve të qytetarit evropian jepet në nenin 2 të Direktivës 2004/38/KE. Kjo Direktivë përcakton një standard në minimum përsa u përket personave që do të përfshihen në konceptin e familjes dhe të jetës familjare, duke i lënë të lirë shtetet që të përfshijnë

⁷ CES Reconciliation of work, Family and Private Life. Marrë në sitin <http://ëëë.etuc.org>.

Direktiva e Parlamentit Evropian 2004/38/KE, e miratuar më 29 Prill 2004 në lidhje me të drejtën e qytetarëve evropianë dhe familjarëve të tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e shteteve anëtare. Kjo Direktivë ndryshon Rregulloren e KEE n. 1612/68 dhe shfuqizoi Direktivat 64/221/KEE, 68/360/KEE, 72/194/KEE, 73/148/KEE, 75/34/CEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE dhe 93/96/KEE.195<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/IT/TXT/HTML/?uri=URISERV:133118&from=IT> . Hyrë më datë 22.09.2015.

edhe kategori të tjera. Kjo Direktivë, gjithashtu, e lë në diskrecionin e shteteve marrjen e masave më të favorshme për mbrojtjen e jetës familjare në kuadër të bashkimit familjar. Sipas Direktivës në kategorinë e familjarëve përfshihen: –bashkëshorti. –partneri i qytetarit evropian me të cilin ai ka lidhur një partnership, në bazë të legjislacionit të shtetit anëtar, nëse legjislacioni i shtetit pritës e konsideron partnershipin e regjistruar të barasvlefshëm me martesën; –pasardhësit e drejtpërdrejtë të cilët janë nën moshën 21 vjeç ose që janë nën kujdestarinë e tij dhe ata persona që janë në varësinë apo pasardhës të drejtpërdrejtë të bashkëshortit apo të partnerit. Në këtë rast partner do të konsiderohet një person sipas përcaktimeve të shprehura në pikën e mësipërme; –të afërmit e varur në linjë paraardhëse të drejtpërdrejtë të qytetarit dhe ata të bashkëshortit ose partnerit. Direktivë tjetër në lidhje me bashkimin familjar është edhe ajo 2003/86/KE, e cila ka ndikuar në futjen e rregullave të përbashkëta për të drejtën e ribashkimit familjar për ata që nuk gëzojnë qytetarinë evropiane.⁸ Duhet përmendur se shtetasit shqiptarë të cilët qëndrojnë në vendet e BE-së për procedurat e bashkimit familjar i nënshtrohen kësaj Direktive. Familjarët e personave joevropianë mund të përfitojnë nga e drejta e bashkimit familjar, pra të bashkohen me ta në një vend të BE-së ku ata banojnë në mënyrë të ligjshme. Qëllimi i kësaj Direktive është për të mbrojtur unitetin e familjes dhe për të lehtësuar integrimin e shtetasve të vendeve të treta. Familjarët e qytetarit evropian, të cilët janë qytetarë joevropianë, që kërkojnë azil apo kanë një status tjetër mbrojtës nga shteti, nuk hyjnë në sferën e zbatimit të kësaj direktive. Në këtë direktivë jepet edhe koncepti i bashkimit familjar. Sipas saj hyrja dhe qëndrimi në një shtet anëtar të pjesëtarëve të familjes të një shtetasi të një vendi të tretë me qëndrim të ligjshëm në atë shtet anëtar në mënyrë që të ruhet familja e bashkuar, edhe nëse marrëdhënia familjare është krijuar përpara apo pas hyrjes së personit rezident¹⁹⁸. Shohim se Direktiva 2004/38/KE, që i drejtohet qytetarëve evropianë, ofron një mbrojtje më të madhe të jetës familjare se Direktiva 2003/86/KE. Kjo gjë ndodh për faktin se përcaktohet një rreth më i gjerë i personave që përfshihen në rrethin e familjarëve. Kështu, Direktiva 2004/38/KE, përcakton një moshë më të madhe për fëmijët që përfitojnë bashkimin familjar, që është moshë 21. Direktiva 2003/86/KE përcakton se fëmija duhet të jetë minoreni, dhe në shumicën e vendeve moshë kur personi bëhet maxhoren është 18 vjeç. Për më tepër, në rast se fëmijët martohen përpara kësaj moshe ata e humbasin të drejtën e bashkimit familjar, në bazë të Direktivës 2003/86/KE, gjë

⁸ Guido Sirianni. Il diritto degli stranieri alla unita familiare. vep.cit., faqe 70.

që nuk ndodh në momentin kur zbatohet Direktiva 2004/38/KE.⁹ Madje, sipas Direktivës 2004/38/KE, pasardhësit edhe pas mbushjes së mohës 21 vjeç, nëse janë në varësi të qytetarit evropian, përfitojnë të drejtën e bashkimit familjar. Zvicra, Belgjika dhe Holanda të drejtën e bashkimit familjar e kanë njohur edhe për çiftet homoseksuale. Italia njih të drejtën e bashkimit familjar për fëmijët e mitur, prindërit që janë në ngarkim të personit, me kusht që prindërit të mos kenë në vendin e origjinës fëmijë të tjerë që janë në ngarkim të prindërve.¹⁰ Gjithashtu, në Itali, mund të bëhet bashkim familjar edhe për fëmijët mbi 18 vjeç që janë në ngarkim të personit, me kusht që fëmijët për shkak të gjendjes shëndetësore nuk janë në gjendje të punojnë. Aktet kryesore në të drejtën komunitare kanë dhënë rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtës për jetë familjare. Zhvillimet e reja në veçanti kanë mundësuar lëvizjen e lirë të studentëve, punëtorëve etj., në mënyrë të tillë për të lehtësuar zhvillimin e qëndrueshmërinë e marrëdhënieve familjare duke siguruar kështu të drejtën për jetë familjare të individëve. Sidoqoftë, duhet theksuar se sektori i jetës familjare nuk është një sektor ku BE-ja ka kompetenca të plota të ndërhyjë; organet e BE-së veprojnë mbi bazën e kompetencave të deleguara nga shtetet duke respektuar disa prej parimeve themelore të organizimit të BE-së siç janë parimi i proporcionalitetit dhe subsidiaritetit. Gjithashtu, në nivelin e BE-së, e drejta për jetë familjare nuk është e unifikuar, por ka ndryshime në parashikimet ligjore të çdo vendi anëtar për mënyrën sesi këto shtete anëtare e sigurojnë të drejtën për jetë familjare dhe të drejtën për të krijuar familje.

Mbrojtja rajonale evropiane e të drejtës për një jetë familjare.

Mbrojtja e të drejtës për një jetë familjare në rajonin e Evropës sigurohet në disa nivele. Gjendja aktuale në Evropë është shumë e veçantë, pasi ajo karakterizohet nga një shumëllojshmëri burimesh të cilat njohin dhe garantojnë këto të drejta, një shumëllojshmëri fushash dhe nivelesh veprimi.¹¹ Për këtë arsye, e parë nga ky këndvështrim, ekzistojnë disa sisteme normative, institucionale dhe juridiksionale, të cilat veprojnë njëkohësisht dhe kanë nivele hierarkie, që në disa raste krijojnë edhe mbivendosje. Shkalla apo niveli i parë i mbrojtjes dhe garantimit të së drejtës së individit për një jetë familjare janë Kushtetutat dhe legjislacionet

⁹ Luljeta Ikonimi, E drejta migratore. Tiranë 2009. vep.cit., faqe 87.

¹⁰ Raporti mbi emigrimin në Bashkimin Evropian. Marrë në sitin zyrtar <http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php>.

¹¹ <file:///C:/Users/pc/Desktop/VENDIME%20GJYKATES/Teme%20Diplome%20-Praktike%20e%20GJEDNJ-se.pdf> fq.5-8

kombëtare. Një tipar i përbashkët i mjaft Gjykatave Kushtetuese evropiane është se mbrojtja e kësaj të drejte bëhet kundër ligjeve arbitrare. Qëndrimi i organizatave rajonale për të siguruar mbrojtje më të madhe të kësaj të drejte ka çuar në miratimin, si brenda Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, të akteve të ndryshme në nivel ndërshtetëror për të siguruar mbrojtje. Sistemi evropian i të drejtave të njeriut ngrihet, në shkallë rajonale, nga një mekanizëm i dyfishtë dhe asimetrik për mbrojtjen e të drejtës për një jetë familjare nëpërmjet një shkalle në rritje të efektivitetit gjyqësor dhe përmes një vullneti politik të shteteve anëtare për garantimin real të kësaj të drejte. Nën ombrellën e Këshillit të Evropës është zhvilluar “sistemi konvencional” i të drejtave dhe lirive të njeriut i cili është vendosur me KEDNJ-në, me anën e të cilit garantohet edhe e drejta për një jetë familjare. Pra, nëse bëjmë një numërim të niveleve të sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtës për një jetë familjare shohim se janë tri nivele: 1. kombëtar, 2. Evropian, si dhe 3. Ndërkombëtar.

Sistemi i garancisë për të drejtat e njeriut, në tërësi, në sistemin evropian është mbresëlënëse, pasi personat fizikë mund t'i drejtohen një juridiksioni mbishtetëror, në rang Evropian për t'u ankuar kundër shtetit të tyre për shkelje të detyrimeve të ndërmarra respektivisht nga neni 8 i KEDNJ-së apo instrumente të ndryshme të miratuara nga Bashkimi Evropian, si neni 7 i Kartës Evropiane të Drejtave Themelore dhe Direktivave të ndryshme. Institucionet juridike evropiane arrijnë të futen dhe të përhapen në sistemin e brendshëm të gjykatave kombëtare, duke garantuar një shkallë autonomie dhe lirie në krahasim me ligjvënësit kombëtar, pasi dimensionin evropian juridik shihet si një mundësi dhe jo si një kusht.

Natyra e jetës familjare

Pika e parë që duhet të qartësohet kur kemi të bëjmë me komponentin e “jetës familjare” të nenit 8 është domethënia që i jepet fjalës “familje”. Nocioni i përdorur nga Gjykata është zhvilluar me kalimin e kohës, në përputhje me qëndrimet në ndryshim të shoqërisë evropiane, dhe mund të vazhdojë të ndryshojë në vështrim të zakoneve në ndryshim e sipër. Gjykata ka ripërsëritur në praktikën e saj gjyqësore se nocioni i “jetës familjare” në nenin 8. Nuk është vetëm i kufizuar në familjet që bazohen në martesë, dhe se mund të përfshijë edhe marrëdhëniet e tjera de fakto. Me rastin e marrjes së vendimit nëse mund të thuhet se një marrëdhënie e caktuar përbën “jetë familjare”, një numër faktorësh mund të jenë relevantë, duke përfshirë ata nëse çifti jeton së bashku, kohëzgjatjen e

marrëdhënies së tyre dhe nëse kanë demonstruar përkushtimin e tyre ndaj njëri-tjetrit, duke pasur fëmijë së bashku apo përmes ndonjë mënyre tjetër.

Qasja¹² fleksibile e Gjykatës merr parasysh llojllojshmërinë e rregullimeve familjare në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe implikimet e krizës dhe drejtimeve të zhvillimeve të tyre. Rrjedhimisht, jeta familjare *de facto* njihet sipas Konventës në baza të njëjta sikurse edhe lidhjet e krijuara në mënyrë zyrtare. Fakti që Gjykata vendos për ekzistimin e jetës familjare sipas parimit prej rastit në rast, duke vlerësuar lidhjet e ngushta personale mes palëve, do të thotë se nuk është e mundur që të cekën të gjitha marrëdhëniet që përbëjnë jetën familjare.

Sido që të jetë, nëse një situatë e caktuar nuk hyn në kuadër të nocionit të “jetës familjare”, mund të gëzojë mbrojtjen e nenit 8 nga këndvështrimi i “jetës private”. Ç’ka përbën jetën familjare për qëllime të nenit 8.

Për qëllime të nenit 8, marrëdhëniet vijuese janë konstatuar se përbëjnë jetën familjare:

- mes fëmijëve dhe gjyshërve të tyre;
- mes motrave dhe vëllezërve, pavarësisht moshës; mes axhës (dajës) apo hallës (tezës) dhe nipit e mbesës së tyre;
- mes prindërve dhe fëmijëve të lindur në marrëdhënien e dytë apo mes fëmijëve të lindur në marrëdhënie jashtëmartesore ose kurorëshkelëse, në veçanti kur atësia e fëmijëve është njohur dhe palët kanë lidhje të ngushta personale;
- mes prindërve birësues/njerkëve dhe fëmijëve.

Jeta familjare nuk është e kufizuar në marrëdhënie shoqërore, morale ose kulturore, por gjithashtu përfshin interesat e llojit material, siç janë obligimet lidhur me mirëmbajtjen, të drejtat trashëgimore dhe kufizimet, si dhe çështjet e disponimit mes të afërmeve të ngushtë. Megjithatë, neni 8 nuk mund të interpretohet se imponon obligime ndaj shteteve për të njohur martesat fetare ose për të krijuar sistem të veçantë për kategoritë e veçanta të çifteve të pamartuara për qëllime të trashëgimisë. Është interesant të theksohet se të gjitha marrëdhëniet e lartpërmendura gjithashtu gjenden në listën e pjesës së këtij doracaku ku bëhet fjalë për “jetën private”. Varësisht prej fuqisë, rregullimeve dhe karakteristikave të lidhjes personale, ato do të konsiderohen brenda njërit apo fushëveprimit tjetër, si të mbuluara përmes nenit 8. Rezultati përfundimtar, gjerësisht mbrojtja, nuk ndryshon. Prania e martesës së ligjshme dhe të mirëfilltë është e mjaftueshme për t'u thirrur në

¹² 2. X, Y, dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar. 73. Schalk dhe Kopf kundër Austrisë.
file:///C:/Users/pc/Desktop/punim%20drejte%20private%20dhe%20familjare.pdf

mbrojtje sipas nenit 8 për të gjithë personat e përfshirë, kështu që fëmijët do të konsiderohen si pjesë e asaj marrëdhënieje nga momenti i lindjes së tyre. Kjo do të thotë se martesat për letra dhe me para, si për shembull ato që bëhen për t'u shmangur rregullave të imigrimit apo për të fituar shtetësinë, mbesin jashtë fushëveprimit të dispozitës. Martesa zyrtare është e mjaftueshme dhe nuk është e nevojshme që jeta familjare të ekzistojë: marrëdhënia mes nënës dhe fëmijës së saj nënkupton mbrojtjen sipas konventës pavarësisht gjendjes martesore.¹³Në rastin Johnston Gjykata sqaroi se çiftet e pamartuara që vazhdimisht dhe në mënyrë stabile jetojnë së bashku me fëmijët e tyre, me rregull do të thuhej se gëzojnë jetë familjare, duke u bërë kështu të padallueshëm nga forma e njëjtë shoqërore e bazuar në martesë. Ngjashëm me këtë, bashkëbanimi nuk është i nevojshëm për ekzistimin e jetës familjare. Siç ka sqaruar Gjykata: Koncepti i jetës familjare, në të cilin bazohet neni 8, edhe në rastet kur nuk kemi bashkëbanim, nënkupton lidhjen mes prindit dhe fëmijës së tij, pavarësisht nëse fëmija është legjitim apo jo. Edhe pse kjo lidhje mund të shprehë rezultat i ngjarjeve të mëvonshme, kjo mund të ndodhë vetëm në rrethanat të jashtëzakonshme. Kjo do të thotë në situatat, siç janë ato që rrjedhin nga vonesa e njohjes së fëmijës nga babai i vet, mosmbështetja financiare e fëmijës së tij apo vendimi i tij për ta lënë fëmijën nën kujdesin e të afërmeve me rastin e emigrimit në një shtet nënshkrues të konventës është konstatuar se përbëjnë rrethanat e jashtëzakonshme, të cilat jo domosdo si të tilla përfundojnë jetën familjare. Përmes nenit 8 po ashtu mund të zgjerohet mbrojtja në situatat, ku krijimi i kontakteve mes kujdestarit dhe fëmijës së tij është i vështirë apo i pamundur për shkak të sjelljes së prindit tjetër. Kur dalin në pah rastet e tilla, Gjykata do të vlerësojë jetën e mundshme familjare që rrezikohet, duke marrë parasysh mjedisin dhe rrethanat, siç është natyra e marrëdhënies mes fëmijës dhe prindit, plani i tyre familjar, rrethanat e krizës familjare dhe lidhja emocionale me fëmijën.

A janë të nevojshme apo të mjaftueshme lidhjet e gjakut për krijimin e jetës familjare?

Prania e lidhjes biologjike dhe e prindit nuk përbën jetë familjare ipso facto.¹⁴Ngjashëm, mungesa e lidhjeve të gjakut nuk do të përjashtojë automatikisht që marrëdhënia të mos hyjë në konceptin e familjes. Edhe pse Gjykata ka vendosur të mos ndjekë qasjen “e realitetit shoqëror para

¹³ Söderbäck kundër Suedisë.
Boughanemi.

¹⁴ Keegan kundër Irlandës.
G. kundër Holandës

atij biologjik”, e vërteta është se vetëm njëherë ka konstatuar se jeta familjare ka ekzistuar mes personave pa lidhje të gjakut. Kjo ka ndodhur në rastin X, Y dhe Z, ku ka konsideruar se marrëdhënia mes femrës dhe mashkullit transseksual dhe fëmijës së tij, të lindur me fekondim artificial me ndihmën e dhuruesit (AID), ka përbërë jetë familjare. Gjykata e bazoi konkludimin e saj në faktin se marrëdhënia e paditëses nuk dallohej nga ajo që gëzon familja tradicionale dhe se partneri transseksual kishte marrë pjesë në procesin e AID-së si babai i fëmijës. Vetëm prania e afërsisë biologjike, pa ndonjë element tjetër ligjor apo faktik që tregojnë ekzistimin e marrëdhënies së afërt personale, sipas mendimit të Gjykatës nuk do të mjaftonte për të iniciuar mbrojtjen sipas nenit 8.

KONKLUZIONE

Koncepti i jetës familjare sa po vjen e po merr një zgjerim dhe një mbrojtje më të madhe qoftë në nivelin evropian, por edhe në nivel kombëtar, kjo falë akteve, direktivave, rregulloreve të nxjerra nga BE të cilat zbatohen në vendet anëtare të BE-së, por pasojat juridike të tyre mund të prekin dhe shtetas të cilët i përkasin vendeve joanëtare të BE-së duke i dhënë një garanci të drejtës për jetë familjare dhe duke e konsideruar si një të drejtë themelore për formacionin social. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Traktati i Lisbonës, Karta për të Drejtat Themelore Evropiane dhe shumë direktiva të tjera i kanë akorduar një rol të rëndësishëm familjes, por Bashkimi Evropian, nuk ka marrë asnjë kompetencë specifike në fushën familjare duke e lënë në dorë të shteteve dhe legjislatoreve vendase të çdo shteti anëtarë të BE-së. Sipas praktikës së GJEDNJ, jeta familjare krijohet nga një martesë, nga një bashkëjetesë, partnership dhe nga çdo marrëdhënie e qëndrueshme midis dy ose më shumë personave, pavarësisht nëse kjo marrëdhënie mbrohet dhe njihet ligjërisht ose jo. Ekzistenca e jetës familjare përcaktohet nga disa faktorë të cilët janë: Jetesa nën të njëjtën banesë të personave, qofshin këta bashkëshortë, bashkëjetues, partnerë, persona që kanë lidhje gjinie ose jo. Por, ka raste, sidomos në familjet e emigrantëve, ku personat nuk jetojnë në të njëjtën banesë. Kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë jetë familjare. Kohëzgjatja e marrëdhënies e cila duhet të jetë e karakterizuar nga vazhdimësia. Demonstrimi i përkushtimit për njëri-tjetrin të anëtarëve të familjes dhe angazhimi për vazhdimësinë familjes, ekzistenca e fëmijëve dhe prezenca e një raporti afektiv real. Por, duhet theksuar se ekzistenca e fëmijëve nuk është kusht thelbësor për ekzistencën e jetës familjare midis partnerëve. Nëpërmjet jurisprudencës së

GJEDNJ, por edhe të GJED, kemi arritur në përfundimin se e drejta për martesë nuk është e vetmja formë e cila legjitimon të drejtën për jetë familjare, por ka edhe forma të tjera, si: bashkëjetesa, marrëdhënia kujdestar-fëmijë, adoptues-fëmijë madje koncepti ka arritur edhe tek partneriteti midis dy gjinive të njëjta duke u njohur të drejtën për jetë familjare edhe personave të komunitetit LGBT në disa vende të Evropës. Sfera e mbrojtjes së nenit 8 është bërë më e ndërlikuar me zhvillimin e praktikës gjyqësore. Në vitet e fundit GJEDNJ-ja ka zgjeruar dukshëm veprimin e saj në respekt të nenit 8, kjo përkon edhe me karakteristikën kryesore të kësaj të drejte, që është balancimi mes mbrojtjes të drejtave të njeriut dhe respektimit të tyre nga ana e shteteve. Mbrojtja e të drejtës për një jetë familjare në rajonin e Evropës sigurohet në nivel kombëtar (nga legjislacionet kombëtare), në nivel rajonal dhe në nivel ndërkombëtar, ku ka një mbivendosje të mekanizmave mbrojtëse të krijuara nga KE-ja dhe nga BE-ja. Sistemi juridiksional përbëhet po nga tre nivele që janë gjykatat kombëtare, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe nga Gjykata e Drejtësisë, ku këto dy të fundit janë sa të pavarura aq edhe të lidhura përsa i përket interpretimit të së drejtës për një jetë familjare. Në Shqipëri, niveli i tretë i mbrojtjes, që i përket Bashkimit Evropian, ende nuk ka fuqi ligjore, për shkak se nuk jemi vend anëtar. Rregullimi i jetës familjare nga ana e BE-së është i pjesshëm dhe ad hoc, për pasojë zhvillimi i së drejtës familjare është në fazat fillestare. Në këtë mënyrë, KEDNJ-ja, dokumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe kushtetutat e shumë shteteve anëtare i kanë akorduar një rol të rëndësishëm familjes. Asnjë kompetencë specifike në fushën familjare nuk i është dhënë Bashkimit Evropian për të vepruar, por ai duhet të respektojë masat e marra nga legjislatori kombëtar.

E drejta për t'u martuar është një premisë për krijimin e jetës familjare, por jo e vetmja. Kjo për faktin se çdo marrëdhënie midis personave e ardhur nga martesë përbën jetë familjare, por jo çdo raport që krijon jetë familjare vjen si pasojë e martesës. Thelbi i së drejtës për martesë është formimi i raporteve juridike të detyrueshme midis çiftit. Ndërsa e drejta për jetë familjare nuk shoqërohet me këtë detyrueshmëri. Diferencat strukturore të këtyre dy të drejtave qëndrojnë pikërisht në faktin se e drejta për një jetë familjare detyron shtetet anëtare që të marrin masa për garantimin e saj. Në kuadër të KE-së është GJEDNJ-ja që kryen kontrollin mbi masat e marra nga shteti anëtar për respektimin e të drejtës për një jetë familjare, ndërsa përsa i përket të drejtës për martesë GJEDNJ-ja kufizohet në verifikimin që veprimet e shteteve të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. E drejta për një jetë familjare nuk garanton të

drejtën për krijimin e familjes apo për martesë. Ajo zbatohet për familje që janë krijuar, që ekzistojnë dhe janë reale. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka njohur përcaktimet e GJEDNJ-së, se koncepti i jetës familjare nuk është i kufizuar vetëm në marrëdhëniet e ngritura mbi martesën. Koncepti i të drejtës për një jetë familjare dhe interpretimi i evolutiv i kësaj të drejte. Interpretimi i të drejtës për një jetë familjare është zhvilluar ndër vite duke u ndikuar nga ndryshimi i vazhdueshëm social në vendet evropiane. Konventa nuk mund që thjesht t'i detyrojë shtetet të abstenojnë nga këto ndërhyrje, por edhe nocioni i respektimit është diçka abstrakte, posaçërisht kur ai shikohet si burim i obligimeve pozitive. Jeta familjare në strukturën e BE-së gjen një rregullim të pjesshëm për shkak të mbajtjes së kompetencave ekskluzive nga shtetet anëtare në këtë fushë. E drejta për një jetë familjare, e përcaktuar në nenin 7 të Kartës, që bën një riprodhim tekstual të nenit 8 të KEDNJ-së, është e barasvlefshme me normat e Traktateve, që do të thotë se ajo është e detyrueshme jo vetëm për institucionet e Bashkimit Evropian, por edhe për shtetet anëtare, në të gjitha nivelet e tyre. E drejta për një jetë familjare, sipas përcaktimeve të bëra në të dhe shpjegimet lidhur me Kartën, është një e drejtë korresponduese me të drejtën e parashikuara në nenin 8 të KEDNJ-së. Si e tillë kuptimi dhe qëllimi do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në KEDNJ, përveç rastit kur BE-ja ofron një mbrojtje më të madhe, si p.sh. në rastin e njohjes të marrëdhënieve midis personave të njëjtit seks apo martesave midis tyre.

Roli i jurisprudencës në zbatimin e të drejtës për një jetë familjare. Jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe e GJED-së ka përcaktuar rast pas rasti kuptimin e jetës familjare dhe të personave që përfshihen në të. Në përcaktimet e bëra në nenin 8 të KEDNJ-së si dhe në nenin 7 të Kartës, si një e drejtë korresponduese me atë të KEDNJ-së, nuk ka një përcaktim të saktë dhe të qartë të këtij koncepti, pasi ajo është një kategori shoqërore e cila ndryshon dhe evoluon. Fillimisht GJEDNJ-ja, dhe më pas GJED-ja, ka përfshirë nën konceptin e jetës familjare aspekte të ndryshme nga ato më tradicionale të tilla, si: respekti për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm apo për të ndryshuar emrin, e drejta për respektimin e orientimit seksual, e drejta për njohjen e atësisë, e drejta për marrjen e kujdestarisë, të drejtat e personave që emigrojnë si mbrojtja e familjes në rastin e dëbimit të personave që janë futur dhe qëndrojnë ligjërisht apo rastet e bashkimit familjar, të drejtat e fëmijëve natyrorë, e drejta e fëmijëve për lindje, e drejta për një mjedis të shëndetshëm etj. Jeta familjare krijohet nga një martesë, nga një bashkëjetesë, partnership dhe nga çdo marrëdhënie e qëndrueshme midis dy ose më shumë personave, pavarësisht nëse kjo marrëdhënie mbrohet dhe njihet ligjërisht ose jo.

Në strukturën e Bashkimit Evropian është Karta që parashikon kriteret e vendosjes së kufizimeve të cilat mund të vendosen vetëm me ligj, duhet të respektojnë thelbin të drejtave dhe lirive, duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Gjithashtu, kufizimi duhet të vendoset vetëm nëse është i nevojshëm për përmbushjen e objektivave dhe interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi Evropian. Është detyrë e GJED-së përcaktimi i të drejtave absolute dhe të pakufizueshme, pasi objekt gjykimi në gjykatë është për interpretimin e akteve dhe për ligjshmërinë e tyre. Individët mund të ankohen për legjislacionin e BE-së ose legjislacionin kombëtar që zbaton legjislacionin e BE-së, nëse mendojnë se nuk është respektuar Karta. Gjykatat kombëtare mund të kërkojnë udhëzime për interpretimin e saktë të legjislacionit të BE-së nga GJED-ja me anë të procedurës paragjykimore. Në rast se kufizimi i të drejtës për një jetë familjare është i kundraligjshëm subjektet e interesuara mund të paraqesin kërkesë pranë juridiksionit përkatës, GJEDNJ ose GJED. Përsa i përket subjekteve që legjitimohen kemi dallim midis këtyre dy gjykatave. Subjektet që legjitimohen për paraqitjen e padisë pranë GJED-së janë individët, shtetet anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian. Ndërsa, në rastin e GJEDNJ-së institucionet e KE-së nuk mund të paraqesin ankesë pranë saj. Për më tepër, vendimi i marrë nga GJED-ja është i detyrueshëm. Kjo tregon se strukturat e ngritura nga BE-ja janë më efikase për mbrojtjen e të drejtës për një jetë familjare, pasi aksesohet nga një rreth më i gjerë subjektësh dhe janë të detyrueshme.

BIBLOGRAFIA

- Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut gjenden në sitin e internetit. www.echr.coe.int
- Marek Antoni Nowicki, Rreth Konventës Evropiane, Komentari i shkurtër mbi KEDNJ-në.
- Roberto Cippitani e Stefania Stefanell. La parificazione degli status di filiazione, Atti del Convegno di Assisi, Itali, Maj, 2013.
- S. Patti, “Diritto privato e codificazioni Europee”.
- Andrea Ciccarelli dhe Pietro Gargiulo, I diritti sociali nell’Unione Europea dopo il Trattato di Lisbona, in Guida al Lavoro, Itali, 2010.
- G. Ferrando, Le relazioni familiari nella Carta dei diritti dell’Unione europea.
- Luigi Daniele, Carta dei diritti fondamentali dell’Unione europea e Trattato di Lisbona, Itali 2008
- Rosanna De Meo, La tutela del minore e del suo interesse nella cultura giuridica italiana ed europea, në revistën Famiglia e diritto,
- McGlynn, C.M.S, “Familja dhe ligji i Bashkimit Evropian, politika dhe pluralizmi”.
- CES Reconciliation of work, Family and Private Life. Marrë në sitin <http://www.etuc.org>
- Guido Sirianni. Il diritto degli stranieri alla unita familiare.
- Luljeta Ikononi, E drejta migratore. Tiranë, 2009.
- Cikël leksionesh “Procedurë Parlamentare”, përgatitur nga Makbule Çeço.
- Arta Mandro-Balili , Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore.
- Libri praktik i Ligjeve të Viktorias.
- M Janis, R Kay and A Bradley, European Human Rights Law: Text and Materials, Oxford University Press, 3rd edition
- Joniada MUSARAJ “KEDNJ, roli dhe rëndësia e saj. Koncepti i gjykimeve civile dhe rëndësia e realizimit të tyre sipas rregullave procedurale”.
- Revista Diritto.it.
- Elsa toska Dobjani, Gjykata Kushtetuese Shqiptare.
- Revista Shqiptare për studime ligjore.
- Zeno Zencovich V, Commentario alla Convenzione europea per la tutela dei diritti dell’uomo e delle libertà fondamentali, Padova,
- Ivana Roagna, Mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.
- M. V. Pérez Asinari, Défis du droit à la protection de la vie privée: perspectives du droit européen et nordaméricain. Challenges of privacy and data protection law: perspectives of European and North American Law. Bruxelles.
- Alpa G., Alcune osservazioni sul diritto comunitario e sul diritto europeo di famiglia,
- Marek Antoni Nowicki, Rreth Konventës Evropiane, Komentari i shkurtër mbi KEDNJ-në:
 - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
 - Komentari i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut.
 - Paktit Kombet e Bashkuara.
 - Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile e Politike.
 - Traktati i Bashkimit Evropian .

- Rregullorja e KEE-së Nr.1612/68.
- Direktiva e Parlamentit Evropian 2004/38/KE.
- Konventa Evropiane e Drejtave të Njeriut.
- Rekomandim i Komisionit të ministrave R (99)

PUNA SOCIALE NË SHKOLLA.
ROLI I PUNONJËSIT SOCIAL NË SHKOLLA DHE
PERCEPTIMET RRETH KËTIJ ROLI

Silvana Lulashi

Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRACT

Puna Sociale në shkolla është një fushë e re konkretisht në kontekstin e Shkodrës. Duke qenë se është një profesion i ri njohja dhe identifikimi i karakteristikave të tij janë shumë të rëndësishme, pasi punonjësi social shkollor është një profesionist, i cili në dispozitat normative parashtohet, që të jetë i pranishëm në çdo institucion arsimor, ku roli i tij është shumë i rëndësishëm dhe ndihmues. Që në vitin 2012, Ministria e Arsimit, në dispozitat normative përcaktoi ngritjen e Njesisë së Shërbimit psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare. Por me ndryshimet dhe rregullimet gjatë viteve, të ligjeve dhe reformave në arsim vetëm në vitin 2021, sollën hyrjen e punonjësit social në shkolla në qytetin e Shkodrës. Si rrjedhojë e hyrjes së punonjësit social shkollor në institucionet arsimore ky punim konsiston në një prezantim dhe njohje me rolin e punonjësit social në shkolla dhe efektet, që solli hyrja e punonjësve socialë shkollorë. Ky ishte viti i parë i hyrjes së punonjësit social në institucionet arsimore parauniversitare, ku u evidentua se ku konsiston roli i tyre dhe çfarë efektesh solli kjo hyrje. Për paraqitjen e këtij informacioni u përdor metoda kërkimore cilësore, për grumbullimin e kuptimeve dhe mendimeve nga vetë profesionistët, si dhe mësuesit dhe nxënësit, të cilët na paraqitën pikëpamjet e tyre rreth hyrjes dhe karakteristikave të rolit të punonjësit social shkollor. Për mbledhjen e të dhënave u aplikuan intervistat e strukturuar dhe focus groupi, ku pjesëmarrësit, punonjësit socialë shkollorë, mësuesit dhe nxënësit arritën të pasqyrojnë rolin e punonjësit social, karakteristikat e këtij roli, fokusin, problematikat që trajton, si dhe parimet etike mbi të cilat bazohet roli i tyre, ku rolin e punonjësit social shkollor e shikojnë në mënyrë pozitive, të nevojshme, që sjell efekte të mira, pjesë integrale dhe ndihmuese për shkollën, gjithashtu fokusohet tek, edukimi lidhur me tematika të caktuara sociale dhe tek çdo nevojë, që mund të kenë nxënësit, stafi i shkollës, si dhe vetë institucioni.

Punonjësi social shkollor është profesionist i specializuar për të evidentuar dhe zgjidhur çdo problem, i cili ndikon në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe arritjen e rezultateve akademike, gjithashtu misioni i tij është krijimi i një klime pozitive dhe mbështetëse në institucionet arsimore.

Fjalë kyçe: Punë sociale në shkollë, punonjës social në shkollë, rol, fokus dhe parime etike.

**The role of the social worker in schools and perceptions about this role.
(Case of Shkodra).**

ABSTRACT

Social work in schools is a new field specifically in the context of Shkodra. Since it is a new profession, knowing and identifying the characteristics of this profession are very important, as the school social worker is a professional, who in the normative provisions is required to be present in every educational institution, where his role is very important and helpful. Since 2012, the Ministry of Education, in normative provisions determined the establishment of the Psycho-social Service Unit in pre-university educational institutions. But with the changes and adjustments over the years, laws and reforms in education only in 2021, brought the entry of social workers in schools in the city of Shkodra. As a result of the entry of school social workers in educational institutions, this scientific work consist in one presentation and introduction to the role of social workers in schools and the effects brought by the entry of school social workers. This was the first year of the entry of social workers in pre-university educational institutions, where it was evidenced where their role consists and what effects this entry brought. Qualitative research methods were used to present this information, to gather meanings and opinions from the professionals themselves, as well as teachers and students, who presented their views on the introduction and characteristics of the role of the school social worker. Structured interviews and focus groups were applied for data collection, where participants, school social workers, teachers and students managed to reflect the role of the social worker, the characteristics of this role, the focus, the issues it addresses, and the ethical principles on which their role is based. Where the role of the school social worker is viewed in a positive, necessary way, it brings good effects,

integral and helpful parts for the school, it also focuses on, education related to certain social topics and to any needs that students, staff can have. school, as well as the institution itself. The school social worker is a specialized professional to identify and solve any problem, which affects the progress of the learning process and the achievement of academic results, also his mission is to create a positive and supportive climate in educational institutions.

Keywords: School social work, school social worker, role, focus and ethical principles.

Hyrje

Puna sociale në shkolla si koncept në vendet në zhvillim është i dëgjuar dhe i ushtruar edhe në praktikë, ndërsa në Shqipëri njihet pak si koncept. Studimet dhe kërkimet e nevojshme se ku konsiston kjo fushë mungojnë.

Ministria e Arsimit rregulloi ushtrimin e këtij profesioni me ligjin nr.69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*". Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare, shikohet të ketë të pranishëm, si punonjës social ashtu edhe psikologun. Me ndryshimet dhe rregullimet e ligjit më 20/10/2020, "*Për organizimin dhe funksionimin, e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social*", sollën hyrjen e punonjësve socialë në kontekstin e Shkodrës.

Hyrja e punonjësve socialë në institucionet arsimore parauniversitare në Shkodër mundësuan që të njohim më nga afër rolin e tyre, karakteristikat e këtij roli, si dhe sfidat me të cilat janë përballur ditët e para të fillimit të ushtrimit të profesionit të tyre në këto institucione.

Tashmë punonjësit socialë kanë filluar të njihen nga stafi i shkollës, nga nxënësit, prindërit dhe të konsiderohen si profesionistë të domosdoshëm në këto institucione arsimore. Mbështetja, lehtësimi, trajtimi dhe zgjidhja e problemeve e bëjnë të domosdoshëm praninë e tij, si një profesionist, që adreson problemet e shkollës.

Punonjësi social shkollor arrin, që me shprehitë dhe njohuritë e tij të adresojë sfidat dhe problemet, me të cilat përballlet institucioni arsimor, nxënësit, stafi i shkollës dhe prindërit. Ai mundëson lidhjen me komunitetin dhe institucionet e nevojshme për trajtimin e problemeve dhe rasteve.

Historiku i Punës sociale në shkollat shqiptare

Deri në vitin 1992, termi *punë sociale* ishte krejt i panjohur në Shqipëri, dhe si rrjedhojë edhe si profesion dhe për më tepër, as që mund të mendohej të ekzistonte si praktikë. Një profesion krejt i ri për shqiptarët e shekullit të 21-të, por që u zhvillua shpejt, madje shumë shpejt, edhe u konsolidua si i tillë dhe zuri vend në strukturat e shoqërisë sonë, si në institucionet publike, ashtu edhe në ato të shoqërisë civile, dhe deri diku edhe në organizmat privatë. Që në fillim Puna sociale u mendua, si një profesion akademik dhe shkencor, që do të ofronte shërbime sociale në tranzicionin shoqëror, politik dhe ekonomik të shoqërisë shqiptare. Punonjësit socialë u vunë në shërbim të institucioneve të reja demokratike, por ata që në fillim kryesisht u shërbyen të varfërve, asistuan të papunët, u afruan pranë familjeve dhe komuniteteve (Belshaku,S & Todhri,F, 2019).

Punonjësit e parë socialë në shkolla kanë vetëm pak vite, që janë miratuar nga Ministria e Arsimit, si pjesë e organikës shkollore dhe e kanë filluar punën e tyre si pjesë e një projekti-pilot në disa shkolla nëntëvjeçare dhe të mesme të Tiranës dhe në disa qytete të tjera. Ushtrimi i këtij profesioni në këtë sektor u rregullua me ligjin *nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në kreun II/ Institucionet arsimore dhe format e arsimimit, Neni 2020* ku theksohet: Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore:

1.Njësitë arsimore vendore u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore.

2.Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, për vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, për hartimin e programeve parandaluese sipas nevojave të komunitetit shkollor. Gjithashtu, detyrat e punonjësit social në shkollë, janë përcaktuar në *Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar*, Tiranë, 2013, *Kreu IX- Shërbimi psiko-social në institucionet arsimore, Neni 44* (Belshaku,S & Todhri, F 2019).

Praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara tregojnë se institucionet arsimore kanë nevojë thelbësore për shërbime mbështetëse, për të arritur misionin e tyre, të cilat duhet të përfshijnë një sërë profesionistësh, ndër të cilët vend kyç zë psikologu dhe punonjësi social. Toseland, Palmer-Ganeles, & Chapman (1986) e përkufizojnë ekipin multidisiplinor, si një grup anëtarësh të komunitetit shkollor, ku secili zotëron shprehje dhe njohuri të veçanta, të cilët bashkohen për të ndarë ekspertizën me njëri-tjetrin, për një qëllim të përbashkët. Ndërsa shkollat trajtojnë pritshmëri gjithnjë e më komplekse, ekipet bashkëpunuese dhe

proceset në ekip, gradualisht po shihen si ‘mjete’ për të përkufizuar problemet dhe për të zhvilluar zgjidhjet, përmes ndërveprimit ballë për ballë. Kështu mund të shkëmbehen shprehjet, të ndryshojnë proceset e të menduarit dhe të krijohen zgjidhje më krijuese . Urdhri nr. 321, datë 11.10.2004 “Eksperimentimi i shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar në vitet shkollore 2004-2005-2006” shënjoji fillimin e ofrimit të shërbimit psikologjik në shkolla, që më tej u shoqërua me një sërë nismash për fuqizimin e rolit dhe rritjes së kapaciteteve të këtij shërbimi (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2004). Ndërkohë, në vitin 2008, pas kësaj faze eksperimentale, përmes një udhëzimi dhe një urdhri të ri, shërbimi psikologjik shkollor u ligjërua tashmë si një shërbim i përhershëm nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në të gjitha shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të zonës urbane të vendit (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2008). Shërbimi psiko-social në shkolla, në formën e vet të sotme, u krijua për herë të parë në vitin 2013, përmes Urdhrit nr. 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 150, datë 3.4.2018 (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2013; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2018). Kjo përbën një fazë të re të zhvillimit të shërbimeve mbështetëse për nxënësit në shkolla, me konceptualizimin e ri të shërbimit si një shërbim psiko-social, i ofruar në kopshte, shkollat e arsimit bazë, dhe shkollat e arsimit të mesëm të lartë, përmes punës në ekip të psikologut dhe punonjësit social. Gjatë viteve të fundit janë bërë një sërë përpjekjesh për të promovuar dhe mundësuar një mjedis të nxëni gjithëpërfshirës dhe që respekton të drejtat e çdo fëmije. Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012 (neni 20), i ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe ligjin nr. 48/2018, dhe Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014-2020) kanë sjellë në vëmendje rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij shërbimi për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale dhe hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor (Manuali i Punës për Punonjësit e Njësisë së Shërbimit Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar, 2020) .

Ndërveprimi nxënës-mësues-familje dhe komunitet

Sipas manualit për ofrimin e shërbimit psiko-social (2020) punonjësi social shkollor ndihmon *nxënësit* të përmirësojnë marrëdhëniet ndërpersonale, të rrisin rezultatet akademike përmes aplikimit të teknikave të ndryshme individuale sipas nevojave specifike, të zhvillojnë vetëvlerësim dhe vetëkontroll, të përballen me situatat e vështira dhe krizat

e ndryshme në shkollë dhe jashtë saj, të mësojnë zgjidhjen e problemeve, zgjidhjen e konflikteve dhe zhvillojnë aftësitë vendimmarrëse, të zhvillojnë aftësi të përshtatshme për bashkëveprim shoqëror, të eliminojnë/zvogëlojnë pengesat, që lidhen me suksesin akademik, të identifikojnë nevojat specifike, duke përgatitur historikun social ose të zhvillimit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe duke marrë pjesë në takimet, që zhvillohen për vlerësimin e këtyre fëmijëve, si dhe në takimet individuale të planifikimit arsimor, përmes shërbimeve të këshillimit (në grup, si individ dhe /ose familje).

Manuali për ofrimin e shërbimit psiko-social (2020), gjithashtu paraqet edhe punën e punonjësit social me *mësuesit*, e cila konsiston tek hartimi dhe implementimi i planeve për të rritur suksesin akademik të nxënësve, sigurim të mbështetjes së vazhdueshme për adresimin e nevojave emocionale dhe të sjelljes së nxënësve, sigurim të informacioneve thelbësore për të kuptuar më mirë faktorët (kulturorë, shoqërorë, ekonomikë, familjarë, shëndetësorë etj.), që ndikojnë në punën dhe sjelljen e një nxënësi, zhvillim të programeve të trajnimit të stafit të shërbimeve në shkollë.

Referuar manualit për ofrimin e shërbimit psiko-social, punonjësi social shkollor ndihmon *familjet dhe prindërit* përmes: intervistimit të familjes për të vlerësuar problemet që ndikojnë në përshtatjen arsimore të fëmijës, mbështetjes së tyre për lehtësimin e përshtatjes së fëmijëve në shkollë, lehtësimin të stresit në familje, për të mundësuar që fëmija të funksionojë në mënyrë më efektive në shkollë dhe komunitet, përfshirjes në programet në dispozicion të nxënësve me nevoja të veçanta, lehtësimin të aksesit dhe përdorimit efektiv të burimeve shkollore dhe komunitare. Punonjësit socialë shkollorë ofrojnë shërbime edhe në plane më të gjera, në *nivel komuniteti*: zhvillojnë strategji ndërhyrjesh parandaluese, p.sh., kundër dhunës në shkollë, abuzimit me substancat etj., koordinojnë ofrimin e shërbimeve për nxënësit përmes aktiviteteve bashkëpunuese ndërinstucionale, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet midis nxënësve, prindërve dhe sistemeve shkollore, zhvillojnë programe alternative kundër braktisjes, bullizimit, dhunës etj., mobilizojnë burime familjare, shkollore dhe të komunitetit, për t'i mundësuar fëmijës të mësojë sa më efektivisht të jetë e mundur në programin e tij arsimor, ndihmojnë për zhvillimin dhe zbatimin e programeve arsimore për fëmijët në përgjithësi, si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta (Manuali i Punës për Punonjësit e Njesisë së Shërbimit Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar, 2020).

Funksioni i punonjësit social të shkollës

Punonjësit socialë të shkollës janë profesionistë të trajnuar me një diplomë në punë sociale, të cilët ofrojnë shërbime lidhur me rregullimin shoqëror, emocional dhe jetësor të një personi në shkollë. Punonjësit socialë të shkollës janë lidhja ndërmjet shtëpisë, shkollës dhe komunitetit në ofrimin e shërbimeve direkte si dhe indirekte për studentët, familjet dhe shkollën, personelin, për të promovuar dhe mbështetur suksesin akademik dhe shoqëror të studentëve. Krijimtaria dhe aftësia, për të përdorur krijimtarinë vetjake me aktorët ndërveprues në sistemin arsimor shkollor ka një rëndësi themelore (Belshaku,S & Todhri,F, 2019).

Funksion i punonjësit social është dhe gatishmëria, për të lidhur nxënësit me komunitetin, siç mund të jetë në rastin e lidhjes së një fëmije me një qendër të kujdesit ditor, prindërit e të cilit janë relativisht të sëmurë tregojnë efektivitetin e ndërtimit të marrëdhënieve në komunitet. Funksioni i punonjësit social është dhe i edukuesit në rastet e edukimit të prindërve përshembull, për sjelljet paranormale të adoleshencës (Belshaku,S & Todhri,F, 2019).

Metodologjia

Në këtë punim është përdorur *metoda cilësore*, pasi kërkohet, që të mbledhim të dhëna nëpërmjet aplikimit të instrumenteve, si ai i intervistave dhe focus groupit për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore. Metoda cilësore përfshin kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe bindje.

Instrumentet kërkimore të përdorura janë focus group-i dhe intervistat e strukturuar. *Focus groupi*, është një teknikë për mbledhjen e të dhënave cilësore në grup. Grupet e fokusit përdoren për të mbledhur të dhëna, që dalin nga diskutimi midis pjesëtarëve të grupit të fokusit me ndihmën e moderatorit (Mathews, B. & Ross, L., 2010). *Intervista* është një metodë e mbledhjes së të dhënave, që lehtëson komunikimin midis dy njerëzve ose ballë për ballë, ose në distancë nëpërmjet telefonit apo internetit dhe i lejon intervistuesit të marrë informacion, ndjenja dhe opinione nga i intervistuari duke përdorur pyetje dhe dialog ndërveprues (Mathews, B. & Ross, L., 2010). Intervistat e strukturuar gjithashtu ofrojnë qëndrueshmëri në natyrën e të dhënave të mbledhura nga njëra intervistë në tjetrën, (Grinell, Jr. & Richard, M & Yvonne A, Unrau 2010).

Kampioni i studimit gjatë fazës së aplikimit të focus groupit është kampionimi i qëllimshëm, pasi të gjithë punonjësit socialë të shkollës janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme si pjesëmarrës në studim, ku pasi

evidentuar punonjësit socialë, ata u përzgjedhën si pjesë e studimit, sepse vetë studimi kërkon njohjen konkrete me këtë rol, nga profesionistët si pjesë e re e organikës shkollore. *Kampioni i studimit* në aplikimin e intervistave të strukturuar ka qenë kampionimi ortek. Kampionimi ortek është një teknikë ku anëtarëve të kampionimit fillestar u kërkohet të identifikojnë persona të tjerë, të cilët më pas kontaktohen nga vetë hulumtuesit (Mathews, B. & Ross, L., 2010). Pjesëmarrësit e intervistave, janë përzgjedhur nga punonjësit socialë të shkollave përkatëse, të cilët më pas kanë bërë lidhjen e tyre me studiuesin. Këto dy lloje kampionimi u përzgjedhën duke pasur në konsideratë instrumentet e përdorura dhe objektivat e punimit, si dhe për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore.

Në këtë punim, përpara aplikimit të instrumenteve si ai i intervistës dhe focus groupit, u morën në konsideratë disa çështje etike, që iu bënë të qarta pjesëmarrësve, si ai i pëlqimit të informuar, ku pranimi u realizua me vullnet të lirë, pjesëmarrësve iu dha informacion i saktë dhe i qartë. Aspekt etik tjetër, që u mor në konsideratë është mbrotja e të dhënave dhe konfidencialiteti, ku u sigurova se të dhënat do të mbliidhen dhe punohen në mënyrë të drejtë dhe të ndershme, dhe se anonimati do të ruhet dhe nuk do të ketë veprime dashakeqëse as nxjerrje e të dhënave personale.

Rezultatet e studimit

Në procesin e analizimit u evidentuan këto tema:

1. *Hyrja e punonjësit social në shkollë.*
2. *Rëndësia e pranisë së punonjësit social në institucionet arsimore.*
3. *Karakteristikat e rolit të punonjësit social në institucionet arsimore.*
4. *Fokusi i punonjësit social shkollor.*

KONKLUZIONE E REKOMANDIME

Konkluzione

- Puna sociale e shkollës është një fushë e specializuar e praktikës brenda fushës së gjerë të profesionit të punës sociale.
- Punonjësit socialë të shkollës sjellin njohuri dhe aftësi unike në sistemin shkollor dhe ekipin e shërbimeve të studentëve, janë profesionistë të trajnuar të cilët mund të ndihmojnë me shqetësime të shëndetit mendor, shqetësime të sjelljes, mbështetje pozitive të sjelljes, mbështetje akademike dhe në klasë, konsultime me mësuesit, prindërit dhe drejtuesit e shkollës.
- Punonjësit socialë shënuan hyrjen e tyre në institucionet arsimore si rrjedhim i ndryshimeve në dispozitat normative nga Ministria e Arsimit. Ku

reformat e ndryshme në arsim, sollën hyrjen e tyre në institucionet arsimore, si një profesionist ndihmues dhe lehtësues për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

□ Problematikat, sfidat, të papriturat me të cilat përballet shkolla kërkojnë përfshirjen e punonjësit social në institucionet arsimore, për evidentimin dhe trajtimin e tyre, si dhe ofrimin e zgjidhjeve të duhura.

□ Një profesionist i specializuar i cili mund të trajtojë të gjitha problemet me të cilat përballën mësuesit, nxënësit, prindërit, drejtuesit e shkollës, shikohet si i domosdoshëm dhe shumë i vlerësuar në institucionet arsimore dhe një bashkëpunues shumë i mirë.

□ Bazuar tek përgjigjet e të intervistuarve, u vunë re shumë ndryshime lidhur me profesionin e punonjësit social, ku me ndryshimet e fundit të bëra, punonjësit socialë kanë ndarje pune të qarta me psikologun, ku punonjësi social nuk e realizon këshillimin, dhe kjo mbetet vetëm në kompetencë të psikologut, ashtu sikur edhe planet e trajtimit të personave me AK.

□ Roli i punonjësit social në praktikë shfaqet ndryshe, nga roli i punonjësit social me të cilin ne jemi prezantuar në literaturë kryesisht tek pjesa ku punonjësi social realizon anketa dhe pyetësor, pra është një hulumtues, i cili paraqet nivelet e rrezikshmërisë të problemeve të evidentuara.

□ Punonjësit social të shkollës janë përballur me vështirësi, sepse ngatërrohet roli i tyre nga psikologu dhe mosbesim nga ana e stafit të shkollës për atë se çfarë bën dhe ku konsiston roli i një punonjësi social shkollor.

□ Kohët e fundit punonjësve socialë shkollorë, po u jepet vëmendja e duhur dhe po shikohen si një pjesë e pandashme e shkollës, ku roli i tyre, detyrat dhe përgjegjësitë janë të rregulluara me ligj nga Ministria e Arsimit. Në nivel *rekomandimesh* për përmirësimin e rolit të punonjësve socialë shkollor duhet:

Së pari, unë do rekomandoja që, roli i punonjësve socialë të jetë konçiz dhe i qartë, i mirëpërcaktuar në mënyrë që punonjësit socialë të përqendrohen tek institucionet arsimore dhe jo të kenë role shumëfishe, të cilat mundësojnë “përhapjen” e punonjësve socialë në shumë nivele dhe harrojnë se përse ata janë realisht në institucion.

Së dyti, punonjësit socialë të mos qëndrojnë vetëm në kuadrin e asaj se çfarë kanë mësuar gjatë tre viteve të tyre akademike, sepse në shkolla ka kaq shumë situata delikate saqë njohuritë që punonjësit socialë kanë nuk mjafton. Kështu që të realizohen sa më shumë trajnime lidhur me këtë profesion dhe module për ushtrimin e tij në mënyrë sa më eficiente.

Së treti, të ketë edhe supervizorë, që i ndihmojnë punonjësit socialë që të zgjidhin rastet dhe të mos bien në konsumim ose në gabime etike. T'u japin atyre drejtimin e duhur etik në situatat kur ata përballen me dilema etike.

Së katërti, të realizohet promovimi i rolit të punonjësve socialë shkollorë në media, sepse flitet shumë pak dhe aspak në media lidhur me ushtrimin e këtij profesioni.

Së pesti, t'u jepet hapësirë brenda institucionit arsimor, punonjësve socialë, në mënyrë që ata të ushtrojnë profesionin e tyre, si dhe të prezantohen me nxënësin, që më pas nxënësit të dinë se ku të drejtohen dhe se çfarë roli ata kanë në institucion.

Së gjashti, të realizohet një ndarje e rolit të punonjësit social dhe psikologut, dhe kjo ndarje të prezantohet në çdo institucion arsimor ku ndodhen punonjësit socialë shkollorë.

Së shtati, të shtohet njohja mbi rolin e punonjësit social në çdo institucion arsimor, për stafin, nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Së treti, të rritet numri i pranisë së punonjësve socialë në institucionet arsimore parauniversitare, për një mbarëvajtje më të mirë të procesit arsimor, si dhe trajtimin e problematikave.

BIBLIOGRAFIA

1. Belshaku, S & Todhri, F. (2019). *Puna Sociale në Shkollë*. Tiranë: Enja.
2. Grinell, Jr. & Richard, M & Yvonne A, Unrau. (2010). *Social work research and evaluation: Foundations of evidence-based practice*. Oxford University Press.
3. *Manuali i Punës për Punonjësit e Njesisë së Shërbimit Psiko-Social në Sistemin Arsimor Parauniversitar*. (2020). Tiranë.
4. Massat, C.R & Kelly, M.S & Constable, R. (2015). *School Social Work: Practice, policy and research*. In *School Social Work*. USA: Oxford University Press.
5. Mathews, B. & Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit- udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).

**PËRMIRËSIMI I METODOLOGJISË NË
MËSIMDHËNIE PËR NIVELE TË NDRYSHME NË
KLASA KOLEKTIVE. (RASTI I SHKOLLËS
BAKS-RRJOLL-DRAP LEZHË)**

Agron Teli, Aida Goga

Shkolla "Gjergj Vat Martini"

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti i Filozofisë

ABSTRAKT

Objekti i studimit tonë janë shkollat me klasa kolektive të cilat kryesisht janë në zonat rurale. Për shkak të rënies së numrit të nxënësve në disa shkolla nuk punohet më me klasa individuale, por me klasa kolektive duke e vështirësuar kështu mjaft edhe punën e mësuesit. Qëllimi ynë është që përmes përvijës së një shkolle të marrë në shqyrtim të propozojë zgjidhje për funksionimin sa më të mirë të këtyre klasave, pa dëmtuar cilësinë e mësimdhënies. Për të realizuar këtë studim janë përdorur metoda sasore e cilësore dhe për analizimin e tyre janë përdorur disa programe, si programi Weft QDA, programi SPSS 20.00 etj. Në fund kemi dalë në disa përfundime dhe kemi dhënë disa rekomandime të përgjithshme, si dhe disa rekomandime specifike për mësuesit.

Fjalë kyçe: klasë kolektive, mësues, nxënës.

Improving teaching methodology for different levels in collective classrooms. (The case of the school Baks-Rrjoll-Drap Lezha)

Abstract

The focus of our study are schools with collective classes which are mainly in rural areas. Due to the decrease in the number of students in some schools, it is no longer possible to work with individual classes, instead with collective classes, thus making the work of the teacher much more difficult. Our goal is to propose solutions for the best functioning of these classes through the experience of a school under consideration, without

compromising the quality of teaching. Quantitative and qualitative methods were used to conduct this study and several programs were used for their analysis, such as the Weft QDA program, the SPSS 20.00 program, etc. In the end we came to some conclusions and gave some general recommendations and some specific recommendations for teachers.

Key words: collective classes, teacher, student

Hyrje

Në ditët e sotme po diskutohet mjaft për produktivitetin e klasave kolektive, biles edhe ekzistencën e tyre në të ardhmen, prandaj mendojmë se është moment i përshtatshëm për të dhënë përvojën tonë dhe për të propozuar disa ndërhyrje në shkollat që punojnë me klasa kolektive. Në qendër të studimit është shkolla Baks-Rrjodh e cila punon me klasa kolektive, por në disa pikëvështrime studimi është shtrirë edhe në shkolla të tjera të Zonës së Velipojës ku ka klasa kolektive. Studimet në Shqipëri lidhur me problematikat e të mësuarit me klasa kolektive nuk janë të shumta, megjithëse klasat kolektive vazhdojnë të jenë një realitet në disa zona të vendit. Në këtë kuptim, ky punim duke qenë se vë në fokus këtë çështje studimore me rëndësi praktike, mund të jetë një kontribut modest.

Së dyti, realizimi i një studimi të tillë krijon mundësinë e krahasimit të përvojës sonë aktuale në këtë fushë me përvojën e vendeve të tjera dhe ndërtimin e perspektivës për të ardhmen e klasave kolektive, duke pasur ndërmend përvojat e vendeve më të zhvilluara.

Së treti, studimi që po prezantohet parashtrohet modele konkrete ndërhyrjeje për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e klimës në shkollat me klasa kolektive.

Së katërti, sugjeron domosdoshmërinë në ruajtjen e cilësisë së lartë në klasat kolektive lejon ndryshueshmërinë (fleksibilitetin).

Qëllimi i punimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është identifikimi i problematikave në klasa kolektive dhe dalja në disa rekomandime për përmirësimin e mësimdhënies në këto klasa. Mësimdhënia në klasat kolektive është një proces i vështirë, por ai duhet t'i tërheqë nxënësit, duhet të ruajë vijueshmëri tek të gjithë nxënësit dhe të krijojë kënaqësi. Arritja e realizimit të procesit mësimor në të gjitha ciklet e arsimit të detyruar sipas standardeve të kurrikulës, duke u mbështetur në bazën ligjore duhet të bazohet në modelet e suksesshme në fushën e edukimit, të përvojave të

shkollave të suksesshme në këtë fushë dhe mbi të gjitha duhet të ndërtohet një strategji.

Një prej qëllimeve tona është pikërisht të sygjerojë strategji, metoda dhe teknika mësimore për të arritur standarde të larta në mësimdhënien në klasa kolektive, bazuar në përvojën e shkollës Baks-Rrjoll (Shkodër)¹.

Disa parashtrime me karakter teorik

Sipas konceptimit të bërë nga profesor Shefik Osmani: “*Klasa kolektive, formë e CU të shkollës tetëvjeçare (KII-IV), ku ndonëse ruhet e njëjta strukturë e planit mësimor dhe e njëjta përmbajtje e CU të zakonshëm (me klasa direkte), për kushtet specifike të numrit të pakët të nxënësve një mësues punon më 2 deri 4 klasa kolektivisht, duke proceduar mbi bazën e një orari specifik, që i përgjigjet rrethanave konkrete dhe duke përdorur forma në përshtatje me veçoritë e punës me disa klasa njëkohësisht*”.²

Ndërsa në literaturën e sotme klasë kolektive quhet klasa ku mësojnë së bashku nxënësit e dy a më shumë klasave të arsimit fillor ose dy a më shumë klasave të arsimit të mesëm të ulët. Klasa kolektive mund të emërtohet dhe “klasë e bashkuar”, pasi ajo është një bashkim nxënësish të grupmoshave të ndryshme me diferencë nga një deri në pesë vjet në arsimin fillor, dhe nga një deri në katër vjet në arsimin e mesëm të ulët. Mësimdhënia në klasat kolektive dallon për veçoritë specifike që hasen në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies duke përcaktuar vështirësitë dhe përparësitë që hasen në klasat kolektive, duke mos harruar:

- moshë të ndryshme që sjellin kapacitete të ndryshme vlerësimi,
- hapësirat e integritimit ndërlëndor që sjell teksti i nxënësit në mësimin plotësues nga niveli fillestar deri në ngritjen e nxënësve,
- që mësuesi duhet të sjellë njohuri duke e koncentruar kohën nga njohuritë fillestare shkallë-shkallë deri te konkluzioni.³

¹ Shënim: Shkolla 9-vjeçare “Baks Rrjoll” ndodhet në fshatin Rrjoll të njësise Administrative Velipojë (Shkodër). Nga vetë pozita gjeografike shkolla është e vendosur në një zonë turistike dhe një zonë në zhvillim, sepse shumë shpejt aty do të kalojë rruga që lidh Ranën e Hedhun me Ulqinin dhe zonën bregdetare. Ajo kufizohet me lagunën e Vilunit në veri, me malin e Majës së Zezë në jug dhe detin Adriatik në perëndim. Shkolla “Baks-Rrjoll” për herë të parë është hapur në vitin 1957 si shkollë vartëse e shkollës Mali-Kolaj. Në vitin 2000 shkolla “Baks-Rrjoll” u bë shkollë vartëse e shkollës 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”, Velipojë.

² Shefik Osmani, *Fjalori i pedagogjisë*, Tiranë, 1983, f. 306.

³ Kristina Gjoka, Albana Tahiri (Tiranë), “Problemet me mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës shqipe në klasa kolektive, të projektuara në klasat e MPGJSH”, *Shkolla për gjuhën dhe kulturën e atdheut dhe identiteti kombëtar*, nr. 9, Prishtinë,

Në këtë fushë kanë punuar edhe specialistë të tjerë, si: M. Gjokutaj⁴, Nj. Kazazi⁵, B. Rama⁶ etj. Sipas specialistit të arsimit B. Rama: “Për klasën kolektive përmes hulumtimit tonë bibliografik, kemi gjetur disa terma që përcaktojnë atë që emërohet klasë kolektive: klasë me shumë nivele (ose multi), klasë me disa fishtë, e katërfishtë, klasa të kombinuara, klasa të binjakëzuara, klasa shumëvjeçare. Një klasë kolektive është një klasë që kombinon disa klasa (të arsimit bazë për shembull), në të cilën bashkëjetojnë nxënësit të cilët nuk kanë të njëjtën moshë dhe që nuk janë në të njëjtin nivel të nxëni.”⁷

Me mjaft rëndësi është edhe organizimi i punës së mësuesit në klasë. Sidomos për arsimin fillor: “Mësuesit i del për detyrë të bëjë planifikimim të hollësishëm të punës në varësi të temave, qëllimeve, klasës, numrit të nxënësve etj., probleme të cilat kushtëzojnë ecuri të ndryshme didaktike në situata të ndryshme.

Përgjithësisht në shkollën fillore përdoren këto tipe mësimi:

- a. Mësim gjatë të cilit paraqitet lëndë e re në të dyja klasat;
- b. Mësim gjatë të cilit vetëm në njërin klasë paraqitet lëndë e re dhe në klasën tjetër bëhen ushtrime, përforsim a përsëritje etj.;
- c. Mësim gjatë të cilit në asnjërin klasë nuk paraqitet lëndë e re, por bëhen ushtrime, përforsim, përsëritje a kontroll i lëndës së dhënë më parë”⁸.

Që shkollimi me klasa kolektive të jetë i suksesshëm për të siguruar “arsimin për të gjithë” ai duhet të tërheqë dhe të ruajë vijueshmëri të rregullt të të gjithë nxënësve. Kjo ndodh vetëm nëse shkolla me klasa kolektive u jep nxënësve kënaqësi.⁹

Formimi i klasave kolektive bëhet në përputhje me Udhëzimin e MASR-së nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

Një rëndësi të madhe për funksionimin e këtyre klasave merr sigurisht edhe procesi i përgatitjes së mësuesve dhe përditësimi i njohurive të mësuesve sidomos duke u mbështetur në të mësuarit me kompetenca. “Përgatitja e mësuesve të rinj duhet të jetë në koherencë me zbatimin e

⁴ M. Gjokutaj, “Mësimdhënia në klasat kolektive”, *Kurrikula dhe shkolla*, Cikli fillor, 5, Tiranë, 2003; I. Metani, M. Gjokutaj, R. Guci, *Konceptimi dhe organizimi i punës me klasat kolektive*, Tiranë, 2003.

⁵ Nj. Kazazi, “Mësimdhënia në klasat kolektive”, *Gjuha dhe leximi në shkollë*, nr. 1, 2002.

⁶ B. Rama, *Klasat kolektive në shekullin XXI*, Tiranë, 2019

⁷ B. Rama, *Klasat kolektive në shekullin XXI*, Tiranë, 2019, f. 20.

⁸ Nj. Kazazi, I. Hoti, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shkodër, 2016, f. 111.

⁹ *Koncepti dhe organizimi i punës me klasat kolektive*, Save the Children, Tiranë, 2003, f. 12.

kurrikulës me kompetenca në shkollat tona. Ata gjatë përgatitjes së tyre duhet të mësojnë teorikisht dhe të zbatojnë praktikisht parime të tilla, si: zhvillimi i plotë dhe harmonik i fëmijës; ndryshimet individuale të nxënësve; aktivizimin e nxënësve gjatë procesit mësimor dhe zbatimin e metodave zbuluese; integrimin e kurrikulës; rolin dhe rëndësinë që ka mjedisi i cili mbështet të mësuarin etj.”¹⁰

Metodologjia e punës: Të dhëna sasiore ose cilësore nga shkolla

Ky studim ka ndjekur një dizajn përshkrues - korrelacional. Pra, qëllimi është që të njihet situata ekzistuese dhe të ndërtohet një model i mundshëm ndërhyrjeje për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në klasat kolektive dhe të shihen efektet e saj. Jemi të vetëdijshëm se kjo metodë nuk i jep përgjigje çdo pyetjeje të mundshme, por ka vendosur përdorimin e saj nisur nga kushtet aktuale. Fjala është për numrin e kufizuar të shkollave/anekseve shkollore në të cilat ekzistojnë klasa kolektive.

Për këtë shkak është përdorur metoda sasiore. Siç edhe dihet, metoda sasiore e studimit mundëson përgjithësimin e gjetjeve shumë herë më mirë sesa metoda cilësore.

Metodologjia e të dhënave do të bazohet në:

1. Vëzhgimin e vazhdueshëm në klasë dhe mbledhjen e të dhënave përmes instrumentit për mësimdhënie në nivele të ndryshme në të gjitha klasat.
2. Të dhënat e reflektuara nga bisedat formale dhe joformale me mësuesit.
3. Megjithatë, nga ana tjetër, për ta eksploruar më në thellësi dukurinë përpara ndërtimit dhe zbatimit të ndërhyrjes ka qenë e nevojshme të realizohen disa intervista me natyrë cilësore me nxënës dhe mësues.

1. Vëzhgimi i vazhdueshëm në klasë dhe mbledhja e të dhënave përmes instrumentit për mësimdhënie në nivele të ndryshme në të gjitha klasat.

Vëzhgimi i vazhdueshëm në klasë ka si qëllim mbledhjen e të dhënave për metodologjinë e përdorur në orën e mësimit. Gjatë vëzhgimeve të bëra në periudhën mars-dhjetor 2021 kemi vënë re se mësuesit përdorin kryesisht dy grupe metodash, ato me qendër mësuesin (kryesisht *shpjegimin*,

¹⁰ F. Vadohej, “Përgatitja e mësuesve të rinj të arsimit fillor, për të mësuarit me kompetenca”, *Buletini shkencor*, Seria e Shkencave të Edukimit, Shkodër, nr. 68, 2018, f. 11.

demonstrimin, të pyeturit) dhe me qendër nxënësin (*punë me grupe, punë dyshe, tryezën e rrumbullakët, diskutimi* etj). dhe më pak metodat e hulumtimit (si: *loja me role, projekti* etj.). Në disa raste kemi vënë re se i jepet më shumë përparësi mjeteve demonstruese të përgatitura nga mësuesi dhe i lihet pak apo aspak hapësirë atyre që mund të përgatiten nga vetë nxënësit.

Sa i takon teknikave përdoret shpesh teknika që zhvillojnë aftësitë folëse të nxënësve në lëndë të ndryshme, si *stuhi mendimi*; teknika që kanë në qendër të shkruarin, si *tabela e koncepteve, pesëvargëshi*. Por nga ana tjetër nuk kemi ndeshur teknika, si *Diagramën e Venit, Instert* etj.

2. Të dhënat e reflektuara nga bisedat formale dhe joformale me mësuesit.

Nga bisedat formale dhe joformale me mësuesit kemi konstatuar se,

- a) Mësuesit kanë vështirësi në mësime dhe bazuar në projekte.
- b) Mësuesit përdorin në mënyrë efektive metodën e diskutimit.
- c) Mësuesit kanë vështirësi në përdorimin e teknikave, si *Kubimi, Diagrama e Venit* etj.
- d) Mësuesit e ndiejnë të nevojshme përditësimin njohurive sidomos në fushë të metodologjisë së mësimit.

3. Intervista me natyrë cilësore me nxënës dhe mësues.

Kampioni i studimit

Në këtë studim kanë marrë pjesë mësues dhe nxënës të cilët kanë plotësuar instrumentet për të cilat do të flitet më poshtë në mënyrë të detajuar. Përfshirja e dy palëve kryesore në procesin e mësimit dhe të edukimit në përgjithësi mundëson krahasimin e këndvështrimeve të tyre, gjetjen e pikave të përbashkëta dhe dallimeve dhe sa të jetë e mundur përafrimin e tyre përmes gjetjes së zgjidhjeve të ndërmjetme, të kënaqshme për të dyja palët. Nxënësit që kanë plotësuar instrumentin janë nga klasa e dytë deri në klasën e nëntë. Bëhet fjalë gjithsej për 50 nxënës. Duke qenë se bëhet fjalë për një gamë të gjerë moshash dhe rrjedhimisht edhe stadi të ndryshme zhvillimi, fëmijëve nga 7/8-12 vjeç u është dhënë një instrument i caktuar, ndërsa të tjerëve nga 13-15 që kanë hyrë në moshën e adoleshencës dhe e kanë më të sofistikuar të kuptuarin për edukimin, shkollën dhe jetën në tërësi iu është dhënë një instrument i ndryshëm.

Mësuesit e përfshirë në studim janë shtatë, dy femra dhe pesë meshkuj. Shpërndarja gjinore e fëmijëve është gjithashtu e kënaqshme 21 djem dhe 29 vajza. Moshën mesatare është $M_{mes} = 10.1$ vjeç; $DS = 3.21$. Kampioni i plotë është kontaktuar në anekset e shkollave të zonës së Velipojës, më saktësisht në aneksin e Rrjollit që i përket shkollës 9-vjeçare

“Gjergj Vat Martini” dhe anekseve të Reçit të Ri, Luarzit dhe Mal Kolaj, të gjitha anekse të shkollës së mesme të bashkuar “Nikollë Zagorjani”.

Puna me instrumentet

Instrumentet sasiore

Instrumentet sasiore, përndryshe pyetësorët e përdorur janë ndërtuar për këtë qëllim duke qenë se autorët pas procesit të kërkimit nuk kanë mundur të gjejnë instrumente të përshtatshme për këtë qëllim. Pavarësisht se ekzistojnë mjaft instrumente që masin marrëdhënien mes mësuesve dhe nxënësve, të nxënësve, apo klimën në shkollë, klasat kolektive kanë veçori të tilla që e vështirësojnë përdorimin e tyre. Thënë ndryshe, veçoritë e sapopërmendura, pra marrëdhënia mësues - nxënës, të nxënësve dhe klima janë tipike për këto klasa.

Struktura e brendshme

Instrumentet përmbajnë nga 16 pohime të cilat janë ndërtuar si fjali të thjeshta pohore. Për pikëzimin e tyre është ndjekur shkalla Likert që lejon përdorimin e më shumë alternativave. Në këtë instrument janë përdorur tri të tilla, përkatësisht: krejt kundër (1), 50% dakord (2) dhe krejt dakord (3). Kemi arsyetuar në këtë mënyrë, sepse përdorimi i shumë alternativave për fëmijë që më së shumti i përkasin fëmijërisë së mesme (mosha mes. = 10.01 vjeç). Përmbajtja e tyre është e ngjashme nga ana kuptimore, por për të lehtësuar të kuptuarin e fëmijëve ka ndryshime relative leksikore.

Pohimet 4, 9, 13, 14 dhe 16 kodohen në kah të kundërt. Për analizimin e të dhënave është përdorur program SPSS 20.00.

Pilotimi

Për të testuar vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e brendshme të instrumenteve instrumenti është pilotuar fillimisht me nxënës të arsimit fillor në klasat e zakonshme. Ky testim ka qenë i mundur për shkak se pohimet e ndërtuara janë të vlefshme nga ana kuptimore edhe për nxënësit e klasave të zakonshme. Instrumentet u janë shpërndarë 160 nxënësve. Pas testimit rezultoi se $\alpha = .71$ për instrumentin e moshës 7/8 - 12 vjeç dhe $\alpha = .73$ për instrumentin e moshës 13 - 15 vjeç, çka është tregues i besueshmërisë së lartë. Sipas Kronbahut besueshmëria $\geq .50$ i bën instrumentet të përshtatshme për përdorim, ndërsa, $\geq .70$ bën që ato të jenë mëse të përshtatshme.

Përmbajtja e intervistave

Intervista është ndërtuar posaçërisht për këtë studim. Ajo është gjysmë e strukturuar dhe ka si qëllim marrjen e informacionit të thelluar. Në përbërje të saj janë dhjetë pyetje që kanë të bëjnë me përshkrimin e procesit mësimor në klasat kolektive, ndryshimet e mundshme mes mësimin në

klasat e zakonshme dhe në klasat kolektive, vështirësitë specifike të mësimdhënies në klasat kolektive, metoda/t e administrimit të kohës në klasat kolektive, verifikimin e të kuptuarit të nxënësve në klasat kolektive, për ekzistencën e mundësisë, ose jo të të nxënësve në klasat kolektive, për çështjen tejet bashkëkohore të teknologjisë në mësimdhënie dhe mundësitë e përfshirjes së saj në klasat kolektive, drejtimin që duhet të ndjekë rruga për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në klasat kolektive dhe alternativat konkurruese që mund të zëvendësojnë klasat kolektive.

Herë pas here është kërkuar që përgjigjet të ilustrohen me shembuj konkretë për ta bërë përgjigjen më të qartë dhe sa më të lidhur me realitetin.

Analiza cilësore e intervistave

Për analizimin e intervistave është përdorur fenomenologjia interpretative duke qenë se jemi të interesuar më së shumti për veçoritë e një fenomeni faktik, të njohur si të tillë. Në këtë rast interpretimi dhe përshkrimi janë vazhdimësi e natyrshme e njëri-tjetrit duke qenë se çdo studiuues arsyeton dhe interpreton me një masë të caktuar subjektiviteti. Fillimisht janë lexuar intervistat një nga një dhe janë identifikuar temat e mëdha, më pas është bërë integrimi i tyre për të formuar kategoritë interpretative. Interpretimi është bërë duke i bashkëngjitur intervistës së parë kategoritë e dala nga intervistat pasardhëse.

Për të lehtësuar punë dhe për të pasur më shumë saktësi është përdorur programi Weft QDA.

Çështjet etike dhe profesionale

Autorët kanë treguar kujdes të posaçëm për çështjet etike të studimit. Subjekteve pjesëmarrëse u është treguar që në krye të herës qëllimi i studimit, janë siguruar se të dhënat e tyre nuk do të bëhen publike për asnjë arsye dhe u është marrë miratimi për përfshirjen në studim, atyre vetë, ose prindërve të tyre në rastin e fëmijëve nën 12 vjeç. Subjektet janë lejuar të vendosin vetë për pjesëmarrjen ose jo në studim.

Pyetjet kërkimore

Cilat janë aspektet jofunksionale të klasave kolektive në anekset e shkollave publike të arsimit bazë në zonën e Velipojës?

Çfarë ndërhyrjesh praktike mund të ndërmerren me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe klimës në shkollë në këto klasa?

Rezultatet

Rezultatet e analizës cilësore

Nga intervistat me mësuesit kanë dalë katër (3) tema të cilat shtjellohen në

vijim.

Ngarkesa mësimore

Në këtë pikë mësuesit kanë dhënë mjaft informacion, sepse në njëfarë kuptimi është çështja që i prek më drejtpërdrejt se të tjerat edhe sepse kryesisht për shkak të ngarkesës puna u lehtësohet ose vështirësohet.

A. thotë: *“Duhet mbi dhjetë fëmijë në një klasë kolektive që të japin mësim dy mësues në atë klasë. Mund të kesh dhjetë fëmijë dhe nuk sjell dot asnjë mësues tjetër pa u shtuar të paktën edhe një nxënës tjetër”.*

Sipas S. *“Ka qenë më e thjeshtë më përpara. Orari funksiononte ndryshe. Klasat I merrja dy e nga dy, lëndët e dyta e kisha më të thjeshtë t'i bashkoja se më favorizonte ndarja e klasave në lëndët bazë. Prap e kam në dorë ta bëj, por është më vështirë”.*

Nga ajo që merret vesh prej pohimeve të mësipërme edhe pse një mësues i arsimit fillor si në rastin e S-së mund të ketë pesë klasa mësimore (1-5) brenda së njëjtës klasë fizike, nëse numri total i nxënësve është më i vogël se 11, mësuesit janë të detyruar të punojnë të vetëm. Kjo e vështirëson si mësimdhënien ashur edhe mësimnxënien. Askush nuk mund të japë nëse proceset e asimilimit dhe akomodimit të të nxënësve integrohen.

B. shton: *“Për Zotin nuk e mbledh dot mendjen sa duhet. Herë kryefjalën, herë kundrinorin, herë rrethanorin. Njeriu nuk i duron dot në shtëpi 12 vjeçin dhe 15 vjeçin, kur bëhen bashkë nganjëherë. Një ulet, një çohet. Buka e gojës!”*

Pra, nuk është e vështirë të identifikohen dy faktorë që kanë të bëjnë sa me aftësinë e mësuesit për të ruajtur të njëjtin përqendrim dhe të njëjtin angazhim me të gjithë nxënësit dhe më çdo temë nga fillimi deri në fund të mësimimit aq edhe me sasinë e informacionit që nxënësit marrin dhe cilësinë e tij.

Gj. vë në dukje se *“Me fëmijët e vegjël të paktën i merret dora. Sidomos, kur janë pak dhe ua njeh edhe familjet. Krijohet një mjedis pak më i afërt se në shkollat e zakonshme...ç'të them...megjithatë lodhja është më e madhe se e mësuesve në klasat teke...një vit ke katër fëmijë, por vitin tjetër mund të vijnë dhjetë...dhe nuk ta beson njeri!”*

Dëgjimi aktiv mund të shquajë faktin se mësuesi në fjalë është pajtuar me lodhjen në vetvete, faktin në vetvete, por e vuan së brendshmi mosvlerësimin e punës që bën dhe mbase edhe “vështtrimin” mosbesues të tjerëve, ndonëse diçka e tillë nuk del e qartë nga përgjigjja duke mbetur kështu vetëm hamendësim i autorëve.

V. është më interesante për faktin e mospërgjigjes, kur thotë: *“Nuk e di, shihe vetë punën. Si e sheh ashtu është”.*

Vështirësitë teknike

Gj. e fillon kështu përgjigjen e vet *“Më thuaj ti sa kilometra të thotë mendja se kam bërë gjithë jetën deri në punë dhe nga puna në shtëpi dhe deri ku do të kisha mbërritur po t’i kisha bërë për qejf të paktën gjysmën e tyre? Stres i paparë. Ftohtë, shi, borë, bllokohet rruga, hapet rruga, në dimër e në verë në pikë të mëngjesit jemi në makinë”*.

B. ka fjalë të ashpra *“Pash Zotin çfarë punë më thua. Herë prishet makina, herë ndërron orari, herë nuk ka makinë fare dhe bën nuk di sesa kilometra në këmbë. Çfarë pune mund të bëj unë, kur të mbërrij në shkollë?”*

E. sheh në perspektivë, kur shprehet: *“Mësuesit janë njerëz. Si njerëz kanë nevojë ‘t’i karikojnë bateritë’, kur u shkarkohen, mirëpo nëse nuk u lë kohë, nuk ke as çfarë të presësh në rezultate, në asnjë drejtim. Një mësuesi që bën pesë ditare dhe i kërkohet llogari njësoj si mësuesit që bën një ditare duhet t’i durosh edhe frustrimet edhe shpërthimet. Njerëz janë. Rutina është e mirë, por, kur nuk ndryshon kurrë bëhet e lodhshme. Kur vetë rutina është stresuese përveçse e palëvizshme merre me mend fundin”*.

Në këndvështrimin e S.-së edhe vendndodhja e shkollës ka të bëjë. *“Një gjë është transporti i detyrueshëm, një gjë tjetër që shkollat të ndërtohen larg komuniteteve të banuara siç është rasti ynë”*.

F. ka vërejtur dy elemente të tjera që i sjell në fokus. Së pari, hapësirën fizike të klasave dhe së dyti mungesën e internetit dhe të teknologjisë. *“Në kushtet e sotme mungesa e teknologjisë e bën mësimdhënien dhe mësimnxënien të duken të vjetëruara, aspak në përputhje me nevojat bashkëkohore. Është një dukuri pak a shumë e ngjashme me diçka që në psikologji njihet si ‘përmbushja e profecisë vetjake’. Pra, përveç vështirësive faktike edhe besimi i brendshëm që vendi nuk është i përshatshëm çon drejt mosshfrytëzimit të vazhdueshëm të atyre mundësive që mund të shtojnë shanset për rezultate më të mira dhe komoditet më të madh personal në punë”*.

Rëndësia e kushteve të mira të punës është botërisht e njohur. Thënë drejt, shkollat vetë kanë burime mëse të limituara financiare. Shto këtu edhe faktin se duke qenë shkolla të vogla dhe periferike vëmendja e drejtuesve të zyrave/drejtorive rajonale arsimore përqendrohet më shumë te shkollat më të mëdha e më problematike problemet e mësipërme mbeten thuhet përherë pa zgjidhje. Mungesa e internetit kufizon mjaft edhe kufizim në aftësimin e asaj që njihet si kompetencë digjitale, por edhe krijon pamundësinë e përdorimit të disa teknikave që e kanë bazën tek teknologjia.

Autori është i ndërgjegjshëm për faktin se drejtuesit dhe mësuesit pak mund të bëjnë në drejtim të përmirësimit të problematikave të përfshira në temën

e dytë.

S. në mendjen e vet ka përshtatur edhe një zgjidhje alternative: *“Më mirë do të ishte sikur mësuesi të shkonte në shtëpinë e nxënësve, sepse detyrimisht do të kishte më pak fëmijë nën kujdesin e vet dhe më shumë fleksibilitet oraresh dhe lëvizjeje”*.

Në fakt, një zgjidhje e tillë nuk do të ishte unike, sepse ekziston edhe në vende të tjera, por është e qartë se në vendin tonë nuk është marrë në konsideratë.

E ardhmja e klasave kolektive

Sipas E. *“Për sa kohë politikat arsimore të vazhdojnë të jenë të njëjtat, kryesisht investimi në çdo dimension të arsimit edhe klasat kolektive aty do vazhdojnë të jenë”*.

Ndërsa ajo që vë në dukje S. është se *“emigracioni ka prishur punë edhe për shkollat. Edhe në këtu e ndiejmë. Mirë që klasat hapen edhe më pak fëmijë se vështirë do ta kishim. Puna si punë është parësore me dhe pa vështirësi”*.

I njëjti mësues shton edhe se *“[klasat kolektive] drejt zhdukjes janë. D’ i dalë fundi se s’bën. Është jashtë çdo mode kjo punë kështu”*.

Siç vërehet qëndrimet janë kontradiktore përse i përket hapave të mëvonshëm në lidhje me klasat kolektive. Mësuesit nuk kanë mospërputhje idesh për faktin se klasat kolektive si metodë kanë më pak rezultate se ato të zakonshme, por në mënyrë të tërthortë shprehin dy gjëra: (1) besimin se asgjë nuk varet nga fjalët që ato thonë dhe (2) shqetësimin se mbyllja e tyre do të sjellë papunësi dhe paqëndrueshmëri financiare për ta. Këto pohime janë në vazhden a tyre të dala nga tri temat e para. Nga ana tjetër ato shprehin edhe një fakt thelbësor dhe shqetësues për komunitetin e nxënësve dhe të prindërve: shqetësimi parësor në mos ekskluziv është puna si e tillë. Megjithëse ky është një shqetësim i respektueshëm përmasa në të cilin shfaqet lë në hije shqetësime të ndjeshme për nxënësit dhe prindërit që lidhen me formën, përmbajtjen dhe rrjedhimisht me cilësinë e arsimit, në këtë rast në klasat kolektive.

Rezultatet e analizës sasiore

Tabela 1 Të dhëna përshkruese për gjininë / instrumenti për nxënësit

Variablet	Frekuenca	Përqindja %
<i>Gjinia</i>		
Femra	17	54.83

Meshkuj	14	45.16
---------	----	-------

Tabela më sipër është shpjeguese e variabilitetit gjinor të fëmijët 7-8 deri në 12 vjeç. Siç vihet re shpërndarja është e përafërt çka jep një panoramë të qartë për të dyja gjinitë.

Tabela 2 Të dhëna përshkruese për gjininë / instrumenti për nxënësit e AF.

Variablet	Frekuenca	Përqindja %
<i>Gjinia</i>		
Femra	11	57.89
Meshkuj	8	42.1

Tabela e dytë ka të njëjtin funksion, por është tregues i shpërndarjes gjinore të të rinjve 13- 15 vjeç që e kanë plotësuar instrumentin. Edhe këtu shpërndarja është e kënaqshme, por numri më i vogël sesa në grupmoshën pararendëse.

Tabela 3 Të dhëna përshkruese për moshën - instrumenti për fëmijët 7 - 12 vjeç.

Variabli	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Mosha	1	6	3.87	2.39

Një tabelë e ngjashme është ajo e mësipërmja me numrin 3 e cila shpjegon variabilitetin moshor të fëmijët 7-12 vjeç. Vihet re se devijimi standard është i kënaqshëm çka flet edhe për një shpërndarje të mirë brenda grupmoshës.

Tabela 4 Të dhëna përshkruese për moshën / instrumenti për fëmijët 13 - 15 vjeç.

Variabli	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Mosha	1	3	2.79	3.21

Edhe në grupmoshën e fëmijëve pak më të rritur mesatarja dhe devijimi standard dëshmojnë se shpërndarja brenda grupmoshës është e kënaqshme.

Tabela 5 Struktura e brendshme e instrumenteve.

Emërtimi i shkallës	Nr. i pohimeve
Mësimnxënien në klasë	1, 2, 3, 4, 9, 10, 11, 13, 15, 16
Klima në klasë dhe marrëdhënia me mësuesit	5, 6, 7, 8, 12, 14

Tabela e 5-të tregon strukturën e brendshme të instrumenteve. Saktësojmë këtu se të dy instrumentet kanë të njëjtën strukturë. Përbëhen nga dy shkallë matëse që kanë në fokus mësimnxënien nga ana e nxënësve dhe

marrëdhënien e tyre me nxënësit sikurse edhe klimën e klasës si e tërë.

Tabela 6 Mesatarja, devijimi standard, rezultatet minimale dhe maksimale të shkallëve të dy instrumenteve.

Emërtimi i shkallëve	Mesatarja	Devijimi standard	Minimumi	Maksimumi
Mësimnxënia në klasë	18	2.31	9	27
Klima në klasë dhe marrëdhënia me mësuesit	12	2.74	6	18

Më sipër shpjegohen vlerat minimale dhe maksimale, mesatarja e pohimeve të instrumenteve dhe devijimi standard për shkallët.

Tabela 7 Besueshmëria e instrumentit për fëmijët 7/8 – 12 vjeç.

Emërtimi i instrumentit	(Alfa) Shkalla e besueshmërisë
Mësimnxënia në klasë	.67
Klima në klasë dhe marrëdhënia me mësuesit	.61

Shkallët e instrumentit kanë besueshmëri të kënaqshme, pothuajse optimale. Shkalla e mësimnxënies duket se ka qëndrueshmëri më të mirë se tjetra. Ndërkaq besueshmëria e instrumentit të plotë në fazën e aplikimit të subjektet e 7-12 vjeç ka qenë .63, më e ulët se në fazën e pilotimit çka mund të shpjegohet me numrin më të ulët të subjekteve që e kanë plotësuar.

Tabela 8 Besueshmëria e instrumentit për fëmijët 13 – 15 vjeç.

Emërtimi i instrumentit	(Alfa) Shkalla e besueshmërisë
Mësimnxënia në klasë	.65
Klima në klasë dhe marrëdhënia me mësuesit	.60

Edhe koeficienti i besueshmërisë i instrumentit të dytë ka rezultate të ngjashme me pararendësin. Aplikimi në numër të vogël subjektësh që kanë shërbyer si kampion për grupmoshën 13-15 vjeç është shkaku i rezultatit më të ulët. Ndërkaq, besueshmëria e instrumentit të plotë është .59.

Analiza e fundit sasiore, por padyshim analiza kryesore dhe më e rëndësishmja është ajo e korrelimit të faktorëve.

Në instrumentin e parë, atë për fëmijët 7/8 - 12 vjeç, korrelimi mes mësimnxënies në klasë dhe klimes në klasë & marrëdhënies me mësuesit është $r = .41$; $p < .01$.

Ndërkaq në instrumentin e dytë të aplikuar te fëmijët 13 - 15 vjeç, marrëdhënia mes këtyre dimensioneve është $r = .37; p < .01$.

Siç vihet re marrëdhënia është sinjifikative nga ana statistikore në të dyja rastet. Falë analizës së korrelacionit është mundësuar gjetja e marrëdhënies mes variableve çka lejon të kihet një ide më e mirë për mënyrën e ndërtimit të ndërhyrjes së studimit. Duke ditur çfarë marrëdhënieje ekziston mes variablave mund të krijohet qartësi për elementet që do të përfshihen në ndërhyrje dhe rëndësinë që do t'i kushtohet rolit të secilit.

PËRFUNDIME

Gjatë punës së bërë për realizimin e këtij studimi kemi arritur disa përfundime:

- Mësimdhënia në klasa kolektive është një mësimdhënie specifike e cila përfshin nxënës të moshave të ndryshme dhe sigurisht me formim dhe aftësi të ndryshme.
- Klasat kolektive në ato zona që mund të jenë të izoluara dhe me largësi nga qendra duhet të ekszitojnë, por duhen përmirësuar disa anë të punës me këto klasa.
- Ngritja dhe funksionimi i klasave kolektive është regulluar më mirë me bazën ligjore, ku mund të përmendim Udhëzimin nr. 30 i MASR-së, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Gjatë literaturës së konsultuar kemi ndeshur edhe me raste të punës me klasa kolektive edhe në vende të tjera, por gjatë vëzhgimeve të bëra kemi vënë re se mësuesit kanë vështirësi në përdorimin e një metodologjie bashkëkohore dhe shpesh mbesin në një numër të reduktuar metodash.
- Praktikrat që përdorin mësuesit mendojmë se duhet të bazohen më shumë në frymën e grupit dhe më pak individuale.
- Mësuesit përdorin pak ose aspak teknologjinë gjatë orës së mësimi. Kjo praktikë do ta ndihmonte shumë si mësuesin ashtu edhe nxënësit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së pajisjeve të tilla në shkollë, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme që janë bërë për sigurimin e domosodshëm të bazës materiale.
- Strukturat përgjegjëse duhet të mbështesin mësimdhënien në klasat kolektive për funksionimin e tyre edhe në të ardhmen.

REKOMANDIME**Rekomandime të përgjithshme**

- Investimi në hapësirat fizike të klasave është urgjent dhe kërkon shtimin e numrit të klasave ose zmadhimin e tyre nga njëra anë dhe pajisjen e tyre me mjete bashkëkohore të mësimdhënies.
- Do të ishte e arsyeshme që platforma e TVSH-së “Shkolla ime”, televizioni publik kombëtar, në një prej kanaleve të tij të kishte orë mësimore që përkojnë me planin vjetor mësimor për klasat kolektive.
- Mendojmë se është detyrë e universiteteve t’i trajtojnë me përparësi problemet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies me këto klasa në didaktikat e lëndëve të ndryshme mësimore.
- Kualifikim i veçantë i mësuesve që punojnë me klasa kolektive me module të veçanta për këtë kategori mësuesish.
- Rekomandojmë këtë plan veprimi me 4 module për mësuesit që punojnë me klasa kolektive:

Moduli I

Grupet heterogjene në klasë (4 orë – 1, 1, 2)

1. Çfarë janë grupet heterogjene.
2. Shpërndarja e punës dhe kohës në grupet heterogjene.
3. Karakteristikat e grupeve heterogjene. Balanca mes fokusit individual dhe atij grupor.

Moduli II

Edukimi multikulturor (4 orë – 1, 3)

1. Shpjegimi i rëndësisë së përcjelljes së informacionit të paanshëm dhe në sasi të njëjtë.
2. Rëndësia e orëve të veçanta dhe vëmendjes së përgjithshme mbi rolin e artit, lojës dhe trashëgmisë kulturore.

Moduli III

Shkathtësitë për jetën (10 orë)

1. Eksplorimi i kuptimit të pjesëmarrësve për shkathtësitë e jetës që përmenden në vijim.
2. Njohja e veçorive universale të këtyre shkathtësive.
3. Njohja e vështirësive jetësore të fëmijëve që mund të ndikojnë në brendësimin më të madh ose më të vogël të tyre.
4. Vendimmartja dhe zgjidhja e problemeve në klasë.
5. Të menduarit krijues.
6. Dëgjimi aktiv.
7. Vetëdërgjegjësimi.
8. Këndvështrimi nga perspektiva e tjetrit.

9. Asertiviteti
10. Aftësitë ripërtëritëse.

Moduli IV

Personalizimi i të nxënit (4 orë)

1. Metoda dhe teknika për njohjen e karakteristikave të nxënësve.
2. Fokusimi tek interesat e tyre dhe grupimi efektiv.
3. Ndihma që nxënësit të vendosin qëllime të arsyeshme dhe të arritshme.
4. Përdorimi i burimeve alternative në masën dhe mënyrën e mundshme.

Rekomandime për mësuesit

Pas trajtimit teorik dhe evidentimeve e gjetjeve gjatë vëzhgimeve kemi arritur në disa rekomandime për mësuesit:

- Mësimin mund ta zhvilloni me të gjitha klasat së bashku. Ju mund të vendosni vetë veprimtaritë e përbashkëta dhe veprimtaritë me klasa të ndara. Jepini mësimin njëerës klasë, ndërkohë që të tjerët punojnë në mënyrë të pavarur. Për disa veprimtari, mund t'i caktoni nxënësit e klasave më të larta të punojnë me nxënësit e klasave më të ulëta, në mënyrë që të nxënë më shumë, të nxënë së bashku duke krijuar ndjesinë e solidaritetit në klasë. Në këtë mënyrë nxënësit e klasave më të larta mund të luajnë rolin e ekspertit, sidomos për lëndë që kanë ushtrime, si matematikë, gjuhë etj.
- Ndajini nxënësit në grupe sa më heterogjene sipas aftësive, moshës, nivelit, prirjeve etj. Kjo do t'u japë mundësinë nxënësve që të përmirësojnë arritjet e tyre, të zhvillojnë aftësitë sociale dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.
- Lidhni mësimin me situata të jetës së përditshme. Nxënësit e kuptojnë një koncept të caktuar më qartë nëse e lidhni atë me jetën e përditshme, traditat dhe kulturën e tyre. Për shembull, në gjuhë konceptimin e emrit mund ta filloni me një pezantim të përbashkët për të gjitha klasat II-V. Kjo mund të realizohet duke nisur me emërtimin e fshatit (Baks-Rrjodh), qendrës (Velipojë), qytetit (Shkodër), apo sendeve e objekteve që ata ia kanë pjesë të jetës së përditshme, si: *deti, peshku, dallga, rëra* etj. Mund të lexohen pjesë nga tregime me qendër zonat bregdetare, krijime të tyre etj., mund të bëhet lojë me role etj.
- Përshtateni programin lëndor në kontekstin e komunitetit ku jepni mësim dhe atë të klasës suaj. Zbatoheni programin në mënyrë sa më fleksibël, duke përdorur një sërë strategjish të mësimdhënies dhe të

menaxhimit të klasës sipas rrethanave të ndryshme, stileve të të nxënit dhe nevojave individuale të nxënësve.

- Mbani në vëmendje diversitetin e nxënësve, sipas gjinisë, moshës, familjes, rrethanave socio-ekonomike, gjuhës, aftësive dhe nevojave të veçanta. Në këtë mënyrë diversiteti do të mund të shfrytëzohet si instrument për ta përmirësuar të nxënit dhe nuk do të jetë aspak një problem.
- Krijoni një mënyrë tuajën individuale të mësimdhënies duke iu përshtatur rrethanave, mënyrave dhe nevojave të ndryshme të të nxënit të secilit nxënës. Kjo gjë fillon që me identifikimin e hershëm të nxënësve, të cilët rrezikojnë të ngelin dhe pasohet me ofrimin e ndihmës dhe vëmendjes së veçantë duke u siguruar që do t'ia dalin me sukses dhe të mos shkojnë deri në braktisjen e shkollës.
- Krijoni një mjedis tërheqës për nxënësit, që të ketë jo vetëm materialet e domosdoshme, por edhe të ketë një klimë mikpritëse, një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt.
- Krijoni një klimë miqësore dhe bashkëpunuese me të gjithë fëmijët në klasën kolektive. Kështu mund të organizoni veprimtari duke i përzier nxënësit e klasave të ndryshme, duke krijuar grupe të mëdha dhe të vogla, por duke lënë hapësirë për punë individuale.
- Bëhuni fleksibël me kohën, duke kaluar nga një grup te një grup një tjetër. Duhet të ekuilibroni vëmendjen mes nxënësve me arritje të mira, që mund t'i keni caktuar si ndihmës dhe nxënësve me arritje më të ulëta, të cilët kanë nevojë për më shumë vëmendje.
- Përfshini në procesin e nxënies burime të tjera që keni, si: stafin drejtues, kolegët, prindërit, komunitetin vendor dhe rrjetin profesional (me anëtarët e të cilit mund të ndani përvoja të dobishme, mund të shkëmbeni materiale dhe plane mësimore).
- Zhvilloni aftësi të tjera të nevojshme për të ndihmuar një shkollë të vogël dhe të largët që të ketë sukses. Mësimdhënia në klasat kolektive është një sfidë në vetvete, por puna me kolegët për ta bërë shkollën tuaj të vogël të suksesshme, kërkon edhe aftësi të tjera, si: t'ia dalësh me burime të kufizuara dhe të përpiqesh të mbledhësh sa më shumë të tjera; të kryesh vetëvlerësimin e shkollës për arritjet dhe nevojat e saj dhe të hartosh një plan për përmirësimin e shkollës; të keni përkrahjen e prindërve të varfër dhe shpesh të pafuqishëm dhe të paiterësuar; dhe të gëzosh mbështetjen e drejtuesve të komunitetit vendor. Të gjitha këto janë aftësi të dobishme në shkollat me klasa kolektive.

BIBLIOGRAFI

- *Koncepti dhe organizimi i punës me klasat kolektive*, Save the Children, Tiranë 2003.
- GJOKA Kristina - TAHIRI, Albana, “Problemet me mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës shqipe në klasa kolektive, të projektuara në klasat e MPGJSH”, *Shkolla për gjuhën dhe kulturën e atdheut dhe identiteti kombëtar*, nr. 9, Prishtinë, korrik, 2014.
- GJOKUTAJ, Mimoza, “Mësimdhënia në klasat kolektive”, *Kurrikula dhe shkolla*, Cikli fillor, 5, Tiranë, 2003.
- KARAMETA, Pëllumb, *Drejtimi dhe menaxhimi i shkollës*, Tiranë 2016.
- KAZAZI, Njazi, “Mësimdhënia në klasat kolektive”, *Gjuha dhe leximi në shkollë*, nr. 1, 2002.
- KAZAZI, Njazi- HOTI, Irida, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shkodër, 2016.
- METANI, I.,- GJOKUTAJ, M., - GUCI, R., *Konceptimi dhe organizimi i punës me klasat kolektive*, Tiranë, 2003.
- OSMANI, Shefik, *Fjalori i pedagogjisë*, Tiranë, 1983.
- RAMA, Besnik, *Klasat kolektive në shekullin XXI*, Tiranë, 2019.
- VADOHEJ, Fatmir, “Përgatitja e mësuesve të rinj të arsimit fillor, për të mësuarit me kompetenca”, *Buletini shkencor*, Seria e Shkencave të Edukimit, Shkodër, nr. 68, 2018.
- Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar për periudhën 2014-2020.
https://arsimi.gov.al/epcontent/uploads/2018/07/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015-1.pdf
- Udhëzim nr. 30 i MASR-së, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Udhëzim nr. 14 datë 28.07.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

BOTIME

Në muajin prill 2021 u botua Udhëzuesi “*Roli i psikologut në polici*”, Tiranë, me autorë: dr. Valbona Treska, prof. as. dr.Fatbardha Osmanaga dhe dr.Skerdi Zahaj, udhëzues i përbashkët nga Pameca V, Urdhri i Psikologut dhe Policia e Shtetit. Ky botim u prodhua me mbështetjen finaciare të Bashkimit Evropian.



Titulli: *Udhëzues-Roli i psikologut në polici.*

Autorë: Dr.Valbona Treska,
prof.as.dr.Fatbardha Osmanaga,
dr.Skerdi Zaha.

Përmbajtja

Hyrje

Historik i shkurtër i psikologut në polici.

Kapitulli I. Fusha e kompetencës bazuar në detyrat funksionale.

Kapitulli II. Kodi i drejtësisë penale për të mitur.

Kapitulli III. Kodi i etikës dhe deontologjisë i Urdhrit të Psikologut në Shqipëri.

Kapitulli IV. Vlerësimi.

Kapitulli V. Trajtimi.

Referencat.

ISSN 2221 – 6863

*Doli nga shtypi korrik, 2022 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*